



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

NGA SEANCA PLENARE E KUVENDIT TË KOSOVËS, TË MBAJTUR MË
18 DHE 21 PRILL 2008

SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE KOSOVA, ODRŽANE
18. I 21. APRILA 2008. GODINE

Prill – April
2008

R e n d i i d i t ë s:

1. Fjala e Presidentit të Republikës së Kosovës lidhur me gjendjen e përgjithshme në vend,
2. Informata për punën 100 ditëshe të Qeverisë së Republikës së Kosovës,
3. Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës për periudhën 2008-2011.

D n e v n i r e d:

1. Reč predsednika Republike Kosova u vezi sa ukupnim stanjem u zemlji,
2. Informacija o 100 dnevnom radu Vlade Republike Kosova,
3. Program Vlade Republike Kosova za period od 2008.-2011. godine.

Agenda

1. Speech of the President of Republic of Kosovo regarding overall situation in the country,
2. Information on 100 days work of the Government of Republic of Kosovo,
3. Program of Government of Republic of Kosovo for period 2008-2011.

Seanca filloi punën në orën 11,00

Seancën e drejtoi zoti **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

KRYETARI I KUVENDIT: Të nderuar deputetë,

I nderuar, zoti President i Republikës së Kosovës, Fatmir Sejdiu,

I nderuari Kryeministër, Hashim Thaçi,

Të nderuar zëvendëskryeministra,

Të nderuar ministra,

Të nderuar përfaqësues të zyrave diplomatike,

Mirë se keni ardhur në seancën e sotme plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës!

Konstatohet se në sallë janë të pranishëm 108 deputetë, prandaj janë plotësuar kushtet për ta filluar punën sipas rendit të ditës, të cilin e kemi marrë me kohë.

Të nderuar deputetë, u njoftoj se, në pajtim me Kreun 9, pika 2.4 të Kornizës Kushtetuese, Presidenti i Republikës së Kosovës, zoti Fatmir Sejdiu, ka kërkuar që para deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës të mbajë fjalim për gjendjen e përgjithshme në Kosovë.

Prandaj, ftoj Presidentin e Republikës së Kosovës, zotin Fatmir Sejdiu që t'iu drejtohet deputetëve.

Foltorja është e juaja, zoti President!

(Duartrokitje)

PRESIDENTI, FATMIR SEJDIU: Faleminderit!

I nderuari, Kryetar i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi,

I nderuari, Kryeministër, zoti Hashim Thaçi,

Të nderuar përfaqësues të Misionit Civil Ndërkombëtar të UNMIK-ut dhe përfaqësues të misionëve diplomatike,

Të nderuar zëvendëskryeministra dhe ministra,

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Qytetarë të dashur të Republikës,

Zonja dhe zotërinj,

Jam paraqitur para këtij institucioni të lartë disa herë gjatë këtyre dy vjetëve si President i Kosovës dhe udhëheqës i Ekipit të Unitetit, i ngarkuar me punën e finalizimit të procesit për përcaktim të statusit, që duhej të përfundonte, siç u krye, me pavarësimin përfundimtar të Kosovës.

Kam nderin e veçantë që sot t'i drejtohem Kuvendit dhe, përmes këtij forumi të lartë, juve qytetarë të dashur të Kosovës, me një fjalë për gjendjen e përgjithshme në vend dhe për synimet strategjike të vendit tonë, sidomos për çështjet që lidhen me fushëveprimtarinë e Presidentit.

Data e 17 shkurtit të vitit 2008 do të hyjë në historinë e Kosovës e të botës si Dita e Pavarësisë së vendit tonë. Tash, dy muaj pas, mbasi që kemi kryer punët që lidhen me institucionalizimin ligjor të pavarësisë, në radhë të parë me miratimin e Kushtetutës së Republikës në fillim të këtij muaji, mund të themi se Kosova është shtet që ka lindur mbarë.

Republikën e Kosovës e shpallëm pas një procesi të gjatë ndërkombëtar për përcaktimin e statusit, në pajtim me vullnetin e shumicës së popullit të Kosovës, në përputhje me rekomandimet e Emisarit Ndërkombëtar të Statusit, Presidentit Marti Ahtisari, në koordinimin me miqtë dhe aleatët e Kosovës, në radhë të parë me Unionin Evropian dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Republika e Kosovës është përqafuar gjerësisht nga bota demokratike. Pavarësia jonë është njohur nga 37 vende, duke përfshirë edhe 7 nga 8 vendet e G8-shit. Vendi ynë pret njohje nga shumë vende të tjera. Kjo siguron bazën e rëndësishme për të mbështetur inkuadrimin tonë në sistemin ndërkombëtar. Integrimi ynë në strukturat Euroatlantike

është prioritet mbi të gjithë të tjerët. Për të hyrë në Bashkimin Evropian dhe në NATO na duhet njohja e të gjitha vendeve anëtare të këtyre institucioneve dhe plotësimi i kriterëve për anëtarësim në të dyja organizatat. Kjo merr kohë, por është pikësynimi me rëndësinë jetike për ekzistencën tonë.

Me dekada, breza të tërë veprimtarësh shqiptarë punuan për ta zgjidhur çështjen e Kosovës. Ishin këto përkushtime e sakrifica të pandërprera dhe më sublimë të mundshme. Personalitete të shumta, përgjatë dekadave, u pushkatuan apo vuajtën në burgje të rënda dhe afatgjata.

Projekti i pavarësisë së Kosovës si zgjidhje për çështjen e Kosovës u maturua në 18 vjetët e shkuara, para se të kurorëzohej me Deklaratën e Pavarësisë më 17 shkurt të vitit 2008. Ideja është e para, thoshte Platoni, filozofi i shtetit ideal. Ideja e shtetit të pavarur të Kosovës ka lindur, është kultivuar dhe është ndërtuar gjatë rezistencës së përgjithshme politike e institucionale të udhëhequr nga Presidenti Ibrahim Rugova në dekadën e fundit të shekullit të kaluar. Komplementare me këtë ide, pjesë e saj dhe e luftës politike, ka qenë lufta e armatosur e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në fund të shekullit, që lidhet me komandantin Adem Jashari dhe me shumë luftëtarë të lirisë anekënd Kosovës. Nëntë vjetët e rezistencës politiko-ushtarake 1990-1999 dhe nëntë vjetët e rimëkëmbjes fillestare të vendit tonë në rrethana të lirisë 1999-2008 kanë krijuar Republikën e Kosovës që e kemi sot.

Në pranverën e vitit 1999, Aleanca Veriatlantike NATO, lidhja më e fuqishme politiko-ushtarake në historinë e njerëzimit, u vu në mbrojtje të vlerave humane: kundër barbarisë dhe përpjekjes për shfarosje të popullit të Kosovës. Populli i Kosovës do të jetë përherë mirënjohës për këtë ndërhyrje që i dha fund barbarisë dhe solli paqen në vendin tonë dhe në rajon. Kjo ishte luftë në shërbim të paqes. Kjo ishte një luftë për lirinë njerëzore si vlerë fundamentale, por edhe për shpëtimin e një populli të tërë.

Të nderuar deputetë,

Të dashur qytetarë të Kosovës,

Shfrytëzojmë rastin që në emrin e shtetit të Kosovës t'u shprehim mirënjohjen më të thellë të gjithë atyre që derdhën gjak e djersë dhe dije për pavarësinë e Kosovës.

Një nderim të veçantë meritojnë të gjitha legjislaturat dhe qeveritë e Kosovës të këtyre 18 vjetëve, organizimet politike e strukturimet vetanake shtetërore brenda vendit tonë, si dhe diaspora jonë e madhe, që kanë punuar me zell e këmbëngulje të pashembullt, por edhe sistem e disiplinë shembullore për shtetin tonë.

Ju, deputetë të legjislaturës aktuale, sikur edhe ne, udhëheqësit më të lartë të vendit, kemi pasur fatin historik të firmosim pavarësinë e Kosovës, të krijuar dhe të ndërtuar nga dhjetëra mijëra, qindra-mijëra njerëz të mirë të Kosovës, heronj të kënduar e të pakënduar, shqiptarë dhe pjesëtarë të komuniteteve pakicë.

Republika e Kosovës është atdheu ynë: i të gjithëve pa dallim. Kosova ka bërë vendin e vet në hartën politike të botës dhe donë të rrethohet me fqinjë miqësorë. Ne duam të kultivojmë marrëdhënie të mira e miqësore me të gjitha vendet, në radhë të parë me fqinjët tanë të parë: me Maqedoninë, Shqipërinë, Malin e Zi dhe Serbinë, me vendet e rajonit dhe të Evropës, ku ne bëjmë pjesë gjeografikisht e kulturalisht. Kosova është njohur në të vërtetë nga vende nga të gjitha kontinentet e botës dhe kjo na gëzon pa masë.

Tash, që jemi shtet i pavarur dhe sovran, kemi mundësinë ta drejtojmë Kosovën në rrugën e zhvillimit strategjik, që ka qenë i vështirë, nëse jo i pamundshëm, në gjendjen e statusit të papërcaktuar.

Pasuritë natyrore dhe popullsia e re - janë potenciale të zhvillimit të Kosovës në afat të gjatë. Zhvillimi i plotë i tyre bëhet i mundshëm tash që kemi një Qeveri sovranë, jo të përkohshme. Me Qeveri të përkohshme, me idenë e përkohësisë e të gjendjes pezull, nuk ka zhvillim të njëmendtë ekonomik e shoqëror. Këtë e vërteton historia jonë e dekadës së fundit, e rimëkëmbjes fillestare nga shkretimi fizik e shpirtëror që kishte sjellë okupimi dhe mizoria e agresionit serb.

Rimëkëmbja e plotë, rilindja e vërtetë e Kosovës mundet dhe duhet të ndodhë duke vënë në lëvizje potencialet njerëzore, duke ndërtuar institucione demokratike e plotësisht funksionale, duke ndërtuar ekonomi dhe rrjet arsimor e shëndetësor të qëndrueshëm. Vlerësoj se për prosperitetin e vendit tonë shkalla prej 3-4% e rritjes ekonomike për vit, siç mendohet se është aktualisht, është e pamjaftueshme. Na duhet dyfishimi i kësaj shkalle të rritjes në vitet e ardhshme. Shpresoj se Konferenca ndërkombëtare e Donatorëve për Kosovën, që do të mbahet pas disa muajsh, do të japë impulsin e parë për vitin e ardhshëm dhe tutje.

Kapacitetet e Qeverisë sonë, e institucioneve qendrore dhe lokale të pushtetit, janë me rëndësi kapitale për optimalizimin e donacioneve që do të zotohen dhe jepen, duke i vënë në funksion të projekteve prioritare ekonomike e infrastrukture.

Fushat strategjike ekonomike që kërkojnë vëmendjen dhe përkushtimin prioritar të shtetit tonë janë energjetika dhe agrikultura. E para kërkon investime të mëdha, por nuk siguron punësim të madh. E dyta investim të konsiderueshëm për punësim të konsiderueshëm dhe ruajtje të balancit jetësor e social. Energjia siguron bazën për qëndrueshmëri ekonomike dhe sociale të vendit, ndërsa agrikultura komplementaritetin e zhvillimit ekonomik, që është neglizhuar në kohët e fundit. Kjo nuk do të thotë që të lihen anash fushëveprimtaritë e tjera, që janë në interesin jetik për qytetarët e Kosovës.

Regjistrimi i pritshëm i popullsisë dhe i ekonomive familjare të Kosovës do të sigurojë pasqyrë të plotë statistikore, kuantitative dhe kualitative për drejtimet strategjike që duhet të marrë zhvillimi i Republikës së Kosovës.

Duke pasur një popullsi të re, rimëkëmbja e sistemit arsimor bëhet për ne çështje me rëndësi thelbësore, që prek indin më të shëndoshë të qenies sonë. Shoqëritë më të zhvilluara se ne, ndonëse me burime më pak të pasura natyrore, kanë dalë prej stagnimit në prosperitet duke vënë në jetë masa gjithëpërfshirëse për arsimin, duke kthyer shkollimin cilësor në të gjitha nivelet në orientim strategjik dhe nacional. Investimi këtu është afatgjatë. Ngjashëm edhe për sistemin shëndetësor, shumë i kushtueshëm sot kudo në botë.

Punonjësit e arsimit dhe të shëndetësisë të Kosovës duhet të nxirren prej kategorisë së shërbyesve civilë, ku bien aktualisht, për të krijuar mundësinë e diversifikimit dhe të konkurrencës së shërbimeve në rrethana të ekonomisë së tregut. Këtu, gjithsesi, roli i shtetit është i pazëvendësueshëm si garantues dhe rregullator i sistemit, por assesi si frenues i iniciativës së lirë dhe kreative në emër të egalitetit që parasupozon për shumëkënd nocioni i pjesëtarit të shërbimit civil, një nocion rudimentar sot për sot në vendin tonë.

Është koha që të vihet rend në arsimin e lartë, duke aplikuar kritere të pranuar ndërkombëtare për akreditimin e institucioneve. Universitetet nuk guxojnë të shndërrohen në biznese fitimprurëse. Ato duhet të gjenerojnë dije, jo para. Duhet të synohet cilësia, duhet të stimulohet dija e kërkimi në fushat me interes nacional dhe në shkencat fundamentale, edhe kur kjo nuk duket se është kërkesë e tregut të punës. Elitat në këto fusha duhet të ndihmohen prej shtetit.

Me interes të veçantë është të mbështetet bashkëpunimi ndërmjet institucioneve universitare dhe shkencore të Kosovës me institucionet homologe në vendet e Bashkimit Evropian dhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Kultura e kërkon gjithashtu gjithë kujdesin që mund të japë shteti ynë. Promovimi i kulturës materiale dhe shpirtërore të vendit tonë i ndihmon krijimit të identitetit vetanak dhe të dallueshëm të Kosovës.

Të nderuar deputetë,

Të dashur qytetarë të Republikës,

Viti i kaluar dhe fillimviti i sivjem kanë shënuar përtëritjen demokratike që mundëson procesi zgjedhor. Zgjedhjet nacionale dhe lokale të nëntorit të vitit 2007 kanë sjellë rikonfigurim në skenën politike pas një procesi zgjedhor që është vlerësuar si demokratik. E meta më e madhe e këtyre zgjedhjeve pa dyshim është shkalla e daljes në zgjedhje. Kosova ka kaluar procese demokratike në ciklet e kaluara zgjedhore, që nuk e arsyetojnë trendin në rënie të pjesëmarrjes së zgjedhësve. Nëse dy demokraci të etabluara, Franca vitin e kaluar e Italia këto ditë, shënuan pjesëmarrje të daljes në votime mbi 80%, shkalla gati përgjysmë më e vogël e daljes në votime në Kosovë nuk mund të arsyetohet. Nuk duam të besojmë se jemi ngopur me demokraci, sa të përtojmë të dalim në votime në cikle të rregullta zgjedhore.

Pavarësimi i Kosovës do ta bëjë të mundshëm profilizimin politik të skenës sonë, të partive politike, si organizma të rëndësishëm të demokracisë. Opinioni kritik, por edhe i baraspeshuar, i ditur e i përgjegjshëm, i përçarur ndër të tjera edhe nëpërmjet fuqisë së katërt pushtetore, siç konsiderohen media sot, është shumë i rëndësishëm për shëndetin e demokracisë sonë.

Kur jemi te pushtetet - të tri pushtetet e para, legjislativi, ekzekutivi, dhe gjyqësori – Kushtetuta jonë e sapomiratur siguron ndarje të qartë, gjë që siguron baraspeshimin e kontrolluar të sistemit pushtetar në tërësi, për të krijuar në fund të fundit një pushtet koheziv demokratik, jo autoritar. Në veçanti ky balans dhe bashkëpunim midis pushteteve duhet të sigurohet për të krijuar gamën e plotë të ligjeve në përputhje me standardet ndërkombëtare, si dhe kontrollin demokratik të ekzekutimit të politikave e gjithashtu edhe për të siguruar sundimin efektiv të ligjit dhe për të ofruar siguri për të gjithë qytetarët e vendit.

Si President i vendit, që tashmë do të marrë kompetenca më thelbësore për një kryetar shteti, sidomos në fushat që janë atribut të ekzekutivit e të sovranitetit shtetëror, unë do të luaj rolin tim me gjithë fuqinë dhe dijen time. Së pari, siç jam zotuar e më takon ta bëj, do të jem në shërbim të unitetit demokratik të popullit dhe të Republikës së Kosovës.

Në fushën e politikës së jashtme të vendit, të cilën me Kushtetutë e udhëheq unë, prioritet të parë do ta kemi sigurimin e njohjes sa më të shpejtë dhe integrimin e Kosovës në institucionet ndërkombëtare. Në këtë fushë, rol të veçantë do të ketë Qeveria, gjegjësisht edhe Ministria e Jashtme, që është tani në fazën e hershme të funksionalizimit.

Do të krijojmë përfaqësim diplomatik në botë në përputhje me mundësitë dhe interesat jetike të Republikës së re të Kosovës. Do të ndërtojmë edhe shërbimin konsullor jashtë, për t'u shërbyer qytetarëve të huaj dhe diasporës sonë. Ky përfaqësim diplomatik në përgjithësi do të jetë fytyra ndërkombëtare e Kosovës, shumë e rëndësishme tash e në të ardhmen për promovim e interesave të vendit tonë jashtë.

Fusha klasike e sovranitetit – siguria, për të cilën unë kam tani edhe rol kushtetues, do të kërkojë kujdesin e të gjithëve: të Presidentit e të Qeverisë në radhë të parë, por edhe të pranisë ndërkombëtare për një periudhë disavejçare. Forca e Sigurisë së Kosovës do të ndërtohet mbi kriteret e NATO-s dhe me ndihmën e Aleancës. Në ndërkohë, me kujdes dhe respekt do të trajtojmë Trupat e Mbrojtjes së Kosovës si forcë që ka luajtur rolin e vet të rëndësishëm në fushën e emergjencave civile. Do të forcohet Policia e Kosovës për të marrë detyra të reja. Do të krijohet Agjencia e Inteligjencës e Kosovës. Unë këtu kam rol kushtetues, po ashtu, në bashkëpunim me Kryeministrin e vendit, rol që do ta ushtroj për të mirën e sigurisë së shtetit dhe të gjithë shtetasve tanë. Do të krijojmë shërbim të inteligjencës mbi kriteret pastërtisht profesionale, të paanshëm politikisht, besnik ndaj shtetit dhe interesave të të gjithë qytetarëve tanë.

Pavarësia jonë, e mbikëqyrur në këtë periudhë, mbështetet mbi premisën e një komponente të fuqishme të pranisë ndërkombëtare - Misionit të EULEX-it të udhëhequr nga Bashkimi Evropian, që do të ketë rol më shumë se mbikëqyrës në fusha të sigurisë dhe të ligjit. Ne do të bashkëpunojmë me këtë Mision dhe me Përfaqësuesin Civil, prania e të cilëve në Kosovë buron nga Plani i Ahtisarit, duke u legjitimuar tutje edhe më fuqishëm nga ftesa që u kemi bërë ne, institucionet legjitime të Kosovës.

Çmojmë lart pjekurinë politike të qytetarëve të Kosovës dhe kontributin e tyre të jashtëzakonshëm për stabilitetin e vendit, punën dhe angazhimin profesional të institucioneve ndërkombëtare dhe vendore të sigurisë, që me sukses po kapërcejnë sfidat dhe provokimet e herëpashershme që vijnë nga kundërshtarët e pavarësisë së Kosovës.

Gjyqësori i Kosovës është pushtet që pret të reformohet thellësisht në pajtim me nevojat e vendit tonë dhe standardet e fuqishme ndërkombëtare që kemi përqaftuar për këtë fushë. Koha e re kërkon njerëz të rinj, profesionistë të dijshtëm e të përkushtuar, jashtë ndikimeve politike apo tjetërfare nga jashtë.

Unë, si President, do të luaj rolin që më takon për të siguruar bazat e kësaj reforme, për të krijuar një gjyqësor të pavarur, shtyllë të rëndësishme të shtetit ku sundon ligji, me barazi të të gjithëve para këtij ligji. Tash nuk ka, por do të ketë sundim të ligjit në gjithë territorin e Kosovës. Kosova do të jetë unike - territorialisht dhe funksionalisht - pavarësisht problemeve me të cilat ballafaqohemi sot nga strukturat paralele që sponsorizon Serbia në Kosovë me qëllim që ta sfidojë rendin dhe ligjin e shtetit tonë dhe madje vetë ekzistencën e Republikës së pavarur të Kosovës.

Për këtë punë kërkohet veprim i integruar i të gjithë lojtarëve - i Qeverisë së Kosovës, i Zyrës Ndërkombëtare Civile, i EULEX-it, por edhe i UNMIK-ut për kohën dhe mandatin që ka deri në tranzicionin e plotë të pushtetit tek institucionet e Kosovës.

Me dhembje të vazhdueshme e themi se ende, familjet e më se dy mijë personave të pagjetur nuk kanë asnjë informacion për më të dashurit e tyre. Për këtë do të jetë një dhembje që na përcjell edhe në vazhdim, por duhet bërë angazhimet maksimale që të

ndriçohet fati i të pagjeturve. Prandaj, do të angazhohemi që sa më parë të ndriçohet fati i të pagjeturve, duke bërë presionin ndërkombëtar që duhet të bëhet mbi Serbinë apo akterin kryesor të këtij fati të njerëzve tanë.

Të nderuar deputetë,

Të dashur qytetarë të Kosovës,

Këto ditë ekziston një fushatë e madhe dhe përpjekje e Serbisë për mbajtje të zgjedhjeve që ka paralajmëruar për 11 maj.

E kam thënë dhe po e përsëris këtu, para jush, deputetë e qytetarë të nderuar: Kosova nuk është dhe nuk mund të jetë bazë zgjedhore për krijimin e pushtetit të Serbisë në Kosovë. Kjo ka marrë fund një herë e mirë. Kosova është shtet i pavarur dhe sovran, i njohur ndërkombëtarisht. Me parimin e dyshetësisë, serbët e Kosovës që duan të jenë edhe shtetas të Serbisë, mund të votojnë për pushtetin e Serbisë në Serbi. Prandaj, i thërrasim që të jenë akterë të rëndësishëm të ndërtimit të institucioneve të Kosovës dhe jetës së përbashkët.

Prandaj, ju përfaqësues dhe qytetarë të komunitetit serb - shtetas të Kosovës, ju them atë që e kemi thënë edhe në raste të tjera ne udhëheqësit e Kosovës, udhëheqësit tuaj: Kosova është atdheu ynë i përbashkët, i të gjithëve pa dallim. Një pjesë e qytetarëve tanë e ka pas marrë me drojë krijimin e Kosovës së pavarur, kryesisht si rezultat i indoktrinimit sistematik, të ndikimit dhe të presioneve që vijnë nga Serbia, nga elitat politike e kishtarë atje. Këta dy muajt e parë kanë dëshmuar se droja ka qenë e pavend. Në Kosovë ka vend për të gjithë qytetarët e vet. Koha jonë është kohë e barazisë qytetare, jo e dominimit të askujt mbi askënd. Duhet të çmësohemi një herë e mirë me kulturën e dominimit të kohëve të shkuara. Liria e secilit është liria e të gjithëve në Kosovë. Për të ndërtuar një forum ku të shqyrtohen interesat e komuniteteve, me Kushtetutën e Republikës së Kosovës është sanksionuar funksionimi i Këshillit Konsultativ për Komunitete, i cili do të funksionojë brenda Zyrës së Presidentit të Kosovës, nën kryesimin tim. Unë planifikoj që së shpejti të ndërtoj një bërthamë organizative të këtij Këshilli, ndërsa funksionalizimi i plotë i tij do të bëhet pas hyrjes në fuqi të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Në shenjë respekti e kujdesi për shqetësimet legjitime që mund të kenë komunitetet, ne kemi pas krijuar një Këshill të tillë edhe para se të sanksionohej me Kushtetutë, në kohën kur krijonim pakon e statusit me ndërmjetësimin ndërkombëtar.

Të nderuar deputetë,

Zonja e zotërinj,

Mbasi kemi realizuar projektin më të madh kombëtar që ka një popull - ndërtimin e shtetit, ne kemi përpara sprovë të mëdha, jo pak të vështira, por të realizueshme: ta bëjmë Kosovën shtet plotësisht funksional, të qëndrueshëm politikisht dhe ekonomikisht, të sigurt për të gjithë qytetarët - pjesëtar të komunitetit më të gjerë të kombeve të lira në Evropë e në botë. Në botë ka shtete më të mëdha e më të vogla, më të pasura e më të varfra se ne, por ka vetëm një Kosovë: vend me histori të moçme, me shtresime identitare e etnike që shkojnë përtej mileniumeve, me histori të paqes dhe të luftës, me një shpirt thellësisht demokratik dhe frymë të respektit e të pajtimit qytetar. Kjo është Kosova jonë, atdheu ynë, demokracia më e re në botë, shteti i 193-të që pret të hyjë në Organizatën e Kombeve të Bashkuara.

Republika e Kosovës është nisur në rrugën e gjatë të rimëkëmbjes së përgjithshme të vendit tonë. Kështu, me vlerat tona dhe fuqinë tonë ekonomike e shpirtërore, me

identitetin tonë të veçantë - do të takohemi me botën, me fqinjët tanë të afërm e të largët në kontinentin tonë dhe me botën përtej.

Ushqyer me vlerat e lirisë, të demokracisë dhe të pavarësisë, të respektit për të veçantat e secilit dhe për diversitetet në mes kombesh, ne, populli dhe institucionet e Kosovës, u ofrojmë përqaftimin atyre që ushqehen me këto vlera.

Krejt në fund, ju faleminderit vendeve të Bashkimit Evropian, Shteteve të Bashkuara të Amerikës, sikur edhe vendeve të tjera që kanë njohur Republikën e Kosovës dhe atyre që kanë shprehur gatishmërinë ta përqafojnë shtetin e ri në familjen e kombeve të lira të botës.

Një falënderim i veçantë për ndihmën e madhe që po japin institucionet e pranisë ndërkombëtare në Kosovë - UNMIK-u, EULEX-i dhe KFOR-i. Ju faleminderit për vëmendjen!

(Duartrokitje)

KRYETARI: I nderuari, zoti President,
Kam nderin që në emrin tim dhe të të gjithë deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës t'ju falënderoj për fjalën tuaj përmbajtjesore për gjendjen e përgjithshme në Kosovë.

Të nderuar deputetë,
Propozoj një pauzë të shkurtër deri në orën 12. Ju faleminderit!

Vazhdimi i seancës pas pauzës

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
Kalojmë në pikën e dytë:

- Informimi për punën 100 - ditëshe të Qeverisë së Republikës së Kosovës

Kryeministri i Republikës së Kosovës ka kërkuar që para deputetëve të Kuvendit të paraqet Informatën lidhur me punën 100 - ditëshe të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Ftoj Kryeministrin, zotin Thaçi, që para deputetëve të paraqet Informatën lidhur me punën 100 - ditëshe të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: I nderuari, zoti Kryetar,

KRYETARI: Rregulla 23- rendi i ditës, paragrafi 1: “ Kryesia përgatit një propozim të rendit të ditës për seancën e radhës së Kuvendit dhe menjëherë të njëjtin e vë në dispozicion për deputetët e Kuvendit”

Paragrafi 2, në fillim të seancës plenare ky propozim për rend dite do të konsiderohet i miratuar, përveç, nëse një ose më shumë grupe parlamentare apo 6 anëtarë të Kuvendit i propozojnë me shkrim kryetrarit një amendament të rendit të ditës, i cili hidhet në votim. Unë nuk e kam asnjë kërkesë me shkrim nga asnjë deputet, as ndonjë grup deputetësh, prandaj, vazhdojmë me punë.

Zoti Kryeministër, e keni fjalën!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: I nderuari zoti Kryetar i Parlamentit të Kosovës, Jakup Krasniqi,
Të nderuar zëvendëskryeministra, ministra,
Të nderuar deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Më lejoni që me vullnetin tim, me vullnetin dhe përgjegjësinë e gjithë ministrave të Qeverisë së Republikës së Kosovës, të paraqesim para jush, deputetë të nderuar, informatën e plotë të cilën edhe e keni marrë më herët, një informatë e cila është kuptimplote për punën e Qeverisë në 100 ditshin e parë.

Natyrisht se kjo informatë nuk është obligim kushtetues, por është vullneti i imi dhe i Qeverisë së Kosovës, të institucioneve shtetërore të Kosovës që të punojmë me përgjegjësi për transparencë.

Prandaj, këto ditë, të nderuar deputetë, janë të veçanta, si për vendin tonë, por gjithashtu edhe për Qeverinë. Unë i falënderoj të gjithë ministrat për punën, përgjithësinë që kanë treguar gjatë tërë kësaj periudhe në punë të zellshme, por ju falënderoj edhe juve për mbështetje të plotë.

Për këto 100 ditë bashkërisht ne kemi bërë punë të vlerësuar, punë e cila ka reflektuar me të e vendit dhe çdo qytetari të Kosovës ku kjo është vlerësuar dhe prej autoriteteve relevante ndërkombëtare.

Gjatë kësaj kohe ne bashkërisht, të nderuar deputetë, gjitha institucionet e Kosovës, Kosovën e bëmë shtet të pavarur, sovran, demokratik, Kosovën shumetnike, Kosovën vend të shqiptarëve dhe të gjitha komuniteteve tjera.

Institucionet e Kosovës, të gjitha partitë politike, me vullnetin edhe të gjithë qytetarëve festuam me dinjitet, krenari dhe përgjegjësi shpalljen e Kosovës shtet. Shtetin e Kosovës, vetëm gjatë kësaj periudhe, të nderuar deputetë, e njohën rreth 40 shtete më të fuqishme të botës demokratike dhe procesi i njohjes është në vazhdim.

Në këtë kohë Kosova nxori edhe Kushtetutën e shtetit të vet, Kushtetutën moderne, Kushtetutën e perspektivës, Kushtetutën që i hap perspektivë të sigurt edhe zhvillimit ekonomik, edhe stabilitetit institucional, edhe sundimit të ligjit, edhe perspektivës integruese.

Gjatë kësaj kohe Kosova fitoi përkrahje të jashtëzakonshme ndërkombëtare. Kosovës, de fakto i është hapur perspektiva për kandidim të sigurt në NATO dhe Bashkimin Evropian. Kjo rrugë është e pandalshme dhe suksesi është i përbashkët.

Puna dhe serioziteti i institucioneve të Kosovës, i Qeverisë së Kosovës, përgjegjësia që kemi treguar të gjithë bëri që bota demokratike të kuptojë dhe njohë këtë realitet dhe argument të fuqishëm për të njohur fuqishëm shtetin tonë të pavarur.

Unë ju falënderoj të gjithëve për mbështetjen, mirëkuptimin dhe besimin që na është dhënë nga të gjithë ju për punën gjatë kësaj periudhe. Natyrisht, kjo periudhë ka qenë edhe periudha e vendimeve historike, e vendimeve të përbashkët, por natyrisht edhe

gasjeve të ndryshme për problemet të ndryshme qeverisë në vend. Por e gjithë kjo, nga Qeveria e Kosovës dhe unë, është mirëkuptuar që të jetë një konkurrencë e vlerave, një konkurrencë për të mirën e vendit tonë dhe gjithë qytetarëve tonë. Prandaj edhe për sugjerimet, vërejtjet e kritikën kohëpaskohshme kanë qenë të mirëpritura dhe natyrisht të vlerësuara edhe nga Qeveria.

Natyrisht se gjatë periudhës së mëhershme ne kemi dhënë premtimet tona, por edhe kemi filluar implementimin si Qeveri e Kosovës, një implementim me përgjegjësi të lartë shtetërore.

Të nderuar deputetë,

Kemi filluar se instaluari qeverisjen e mirë, stabile, efikase dhe shumë transparente. Kemi filluar implementimin e procesit të zhvillimit të arsimit, një proces ky shumë i ndërlikuar, por që vetëm në periudhën e 90-ditëshit, 100 - ditëshit ka shënuar një progres të paparë për rrethanat, kushtet dhe realitetet kosovare, gjithashtu edhe kompjuterizimi i shkollave. Kemi vazhduar me infrastrukturë rrugore, përmirësimin e gjendjes energjetike, luftën kundër korrupsionit, perspektivë perëndimore për Kosovën.

Që nga dita e parë kemi filluar t'i realizojmë objektivat. Fillimisht kemi marrë masa si Qeveri për llogaridhënie për shpenzimet e parasë publike. Vetëm me vendim për kufizimin e shpenzimeve brenda Qeverisë së Republikës së Kosovës efekti i parë, për dallim nga Qeveria e kaluar, ku ishin shpenzuar rreth 52 milion euro, kurse ne jemi të zotuar që t'i kursejmë së paku 30 milion euro për t'i investuar në sektorë të tjerë institucional për të mirën e vendit dhe mirëqenien sociale të qytetarëve të Kosovës.

Kemi respektuar profesionalizmin e shërbyesve civilë. Përkundër rasteve të caktuara e të shumta po them, të paaftësive, injorancës, pretendimit për ndonjë bllokadë të caktuar as edhe një shërbyes civil nuk është larguar nga puna dhe kjo nuk do të tolerohet edhe në të ardhmen.

Ne kemi filluar që t'i nxjerrim nxënësit nga konteinerët, të bëjmë zgjerimin dhe modernizimin e hapësirave edukative, të ndërtojmë shkolla të reja dhe t'i kompjuterizojmë ato. Këto nuk janë donacione. janë punë, projekte konkrete të investuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës, nga Ministria e Arsimit.

Kemi krijuar autonomi menaxheriale dhe financiare për Universitetin e Prishtinës. Kemi marrë vendime për digjitalizimin e të dhënave në Universitetin e Prishtinës, vendimi për ndërtimin e Fakultetit të Edukimit për çka janë ndarë edhe mjetet financiare.

Kemi filluar formësimin e vendimit për hapjen e Fakultetit të Teknologjisë Informative, tash janë duke u shqyrtuar edhe mundësitë e mbulesës financiare edhe kjo do të ndodhë së shpejti. Kemi marrë vendim për uljen e taksave për regjistrimin e studentëve për vitin e ri akademik. Kemi vazhduar ndërtimin e konvikteve. Kemi marrë vendim për uljen e çmimeve për studentë për banim dhe ushqim, por edhe rritjen e standardit të tyre, e gjithashtu edhe vendimin për akreditim për të gjitha universitetet sipas Deklaratës së Bolonjës.

Të nderuar deputetë,

Kemi filluar edhe ndërtimin e shumë rrugëve lokale dhe sot është duke punuar anekënd Kosovës në këto projekte shumë të rëndësishme për infrastrukturën e rrugëve lokale, por

në të njëjtën kohë ka ndodhur edhe fillimi i angazhimeve konkrete dhe vendimeve për ndërtimin e auto-rrugëve nacionale.

Siç e dini të gjithë është hapur oferta për fillimin e punimeve të auto-rrugës, Auto-banit Vërmicë – Prishtinë - Merdar. Gjithashtu, edhe korniza kohore është e specifikuar dhe është e njohur edhe për ju, për qytetarët edhe mbulesa financiare dhe natyrisht se do të fillojë në kohën dhe programin të cilën e kemi diskutuar dhe e kemi marrë vendime. Natyrisht se kjo do të jetë një ofertë publike edhe vendore, por edhe ndërkombëtare. Në anën tjetër, ka filluar studimi për Auto-rrugën Prishtinë - Ferizaj - Hani i Elezit.

Të nderuar deputetë,

Gjendjen energjetike e kemi gjetur në kolaps të vërtetë, në një anarki të vërtetë, në një krizë të vërtetë. Në terr të vërtetë e kemi gjetur Kosovën. Vështirësitë dhe pengesat fillestare ishin të jashtëzakonshme, por edhe këmbëngulësia jonë ka qenë e madhe dhe sot kemi ndërtuar strategjinë konkrete e cila është përgatitur nga ekspertë vendorë dhe ndërkombëtarë. U ballafaquam me mentalitetin e territ, keqmenaxhimit, keqpërdorimeve, por edhe korrupsionit.

Kjo strategji e Qeverisë së Kosovës parashikon konsolidimin e resurseve aktuale dhe rritjen e efikasitetit të menaxhmentit, investime përmes koncesioneve dhe partneritetit publik privatizues. Vendimet të cilat edhe mbrëmë janë marrë nga Qeveria e Kosovës, shkojnë në drejtim të largimit nga mentaliteti i ekonomisë së planifikimit socialist, në ekonomi të lirë të tregut në procesin e koncesioneve, në procesin e privatizimit përmes partneritetit, por edhe privatizimit të plotë dhe fillimin e ndërtimit të termocentraleve të reja.

Kjo strategji vazhdon me objektivat për ndërtimin e kapaciteteve të reja energjetike, duke u përmbajtur në mënyrë të plotë kriteret për mbrojtjen e ambientit jetësor. Gjithashtu, është formësuar edhe vendimi për kompletimin e Komitetit Drejtues për projektin e Kosovës C, natyrisht me një shqyrtim serioz, të kujdesshëm për shëndetin e qytetarëve dhe zhvillimin ekonomik të Kosovës.

Gjithashtu, kemi nxjerrë strategjinë, kemi filluar edhe marrjen e vendimeve për ngritjen definitivisht të kapaciteteve alternative për prodhimin e energjisë natyrore, hidrocentraleve dhe centraleve të erës.

Zbatimi i kësaj strategjie nënkupton energji të mjaftueshme elektrike për qytetarët tanë, bizneset dhe investime të reja. Kemi filluar që nga dita e parë të jemi të pa kompromis ndaj korrupsionit kudo dhe kushdo që ka qenë i involvuar apo mund të jetë i involvuar dhe nuk do të bëjmë asnjë kompromis- zero tolerancë ndaj korrupsionit.

Kemi filluar të bëjmë Qeverinë transparente që nga dita e parë për qytetarët tanë të cilëve edhe u shërbejmë. Që nga fillimi i qeverisjes sonë kemi ndërmarrë masa që menaxhimi dhe shpenzimet të jenë plotësisht në përputhje me ligjin dhe në funksion të interesave publike. Kemi mbështetur punën profesionale të shërbyesve civilë. Pensionistët veç kanë prekur rezultatin e parë të premtimeve dhe përgjegjësi e vendimeve të Qeverisë së Republikës së Kosovës. natyrisht pritet të bëhet edhe më tepër.

Prandaj, kemi filluar sigurimin e barërave esenciale gratis, transporti publik 50% më i lirë, fillimi i ngritjes pothuaj 100% për pensionistët kontribut-dhënës. Ligji për

pensionistët është në fazën finale dhe do të nxjerrët së shpejti e do të fillojë së implementuari.

Të nderuar e të respektuar deputetë,

Shëndeti i qytetarëve tanë vazhdon të jetë shqetësim për Qeverinë. E ka përmendur shpesh edhe i nderuari ministri Gashi për gjendjen e rëndë që e ka gjetur edhe këtë dikaster të rëndësishëm për vendin dhe qytetarët tanë. Jemi angazhuar që nga dita e parë edhe personalisht së bashku me ministrin që gjendja në sektorin e shëndetësisë të përmirësohet, të depolitizohet dhe të dekriminalizohet, siç e ka potencuar dhe argumentuar ministri, si dhe evitimin dhe tejkalimin e fenomeneve negative, higjienën, që të ketë higjienë të standardit më të lartë, barëra më shumë dhe më cilësore, infrastrukturë më moderne, investim në dije, përgatitje që të jemi edhe pjesë e Organizatës Botërore të Shëndetësisë. Ne e vlerësojmë punën e gjithë atyre njerëzve vullnetmirë, të njerëzve profesionistë në sektorin e shëndetësisë, por devijimet, lëshimet dhe gabime që ka ndodhur, kanë filluar të tejkalohen.

Kemi vazhduar me reforma në drejtësi për gjyqësi të pavarur funksionale, sundim të ligjit në tërë territorin e Kosovës. Do t'i vazhdojmë reformat në ekonomi dhe financa, por, gjithashtu, edhe rritje të angazhimeve në tregti dhe industri edhe vazhdimin e reformimit të pushtetit lokal për të cilën kemi vendosur bashkërisht të gjithë sipas standardeve dhe Dokumentit të Presidentit Ahtisari.

Gjithashtu, janë rritur përkushtimet edhe investimet për investimet për rininë, sport dhe çështje jo-rezidente.

Edhe niveli i punës në Shërbime Publike është rritur. Gjithashtu, Kosova në këtë periudhë ka filluar të ndërtojë të gjitha institucionet funksionale shtetërore. Është i nominuar ministri për Punë të Jashtme, në ditët e ardhshme do të formohen edhe Ministria e Mbrojtjes dhe Shërbimi Inteligjent i Republikës së Kosovës. Është rregulluar, është përgatitur baza ligjore dhe do të procedohet edhe në Kuvend sa i përket Shërbimit Inteligjent të Kosovës.

Gjithashtu, është rritur përkushtimi dhe investimi në: bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural, mjedis dhe planifikim hapësinor. por edhe është bërë një punë shumë e mirë prej ministrit për Kthim në çështjet e kthimit të zhvendosurve që Kosova definitivisht të vazhdojë të ndërtojë realitetin se Kosova është atdhe i gjithë qytetarëve, Kosova është vend demokratik.

Të nderuar deputetë,

Për të gjitha çështjet që ju informova, ju veç jeni të informuar edhe me informatën me shkrim rreth 250 faqe. Jam i vetëdijshëm se kemi probleme, jam i vetëdijshëm se ka lëshime, ka mangësi, por me këto lëshime, me këto mangësi, me ato probleme jemi duke u ballafaquar ditë për ditë dhe jam i bindur në sukses.

Unë me përkushtimin më të lartë, moral, kombëtar dhe shtetëror do të vazhdojë të punojë sa më shumë dhe sa më mirë që të mundem në shërbim tuaj dhe të vendit tonë në përmbushjen e qëllimit tonë për të ndërtuar një Kosovë edhe më të mirë, më të zhvilluar edhe më të fuqishme- Republikën tonë të re.

Në anën tjetër, dua t'i falënderoj të gjithë deputetët, pa dallime partiake apo etnike për mbështetjen që na keni dhënë në projektet tona të rëndësishme për vendin. Edhe një herë ju falënderoj sinqerisht për besimin dhe mbështetjen e unë jam i sigurt se kështu të bashkuar do të kemi sukses për të zhvilluar Kosovën, për të ndërtuar Kosovën tonë të re për të cilën kemi investuar të gjithë. Prandaj, faleminderit shumë!

(Duartrokitje)

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
Kam nderin që në emër tim dhe të gjithë deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës ta falënderoj Kryeministrin e Kosovës për informatën e prezantuar.

Në vazhdim, pika e tretë:

Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës për periudhën 2008 – 2011.

Shikoni, ne punojmë me një Rregullore të Punës. Ju lutem, le të ngritet një përfaqësues i cilitdo grup parlamentar, ku e mbështet kërkesën për të zhvilluar debat për informatën për punën 100 - ditëshe të Qeverisë?

Mirë, fjalën ia jap kryetarit të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Ardian Gjinit, veç ju lutem ta mbështetni kërkesën tuaj.

ARDIAN GJINI: Kjo fjalë, që ma keni dhënë është vetëm sa për të proceduar më tutje, se fjalën e dua më vonë. Përderisa ju e merrni të drejtën të thoni që e përshëndesni në emër të gjithë deputetëve të Kosovës, atëherë, lejona të flasim diçka se ju e morët edhe atë të drejtë, nuk na pyetët neve, a e përshëndesim ne a nuk e përshëndesim. Një pjesë e përshëndet, ndoshta, një pjesë jo. Ndoshta edhe ne e përshëndesim, ama ju duhet të na dëgjoni se a e përshëndesim a nuk e përshëndesim, a na pëlqen, a nuk na pëlqen, dhe të paktën për një kohë të shkurtër të diskutojmë çka kemi dëgjuar sot. Ne nuk kemi ardhur në seancë informative. Nuk na keni shënuar në agjendë që është seancë informative edhe na vijmë ulemi këtu edhe dëgjojmë të tjerët duke folur, zoti Kryetar. Nuk është në rregull kështu, nuk është në rregull, ju keni një opozitë. Nëse doni ta heshtni totalisht opozitën, vazhdoni ju lutem, mirëpo, ju duheni ta dëgjoni nganjëherë zërin e opozitës kur flisni. Nëse s' doni të na dëgjoni, tregona, ne nuk vijmë hiq. Faleminderit!

KRYETARI: I nderuar deputet,
Me gjithë respektin, përsëri po them se është informatë dhe për informatën nuk debatohet. Kemi programin e Qeverisë dhe mund të debatoni për gjithë programin, mund të thoni edhe diçka nga kjo pjesë nëse e kërkon.

Ju lutem, unë po them mbështetni ju kërkesën tonë, tuajën mbi cilën rregull të Rregullores së Punës e Kuvendit e mbështetin kërkesën, unë po ju

(Ndërprerje)

Fjalën e ka deputetja Gjylnaze Sylja, le ta argumentojë në cilin nen e mbështet.

GJYLNaze SYLA: Zoti Kryetar,

Veprimi yt ishte taktik, domethënë çka ke bërë sot është se ke vu në rend të ditës Informatën e Qeverisë para se të diskutohet Programi. Kjo askund në botë nuk ngjanë. Kjo është e para.

E dyta, ju nuk e lexuat rregullën. Rregulla 30.1.2 thotë: “ Në çdo seancë plenare të Kuvendit deputetit i jepet e drejta të propozojë mocion për ta shtyrë seancën”. Ndoshta, ne kemi pasur propozimin për ta shtyrë seancën.

Tjetra, Rregulla 6 pika 4:”Kryesia angazhohet të sigurojë që një proporcion i arsyeshëm i kohës në seanca plenare të Kuvendit, t’u lihet në dispozicion çështjeve të paraqitura nga grupet parlamentare që nuk janë të përfaqësuara në Qeveri, do të thotë që të dy të drejtat na i ke marrë, Nuk është mirë se po i ulni standardet e Kuvendit, zoti Kryetar. Merr këtë si kritikë konstruktive për punën më të mirë të Kuvendit të Kosovës. Nuk bën kështu të udhëhiqni si jeni duke udhëhequr, nuk bën ta kemi programin pasi që Kryeministri e lexon informatën. Ana tjetër është se materialin, raportin 100 - ditësh e kemi marrë dje pasdite diku në orën 16-17 nëpër kutitë tona postare, që është raporti 100 - ditësh. Kryeministri tha:” Nuk është obligim kushtetues”. Zoti Kryeministër, është praktikë e mirë parlamentare për përgjegjësinë dhe transparencën e Qeverisë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, po përsëri, ju e dini se kërkesa bëhet me shkrim dhe unë nuk e kam pasur asnjë kërkesë me shkrim. Fjalën e ka kërkuar deputeti Numan Baliq.

NUMAN BALIQ: Faleminderit, zoti Kryetar!

Ja vas molim da budete veoma pažljivi. Pitanje rada Vlade nije samo pitanje Vlade Kosova, nije samo pitanje opozicije, nego je pitanje svih poslanika u parlamentu Kosova, javnosti Kosova i celokupnog kosovskog društva.

Ja vas pozivam da budete obzirni i da poštujuete javnost, građane, glasaće za to što davanje izveštaja a izbegavanje razmatranja o radu Vlade može se protumačiti i biće protumačeno kao izbegavanje Vlade od odgovornosti. Ja se nadam da mi neće zamjeriti gospodin premijer ako ga osobno prozovem i zamolim ga da u interesu javnosti, u interesu onih kojih su ga glasali i svih nas da se mora obaviti debata. Izbegavanje debate pred javnošću Kosova je kukavički čin, i ja mislim da vi to ne želite. Dozvolite debatu koja je obavezna. Naš posao je ovde da pričamo, gospodine Krasnići. Mi ne dolazimo ovde zato da bi smo kopali kukuruz ili radili ono što radimo u selima tamo od dakle smo došli, nego za to da razmatramo o onome zašto nas je narod ovde postavio. Pozivamo vas da obavimo debatu o izloženom programu Vlade. Hvala vam ljepo!

KRYETARI: Faleminderit!

Ju lutem, ju në Rregullore e keni të drejtën me shkrim të kërkonit interpelancë, nën një.

Nën dy, ju me shkrim e keni të drejtën të kërkonit debat për çështje të veçanta dhe ju si deputetë nuk e keni shfrytëzuar as njërën, as tjetrën të drejtë. Megjithatë, unë po ju jap të drejtën të flisni.

Fjalën e ka anëtar i Kryesisë, zoti Ibrahim Gashi.

IBRAHIM GASHI: Faleminderit, zoti Kryetar që më në fund ma dhe fjalën edhe pse e kërkoja në fillim kur do të duhej të diskutonim për rendin e ditës, sipas meje.

Përsëritje, Zoti Kryeministër, zëvendëskryeministra, ministra, të nderuar deputetë

Jam i obliguar që të përsëris reagimin tim parimor të cilën e kam shprehur në mbledhjen e fundit të Kryesisë së Kuvendit të Kosovës. lidhur me kohën e mbajtjes së seancës, ku do të diskutohej programi i Qeverisë së Kosovës dhe raporti i punës 100 ditësh të saj. Më poshtë, do t'i arsyetoj arsyet parimore që do të duhej ta diskutonim në fillim rendin e ditës dhe të kishim mundësinë t'i shprehnim kërkesat për shtyrjen e kësaj seance për këto arsye.

Agjenda e propozuar për sot është shumë e stërngarkuar, jo për nga numri i pikave, sa për nga rëndësia dhe volumni i tyre.

Dy, koha kur është distribuuar programi qeveritar është shumë e shkurtër dhe duke qenë se materiali është i pashoqëruar me analiza dhe studime përkatëse, pra, është tepër narrativ, kërkon shumë kohë, shumë më tepër kohë për studim që të mund të konstatohet se zgjidhjet që ofrohen a janë funksionale dhe të aplikueshme dhe a kanë analizën për: kohën, resurset dhe koston buxhetore?

Nën tre, gjendja paraqitet shumë problematike në pikën lidhur me raportin e punës 100 - ditëshe të Qeverisë, i cili servohet ose distribuohet vetëm disa orë para fillimit të kësaj seance. Përfundimisht, nga kjo që u tha më sipër është një konstatim i padëshiruar nga ana ime, se Qeveria me qëllim po e provokon Parlamentin dhe opinion me kalkulime të tilla joparimore dhe të panevojshme. Konsideroj se konsekuencat e kësaj praktike do t'i përshkruhen vetëm asaj, pashmangshëm, kjo krijon përshtypje se Qeveria në mungesë të rezultateve konkrete po tenton të manevrojë me kohën. Në fund edhe një herë i lus deputetët, pa dallim pozitë dhe opozitë, si dhe përfaqësuesit e Qeverisë, të kenë mirëkuptim për kërkesën parimore për shtyrjen e kësaj seance, përkatësisht debatit për një javë së paku për të enjten dhe të premten e ardhshme.

Faleminderit.

KRYETARI: Fjalën e ka kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, zoti Ramë Buja.

RAMË BUJA: I nderuar, zoti Kryetar.

I nderuar dhe i respektuar zoti Kryeministër, zëvendëskryeministra, Kabinet qeveritar dhe ju të respektuar kolegë deputetë,

Po më vjen keq që dua vetëm t'ju rikujtoj se e di mirë që e dini se format e kontrollit të Qeverisë janë dy, që njihen në aspektin filozofik, teorik dhe sociologjik dhe janë pyetjet parlamentare dhe interpelanca parlamentare. Po kështu ju e dini askund në botë nuk debatohet për informatën. Unë e di që i dini dhe veç po dua t'ua përkujtuar dhe kam shumë respekt për ju, andaj desha veç t'ju rikujtoj që të mos bëjmë shumë debat rreth kësaj çështje për faktin që keni mundësi që tash në pikën e 3 të debatojmë seriozisht për Programin dhe kemi çka të themi, natyrisht edhe kemi për çka të flasim dhe mund të shfrytëzojmë këtë kohë shumë logjikshëm dhe shumë arsyeshëm. Andaj, nuk e shoh të arsyeshme që të harxhojmë kohë për këtë gjë...

Ju faleminderit shumë!

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

Për hir të opozitës, ne duhet ta shfrytëzojmë një dispozitë të Rregullores së Punës. Rregulla 61. Shmangiet nga Rregullorja e Punës. Unë s'kam të drejtë të shmangem nga Rregullorja e Punës, këtë të drejtë e ka Kuvendi. Për shmangiet nga Rregullorja e Punës mund të vendosë Kuvendi. Ju lutem, jo s'po ia jap fjalën askujt, unë nuk kam të drejtë të shmangëm, ka të drejtë të shmanget Kuvendi. Dëgjoni rregullën 61 "Për shmangien nga Rregullorja e Punës mund të vendosë Kuvendi, me 2/3 e shumicës së deputetëve të pranishëm në Kuvend, përveç nëse ky është në kundërshtim me dispozitat e Kornizës Kushtetuese." Konsideroj që kjo nuk është në kundërshtim me Kornizën Kushtetuese, atëherë përgatituni për votim.

Do të thotë, ju lutem, urdhëro, zoti Kryeministër!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Faleminderit, zoti Kryetar, për këtë mundësi.

KRYETARI: Rendin e ditës shikoni.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Të nderuar deputetë,

Unë këtu jam së bashku me të gjithë ministrat të cilët janë sot në Kosovë, një është me arsye jashtë, por dua të potencoj informata është vullneti ynë, jo e drejtë kushtetuese, por, në të njëjtën kohë, ne jemi treguar të përgjegjshëm për transparencë, që asnjë qeveri deri më tani nuk e ka bërë për të informuar në rastin e 100 - ditëshit ...E para.

E dyta, pajtohem plotësisht për debat, plotësisht, i gatshëm, për këtë arsye jam edhe sot këtu edhe për t'ju informuar edhe për të debatuar, por në ndërkohë, më lejoni që secili ministër të raportojë për punën e vet, pastaj hapim debat.

Faleminderit shumë!

KRYETARI: E ka fjalën Kryeministri.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Ju ftoj për debat, të nderuar ministra, ju ftoj secilin prej juve nëse miratohet nga Kuvendi të raportojë në Kuvend dhe të hapet debat të diskutojmë, do të thotë, jemi të gatshëm për të gjitha mundësitë edhe vullnetet tuaja t'i respektojmë dhe natyrisht e keni edhe informatën edhe raportin. Nëse doni informatë, okej, nëse doni debat urdhëroni!

KRYETARI: Faleminderit! Ju lus deputetë, mund të shmangëm nëse ju- Kuvendi vendos. Nëse Kuvendi vendos që për këtë informatë të bëhet debat, atëherë përgatituni për votim. Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash.

Ju lutem, me Rregullore nuk kemi të drejtë për informatë të bëjmë debat, këtë mundësi, me rregullën 61 e ka të drejtë Kuvendi nëse donë të zhvillojë debat, nëse Kuvendi voton për debat, le të bëhet debati, unë nuk jam kundër debatit.

Sabri Hamiti e ka fjalën.

SABRI HAMITI: Unë prita që shefi i grupit tonë parlamentar të tregojë çka kemi vendosur ne dhe si jemi marrë vesh, por ai, si duket s'po ka qejf, po ju them unë.

Zoti Kryetar i Kuvendit, zoti Kryeministër dhe gjithë ju kolegët e mi. Ne kemi një rend dite të cilin e ka caktuar Kryesia. Është e vërtetë që 2 përfaqësues të opozitës kanë kërkuar që të shtyhet për më shumë kohë, por askush nuk e ka kontestuar atë që e kam propozuar unë që do të thoshte jam përfaqësues i pozitës atje në Kryesi, që duke e

konsideruar punën e programit të Qeverisë dhe raportin të rëndësishë së veçantë, të bëhet seancë e veçantë. Dhe ky është propozim i ashtuquajtur i pozitës. Kjo për informatë themelore, kjo ka qenë kështu. Nëse këta që janë anëtarë atje mendojnë që është ndryshe, le ta demantojnë para publikut dhe jush.

E dyta, ne kemi pasur kërkesën për një fjalim të Presidentit që është bërë sipas rregullave. Kemi pasur kërkesën me shkrim nga Kryeministri që të japë një informatë për 100 - ditëshin. Ne atë informatë me shkrim nuk e kemi marrë, mirëpo, dje në kutitë tona ka ardhur një dokument tjetër i Qeverisë, i cili më nuk është informatë, por është raport. Dhe unë i ofroj zgjidhjen me Rregullore Kryetarit tonë të Parlamentit, por edhe vetvetes që sot me rregullat në fuqi të Parlamentit s'ka shans, nëse i shpjegojmë drejt rregullat, që një tekst që vjen sot të diskutohet në Parlament, ky që është raport. Nëse ju keni dëshirë që të diskutoni për paraqitjen e Kryeministrit Hashim Thaçi, domethënë, ajo që ai e artikuloi këtu, që është më shumë propagandë se analizë, normalisht, sepse është Kryetar Qeverie, unë ju lutem, ne mund të bisedojmë, por jo për këtë që nuk është më informatë, por është Raport i Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe unë po ju them, edhe unë që jam njëfarë lexuesi i shpejtë, nuk kam mbërri ta shoh krejt. Pra, zgjidhjen nuk keni nevojë ta ndërroni, të votojmë për rregulla. Kuvendi thotë që do të bisedojë për fjalën e Kryeministrit, apo jo? Unë mendoj që nuk ka nevojë, sepse kemi pikën e tretë ku mund të bëhen bashkë interesat e analizës së punës së Qeverisë dhe të programit që është. Unë e propozoj këtë zgjidhje. Faleminderit!

KRYETARI: Po, kështu e thashë edhe unë. Faleminderit!

KRYETARI: Ju Faleminderit shumë! Prandaj, është propozimi. Dëshiron Kuvendi të debatojë për informatën e Kryeministrit të Kosovës, zotëri Hashim Thaçi.

Fjalë nuk ka, bile e kanë tepruar, se me Rregullore nuk kanë pasur të drejtë.

Kalojmë në pikën e tretë të rendit të ditës:

3. Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës për periudhën 2008-2011

Të nderuar deputetë, Qeveria e Republikës së Kosovës ka hartuar dhe Kuvendit i ka propozuar me shkrim shqyrtimin e Programit të Qeverisë së Kosovës për periudhën 2008-2011.

Ftoj Kryeministrin e Republikës së Kosovës, zotëri Hashim Thaçi, që para deputetëve ta paraqesë Programin e Qeverisë.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Ju faleminderit, zotëri Kryetar,
Të nderuar deputetë,
Të nderuar ministra, zëvendëskryeministra,

Programi qeveritar paraqet bazat për Kosovën shtet të qytetarëve, të zhvilluar në përputhje me parimet demokratike, të një ekonomie të lirë dhe të qëndrueshme, të një mjedisi shumetnikë dhe të përkushtuar qartë në drejtim të proceseve euro-atlantike.

Republika e Kosovës po kalon në fazën e tranzicionit dhe në këtë program jemi fokusuar në artikullimin e kërkesave imediate të kësaj faze. Qeveria parqet këtë program, duke u bazuar në mundësitë e potencialet e saja dhe të vendit tonë.

Ky Program ka për qëllim menaxhimin e këtyre mundësive: zhvillimin strategjik të vendit tonë dhe krijimin e një pozite të favorshme në politikën ndërkombëtare.

Ky Program paraqet përkushtimin e Qeverisë në konsolidimin e institucioneve, kompletimin e legjislacionit, konsolidimin e administratës publike në përputhje me standardet evropiane, si dhe vënien e rendit dhe të ligjit në tërë territorin e Kosovës.

Ky Program synon t'u përgjigjet kërkesave dhe nevojave të qytetarëve tanë, përmes një politike të përgjegjshme dhe transparente që do ta shpie Kosovën drejt një rritjeje të shpejtë dhe të qëndrueshme ekonomike dhe krijimin e një ambienti të qetë, të sigurt për të gjithë qytetarët e saj.

Ky Program do të rrisë mirëbesimin e ndërsjellë dhe bashkëpunimin e ndershëm dhe korrekt për të gjithë, brenda dhe jashtë Kosovës, duke ofruar partneritet, drejtësi, arsim cilësor, investime të sigurta që do të krijojnë vende të reja të punës dhe përmirësim të mirëqenies të të gjithë qytetarëve.

Ky Program mund të realizohet me bashkëpunimin e ngushtë me të gjithë aktorët politikë, përfshirë edhe shoqërinë civile, komunitetin e biznesit, institucionet akademike dhe partnerët tanë ndërkombëtarë. Me këtë Program, prioritetet më të shprehura janë në katër shtylla kryesore: rritja ekonomike, implementimi i statusit, qeverisja e mirë, zbutja e varfërisë dhe stabiliteti social.

Këto prioritetë janë rezultat i një procesi të gjatë, të konsultimit të Qeverisë brendapërbrenda, po natyrisht edhe me komunat dhe me shoqërinë civile.

Synim i Qeverisë është që këto prioritetë të jenë të përballueshme dhe të qëndrueshme në aspektin fiskal. Kostoja e tyre do të përcaktohet me kornizën afatmesme të shpenzimeve si dhe me mundësinë e aplikimit të projekteve konkrete në Konferencën e Donatorëve për Kosovën.

Këto prioritetë përcaktojnë seriozitetin tonë për të filluar me çështje konkrete dhe sfiduese për zhvillimin ekonomik dhe social të Kosovës. Rritja ekonomike, pra zhvillimi ekonomik do të realizohet përmes intensifikimit të investimeve, privatizimit dhe të ristrukturimit të ndërmarrjeve publike, shtimit të aftësisë konkurruese dhe rritjes së eksportit në ekonomi.

Kapacitetet ekzistuese energjetike dhe infrastruktura e dobët rrugore paraqesin barriera në zhvillim, në zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, por edhe në sundimin e ligjit.

Jam i bindur se potencialet e resurseve natyrore që ka Kosova dhe shfrytëzimi i tyre do ta rrisin zhvillimin ekonomik, do ta ulin shkallën e papunësisë dhe do t'i përmirësojnë kushtet sociale dhe do ta zvogëlojnë varfërinë.

Ky Program ofron mundësinë dhe krijimin e një ambienti të përshtatshëm për tërheqjen e investimeve të huaja dhe që të jemi konkurrues në vendet e regjionit. Investimet kualitative me qëllim të rritjes së produktivitetit, në veçanti në sektorin e energjetikës,

infrastruktura rrugore, ngritja e cilësisë së arsimit, politikës dhe tregut adekuat financiar, sundimi i plotë i ligjit, do të jenë mundësi tjera të këtij programi 2008-2011.

Sektori i bujqësisë është i rëndësishëm dhe ka vëmendje të veçantë në këtë program, që do të mundësojë rivitalizimin e tij dhe ndikimin direkt në uljen e pa punësisë. Pra, me qëllim të rritjes ekonomike, Qeveria e Kosovës do t'i koncentrojë angazhimet e veta në energji dhe miniera, transport, sundim të ligjit, edukim cilësor, bujqësi, politika tatimore dhe sektor financiar.

Energjia dhe minierat, furnizimi cilësor dhe i qëndrueshëm paraqet parakusht të zhvillimit të gjithmbarshëm të Kosovës dhe premtim mandator të kësaj Qeverie. Ritheksoj, premtim mandator të kësaj Qeverie.

Ky Program mundëson një politikë të shëndoshë energjetike, mbështet mjedisin biznesor dhe tërheq investimet e huaja. Ky Program parashikon zhvillim të shpejtë dhe të qëndrueshëm të Kosovës në shfrytëzimin e burimeve natyrore, nëpërmjet nxjerrjes, përpunimit dhe shtimit të vlerës në tregjet ndërkombëtare, duke siguruar ndjeshëm punësimin në industri.

Ky Program mundëson masat e nevojshme strukturore dhe organizative për një furnizim të qëndrueshëm me energji elektrike, në përputhje me qasjet dhe praktikatat ndërkombëtare, në mënyrë që të sanohet sektori elektroenergjetik, duke e shndërruar atë në një sektor që jo vetëm furnizon, por e mbështet fuqishëm zhvillimin e vendit.

Në planin afatshkurtër, dalja nga kriza energjetike parashihet në tri faza, duke involvuar edhe kapitalin privat. Kosova mund të fillojë marrëveshje për koncesion ose privatizim përmes një procesi transparent, mirë të menaxhuar që do t'i sillte përfitime të shumëfishta Kosovës.

Me planin afatgjatë, synimi i Qeverisë është procesi i ndërtimit të Termocentralit C, projekt ky që do të përcjellë dinamikën e vendosur me asistencë teknike nga Banka Botërore, AER-i, USAID-i dhe format tjera të avancuara të ofertimit transparent dhe konkurrues, duke marrë parasysh ndikimet sociale dhe ambientale.

Në drejtim të prodhimit të energjisë elektrike, përveç formave që e kanë për bazë linjitin, do të hulumtohen potenciale tjera të energjisë, sikur janë hidrocentralet në Zhur apo vendet e tjera, por edhe centralet me erë.

Në sektorin minerar do të mundësohet zhvillimi efikas dhe transparent, krijimi i një ambientit të përshtatshëm dhe tërheqës për investime dhe planifikim të zhvillimit të këtij sektori me standarde evropiane, mjedisore dhe sociale.

Transporti dhe Telekomunikacioni, ky Program mundëson një infrastrukturë që do t'i mundësojë Kosovës të jetë pjesë e integritimeve rajonale dhe evropiane. Këto investime do të jenë të orientuara në ndërtimin e autostradave, të rrugëve të reja, zgjerimin dhe rehabilitimin e rrugëve ekzistuese, rregullimin e kadastrit të rrugëve si dhe rritjen e sigurisë në komunikacion.

Vëmendje të veçantë ka transporti hekurudhor, në të cilin parashihet investimi, përmirësimi dhe revitalizimi i infrastrukturës hekurudhore ekzistuese. Po ashtu,

parashihet ndërtimi i infrastrukturës së re, investimi në zhvillimin e shërbimeve dhe të sigurisë në transportin hekurudhor.

Në fushën e aviacionit do të kemi mundësi në investim, modernizim dhe zhvillim të Aeroportit ndërkombëtar të Prishtinës. Do të ketë rritje të operacioneve ajrore të navigacionit, do të bëhet aftësimi i Aeroportit të Gjakovës me mundësitë që kemi për qëllime komerciale dhe si aeroport alternativ. Dhe, po ashtu, janë duke u studiuar mundësitë më të mira që të krijohet Njësia e Helikopterëve.

Telekomunikacioni, do të reformohet me legjislacion dhe teknologji. Do të konsolidohet Operatori Publik i Telefonisë, do të rritet, zgjerohet dhe përmirësohet Shërbimi Telefonik Postar dhe ai i Internetit, përmes formave të veçanta ose të kombinuara të financimit publik dhe të atij privat.

Në këtë program, si prioritet i Qeverisë, prej më të rëndësishmëve, është arsimi. Është hartuar strategjia zhvillimore që do të sjellë një investim afatgjatë në kapitalin njerëzor.

Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës për arsim bazohet në dije, ekonomi dhe punësim. Fokus i përbashkët i tërë Qeverisë është kjo çështje. Këtu përfshihet edhe cilësia në arsim, qeverisja më cilësore, lidhjet e arsimit dhe të zhvillimit ekonomik dhe shoqëror, avancimi i gjendjes materiale dhe ngritja e kapaciteteve për punë kërkimore dhe shkencore.

Sundimi i ligjit, siguri i një vendi ku sundon ligji, me kompletim dhe harmonizim të sistemit juridik, me një sistem gjyqësor dhe prokurorial të pavarur dhe të paanshëm dhe ngritjen e kushteve për të punësuarit në këtë sistem, si dhe bashkëpunimi me agjencionet tjera vendore dhe ndërkombëtare në luftën ndaj krimit të organizuar. Kjo do të kontribuojë drejtpërdrejt në përmirësimin e jetës së qytetarëve dhe në imazhin e Republikës sonë, në përshpejtimin e integriteteve euro-atlantike, të krijojmë prioritete që Qeveria jonë të angazhohet maksimalisht t'i implementojë. Rezultatet e para janë të prekshme.

Me këtë program synojmë të kemi një ambient të sigurt në tërë territorin e Kosovës dhe për të gjithë qytetarët e Kosovës ky Program mundëson krijimin e planeve për menaxhimin e situatave emergjente.

Pajisja e qytetarëve me dokumente civile shtetërore të Kosovës do të jetë preokupim i menjëhershëm i Qeverisë. Ky projekt veç ka filluar.

Politika tatimore, do të shqyrtohet me qëllim të përmirësimit të shkallës konkurruese në raport me vendet e regjionit pa e rrezikuar ... buxhetore të Kosovës. Norma tatimore do të jetë stimuluese për biznesin dhe do të shqyrtohen problemet administrative të identifikuar. Krejt kjo bëhet me qëllim të rritjes së qëndrueshme ekonomike dhe që sistemi tatimor të ndihmojë efikasitetin ekonomik.

Të nderuar deputetë,

Në sektorin financiar, gjithashtu do të angazhohemi për zvogëlimin e interesave që janë relativisht të larta dhe jo shumë stimuluese për investime. Vetëm në tremujorin e parë, me qeverisjen e mirë, me stabilitetin, me sundimin e Ligjit, me luftën kundër korrupsionit, kemi vërshim të investitorëve ndërkombëtarë që kanë siguri, kanë mbështetje, kanë adresë të sigurt, e kanë Qeverinë e Kosovës dhe ky Program vetëm do të

hapë perspektivë. Vetëm dje kemi prezantuar një program të krijimit të mundësive për investorët ndërkombëtarë, në partneritet me atë vendor rreth 250 milion euro.

Ky Program mundëson krijimin e një ambienti të sigurt për bizneset bankare, duke forcuar autoritetin mbikëqyrës të këtij sistemi dhe duke konsoliduar sistemin bankar që shkon në dobi të biznesit.

Qeveria e Kosovës ka ndërtuar politikë të qëndrueshme të partneritetit me biznesin kosovar dhe biznesi kosovar nuk do të vazhdojë të jetë si edhe më herët i shantazhuar, i kërcënuar, por do të jetë partner i ndihmuar dhe i favorizuar nga Qeveria e Kosovës.

Implementimi i statusit, shteti funksional dhe demokratik dhe implementimi i plotë i marrëveshjes së statusit do të jetë në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë. Edhe krijimi i institucioneve të reja në nivel qendror dhe lokal do të bëhet në këtë rrugë. Në këtë drejtim do të krijojmë misione diplomatike në botë, ambasada, por edhe forcën e sigurisë, si njësi profesionale. Në të njëjtën kohë, do të vazhdojmë për të transformuar edhe TMK-në, si dhe institucionet e tjera që kanë të bëjnë me fushën e sigurisë, minoritetet, decentralizimin.

Integrimi i komuniteteve dhe kthimi i të zhvendosurve, ky program mundëson përkrahjen konkrete të zhvillimit dhe të integrimit të bashkësive etnike, duke u përkrahur dhe financuar nga Qeveria e Kosovës. Kjo do të garantojë një kthim të qëndrueshëm individual dhe të organizuar, si dhe angazhim në koordinimin e fondeve shitesë, përveç atyre nga Buxheti i konsoliduar i Kosovës.

Ky kthim nënkupton edhe integrimin e komuniteteve në këtë fushë, do të bashkëpunojmë me institucionet qendrore të gjitha me ato lokale, vendore dhe ndërkombëtare, me OJQ-të, shoqërinë civile, mediat dhe gjithë potencialin kosovar dhe atë ndërkombëtar.

Politika e jashtme e Republikës së Kosovës është e përfshirë në këtë program duke paraparë përshpejtimin e procesit të njohjes së shtetit të Kosovës, thellimin e marrëdhënieve të veçanta me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, shtetet e Bashkimit Evropian, shtetet fqinje, ndërtimin e shërbimit diplomatik dhe konsullor të Kosovës, anëtarësimin e plotë të vendit tonë në organizatat dhe institucionet kryesore, politike, ekonomike dhe financiare ndërkombëtare, mbrojtjen e interesave të qytetarëve tanë në botën e jashtme, si dhe afirmimin e identitetit të Kosovës në botën e jashtme.

Të nderuar deputetë,

Qeverisja e mirë është një nga preokupimet dhe zotimet e Qeverisë sonë. Tani më vlerësimet e para veç i kemi nga të gjithë. Përcaktimi i qartë i kompetencave dhe i përgjegjësisë në të gjitha fushat dhe veprimtaritë, shërbimet e mira dhe transparente, llogaridhënia për shpenzimet e parasë publike, reforma në administratën publike dhe veprimet tjera që sigurojnë qeverisje të mirë, janë pjesë e këtij programi dhe zotim i imi dhe i gjithë ministrave.

Zbutja e varfërisë dhe stabiliteti social. Ky program ofrohet si prioritet i përhershëm dhe afatgjatë, duke e përmirësuar cilësinë e shërbimeve për pensionet dhe çështjet tjera sociale, si dhe në shëndetësi.

Ndihma sociale për familjet e varfra është qëllim kryesor që bëhet nga një sistem i mbrojtjes sociale për personat që nuk mundën t'i ndihmojnë vetvetes e familjes, që Qeveria t'ju ndihmojë me garantimin e të ardhurave minimale për jetesë me dinjitet. Këtu përfshihet edhe kujdesi shëndetësor dhe shkollimi i fëmijëve që jetojnë në varfëri.

Për individët dhe grupet me nevoja urgjente, ky Program ofron përkujdesjen e nevojshme, duke respektuar përmbushur dhe mbrojtur të drejtat e tyre.

Vazhdimi i sigurimi të pagesave të pensioneve dhe shikimi i mundësive për harmonizim me vlerën e shportës së ushqimit, si dhe pagesa e pensionit suplementar për kontributdhënësit, parashihet gjithashtu me Program.

Të nderuar deputetë,

Shëndetësia, krijimi i sistemit të qëndrueshëm për sektorin shëndetësor dhe mundësia e përmirësimit të gjendjes shëndetësore të popullatës, janë pjesë e këtij programi, duke ofruar mundësinë që profesionistët shëndetësorë të shpërblehen për ofrimin e kujdesit cilësor shëndetësor.

Aplikimi i Ligjit për sigurimet shëndetësore dhe përshtatja e tij me mundësitë reale të implementimit janë pjesë e qëndrueshme të Programit të Qeverisë së pavarësisë së Kosovës.

Politikat e tjera qeveritare. Zhvillimi i sektorit privat përmes strategjisë, si dhe investimet e huaja direkte, ato të turizmit, të zhvillimit industrial, mbrojtja e konsumatorëve si dhe ndërtimi i shoqërisë konkurrense me vendet e rajonit dhe ato të Bashkimit Evropian, janë pjesë e këtij Programi. Ky Program parasheh zotimin e Qeverisë për organizimin e pushtetit lokal në përputhje të plotë me Kartën Evropiane për qeverisje lokale.

Mbrojtja e Mjedisit dhe Planifikimi Hapësinor, që përfshinë: ajrin, ujin, tokën dhe zhvillimin e bazës ligjore për zbatimin i normave ndërkombëtare, do të jetë pjesë që do të sjellin cilësinë e planifikimit hapësinor, duke u orientuar në zhvillimin e infrastrukturës dhe të aktiviteteve urbane dhe rurale që e garantojnë mbrojtjen e ambientit jetësor, furnizimin e popullatës me ujë të pijshëm, përmirësimin e sistemit të ujërave të zeza dhe trajtimin e mbeturinave.

Barazia gjinore është obligim i politikave tona dhe i legjislacionit ekzistues, i cili do të respektohet.

Të nderuar deputetë,

Kujdesi i mjaftueshëm për kulturën dhe komunitetin artistik, do të jetë permanent përmes investimeve në projekte artistike dhe kulturore dhe rimëkëmbjen e jetës kulturore, përfshirë edhe investimet dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore, ku do të jetë edhe mbështetja e institucioneve të kulturës në nivel qendror dhe atë komunal.

Fokusimin në mbështetjen e sportit dhe ndërkombëtarizimin e tij, krijimi i kushteve për sportistët e Kosovës, janë pjesë e këtij Programi.

Struktura e re e popullatës është një pozicion shumë efikas dhe Qeveria parasheh politika multisektoriale, duke dhënë mundësi të favorizimit të rinisë kosovare dhe të bashkëpunimit në nivel qendror dhe lokal, atë vendor, ndërkombëtar si dhe bashkëpunimin me organizatat joqeveritare.

Regjistrimi i popullsisë, i ekonomive familjare dhe banesave, do të krijojë një mundësi për zhvillimin e shumanshëm të Kosovës, duke lehtësuar dukshëm hartimin e politikave zhvillimore të vendit.

Diaspora jonë e fortë dhe numerikisht e madhe, ka nevojë që të ketë përkujdesje të Qeverisë dhe krijimin e mundësive për hartimin e politikave që lehtësojnë komunikimin e tyre me vendin dhe i informojnë njerëzit jashtë vendit për zhvillimet në Kosovë.

Të nderuar, të respektuar deputetë,
Këto ishin disa pika të shkurtra të Programit të Qeverisë të Republikës së Kosovës në periudhën mandatore 2008-2011, të cilin në formë të shkruar e keni marrë me kohë. Ky program është evolutiv dhe do t'u përshtatet nevojave zhvillimore të kohës.

Me kënaqësi e pres vlerësimin tuaj, sugjerimet tuaja, të cilat do t'i inkorporojmë dhe programin do ta bëjmë më cilësor për Kosovën dhe qytetarët e saj.

Të nderuar deputetë,
Në fund, dëshiroj të bëj përsëri një sqarim. Ky Program është dorëzuar vetëm një ditë pas nxjerrjes së Kushtetutës së shtetit të pavarur, sovran dhe demokratik të Kosovës. Ky program nuk është i përkryer, por është më i miri i mundshëm për kushtet, rrethanat ekzistuese. Ne, në ditën e themelimit të Qeverisë, të aprovuar nga partnerët e koalicionit dhe opozita demokratike, e kemi paraqitur ekspozenë hyrëse bazë të Qeverisë. Natyrisht, dikush ka pritur që të prezantoj program të Kornizës Kushtetuese, jo janë mashtruar ata. Qytetarët më kanë votuar të prezantoj program shtetëror të Kosovës. Dikush edhe mund ta quaj propagandë, por ata që sot e quajnë punën e Qeverisë së Republikës së Kosovës e kanë quajtur propagandë edhe shpalljen e pavarësisë vetëm 48 orë para se të shpallet. Ju faleminderit!

KRYETARI: Falënderoj Kryeministrin e Kosovës për prezantimin.
Sipas radhës, në debat janë shefat e grupeve parlamentare. Shefi i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, zotëri Ramë Buja.

RAMË BUJA: Të respektuar kolegë deputetë,
I nderuar zoti Kryetar,
I respektuar zoti Kryeministër dhe Kabinet qeveritar,

Unë ju falënderoj shumë për këtë Program të ofruar, që vërtet është program i perspektivës së Republikës së Kosovës. Ju falënderoj në veçanti për një ndërrim të një koncepti të çuditshëm të një maksime popullore nga e thëna në të bërë, është në mes një det i tërë. Ju, në radhë të parë e keni bërë, e pastaj na keni thënë, dhe kjo është mirë në kuptimin më pozitiv të mundshëm, sepse keni dashur që vërtetet të mos përfilisni rreth asaj kornize që na pat kornizuar e lidhur këmbët, por të flisni me logjikën e Kushtetutës së Kosovës, dhe ju falënderoj në veçanti. Andaj, unë po ju them që falënderoj edhe opozitën e nderuar, sepse mbase po të isha në pozitën e juaj, kështu do të kisha bërë si ju. Por, e kuptojmë pozicionin tuaj, sinqerisht e kuptojmë dhe ju falënderojmë që po përpiqeni për t'u konsoliduar dhe vërtet kjo është e mirë, sepse nuk ka mundësi të ketë Qeveri të fortë pa një opozitë të fortë.

Unë uroj që sa më parë të konsolidohet dhe të forcohet opozita për ta sfiduar seriozisht Qeverinë aktuale. Por, unë zotëri Kryeministër, vërtet u jam shumë mirënjohës, sepse

unë po ndihem mirë në këtë pozicion që jam, me punët, angazhimin konkret që ka bërë dhe po bën Qeveria aktuale e Kosovës. Unë po ndihem mirë kur rruga më është e zënë dhe me makinë pres 10-15 apo 20 minuta për të shkuar në një vend të caktuar, sepse punohet në rrugët e Kosovës. Unë po ndihem shumë mirë, në këtë pozicion që jam për faktin që e kemi caktuar si prioritet arsimin në Kosovë, dhe në fakt po punohet seriozisht për arsimin në Kosovë.

Andaj, unë po ju them që, në fillim të fjalës sime, ju përgëzoj, ju uroj dhe ju dëshiroj të gjithë sukseset e mundshme dhe, natyrisht, do të keni gjithsesi mbështetjen dhe ndihmën tonë. Ju faleminderit!”

KRYETARI: Ju faleminderit!

Fjalën e ka shefi i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, zotëri Lutfi Haziri.

LUTFI HAZIRI: Ju faleminderit,
Zoti kryetar,
Zoti kryeministër,
Anëtarë të Kabinetit të Kryeministrit Thaçi,

Unë desha edhe më herët, në pjesën debutuese ta marrë fjalën, por Kryetari, i koncentruar vetëm në anën e majtë të tij, kah opozita, nuk e ka përcjellë monitorin për ta paraqitur qëndrimin e Grupit Parlamentar të LDK-së. Sidoqoftë, profesori Sabri Hamiti e paraqiti atë pjesën e parë të angazhimit, e LDK-ja ka kërkuar respektim të procedurave sipas vendimit të Kryesisë së Kuvendit dhe, realisht, në këtë rrafsh duhet të mësohemi të angazhohemi, në mënyrë që procedurat të mos shkelen.

Kthehem në temë. Natyrisht që Grupi Parlamentar i LDK-së e mbështet Programin qeveritar të paraqitur sot nga Kryeministri Thaçi. Mbështetja jonë bazohet në angazhimin tonë edhe duke qenë partneri kryesor i qeverisjes, edhe duke qenë të vetëdijshëm se ministrat nga radhët e LDK-së në Kabinet kanë marrë pjesë aktive në punimin e këtij Programi punues. Ministrat kanë qenë pjesë e angazhimeve konkrete për ta pasuruar vizionin apo për ta zbërthyer këtë version në program politik për një periudhë më afatgjatë. Natyrisht që besojmë thellë, si grup parlamentar, që ky Program, kjo bazë programore e mirë për të ardhmen e Kosovës, ka politikën e qarta sektoriale, të ndërtuara në afate kohore, në programe ditore, javore, periodike dhe, po ashtu, përgjegjësia që ndërtohet në raport me ne legjislativin, do të respektohet jashtëzakonisht shumë.

Natyrisht, deputetët nga radhët e LDK-së, përveç mbështetjes që i bëjnë programit, do ta pasurojnë me diskutimet e veta. Ata janë ftuar sot që të jenë pjesë konstruktive i këtij debati, duke dashur që roli ynë të jetë edhe më shumë, edhe më produktiv, edhe më pjesëmarrës, në mënyrë që programi ynë, në kuadër të këtij Kabineti, vërtet të rezultojë me suksese, me angazhimet tona të përbashkëta ta përmirësojmë jetën. Dhe, më lejoni krejt në fund, të përshëndes edhe njëherë paraqitjen tuaj përmes kësaj informate që e dhatë të 100 - ditorit, dhe kjo ditë ka qenë e veçantë në kuadër të angazhimeve tona, sepse Presidenti adresoi fjalën e tij dhe adresimi ishte i lidhur ngushtë edhe me këtë program, edhe me kërkesën e tij, si figura më e lartë e unitetit të vendit, që institucionet tona dhe ne të angazhohemi në realizimin e programeve tona.

Andaj, kjo ndërlidhje e angazhimeve dhe kjo paraqitje e raportit sot këtu, tregon qartë se Qeveria ka marrë mbi vete barrën e madhe të realizimit të këtij programi, për të cilin ne nuk kemi asnjë dyshim. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, zotëri deputet!
Sipas radhës, Grupi Parlamentar i AKR-së. Deputeti Ibrahim Gashi.

IBRAHIM GASHI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!
Ju faleminderit zoti Kryeministër për ekspozenë lidhur me Programin e Qeverisë. Ishte gjithëpërmbledhës dhe, natyrisht, i tillë çfarë mund të thuhet në seancë këtu. Do të doja ta korrigjoja pak zotëri Bujën, që adresoi tek opozita diçka. Opozita sot po dëshmon konstruktivitet dhe pjekuri të lartë politike dhe me këtë po dëshmon se është po aq për shtetësinë e Kosovën, sa të gjithë që janë këtu.

Problemi kryesor tek programi i Qeverisë, i ofruar në versionin çfarë është ofruar në fakt, është qasja e tij, janë më tepër qëllime që mund të formulohen lehtë në letër, por është mungesa kryesore e ofrimit të mekanizmave të qartë, që sjellin deri tek qëllimi. Pra, nuk siguron asnjë garanci të prekshme kundër deficitit implementues. Ta zëmë, i tërë raporti përbëhet nga qëllime madhore dhe detaje minore. Gjëja më e detajizuar është se, do të citoj: “do të miratohet kjo strategji, do të bëhet ky plan”, por ajo që ka nevojë të thuhet është: “do të implementohet kjo strategji, do të implementohet ky plan”.

Është e rëndësishme të kuptohet drejt ky paragraf, sepse i tërë programi, veçanërisht politikat sektoriale, bujqësia, telekomunikacioni, arsimit, janë të një fryme të tillë. Përpos asaj që secili mund të kuptoj se është një lulishte e vërtetë, Planit i mungon konsistenca dhe ka diskrepancë të vazhdueshme. Nëse thuhet se do të rishqyrtohet politikat fiskale, thotë rishqyrtohet politika fiskale, që unë e kuptoj, lexo: “uljen e tatimeve”, me qëllim të përmirësimit të shkallës së konkurrencës, në aspektin rajonal dhe në të njëjtën kohë proklamohet zgjerimi i skemës sociale pa precizuar se si do të mbulohet kjo pjesë e humbjeve në bazën buxhetore, do me thënë për mua është goxha e pakuptueshme. Kjo i bie kështu, për shembull: nëse tatimi në korporata ka qenë 20% dhe nëse Kosova ka mbledhur 150 milion euro nga kjo, atëherë këtu humben rrafsh 70 milion euro. Nga kjo rezulton që buxheti në krahasim me atë të kaluarin, do të jetë 75 milion më i ulët. Buxheti edhe ashtu është shumë i ulët, shumë i vogël për ta mbuluar skemat sociale e lëre më të flitet edhe për shpenzimet shtesë.

Tek zhvillimi ekonomik, shtetet kanë 2-3 zakonisht kanë 2 -3 instrumente për të infuzionuar ekonominë, politikën fiskale, politikën monetare, huat, por një mund të jetë edhe investimi në kapitalin social, përkatësisht në njerëzit e mençëm, pra investimin në mendje.

Kosova nuk ka politikë monetare, huat nga jashtë janë shumë të limituara në mungesë të kapitalit financiar shtetëror, atëherë mbetet politika fiskale dhe kushtimisht edhe investimi në kuadro. Për arsye që e përmenda më herët, politika fiskale është shumë e ndjeshme. Zvogëlimi i tatimeve, sado që në një shkallë të caktuar edhe mund të ndikojë në zhvillimin ekonomik, përmes atraktivitetit të investimeve të huaja, nuk të jep siguri të mjaftueshme se kjo do të funksionojë. Për shembull, Mali i Zi i ka ulur tatimet tej mase për 5 vitet e shkuara, por kjo nuk ka ndikuar që të ketë trende pozitive të rritjes ekonomike, andaj nuk ka ndonjë plotësim apo arsyetim në këtë rast se çka do të bëhet në rast se ndodhë e njëjta gjë.

Plani nuk ofron asnjë instrument mbrojtës nga shoku asimetrik, rastet emergjente, tërmete, fatkeqësi elementare. Do me thënë, nuk ofron asnjë mënyrë apo politikë që e mbron popullatën nga rritja e çmimeve globale, gruri, nafta, vaji etj. Këto janë komoditete përbërëse të secilit racion ushqimor dhe të prodhimit. Kjo i ngjanë arsyetimit të Qeverisë së kaluar, kur thoshte se nuk ka ku të stacionojë rezervat e grurit, prandaj nuk kemi rezerva shtetërore.

Papunësia: Nuk paraqitet asnjë instrument që garanton zvogëlim, qoftë edhe 1% të papunësisë. Ndërkohë, nuk sqarohet se me çfarë skemash do të mbulohen këta të papunë. Nuk dëshiroj të besoj se Qeveria pret që vetëm me projekte nga donacionet e huaja ta luftojë në këtë mënyrë papunësinë.

Aviacioni: Aftësimi i Aeroportit të Gjakovës dhe investimet në Aeroportin e Prishtinës po, por qysh, me çfarë fondesh, ku do t'i marrin ato para dhe kur?

Bujqësia dhe zhvillimi rural: I njëjti sindrom, thuhet se do të zhvillohet bujqësia, do të bëhet kjo apo ajo, por nuk tregohet si dhe kur. Për shembull, një mundësi është përmes politikave fiskale negative, uljes së tatimeve në fitim dhe subvencioneve. Ndërkohë, këtu tregohet qëllimi, por nuk tregohet mjeti deri tek arrija e tij. Në mungesë të këtyre sqarimeve kjo është e barabartë me diçka që më shumë më përshtypje se nuk mund të implementohet se sa mund të implementohet derisa nuk është dhënë sqarimi deri në fund.

Ambienti: Është paradoksale që mbrojtja e ambientit përmendet më shumë se sa varfëria. Kuptohet se çështja e ruajtjes së ambientit në vendet me zhvillim të ulët ekonomik, është sfidë për krejt qeveritë, do me thënë ka koston e vet dhe, në këto rrethana, Kosova duhet të tejkalojë së pari varfërinë, e pastaj të fokusohet shumë në ambient.

Shëndetësia: Këtu nuk kam shumë koment, sepse nuk kam parë diçka konkrete, prandaj nuk ka skema të caktuara, apo instrumente të politikave publike që e rregullojnë këtë.

Pensionet: Nuk është shumë kredibile ajo çfarë thuhet, nuk ka diçka të re përpos asaj që ka qenë edhe nga politika e kaluar.

Implementimi i Statusit: Kjo është pjesa ku në fakt të gjithë, edhe njerëzit nga opozita, edhe nga pozita kanë dhënë vlerësime pozitive për punën e Qeverisë. Ne kemi qenë aq të ndërgjegjshëm sa të themi në të gjitha deklaratimet se Qeveria ka bërë punën e saj madhore në implementimin e vullnetit të qytetarëve të Kosovës për shtet të pavarur. Kjo ka ndodhur dhe nuk e mohon askush. Mirëpo, në krejt këtë, do me thënë, ka pasur edhe aleatë të fortë për ta kryer këtë punë edhe opozitën, edhe faktorin ndërkombëtar.

Tek pjesa, për shembull e aviacionit, te kjo implementimi i statusit dhe ato që burojnë, nuk është përmendur fare themelimi dhe pastaj konsolidimi i Agjencionit të hapësirës ajrore të Kosovës, e që shprehimisht parashihet në planin e Ahtisarit. Futja e këtij Agjencioni në prioritetin e Qeverisë është e paevitueshme nga se ky Agjencion përbën një nga shtyllat kryesore të kontrollit të hapësirës ajrore, përkatësisht të kontrollit të një segmentit të sovranitetit të Republikës së Kosovës.

Themelimi i këtij Agjencioni para 15 qershorit duhet të konsiderohet si prioritet për Qeverinë. Po ashtu nuk është cekur edhe as krijimi i legjislacionit përkatës për funksionimin e këtij Agjencioni. Unë nuk do të marrë kohë më shumë. Në një rast tjetër mund t'ua them, duke qenë se i konsideroj të gjithë kolegë të mirë dhe mund të bisedojmë. Këtu thashë atë që kemi vërejtur ne si Grup parlamentar për një kohë tepër të shkurtër sipas nesh, që e kemi pasur në dispozicion. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Sipas radhës, shefi i Grupit Parlamentar të AAK-së, deputeti Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Anëtarë të Qeverisë, a keni pushuar, more, a keni ndenjur vonë mbrëmë goxha? Na keni lënë edhe neve, në atë farë Reality Show, më të famshmin që ka ndodhur ndonjëherë në Kosovë. OK.

I kemi disa probleme të kuptojmë dhe është mirë që në këtë fatkeqësi, është një fat që të gjithë njerëzit janë dëshmitar dhe shohin se çka ndodhë. Ky është fati, fat i mirë është që kemi Kuvend ku flitet dhe që njerëzit shohin. Do t'i përmendi fillimisht vetëm dy paradokse që i kam vërejtur këtu të vogla. Presidenti i Kosovës, në fjalën e tij e cila lidhet me Programin e Qeverisë edhe me Raportin 100-ditësh, thotë se universitetet nuk guxojnë të jenë institucione profitabile. Ju lutem, të njëjtën kohë Kryeministri thotë: 100% ekonomi të tregut. Merruni vesh në mes veti njerëz, se janë të ndryshme këto çështje, nuk janë bashkë.

Një çështje tjetër, të cilën do ta përmend, është se Kryeministri thotë se rreth 40 shtete e kanë njohur Kosovën. Edhe fëmijët e shkollës fillore po shkojnë në ueb-faqen Kosovothankyou edhe po i shohin sa janë, a janë 37, a 40, a 50. Po shndërrohet në normë mashtrimi publik duke manipuluar me shifra. Rreth 40, nuk janë rreth 40, dihet saktë cili është numri.

Te programi, do të ndalem pak. Ky program i Qeverisë nuk e përmban as edhe një datë të vetme përpos datës 17 shkurt. As edhe një numër të vetëm përpos numrave të paragrafëve, 3.1.6, 3.1.7 etj. etj. Këto janë çka ka. Sikur ta kishim parë një element programor, i cili thotë: Taksat në duhan dhe në alkool, të cilat i marrim sot, gjenerojnë 1 milion euro në buxhet, ne do t'i dyfishojmë këto taksa dhe do t'i nxjerrim 2 milion euro, dhe me ato 2 milionë euro do t'ua rrisim nga 1000 euro mësuesve, ne kishin parë që ka program, se po shihet kur fillon, kur mbaron, cilat janë shifrat.

Tjetra është se kjo Qeveri, as pas 100 ditëve të punës nuk ka mbërri të nxjerrë diçka të qartë në letër edhe të vijë e të na tregojë, kështu duam të bëjmë. Fjalitë kryesore të cilat gjenden ose togfjalëshat kryesorë të cilët gjenden në këtë program janë: do të provojmë, do të tentojmë t'i gjejmë mënyrat, etj. etj. etj. Do të duhej, çka s'ka. Shikoni, për shembull, te pensionet, vetëm te pensionet. Nxirrni programin dhe shihni. Të gjitha premtimet janë bërë për pensione në Kosovë, vetëm tre reshta ekzistojnë në program edhe do t'i lexoj këta tre reshta që ta shihni edhe ju vet se çfarë plani për pensionet ka Qeveria e Kosovës. Thotë kështu: "Vazhdimi i sigurimit të pagesave të pensioneve dhe shikimi i mundësimeve për harmonizimin e vlerës së shportës së ushqimi, shikimi i mundësive në përputhje me trendin kohor të çmimeve, si dhe pagesa e pensionit suplementar për kontributdhënësit në ish sistemin e kaluar pensional". Fjalë për fjalë e citova, nuk e kam hequr, as nuk e kam shtuar asnjë fjalë. Tani, kur i kanë vizituar pensionistët, ju kanë thënë, ne e dimë qysh, i kemi mjetet, i kemi mënyrat, i kemi krejt. Sot po thonë, do ta shohim mundësinë.

Tjetër, tek rritja e kapacitetit fiskal të komunave. Paramendoni çka thotë për komuna Programi i Kosovës. Thotë kështu, prapë po citoj, veç dy rreshta janë: “Komunat të krijojnë kushte për rritjen e shkallës së pavarësimit buxhetor, duke zgjeruar gamën e të hyrave vetanake dhe duke ngritur shkallën e inkasimit”. Fund. Stop! Mbaroi.

Çështja tjetër, reformat në administratën publike, puna më e madhja, janë nja katër rreshta, nuk po i lexoj, me të vërtetë lexoni vet, është turp. Ky dokument më tepër i ngjason një dokumentit të cilin e kish përgatitur...dhe i kishte rekomanduar Qeverisë se në cilat pika duhet fokusuar, me çka duhet të merret Qeveria. Por, ky program nuk është. Programi dihet kur fillon, sikur mbrëmë Reality show, thotë në orën 8,00 fillon, në orën 11,30 mbaron. Nëse nuk ia tregon kohën kur, atëherë duhet t’i thuash, dikur kah mbrëmja fillon.

Edhe në fund, do me thënë, të pjesës për Programin, po them, nëse përpos programit, tani shikohet edhe strategjia legjislative të cilën e kemi marrë më herët dhe bashkohen të dyja, shihet me të vërtetë që nuk ka asnjë sens më të voglin të qeverisjes. Ajo nuk është strategji, është listë e ligjeve të cilën e kemi lënë ne edhe zëvendëskryeministri me 3 mars thotë: 170 ligje kemi për t’i sjellë, 50 i kemi kaluar, kanë qenë gati, edhe nja 20 të tjera janë gati, të tjerat nuk ia kanë nisur as të bëhen. Mirëpo, Qeveria ka mbërri të bëjë diçka. Unë po ju kallëzoj çka mbërri të bëjë. Mbrëmë kemi dëgjuar që në Kosovë u bë edhe Kosova A-6, sefte kam dëgjuar unë në Kosovë ka A-6. Atëherë, kemi parë që, do me thënë, njerëzit duhet të kenë kujdes çka flasin, se duhet të jenë të disiplinuar njerëzit në Kosovë se çka po flasin, se nuk bën të flasin gjithçka, se nëse flitet gjithçka, kush e di se çka të ndodhë.

Dua të flas pak edhe për njohjen ndërkombëtare, që janë dy pjesë të dështimeve të Qeverisë, vetëm dy minuta t’ua marrë për Raportin. Te njohja ndërkombëtare, a mendon dikush prej jush këtu që t’i quajmë të gjitha vendet të cilat po i lusim të na njohin, që janë numër, i ndihmon njohjes ndërkombëtare? A e dini ju që Kryeministri i Kosovës ka thënë në televizion që deri më tani ka përfunduar njohja kualitative edhe krejt vendet të cilat na po i lusim të na njohin, i ka quajtur numra, i ka quajtur vende kuantitative. A mendoni ju që i ndihmojnë njohjes së Kosovës nga ana e Maqedonisë deklaratat e përditshme të Kryeministrit – Maqedonia nesër ka për të na njohur. Nuk i ndihmon as njëra, as tjetra. Do me thënë, një pjesë të fajit pse janë vetëm 37 vende që na kanë njohur, e ka Qeveria. Kjo Qeveri e ka atë pjesë të fajit.

Një pjesë tjetër e dështimit total të Qeverisë, dhe ky ndoshta është dështimi më i madh, që nëse nuk kemi kujdes, ka për pasur pasoja afatgjate për Kosovën, është Mitrovica, njerëz. Qeveria ka dështuar të japë edhe idenë më të voglën se qysh të zgjidhet problemi në Mitrovicë. Ne e dimë që nuk mundet vetëm, nuk kemi iluzione, por nëse kjo Qeveri ka dështuar të japë edhe idenë më të voglën për të bashkëpunuar me bashkësinë ndërkombëtare, qysh të zgjidhet çështja e Mitrovicës, atëherë ne kemi dështuar të gjithë. Asnjë ide të vetme, vetëm ka pritur dhe ka këqyrë në seri.

Tani të kthehem vetëm nja dy minuta te çështja e Raportit të 100-ditëshit, meqenëse Kryetari vet tha se do të kemi mundësi pak të flasim...

KRYETARI: Ju lutem deputetë, dëgjoni!

ADRIAN GJINI ... kështu është ë fjala, nuk e kam pasur në plan të ndalem vetëm te ministri i Mjedisit dhe ta demoloj ministrin e Mjedisit. Kam dashur të flas më gjatë, por tash më duhet ta demoloj veç këtë, sepse nuk kam kohë.

Shikoni çka ka në Raport të 100-ditëshit, vetëm shikoni ju lutem! Ministrisë së mjedisit, kam qenë ministër, tash jam ish ministër dhe i di, këto i di të paktën. Thotë kështu: “Inicimi i procedurës për kompensimin e pronave në kompleksin memorial Adem Jashari”. A e dini, bre, kur ka nisur ai Kompleks memorial i Adem Jasharit. A ka nisur në këto 100 ditë, a? Që tjetra: “Vazhdimi i punëve për ndërtimin e kanalizimit, lagja III në Skenderaj”. Kush është prej asaj ane, e di kur ia ka nisur. Tjetra: “Fillimi i punëve në Ujësjellësin e Banjës së Pejës”. Tjetra: “Sanimi i deponive të vjetra në Gjakovë, Prizren, Kaçanik”. Nuk po vazhdoj, njerëz, qytetarët e dinë, janë aty, ata e dinë kur kanë nisur këto projekte. Edhe nëse unë i marrë katër ose pesë faqe të pjesës së Ministrisë së Mjedisit, dhe i nxjerr vetëm dy aktivitete që mund të thonë që janë nisur për këto 100 ditë, shumëzoni me krejt dokumentin që i ka 260 faqe. Njerëz, vetë kanë shkuar në administratë dhe ju kanë thënë: - Nxirrni në listë krejt çka është duke bërë Ministria, dhe vinë e na thonë ne se i kemi bërë për 100 ditë. Unë mendoj se në këtë mënyrë po instalohet mashtrimi publik si normë në Kosovë, Njerëz, të gjithë e dinë dhe askush nuk flet. Duhet të flisni, duhet të flasin njerëzit. Është mashtrim publik, të gjithë e marrin vesh. Unë ju falënderoj për vëmendjen. Edhe njëherë po them, shumë faleminderit që kemi një platformë që mund të flasim, se përndryshe na i kanë mbyllur edhe mediat, sikur mbrëmë, për shembull. Regjimet brirë nuk kanë, kështu ia nisin, ta mbyllin foltoren, ta mbyllin median, t’i kontrollojnë krejt çka ka për të kontrolluar dhe kështu ia nis. Ju faleminderit, zoti Kryetar!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Lus deputetët që të mbajnë qetësi, nën një. Në dy, jeni lajmëruar për fjalë, keni të drejtë ta merrni fjalën kur t’ju vijë radha, por vërtet të dëgjohet edhe mendimi i kundërt, se në fund të fundit, kjo është përgjegjësi edhe e pozitës, edhe e opozitës. Tani, në radhë është shefi i Grupit Parlamentar të LDD-së, zoti Lulzim Zeneli. Deputet, e keni fjalën!

LULZIM ZENELI: Ju faleminderit, zotëri Kryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë, anëtarë të Kabinetit qeveritar, fatkeqësisht Kryeministri nuk është këtu të dëgjojë, ndoshta ka edhe angazhime të tjera.

Por, një çështje që do të duhej t’ia shtronim si pyetje kësaj Qeverie para se të fillojmë debatin për këtë dokument që është ofruar për diskutim, me të vërtetë a ka Qeveria tjetër dokument, pos kësaj që do të shërbejë si bazë për punën e vet, e nëse jo, atëherë lirisht mund të konstatojmë këtu.

Këtë dokument nuk po e quaj program. Mund të jetë gjithçka tjetër, vetëm program jo! Mund të jetë koncept, vizion, analizë, gjithçka, në gjithë terminologjinë e mundshme, mund ta përdorim dhe ta adresojmë në kuadër të këtij dokumenti, vetëm program jo. 80% ose më shumë se 80% të pjesës përbërëse të këtij dokumenti nuk ngjason në Program, nuk ka objektiva programore. Nuk ka elemente që mund ta identifikojmë se vërtet cila është baza mbi të cilën është mbështetur koncepti i kësaj Qeverie. Është vështirë edhe të flitet për këtë dokument. Mua, me të vërtetë më vjen shumë keq për një partner të koalicionit qeverisës, i cili, të paktën, ka pasur një traditë, ka pasur një kulturë sidomos në hartimin e dokumenteve. Dhe, ajo çfarë do të them tash, do të ishte, vërtet, a kanë marrë pjesë ministrat e Kabinetit qeveritar në hartimin e këtij dokumenti? Nëse po, atëherë kjo është më shumë se skandaloze.

Kjo Qeveri do të mbahet mend sepse pas 100 ditëve të punës së vet na ka ofruar një dokument që është mëdyshje më e madhe se si ka arritur të punojë në mënyrë ad-hoc në realizimin e punëve të përditshme, do të thosha. Është folur shumë se “s’kemi pasur kohë”. Është folur shumë se “ka qenë periudha e statusit të Kosovës”. Me të vërtetë është një mega-deklaratë që është adresuar nga ana e Qeverisë. Mirëpo, në qoftë se kemi për bazë atë çfarë na ka servuar në këtë dokument, më herët e quajta skandaloze, dhe tash them: shikoni vetëm një element – me shumë eufori kjo Qeveri i adreson përmes këtij dokumenti, thotë: “katër prioritete të kësaj Qeverie – rritja ekonomike, implementimi i statusit, qeverisja e mirë, zbutja e papunësisë, e varfërisë dhe stabilitetit social”. A e dini ku ngjason kjo frazë? Standardet para statusit! Njëherë ta zhvillojnë ekonomikisht vendin, pastaj ta implementojnë statusin dhe, tek dikur më vonë, të fillojnë zbutjen e varfërisë dhe zvogëlimin apo stabilitetin social. Do të thotë, krejt mbrapsht. Është vërtet shumë vështirë të gjesh element që mund të thirresh në programin e kësaj Qeverie. Mirëpo, me shumë keqardhje që e vlerësoi mjaft punën që është kah e bën, arsimi nuk është prioritet i kësaj Qeverie, siç është proklamuar kohë më herët dhe nuk shoh të paktën asnjë fjalë që ka të bëjë me hapa konkret përmes këtij dokumenti.

Në këtë dokument, të nderuar profesorë të Universitetit, që jeni sot prezentë, asnjë fjalë më e vogël nuk ka të bëjë me shkencën. Mirëpo, siç dihet, paska qenë kapaciteti shumë i kufizuar i atij personi që ka formuluar këtë dokument.

E shohim këtu një fjalë: “Kjo Qeveri angazhohet për vazhdimin e reformave dhe ristrukturimin e sistemit energjetik”. Definitivisht, kjo Qeveri pajtohet për punën që është bërë në kontinuitet rreth sistemit energjetik të vendit dhe vazhdon t’i zhvillojë ato reforma që janë instaluar shumë më herët, derisa pasqyra tjetër, në aspektin e energjisë së vendit shihet qartë. Është pikëpyetje e madhe si ka mundur që gjatë periudhës të fushatës me aq guxim dhe eufori të proklamohet një strategji, një vizion, dhe tash dy rreshta nuk i kemi në këtë platformë, në këtë dokument, në të cilat do të mund të thirremi si në pika referente apo orientuese.

Ekonomia. Degët kryesore të ekonomisë, për të cilën është pretenduar se janë bazë për ecje të sigurt përpara e që e çojnë këtë vend drejt një krijimi të stabilitetit, sipas këtij dokumenti, asgjë konkrete nuk ka.

Profesor Ramosaj, do t’me kritikojë më vonë kur ta marrë fjalën, por asnjë dëshmi, asnjë pikë referente, asnjë objektiv nuk ka si do të zgjerohet baza tatimore e këtij vendi.

Flitet shumë për politika fiskale, tatimet, por nuk përmendet asgjë konkrete. Përmenden investime të huaja, por Qeveria s’i tregon se cilët do të jenë ata hapa që bien deri te joshja e këtyre investimeve.

Pagat. Shikoni, nën firmën e këtyre pagave është zhvilluar krejt procesi i fushatës zgjedhore. Këtu asnjë element nuk i adresohet kësaj problematike, për të cilën, jam i bindur, si shumë qytetarë të Kosovës se do të presin me ëndje çka do të flitet sot në Kuvendin e Kosovës, sidomos për sistemin e arsimit dhe sistemin e shëndetësisë, për të cilin dokument, nuk kam fjalë se si do ta quaj.

Më vjen shumë keq, këtu e kemi edhe ministrin e shëndetësisë, në këtë rast, për të cilën është proklamuar një vizion shumë më i qartë, hapa konkretë, e bile-bile, në këtë dokument përmenden projektet afatshkurtra dhe afatmesme, derisa gjendjen e kemi buzë

kolabimit. Nuk përmendet asnjë hap konkret se cila do të ishte rruga konkrete në zbutjen, të paktën daljen nga kjo krizë e thellë që e ka kapluar sistemin shëndetësor të vendit.

Pak më herët, kryeministri ceku se “e kemi gjetur një gjendje shumë të rëndë”. Nëse e shikojmë strukturën e udhëheqjes të sistemit shëndetësor të vendit, pas luftës e deri më tash, atëherë diçka s’është në rregull me këtë deklaratë. Keni vazhduar vazhdimisht dhe e keni prurë kolabimit total. Mjekët e dinë mirë, dhe jo vetëm këta, çka do të thotë kjo.

Më herët e kërkoja fjalën si shef i Grupit Parlamentar dhe nuk m’u dha mundësia të shprehem rreth raportit apo informatës. Shikoni, është shumë vështirë që kjo Qeveri, apo njerëzit të cilët i proklamojnë këto politika, nuk e kanë të qartë, së paku nga aspekti i formulimeve të dokumenteve që kanë të bëjnë me raport apo me program. Këtë raport që e kemi marrë më herët, ngjason në strategji, në analiza dhe në vlerësime, bile-bile ishte një kapitull, ku thotë: “strategjia e integritetit”. Me të vërtetë, në qoftë se edhe Qeveria e Kosovës krijon strategji, që nuk do të ishte punë e një ekzekutivi të një vendi, se krijon strategji ekzekutivi, këtu nuk po shoh. Është vështirë të gjesh diçka të tillë këtu konkrete.

Unë kam qenë në mëdyshje a ta marrë fjalën apo jo, por po shoh se klima çfarë po adresohet në Kuvendin e Kosovës është që të iket në maksimum, jo për shkak të numrave, sepse pozita i ka numrat, por për shkak të komunikimit me opinionin dhe ajo është, do të thotë, më shumë se skandaloze. Nuk kemi një mundësi të tillë që të vjen në sprovë diçka çka mund të ndryshojë këtë koncept të kësaj Qeverie. Mirëpo, përveç disa iniciativave që janë ndërmarrë, që shihet se ka iniciativa konkrete në punën e kësaj Qeverie, në këtë dokument nuk figuron asgjë. Nuk figuron asgjë dhe është për të ardhur keq si është e mundur një kabinet qeveritar, që thirret në teknokraci, në superstrukturë, në politikë kadrovike, ta pranojë këtë dokument. Ky është realiteti ynë! Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Sipas radhës, nga Grupi Parlamentar “7+” shefi i Grupit, deputeti Zylfi Merxha.

ZYLFI MERXHA: Përshëndetje, zoti President i Kosovës, i nderuari Kryetar Jakup Krasniqi!

Përshëndes Kryeministrin dhe zëvendëskryeministrat, së bashku të gjithë ministrat,

Përshëndetje për kolegët e mi deputetë, për ata që jemi shumë kohë këtu dhe për këta që kanë ardhur tash. Kisha një nafakë të keqe që më ra pas dy diskutuesve shumë të mëdhenj, që dinë të flasin dhe unë afër tyre do të dukem shumë i vogël, mirëpo çka të flas do të flas prej zemrës dhe të vërtetën.

Ky Parlament, prej ditës së parë e di si është formuar, në 2001-shin, po ashtu kemi pasur do të dhëna: jo ky ka punuar, jo ky s’ka punuar, mirëpo askush s’ka thënë se prej që jemi dalë nga lufta shumë kemi bërë shumë. Fola për të parin. Për të dytin, ia nisi shumë mirë, por nuk zgjati. I treti, çfarë kujtojmë ne. Populli po e di a mundet ndokush për 90 ditë, po edhe ta kishin atë shtagën që thonë “qiribu-qiriba” s’munden këta me i pas meritat. Meritat janë të kësaj Qeverie që i kam pas veti, që udhëheq zoti Kryeministër Thaçi me ministrat e vet dhe që ka bërë aq shumë dhe le që jemi Republikë, kemi pavarësinë, por krejt bota u çua në këmbë dhe thotë: kush është kjo Kosovë, sa është kjo Kosovë? Këtë po e harrojmë, sepse ne duam ta ulim dikë, t’ia humbim vlerën dikujt, por me ia humb vlerën dikujt nuk është mirë, ose bile duhet bërë real e t’i thuash, e ke bërë këtë, e këtë, e këtë jo dhe jo, është reale.

Unë s’po di çka s’ka bërë, që t’i them, këtu para jush. E di që të gjitha të mirat i ka bërë.

Një po ua them, këta ministra, që i kam prapa, të gjithë i kanë yjtë, të cilët yje, disa yje japin dritë më shumë disa më pak, por ai që vizëlloi ishte Kryeministri Thaqi, në krye të tyre. Unë s'kam aq shumë fjalë të them, por ta dini se së shpejti Kosovës do t'i marrin lakmi për rrugën që e ka marrë. Faleminderit!

KRYETARI: Radhën e ka Grupi Parlamentar – SLS. Fjalën e ka deputeti Branislav Gërbiq.

BRANISLAV GRBIĆ: Pošto Bojan Stojanović nije tu, ja ću umesto njega nešto reći.

Poštovani Predsedniče,

Poštovani zameniče i poštovani ministri,

Dragi delegati,

Kao učesnik u prošlom sazivu Vlade Kosova mogu i imam pravo da od prilike kažem nešto što je sigurno u interesu svih građana Kosova, uključujući tu, znači i predstavnike Srpske zajednice i sebe kao predstavnika Srpske zajednice da kažem da smatram da svaki program vlade je dobar onoliko koliko je primenljiv i koliko je moguće iskoristiti od svih pretpostavki da jedna vlada može da uspe u tom programu.

Sigurno da je tu potrebno ne samo podrška vlasti, nego i podrška građana Kosova i svih onih koji žele da stvore jedan prostor u kome će se svi osećati sigurno i u kome će svi videti svoju budućnost. Prema tome, smatram da svaki program je dobar u onoj meri koliko je on primenljiv i koliko je prihvatljiv od svih nas i u onoj meri koliko međunarodna zajednica posmatra sve nas i smatra da smo u tom kontekstu svi spremni da prihvatimo jedan izazov koji se zove, znači, život na Kosovu.

Kao takvo, smatram da sigurno i opozicija ima pravo da u svom tom kontekstu izlaganja, kroz svoj rad smatra da je u nekom delu moguće da se neke stvari isprave i da smatraju da su u tom smislu i oni u pravu.

Sigurno da bez opozicije ne može ni program vlade da uspe i da se da, znači, podstrek vladi. U tom kontekstu smatram da samo vlada može da bude jača i da ima svoj cilj i zadatak da istraje na tom putu koji je zacrtan u jednom tom periodu svoje vladavine.

Smatram da sigurno ima dosta da se toga odredi. Jedan od vodećih pitanja i jedno od vrlo pragmatičnih pitanja, kao što je spomenuo i kolega, je i severna Mitrovica. Znači, tu su problemi koji su bili i koji traju i koji će sigurno biti još deo i programa ove vlade. To je znači jedno multietničko poverenje i multietnički život na prostorima Kosova, znači za jedan zajednički život svih predstavnika zajednice na Kosovu. To je znači jedan ozbiljan problem koji ova Vlada ima pred sobom i koji treba da se reši i smatram da će ona biti toliko uspešna ako taj problem reši, jer treba mnogo stvari da se odrede tu, treba mnogo poverenja za koje je potrebno vreme koje je već prošlo i vreme koje dolazi.

Znači, ujedno ispred Poslaničke grupe želim da još jednom zahvalim svima vama na učešću u ovom Programu, znači premijeru na izlaganju i ujedno da ćemo biti tu da samim tim i prisustvujemo i našim izlaganjem da damo podršku da ovaj program uspe. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit! Pra, ne përfundua me shefat e grupeve parlamentare. Tani do të japim një kohë për pauzë deri në orën 15, dhe pastaj do të fillojmë diskutimin, me të paraqiturin për fjalë Sllavisha Petkoviq.

Vazhdimi i seancës pas pauzës

KRYESUESI IBRAHIM GASHI: Të nderuar deputetë, lus t'i zëni vendet për të vazhduar punën.

Sipas raportit të fundit, në sallë janë të pranishëm 76 deputetë dhe janë kushtet e plotësuara për vazhdimin e punës së seancës.

Para se të fillojmë me diskutime, nëse ndokush nga deputetët është i interesuar ta dorëzojë diskutimin e vet me shkrim, atë mund ta bëjë. Vazhdojmë debatin. Fjalën e ka deputeti Sllavisha Petković.

SLAVIŠA PETKOVIĆ: Ja sam danas vrlo iznenadjen, da kažem vrlo frapiran sa ovim papirima koje držim na ruke. Prvo sam ih dobio u momentu kada sam ušao u salu i još su vrući, verujte. Jos su vrući! Znači još, tek toliko o tome, ozbiljnost.

Drugo, ja o ovome stvarno ne znam šta da kažem. Za mene je ovo jedna gomila papira koje nigde veze nema. Ja bih voleo da mi je neko rekao za ovih sto dana tačno i konkretno šta je uradjeno, ali ništa.

I sad, nešto što mi je upalo u oko! Ne bih intervenisao posebno za ministra da premijer nije sam inicirao i spomenuo dva ministra, između ostalog i ministra za povrata.

Ovde ja vidim, kaže: „šta je Ministarstvo realizovalo za 100 dana“. Znači, ja čitam kako je napisano. Ovo su projekti, koji nigde veze nemaju, tako da premijer treba da obavesti ministre kada je izveštaj i da ne sme da pišu nešto što nije, da ne bi upotrebio neku drugu reč.

Znači, ovo ovde što je napisano, ako mi sada neko, premijer ili ministar kaže kada i gde je ovo uradjeno, evo ja sam spreman pred svima vama da pojedem ovo! Odmah, evo, pred svima, bez vode i bez ičega ja ću pojesti sada ovo ako mi neko kaže datum, vreme i gde je ovo uradjeno, ili ovo što je napisano. Tako da, gospodine premijeru, treba da kažete ministrima da kad pišu da vode računa, ovo je ipak Parlament i moramo da pričamo kako jeste. Ja znam da to vama ne odgovara, ali dobro – kakva Vlada, takvi i ministri! Vrlo prosto. Ja se sećam kampanje, za izbore i sva ona velika obećanja koja nam je premijer davao tada, doduše da ne kažem da nisu uradili ništa, jesu. Pre ove vlade nismo imali struju po tri sata, a sada nemamo struju po šest sati. Pre ove vlade je bilo po dva sata čekanja na putevima, sada čekamo po ceo dan. O vodi, da i ne pričamo. O standardima, i o njima nećemo da pričamo.

Ali, nešto što me čudi ovde i meni je žao što moram da spomenem ovde čoveka, a vidim da nije tu. Ne čudi mene premijer. Premijer mora da brani sam sebe, to je sasvim normalno i ako brani nešto što ne može da brani, ali dobro. Doćiće vreme i za to. Čude me znači moji bivši partneri, moji bivši prijatelji sa kojima sam bio u tri vlade, koji pristaju da premijer ovde proziva bivšu vladu u kojoj, sadašnji šef Poslaničkog kluba, na žalost, nije tu i mislio sam da će biti tu, bio zamenik premijera i ministar u dve vlade. Znači premijer kaže znate kako „haos“, „korupcija“ i tako dalje i tako dalje, a sa njima ste partneri. Sada meni tu nešto nije jasno. Sada, stvarno ja nešto tu ne razumem. I gde isti taj, koji je bio zamenik premijera u bivšoj vladi, izlazi ovde i brani vladu i kaže mi smo zajedno, mi radimo, mi smo partneri. Ja sad stvarno ne razumem s kim ste vi partneri. Ja

stvarno ne razumem. Ako ste partneri sa onima sa kojima ste zatekli mito, korupciju i haos kažete da je prošla vlada, u toj vladi vi ste danas partneri sa njima. Znači samo me to čudi malo i ništa drugo.

Ja ne znam, stvarno sam očekivao da za 100 dana rada vlade pokaže nešto. Ja znam, bio sam ministar u tri vlade a ne u jednoj. Za svaku od 100 dana vlade, od Vlade Ramuša Haradinaja, Bajrama Kosumija i Agima Čekua uvek kada smo govorili o 100 dana rada vlade, davali smo publikaciju, taksativno šta je koje ministarstvo radilo i pulus taksativno šta je plan i program, šta će se dalje dešavati. Ovde smo dobili „fontanu lepih želja“, jednu publikaciju ovde s kim se to premijer sastane svaki dan, s kim pije kafu i tako dalje, to naravno verovatno narod ne interesuje.

I ova slika pozadi lidera Evropske unije, bolje da ste stavili sliku ove sirotinje koje nema hleba da jede na Kosovu pošto ih ima mnogo, nego da slikate lidera Evropske unije. Stvarno, jer ako ste hteli iz svih vaših priča koje ste dali u kampanji i svih lepih govora koje ste pričali ovde kada ste postali premijer od toga niste napravili ništa.

Evo, ja vam to kažem najotvorenije i drugo vi dajete sebi kao najveći rezultat to što ste potpisali Deklaraciju o nezavisnosti. Gospodine premijeru, i tu Deklaraciju ste potpisali tako što su prethodne tri vlade napravile sve da bi došli do te deklaracije, tako da i to nije vaša zasluga. Znači, ni sa tim ne možete da se kitite. To je samo jedan produkt koje su sve vlade radile i na kraju se to završilo, vama je zapalo da to potpišite, ni krivi ni dužni ali – dobro. Tako da ja u stvari danas ne znam o čemu mi uopšte danas razgovaramo. Plan Vlade nemamo. Nemamo šta je koje ministarstvo radilo i to što ovde piše ima dosta neistina, prema tome danas smo samo, gospodo, izgubili vreme i ništa drugo.

Drugo. Ja na primer, od pola 12, dižem ruku i po poslovniku ne mogu da dobijem reč iako je predsednik Parlamenta dužan da mi to da, i sada da obavestim sve – Berlinski zid je srušen 88. Komunisti su od 88. pao, tako da diktature nema, gospodo. Ovo je Parlament, demokratija, demokratija je da se saslušamo. Nekom se sviđa šta pričamo, nekom se ne sviđa, ali i ja moram da slušam kada vi pričate, iako mi se ne sviđa i vi morate mene da saslušate iako vam se, ja znam, ne sviđam, ali to je ipak demokratija. Tako da za mene, verovali ili ne, iako nisam bio dugo vremena u Parlamentu, eto danas samo sam izgubio dan i pregledao ovu gomilu papira i ništa nisam razumeo ovde.

KRYESUESI: Faleminderit nga deputeti! Radhën e ka deputeti Bahri Hyseni, le të përgatitet Donika Kadaj.

BAHRI HYSENI: Faleminderit, zoti kryesues!

Përshëndetje zoti Kryeministër, zëvendëskryeministra dhe ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Që në fillim, zoti Kryeministër, së bashku me kabinetin qeveritar, ju përgëzoj për një punë shumë efektive, shumë të palodhshme, transparente dhe gjithsesi të guximshme.

Natyrisht, që gjatë mandatit tuaj, por natyrisht edhe me iniciativë dhe ndihmën e të tjerëve, kemi arritur që Kosovën ta shpallim shtet të pavarur dhe sovran, tanimë të njohur ndërkombëtarisht. Gjatë mandatit tuaj kemi arritur që të nxjerrim aktin më të lartë legjislativ të vendit dhe padyshim kemi bërë edhe simbolet shtetërore. Për këtë, qytetarët e Kosovës s'kanë pasur asnjë dilemë, sepse Kryeministri dhe njerëzit që tani gjenden në Qeveri kanë udhëhequr procese edhe shumë më të rëndësishme se këtë që kemi.

Do të përqendrohem pak rreth programit qeveritar, që e kemi para veti dhe konsideroj se para veti kemi një program shumë të qartë, objektiv, real por edhe program i cili ofron perspektivë për qytetarët e Kosovës dhe për institucionet në të cilat gjendemi edhe ne.

Qeveria, në mënyrë objektive dhe shumë të qartë, ka përcaktuar prioritetet të cilat tanimë, edhe në praktikë, kanë filluar të zbatohen, për ata që dëshirojnë me i pa. Në mënyrë të qartë, ka përcaktuar këtë program dhe kushtet e zhvillimit ekonomik, që unë po i përmendi vetëm disa prej tyre: energjinë dhe minierat, transportin, sundimin e ligjit, administratën publike, edukimin dhe të tjera.

Unë do të ndalem vetëm në disa nga fushat, për të cilat konsideroj që në fillim është parë një punë shumë e mirë. Po ndalemi te menaxhimi i financave publike, që konsideroj një prej fushave me të cilat matet edhe rezultati i punës së Qeverisë.

Nëse i marrim dhe i krahasojmë zërat e buxhetit, shumë qartë shihet se zëri i buxhetit për investime kapitale, është trefishuar dhe kjo nuk bëhet për të mirën e kabinetit qeveritar por bëhet për të mirën e qytetarëve të Kosovës dhe padyshim në mënyrë të detajuar në këtë raport përmenden infrastruktura rrugore, e cila ka filluar që në fillim të mandatit dhe ky efekt dhe këto procedura që kanë filluar tani dëshmojnë se në përfundim të mandatit nuk do të kemi buxhet që do të na kalojë në vitin vijues dhe projektet do të mbeten pa u realizuar. Prandaj, ky është menaxhim shumë i mirë. Ju e dini si na ka ndodhur që në fund të viteve kalendarike buxhetore mbesin gjysma e projekteve mu për shkak të procedurave që i kemi filluar një muaj para përfundimit të vitit të buxhetit fiskal.

Çështje tjetër, është çështja e zërit tjetër – mallrat dhe shërbimet. Secili që dëshiron me parë e sheh se Qeveria, përmes akteve të fundit që i ka nxjerrë, këtë kategori të mallrave dhe shërbimeve apo shpenzimet të them më mirë i ka reduktuar në atë masë sa që nga këto përfitime do të përfitojnë vetëm qytetarët e Kosovës. Po i përmendim disa prej tyre.

Tanimë është lehtë të qarkullohet në rrugët e Kosovës, pengesat mund të jenë pengesa teknike por për shkak të punës, por është më lehtë të kalohet për shkak të lëvizjeve të pakta të veturave qeveritare dhe gjërave tjera. Dhe në kuadër të kësaj hyjnë edhe shpenzimet për letër. Edhe letrën do ta shpenzojmë sepse është çështje e buxhetit. Mbi të gjitha, për shkak të kufizimit të shpenzimeve në sfera të ndryshme, për shkak të lëvizjeve të kufizuara që do t'i kenë edhe shërbyesit civilë, e në këtë rast edhe kabineti qeveritar sepse do të bëhej me leje të veçanta, ne do të përfitojmë me dhjetëra milionë euro, të cilat pastaj Qeveria mund t'i destinojë nëpër fusha përkatëse për infrastrukturë të ndryshme, qoftë për edukimin, qoftë në infrastrukturë për të bërë një jetë më të mirë për qytetarët.

Një çështje tjetër, padyshim nuk mund ta kalojmë, edhe pse Qeveria ka qenë shumë modeste dhe në programin e saj nuk ka paraparë edhe planin legjislativ që do ta ketë shumë të ngjeshur. Edhe kjo është çështje shumë me rëndësi. Diku, mbi 40 ligje janë përcjell dhe pritet të përcillen, sipas aktivitetit legjislativ, edhe mbi 100 të tjerë. Kjo është punë dhe për këtë meritojnë të kenë respekt, sepse shumë fusha ende nuk janë të rregulluara me legjislacion dhe ju e dini që njëra prej formave të integritimeve në Bashkimin Evropian do të jetë që ne t'i plotësojmë këto zbrazësi me infrastrukturë ligjore.

Mbi të gjitha, unë do t'i përmend edhe disa çështje me interes që Qeveria i ka bërë në aspektin e legjislacionit dhe kjo u pa edhe mbrëmë, kur me qëllim të ngritjes së nivelit, kanë ngritur edhe dy komisione ad-hoc të cilat do ta ndihmojnë punën e Kuvendit. Dhe,

për të siguruar një legjislacion të qëndrueshëm, stabil dhe me shumë kompetencë, ka përcaktuar që dy nga zëvendëskryeministrat të udhëheqin me këto komisione dhe natyrisht se ne në Kuvend do ta kemi shumë më lehtë sepse deri tani na janë servuar, në mungesë të këtij filtri, edhe ligje për të cilat nganjëherë kemi pasur probleme. Prandaj, për këtë ju përgëzoj sepse na e keni lehtësuar punën në komisionet parlamentare.

Çështje tjetër me interes është çështja e reformave në administratën publike. Unë jam shumë mirënjohës që së paku për këto 100 ditë pune Qeveria e Kosovës nuk ka pasur në prioritet ndërhyrjen në shërbimin civil të Kosovës. Ju e dini sa na ka kushtuar ndërhyrja në profesionalizëm. Ajo ka ndikuar aq shumë sa që ka ndikuar në efektin, në krijimin e institucioneve demokratike dhe mbi të gjitha ka ndikuar edhe për raporte, të cilat kanë ardhur nga Bashkimi Evropian dhe në shumtën e rasteve edhe janë kritikuar.

Prandaj, në këtë program, mbështetja për reformën e administratës publike është e qëndrueshme, është për t'u përkrahur, sepse ne e kuptojmë se kemi një administratë shumë të re, të krijuar vetëm pas luftës dhe kemi nevojë që të kemi trajnime shtesë, të kemi specializime në fusha të ndryshme dhe kjo gjithsesi do t'i ndihmojë në rend të parë institucioneve të Kosovës, e më pastaj do t'i ndihmojë edhe qytetarëve, sepse një administratë efikase në mënyrë efikase do të kryejë edhe shërbime para qytetarëve të Kosovës.

Një çështje tjetër me interes që përmendet në programin e Qeverisë, është çështja e sundimit të ligjit dhe kjo shihet më mirë kur në këtë program parashihet që t'i jepet edhe një fuqi.....

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet Hyseni!

Tash kemi mundësinë për zgjatjen e fjalimit. Çfarë mendoni ju, lidhur me këtë? Unë mendoj se duhet ta respektojmë dhjetëminutëshin të gjithë, sepse radha e diskutuesve është mbi 50, deri tash.

Faleminderit, deputet Hyseni! Fjalën e ka deputetja Donika Kadaj dhe të bëhet gati Fatmir Rexhepi.

DONIKA KADAJ: Faleminderit!

Të nderuar,

Derisa Kryetari i Kuvendit e ngulfat në vazhdimësi debatin, në mënyrë që të mos dalin dështimet e Qeverisë në shesh, në pauzën për kafe, një kolegë imi nga pozita më thotë – “këqyr çka po flet, mos na kritiko se t'i ngrehim veshët”! Paramendoni ku ka mbërri ky institucion dhe në çka është shndërruar. Prandaj, Qeveri e nderuar, kthjelluni dhe sqaroni konceptet. Kthjelluni dhe mos i përzini konceptet sepse Kosova është vend demokratik, i lirë e i pavarur dhe e ka vendin në Evropë, prandaj konceptet tjera nuk janë pjesë e Kosovës, as e këtij Parlamenti.

Tjetra. Dihet mirëfilli se reklamë i bëhet një produkti jokualitativ, që nuk shitet në treg, që s'ka kualitet të plasohet vetë, prandaj investohet në të. Mirëpo, kur ky investim bëhet me paratë e tatimpaguesve kosovarë, është e dhembshme.

Të nderuar,

Kjo broshurë këtu, përveç fotografive të bukura, nuk përmban asgjë tjetër në veti. Mirëpo, kushton edhe shumë shtrenjtë. Kushton shumë shtrenjtë dhe paguhet nga mjetet e

tatimpaguesve, nga ato para për të cilat Kryeministri, në fushatën e tij ka premtuar se do të bëjë investime kapitale dhe cilat janë ato investime kapitale: – 3 milion shtesë në zyrën e tij për mallra dhe shpenzime, nuk është investim kapital, ju lutem.

Qeveria po thirret, do të thotë, në mirëqeverisje të mjeteve buxhetore, mirëpo kemi shumë lëshime të cilat do të paraqiten në këtë Kuvend dhe shpresojmë se këtu do të na lejohet debati dhe të mos ndodhur sikur kjo sot. Derisa Kryeministri flet për një mirëqeverisje, Presidenti mburret me shpalljen e pavarësisë së vendit, por mos harroni se pikërisht me datën 17 shkurt kjo strukturë tentoi të përvetësojë një ngjarje që erdhi si finale e një procesi të gjatë, të përgjakur dhe me shumë sakrifica dhe hezitoi të paktën të përhëndet ata të cilët në këtë proces janë më meritoret. Me sjelljet e tilla, Qeveria tentoi të regjionalizojë vendin.

Të nderuar, neve na duhet një Kosovë si tërësi dhe jo me rajone e lokacione të ndryshme.

Nëse dita e mirë shihet në mëngjes, vaj halli për vendin. Paramendoni, si kemi filluar? Para një ore, ose, realisht para dy orëve dëgjojmë një informatë që diku thuhet raport e diku informatë, e që na është dhënë në shqyrtim mbas 12, sepse sipas Qeverisë s'është punë e deputetëve të debatojnë për punën e Qeverisë. Dhe, më pas, në rend dite kemi programin dhe çfarë programi. Program i paraqitur pas një vonese të madhe dhe pas presionit të madh nga opinioni publik. Është më së paku program dhe cilësohet më tepër si ide fillestare në stilin: “sa bukur do të dukej vendi”.

Në program janë një numër i madh projektesh që janë hartuar nga qeveria e kaluar dhe është paraparë që tanimë të jenë në funksion. Mirëpo, për shkak të mospunës së Qeverisë, ka ngecur.

Objektivat e tjera, që parashihen në këtë program, nuk janë të detajuara, nuk janë konkrete dhe nuk ka strategji të implementimit të tyre e as afate kohore. Lëshimet e mëdha vërehen sidomos në zhvillimin e sferave më të rëndësishme për vendin: ekonomia, energjetika, arsimi, shëndetësia e tjera. Në përgjithësi, gjatë shqyrtimit të programit, vërehet se është bërë një identifikim i problemit. Si për shembull: Kosova ka probleme me furnizim me energji elektrike dhe çka, të gjithë e dimë, por cila është zgjidhja për këtë problem dhe kur ky problem do të zgjidhet. “Qeveria do të hulumtojë mundësinë, do të bëjë këtë, e atë...” por nuk ka strategji konkrete se si do ta bëjë këtë.

Ky është një shembull se si është përpiluar dhe çka përmban ky program, i cili, gjatë gjithë kohës të japë një ndjenjë se Qeveria është një organizatë e madhe joqeveritare që ka identifikuar problemet në një vend të largët jashtë Kosovës dhe tani po i prezanton si të arritura.

Të nderuar, në vazhdim do të ndalem tek fusha e arsimit. Gjatë leximit të programit, para syve më rrinte një bildbod i shtrenjtë, i dizajnuar bukur, ku thuhej: “Kush do t’ju rrisë rrogat? – Hashim Thaçi”! Ky premtim iu bëhej punëtorëve të arsimit. Ndërkaq, sot, në programin e paraqitur, nuk parashihet asnjë rritje rrogash në këtë mandat. Domethënë, edhe me këtë rast, janë mashtruar mbi 27.000 familje ose 27.000 mësimdhënës, të cilëve iu është thënë se Qeveria do t’ua rrisë rrogat. Prandaj, lëreni marketingun e lajmet për kompjuterizim. Shikoni realitetin dhe kërkoni falje për të gjitha të pavërtetat që keni plasuar në opinion.

E nderuar Qeveri,

Deri në këtë moment, ju humbët hapin e kohën dhe vendin nuk mund ta drejtoni përpara. Prandaj, si deputete e Kuvendit të Kosovës, kërkoj që të përfundoni me defilime mediale dhe t'i përvisheni punës, sepse fushata elektorale mori fund dhe Kosova nuk ia ka borbx askujt të mbetet peng i mospunës, mosdijes dhe neglizhencës tuaj. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, deputete Bujupi! Fjalën e ka deputeti Fatmir Rexhepi, le të përgatitet Melihate Tërmkolli. Ju lutem, për replika, vetëm nëse thirren ministrat me emër ose Kryeministri, përndryshe nuk mund të paraqitni për fjalë.

FATMIR REXHEPI: Faleminderit, zoti kryesues! Përshëndetje për kolegët deputetë, Kryeministrin dhe anëtarët e Qeverisë,

Tani që po e bëjmë një debat lidhur me programin e Qeverisë për periudhën katërvjeçare 2008-2011, mendoj se rëndësia e tij qëndron që secili prej ne të kontribuojmë që sa më mirë të kemi perspektivë në drejtimin e zhvillimit dhe ndërtimit të vendit tonë.

Janë dy mundësi këtu në Parlament, të kemi një qasje konstruktive dhe përkrahje parimore apo të zgjedhim tjetrin – të bëjmë marketing dhe propagandë, ashtu sikur që nganjëherë dimë të bëjmë.

Unë mendoj se do të kontribuoj me pjesën e parë. Prandaj, që të kemi një program të mirë të një qeverie, ai mund dhe duhet të vlerësohet se ofron dhe përmban objektivat strategjike, si dhe planin e veprimit konkret të Qeverisë në aktivitetet të cilat i takojnë, siç janë pra ndërtimi i shtetit dhe forcimi i demokracisë, stabiliteti politik dhe siguria e qytetarëve, stabiliteti ekonomik, zhvillimi dhe siguria për investime të jashtme dhe të biznesi vendor, fondet dhe financim të qëndrueshëm për të financuar sektorë të shërbimeve publike të gjitha fushave, investim dhe zhvillim të gjithanshëm në infrastrukturë apo organizim dhe funksionim i mirë i shërbimeve të Qeverisë jo vetëm për qeverisje brenda por edhe shërbim diplomatik dhe të gjithë asaj performance që i duhet integriteteve të vendit, si dhe drejtimet dhe reformat që kanë të bëjnë lidhur me transformimin e pronës, privatizimin pas një përvoje që e mori koha e shkuar, apo edhe drejtimet makroekonomike të karakterit zhvillimor në mënyrë që të kemi një zvogëlim të papunësisë.

Prandaj, këtë debat, unë e shoh se në fund do të kemi një rezultat i cili do të tregojë për të gjitha këto synime të cilat duhet t'i kenë një program, kështu që na takon si deputetë dhe unë po ashtu do të ndaj disa vërejtje të mia parimore për t'i kontribuar këtyre drejtimeve të caktuara.

E shoh të rëndësisë politike, për shkak të koalicionit qeveritar, për shkak të partneritetit në pjesëmarrje në Qeveri që në hyrje të programit të definohet më qartë se a ekziston koalicioni qeveritar apo jo, e cila nuk është pjesë në kuadër të këtij programi. Është e mira e rëndësisë politike, sepse kujtoj se programi politik bazat e programit për funksionimin si parlament dhe si qeveri duhet të garantohen pra që në hyrje të programit për qytetarët dhe për detyrimet që i kanë subjektet politike, në këtë rast PDK, LDK dhe grupimet tjera në koalicion për qeverisjen e vendit që kujtoj e ka një vend më të mirë se kjo që është dhënë në program, dhe për mos me dalë pastaj në atë pjesën tjetër që mund të shërbejë vetëm si marketing.

Në pajtim me hisen që i takon LDK-së këtu, unë e shoh se faza 100-ditore ka qenë kohë e mjaftueshme që të kemi një program dhe këtë që e kemi para veti dhe ky program të shtohet dhe të karakterizohet edhe me disa çështje të tjera në vendosjen e figurave apo

konkretizimit me vlera dhe shuma të caktuara në mënyrë që të bëjmë një krahasim pas katër viteve se si e filluam qeverisjen dhe si do ta lëmë qeverisjen në fund të mandatit tonë.

Në kuadër të kësaj, unë për shembull do të them se çfarë është drejtimi i politikave makroekonomike, a ka vend që të thuhet synimi, për shembull dhe të synohet të arrihet brenda katër viteve, sepse nuk e kemi këtë aty. Meqë e kemi Kryeministrin këtu, sa do të jetë GDP-ia ose bruto-produkti i vendit, a është ky që duhet të jetë përafërsisht 2 miliardë apo 4 miliardë. Lidhur me këtë, sa do të jenë shpenzimet ashtu siç i planifikoni, në mënyrë që të bëjmë një krahasim nesër edhe për investimet kapitale por edhe sa do të jetë shkalla e zvogëlimit të papunësisë, deri në cilën shkallë synojmë të arrijmë, a synojmë të arrijmë deri në 30% apo 25%, sepse nuk mund të themi 30, sepse është vështirë, por deri ku synojmë të arrijmë.

Prandaj, të mos mbetet kjo e mangët, unë kujtoj se në këtë drejtim duhet të kemi një konkretizim sa i përket edhe synimeve të tjera, pra të mos jetë pjesë e programit e të themi se ne do të kujdesemi për shoqërinë e Kosovës për këtë, e këtë. Kujdesi është diçka tjetër. Nuk jemi ne shoqëri e ligë dhe e sëmurë, por ka diçka tjetër që duhet ne si Qeveri ta bëjmë bashkërisht.

Ajo që dua të them, ka të bëjë me atë që për 4 vite – deri në vitin 2011, si deputet dhe qytetarë do të doja ta di se cili është synimi ynë i përbashkët i kësaj Qeverie, a mundemi që pagat nga 200 euro për arsimtarin, për policin, për mjekun në shëndetësi ose në administratë pagat që janë nga 200 euro të planifikojmë ose synojmë të arrijmë në 400, 500 apo së fundi në 300 e jo kështu siç është. Mendoj se kjo e konkretizon, e fuqizon dhe garanton një besim të qytetarit tek programi ynë.

Pastaj, për shembull politikën në sektorin e energjetikës. Në këtë rast, te objektivat konkrete, mendoj se duhet pasuruar këtë dhe të thuhet se çka synojmë, e jo sikur tash që kemi thënë. Unë po e shoh këtu synimin 24 me 0. Nuk po e them ashtu, por duhet ta di përafërsisht synimin e Qeverisë tonë deri në vitin 2011, e nuk po them të 2009-shit dhe çka do të bëjmë me prodhimin vendor. Këtë mund ta dimë për katër vite, qoftë për termocentrale a do të jetë 800 megavate, a do të jetë 1100 megavate, pra duhet kjo të jetë e konkretizuar në mënyrë që ta dimë se kjo do t'i përmbushë disa nevoja elementare për të kaluar në një fazë tjetër të ngritjes së kapaciteteve me një strategji. S'do të bëj pra llafë për termocentralin C, sepse është çështje tjetër. Por ka rëndësi të madhe të thuhet se do të ndërtojmë rrjetin e transmisionit të lartë, në cilat drejtime – kaq kilometra, sepse janë të nevojshme dhe ato mund t'i parashohim në program, por nuk janë. Ose, do të kemi furnizim të energjisë, apo inkasim jo të kësaj shkalle çfarë është sot, bie fjala 52 ose 58% por duhet të synojmë të themi do ta kemi 90% dhe i plotësojmë ato standarde që vërtet të duhet ky sektor ta kryejë misionin e vet.

Ngjashëm do ta theksoja vërejtjen time parimore edhe te sektori i infrastrukturës. Në faqen 17, thuhet atje se “investimet me interes kombëtar, gjeopolitik dhe gjeostrategjik janë të përfshira në program”. Meqenëse është program katërvjeçar, për çka edhe kam debatuar edhe më herët lidhur me këtë vit, por kjo ka shkuar, prandaj unë dëshiroj të shoh aty sepse mendoj që është në interes gjeopolitik dhe gjeostrategjik që të futet edhe në kuadër të programit, nëse është harruar për 2008 që kemi biseduar këtu edhe me Kryeministrin dhe me ministrin, rruga pra Gjilan ose Prishtinë-Gjilan-Bujanovc. Për këtë mendoj se jemi të njëjtë mendim, por në program katërvjeçar duhet të ekzistojë. Ose, për shembull, atë që e ka thënë Kryeministri për hekurudhat. Nëse e lexojmë programin,

unë kisha dëshiruar që programi mos të thotë kështu për hekurudhat. Thuhet “për hekurudhat”! Cilat hekurudha? Brenda Kosovës, apo ku? Në cilat drejtime, a kemi për të shkuar prej Ferizajt - në Viti e Vranjë apo do të kemi këtu tjera. Ka rëndësi kjo! Nuk po bëj hajgare, po singërisht po ju them se ka rëndësi kjo dhe duhet të jetë pjesë e programit, sepse mund të thuhet nesër për katër vjet, por s’kemi mund ta bëjmë këtë dhe s’bëhet kiamet i madh, por duhet ta kemi në program.

Kam edhe një vërejtje timen parimore, që ka rëndësi për ndërtimin e një qëndrimi dhe një politike për mbrojtjen e resurseve natyrore. Pra këtu duhet të ketë qëndrim, që nuk është brenda programit, për burimet e ujit dhe resurset, sikur që kanë praktikuar edhe vendet tjera në programet e qeverive të tyre. Pra, ato duhet të jenë të siguruara në mënyrë që nesër të mos kemi privatizim apo diçka tjetër sepse na mbetin qytetarët edhe pa mal edhe pa ujë.

Në përfundim, pra edhe duke e çmuar vëmendjen dhe kohën, unë me gjithat shoh të gjithë këtë debat dhe interesimin tim për një përkrahje parimore, por duke qenë i vetëdijshëm se vërtetë kjo të plotësohet, pasi që jam shumë i interesuar që ky program qeveritar të jetë në funksion të atij programi politik që e ka koalicioni qeverisës dhe të përmbush ato objektiva elektorale për një zhvillim të qëndrueshëm të shtetit të ri, por edhe si përgjegjësi, them, që e ka edhe Lidhja Demokratike e Kosovës për këtë program politik, për këto qëndrime politike, për këto objektiva programore për qytetarët dhe gjithë asaj kohe që kemi marrë pjesë në fushatë dhe pas fushatës, pra për një koalicion qeveritar.

KRYESUESI: Faleminderit, deputet Rexhepi! Fjalën e ka deputetja Melihate Tërmkolli, le të përgatitet Safete Hadërgjonaj.

MELIHATE TËRMKOLLI: Faleminderit zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Unë mendoj që programi i Qeverisë së Kosovës është një dokument tepër i vonuar dhe arsyetimet e Kryeministrit me pavarësinë, janë shumë të papranueshme, për të mos thënë – banale dhe joserioze, sepse është shumë e qartë që këta përfaqësues të institucioneve kanë qenë më shumë aktorë sesa faktorë në procesin e finalizimit të pavarësisë së Kosovës. Madje, kur është kërkuar ndonjëherë përgjegjësi nga ta, qoftë gjatë procesit të bisedimeve apo edhe më vonë, gjithmonë janë arsyetuar se kjo çështje është në duar të ndërkombëtarëve.

Mund të them se programi nuk ka asgjë të përbashkët me një program të mirëfilltë qeveritar. Do të ndalem në dy-tri pika që kujtoj janë të rëndësishme jo vetëm për sot, por mendoj edhe për brezat që vijnë. Në këtë program flitet për luftën kundër korrupsionit dhe për asnjë hap konkret, por përveç ndërhyrjes joligjore që veç e konfirmojnë logjikën diktatoriale të kësaj qeverie.

Deklarohet për luftë kundër korrupsionit, ndërsa zoti Thaçi, keni drejtuar një politikë e cila është e identifikuar me instalimin e korrupsionit të paparë në vend.

Të përkujtojmë vetëm periudhën e pasluftës në Kosovë, uzurpimet e tmerrshme të pronës dhe pasurisë së qytetarëve të Kosovës, pompat e benzinës, kontrabandën, krimin e organizuar. Të përkujtojmë krimet e rënda politike që u bënë dhe kurrë nuk u zbuluan dhe nuk u dhanë sqarime se kush e vrau Enver Malokun, kush e vrau Xhemajl Mustafën, kush

e vrau Shaban Manajn, kush e vrau Smajl Hajdarajn, kush e vrau Ukë Bytyqin, Ismet Rracin, veprimtarë dhe atdhetarë të devotshëm të vendit.

KRYESUESI: Të lutem, deputete, përmbaju rendit të ditës!

MELIHATE TËRMKOLLI: Ju, me disa bashkëmendimtarë – edhe të LDK-së, para pak kohe gati e dogjët Parlamentin për një palë syza, për të fshehur miliona të dyshuara për keqpërdorime.

KRYESUESI: Ju lus, përmbajuni rendit të ditës dhe të ruheni nga kualifikimet.

MELIHATE TËRMKOLLI: Unë mendoj se duhet të jepet përgjegjësi edhe për syzat dhe, më falni, sepse jam duke folur rreth programit dhe rreth një pike shumë të rëndësishme të programit qeveritar. Të lutem, mos më ndërprej! Po e përsëris, duhet të jepet përgjegjësi edhe për syzat, për paditë institucionale dhe jo ato të dosjeve nga rrugët, zoti Thaçi, që i keni bërë ju. Për miliona po rrinë, po mrizojnë me vite në gjykatat e Kosovës. Po e përmend vetëm një rast – 124 mijë eurot e ministrit Krasniqi në atë kohë të MSHP-së, për të cilat kurrë nuk u sqarua dhe ajo padi kurrë nuk e mori formën e prerë. Nuk di çka keni bërë me gjykatat.

Zoti Thaçi, sa njerëz të qeverisë tuaj janë pjesë e korrupsionit. Mendoj se duhet ta sqaroni para qytetarëve të Kosovës. Kjo Qeveri, në emër të duarve të pastra, e ka përlyer fytyrën, zoti Thaçi.

KRYESUESI: Një herë, është mirë të flisni lidhur me programin, të diskutojmë.

MELIHATE TËRMKOLLI: Po flasim për AKM-në, flasim për PTK-në njerëzit e të cilave i keni në Qeveri. Cili është morali i kësaj Qeverie, kur, po e zëmë, po flas vetëm për njërin nga ministrat, që personalisht s'them se kam diçka personale me të – zoti Ahmet Shalën, me pasaportë të huaj merr 7.000 euro – ka marrë nga AKM, nga buxheti i Kosovës dhe flet për moral. Më falni, këta njerëz flasin për moral në këtë vend.

Me këtë gjendje, është problem dhe s'di si do ta luftoni korrupsionin, zoti Thaçi.

Edhe një çështje tjetër, që mendoj se duhet ta sqaroni para qytetarëve të Kosovës dhe ajo është se – sa persona të SHIK-ut i keni në Qeveri, zoti Thaçi.

KRYESUESI: Zonja deputete, të lutem, konform pikës së rendit të ditës, duhet t'i përmbaheni.

MELIHATE TËRMKOLLI: Janë këto çështje, të cilave duhet t'iu jepni përgjigje para qytetarëve të Kosovës.

Unë mendoj se kjo Qeveri, megjithatë, ka bërë diçka.

KRYESUESI: Kjo që thoni, nuk është në përputhje me rendin e ditës. Edhe një herë po ua tërheq vërejtjen para se të ndërprej.

MELIHATE TËRMKOLLI: Zoti kryesues, mos më ndërprej dhe mos m'i merr minutat.

KRYESUESI: Shikoni, në cilësinë e kryesuesit, konform Rregullores, mund edhe të ndërprej.

MELIHATE TËRMKOLLI: Kjo qeveri, ka bërë diçka të mirë dhe iu ka treguar qytetarëve të Kosovës se si nuk duhet të qeveriset në veçanti në kohën e pavarësisë.

KRYESUESI: Ju lutem, rikthehuni te programi, nëse doni të mos ju ndërprej.

MELIHATE TËRMKOLLI: Mendoj se ka më shumë demagogji krejt në këtë program sesa një esencë. Imazhi i jashtëm artificial veç e konfirmon këtë zbrazësi.

Tash të them edhe dy-tri fjalë rreth informatës, të cilën e dhatë, e që doli se është as raport e as informatë, një raport që është shumë voluminoz për 3 muaj të punës dhe të veprimit në krahasim me një program të punës që pretendohet të jetë për 4 vite e që, siç e thashë më herët, nuk do me thënë shumë. Tre muaj, nuk është edhe periudhë e gjatë për të pritur rezultate. Kjo është shumë e qartë për të gjitha qeveritë, mirëpo qasja e deritanishme, mendoj se është shumë e gabuar dhe false. Pavarësia nuk lidhet me asnjë miligram të punës së kësaj Qeverie. Mos mashtroni, zoti Kryeministër! Pavarësia është rezultat dhe themel, të cilat janë vu shumë – shumë më herët dhe kjo Qeveri, për secilin, e çmoj kontributin, por si mekanizëm i organizuar institucional asnjë miligram pune nuk e keni rreth pavarësisë së Kosovës. Edhe çështjet tjera që lidhen me ligjet, flitni për ato rezultate. Mbi 90% të punëve që i keni kryer deri tash dhe që keni për t'i kryer tërë vitin, e ndoshta edhe tërë mandatin, janë rezultate të punës së Qeverisë paraprake dhe unë këtë nuk e konsideroj si mangësi, e konsideroj përparësi të kësaj Qeverie, e cila e ka vazhduar punën dhe që mendoj se është mirë, është mirë sepse janë punë të mira për Kosovën. Tëra ligjet e Presidentit Ahtisari kanë qenë të gatshme deri tash dhe shumica e ligjeve organike janë të gatshme, dhe veç janë duke u proceduar në Parlamentin e Kosovës. Shumica e projekteve kapitale janë po ashtu pothuaj të realizuara ose janë në finalizimin e tyre nga Qeveria paraprake. Dhe, unë ju uroj dhe përgëzoj për këtë vazhdimësi të cilën e keni bërë, sepse mendoj që është në interes të vendit dhe duhet të vlerësohet si e tillë. Ju faleminderit shumë!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka Kryeministri, zoti Hashim Thaçi.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Ne sot kemi prezantuar Programin e punës të Qeverinë për mandatin qeveritar për vitin 2008-2011 dhe fillimisht dua të ritheksoj fuqishëm se koalicioni aktual është duke funksionuar shkëlqyeshëm dhe i falënderoj të gjithë partnerët për punën, përkushtimet, vullnetin, përgjegjësinë shumë të lartë shtetërore, por në të njëjtën kohë Qeveria s'i zë të gjithë.

Tjetër. Programi që është prezantuar sot, nuk është program partiak. Është Program i Qeverisë së Kosovës. Është program i të gjithëve. Këtu nuk jam që të polemizoj, por të sqaroj se duhet të udhëtoj dhe shpresoj se kryesuesi do ta sqarojë çështjen.

Puna mediale, është përmendur shpesh, por është mrekulli të kesh transparencë. Transparenca është vlerë, jo propagandë. Duhet bërë dallimin e propagandës komuniste nga transparenca, hapja, komunikimi me qytetarët, komunikimi i drjetëpërdrejt, por edhe transparenca në raport me qytetarin, transparenca është ajo që e çon vendin dhe e zhvillon demokracinë prandaj këtë duhet kuptuar si vlerë të Qeverisë së Kosovës dhe natyrisht

partneritet të ngushtë me shoqërinë civile, mediumet dhe të gjitha të tjerat. Gjithashtu, falënderoj për përkrahjen e plotë, veçanërisht të koalicionit por edhe të opozitës demokratike për luftën ndaj korrupsionit.

Unë nuk dua të merrem me çështjet që u ngritën më herët nga Sllavisha dhe Arianiti por dua të potencoj se kjo luftë veç sa ka filluar. Do të ketë qenë Ardiani. Prandaj, kjo betejë është e pandalshme dhe do të ketë zero tolerancë ndaj korrupsionit. Prandaj, ju garantoj dhe siguroj se Qeveria e Kosovës ka vullnet në këtë drejtim, ka edhe guxim dhe s'trembet prej askujt. Është sundimi i ligjit dhe për aty ku është sundimi i ligjit jemi shumë të vendosur që kushdo që të jetë, nuk do të lejojmë kurrë, në asnjë kohë, në asnjë rrethanë motivimin politik, por edhe ju siguroj se askënd nuk do ta mbrojë politika nga krimi i organizuar dhe askush nuk do ta shfrytëzojë politikën për t'u mbrojtur nga krimi. Prandaj, këtu kërkoj partneritet. Faleminderit për përkrahje!

Pavarësia, vërtetë është meritë e të gjithëve. Rezistenca jonë ka filluar edhe para nesh, ka këtu edhe më të vjetër se unë që ka filluar shumë herët dhe e kemi vazhduar bashkë, e kemi përmbyllur dhe kjo është meritë e popullit të Kosovës dhe e vlerës së politikës perëndimore të Kosovës.

Natyrisht, është edhe meritë shumë e madhe e këtij koalicioni qeveritar që e përshpejtoi datën e shpalljes së pavarësisë dhe të njohjes së pavarësisë.

(Reagime nga deputetët)

KRYESUESI: Ju lus për konsideratë për secilin, derisa të diskutojë, sepse këtë do ta keni secili mundësinë ta merrni fjalën.

HASHIM THAÇI: Dhe, në anën tjetër, ishte meritë e madhe që të ruhet ky partneritet me komunitetin ndërkombëtar. Prandaj, respekt për vlerësimin më të lartë për të gjitha sugjerimet, vërejtjet dhe kritikët parimore. I kuptoj edhe mllefet, të rreshtit atje të fundit, por sido që të jetë, ne do t'ju mirëkuptojmë dhe unë do të vazhdoj të jam edhe më tutje avokat i opozitës demokratike, por edhe ballafaques i opozitës së mllefët.

Tash, më lejoni të tërhiqem, sepse më duhet të udhëtoj në mbledhjen e Këshillit të Sigurimit. Faleminderit për respekt dhe mirënjohje!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Kryeministër. Vazhdojmë me diskutuesen Safete Hadërgjonaj. Le të përgatitet Naim Maloku.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuari, zoti Kryeministër,

I nderuari Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Përpos asaj që zoti Kryeministër e theksoi në lidhje me vonesën e këtij programi qeveritar, mendoj se ka edhe një të mirë që po diskutohet pak me vonesë ky program qeveritar, sepse ndihesh mirë kur diskuton për programin, kurse në praktikë ke rezultate që janë të prekshme nga qytetarët dhe në praktikë ke rezultate dhe suksese të cilat janë konkrete dhe të prekshme nga qytetarët e Kosovës.

Qytetarët nuk presin sot se çfarë ne do të flasim në Parlament dhe unë jam e bindur se qytetarët e Kosovës do të presin se çka do të bëhet për ta, çka do të bëhet për mirëqenien

e tyre. Dhe kjo Qeveri ka dhënë provat e para se është duke punuar për mirëqenien e qytetarit të Kosovës.

Është e vërtetë se njerëzit shohin dhe kanë parë edhe gjatë tri vjetëve të kaluara një ish qeveri që ka qenë në pushtet. Kanë parë dje keqmenaxhim, keqpërdorim, korrupsion, kriminalitet, të cilat pasoja dhe dukuri i kanë vuajtur qytetarët në krahët e tyre. Sot po shohim investim në infrastrukturë, në arsim, në shkencë, investim në dije për t'i hapur perspektiva zhvillimit ekonomik të Kosovës.

Dua ta them edhe një çështje, dhe i drejtohem zotit Kryeministër, se ka ardhur koha që të dihet vërtet se kush është uzurpator i pronave publike, kush është bartës i krimit dhe kontrabandës. Kam besim se këtë do ta bëjë shumë shpejt Kryeministri dhe Kabineti qeveritar.

Sot trumbetohet shumë se Kosova paska drita 6 orë dhe 3 orë sikur ka qenë përpara, por unë dua të them edhe një gjë tjetër. Tetë vite, ata që deklarojnë vrullshëm sot për t'u përmirësuar energjia, e kanë shkatërruar për tetë vite gjigantin ekonomik KEK-un dhe nga një gjigant i fuqishëm ekonomik e kanë shndërruar në një dinozaur të ekonomisë së Kosovës dhe presin sot që për 100 ditë të rregullohet e stabilizohet energjia. Kjo, të nderuar deputetë, është më tepër një naivitet politik, sepse të gjithë qytetarët e dinë se për 100 ditë problemi i energjisë nuk rregullohet.

Të nderuar deputetë,

Programi i Qeverisë që na është ofruar për diskutim, përmban linjat themelore dhe objektivat që synohen të arrihen në katër vitet e ardhshme. Njëkohësisht, janë parashikuar edhe objektivat afatshkurtra për çështje që kanë të bëjnë direkt me jetën e qytetarëve. Në këtë program Qeveria ka paraqitur potencialet e saja për funksionalizimin e shtetit të Kosovës.

Është me rëndësi të thuhet se Qeveria ka paraqitur prioritetet që janë të pranueshme në aspektin financiar, gjë që hedh poshtë çfarëdo deklarimi se ky program është “fontanë dëshirash” apo program për fushatë zgjedhore.

Deputetë të nderuar,

Në fillim të mandatit të kësaj Qeverie u realizua ëndrra e kamotshme e popullit të Kosovës për shtet të pavarur dhe sovran. Kryeministri me Kabinetin qeveritar, sot me programin e tyre, ofrojnë mundësi për të ndryshuar rrjedhën e së ardhmes duke iu ofruar qytetarëve një qeverisje që bëhet faktor i nxitjes së zhvillimit ekonomik dhe përshpejtimit maksimal të integrimit evropian dhe Euroatlantik.

Kolegë të nderuar deputetë,

Në programin qeverisës vërehet vendosmëria e kësaj Qeverie për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar. Qytetari i Kosovës ka vërejtur dhe është i sigurt se kabineti aktual qeveritar nuk është i korruptuar siç ishin paraardhësit e tyre, sepse që në fillim të funksionimit të kësaj Qeverie janë vërejtur hapa të guximshëm për të ndërprerë shpërdorimin e parave të taksapaguesve, është vërejtur përkushtimi dhe përgjegjshmëria për ushtrimin e pushtetit duke luftuar fenomenin e korrupsionit të instaluar në Qeveri, krimit të organizuar dhe është përkushtuar për reformat e qeverisjes demokratike dhe për shtet ligjor, është e përkushtuar në luftë kundër evazionit fiskal dhe ekonomisë informate e po ashtu edhe kundër kontrabandës.

Nga analiza e programit, vërehet se kjo Qeveri po hap perspektiva për financimin e projekteve strategjike për të bërë investime në përmirësimin e infrastrukturës dhe pjesëve tjera të sektorit publik. Është e përkushtuar në krijimin e kushteve optimale për projekte të rëndësishme për të gjeneruar rritje ekonomike, ulje të papunësisë, përmirësim të kushteve sociale dhe zhvillim të gjithmbarshëm të gjitha strukturave të popullsisë së Kosovës.

Kosova, edhe nëntë vite pas luftës nuk ka strategji zhvillimore. Strategjia dhe plani zhvillimor i Kosovës, për të cilin janë dhënë miliona euro nga buxheti i Kosovës dhe nga donatorët e rëndësishëm, nuk u shoqërua nga vullneti politik i ish-qeverisë për t'u shqyrtuar dhe miratuar në Kuvend. Strategjia dhe plani zhvillimor i Kosovës u përdor vetëm për demagogji duke krijuar imazhin e rremë të përpjekjeve për të rritur efektivitetin dhe efikasitetin e financave publike kështu që prioritetet zhvillimore dhe shpenzimet buxhetore janë bërë në të kaluarën pa përcaktimin e qartë të objektivave strategjike dhe më tepër janë bazuar në interesat personale dhe elektorale dhe jo në shërbim të përmbushjes së synimeve dhe objektivave strategjike.

Qeveria, e cila na ka ofruar këtë program, është e vendosur që të bëjë realitet zotimin e saj dhe sa më shpejt Republika e Kosovës të ketë strategjinë zhvillimore dhe t'i jepet fund artikullimit pa shumë përmbajtje të planeve strategjike, t'i jepet fund zhvillimit stihik pa përcaktuar prioritetet zhvillimore që kanë karakterizuar qeverinë e mëparshme. Qeveria ka identifikuar mirë pengesat për tërheqjen e investimeve, ashtu që në programin e saj është fokusuar në dhënien e prioritetit të ligjit, tregut financiar dhe politikës fiskale.

Deputetë të nderuar,

Qeveria, në programin e saj, në planin ekonomik ka paraparë reformën në sistemin tatimor. Ajo ka identifikuar se politikat fiskale ekzistuese dhe zbatimi korruptiv dhe deformues i tyre është shndërruar në një faktor mjaft negativ dhe barrierë e lartë e zhvillimit ekonomik. Që në fillim të punës së saj ka hartuar projektin e ndryshimit të politikave fiskale duke bërë përpjekje që sistemi tatimor të shndërrohet në instrument të funksionit të zhvillimit ekonomik.

Orientimet e qarta programore të Qeverisë reflektojnë punë të kujdesshme që administrata tatimore dhe doganat të mos jenë deformuese të tregut dhe mjet korruptiv dhe evazion fiskal, siç ka qenë deri më tani, por mjet ndihmues për bizneset dhe për qytetarët tatimpagues.

Qeveria me programin e saj është e përkushtuar të reformojë sistemin e planifikimit të financave publike duke hartuar kornizën afatmesme të shpenzimeve dhe duke harmonizuar zhvillimin e buxhetit vjetor në kornizën afatmesme të shpenzimeve. Nga programi i Qeverisë vërehet se Qeveria është e përkushtuar për përmirësimin e performancës së institucioneve qeveritare që merren me mbledhjen dhe shpenzimin e parasë publike.

Nga informata e Kryeministrit vërehet se Qeveria veç ka dhënë rezultate të para në vendosmërinë e saj për të vënë bazat e një sistemi të mirë të menaxhimit të financave publike ku të gjitha ministrat kanë zvogëluar mjetet e shpenzuara për luks qeveritar dhe kanë intensifikuar punën në shfrytëzimin e mjeteve për investime kapitale, taksapaguesve kanë filluar t'u kthehen mjetet në formë të të mirave publike.

100 ditët e qeverisjes shënojnë suksese të para të prekshme të qëndrueshme të një qeverie të përkushtuar për të punuar për përmirësimin e jetës së qytetarëve. Për këto dhe shumë arsye tjera, ne do ta përkrahim programin qeveritar dhe do t'i japim mundësi qeverisë që t'i realizojë objektivat e veta programore në të mirë të cilësisë së jetës së qytetarëve. Faleminderit për vëmendjen!

KRYETARI I KUVENDIT: Faleminderit! Ju njoftoj se, megjithatë, një renditje të diskutimit do ta bëj, në favor të opozitës. Ftoj për fjalë, anëtarin e Kryesisë, Naim Maloku.

NAIM MALOKU: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Unë nuk desha të hyj më tepër në elaborimin se a është ky program që na e ka sjellë Qeveria për të debatuar sot si program qeverisës apo jo. Parafolësit e mi edhe nga pozita, edhe nga opozita i theksuan të gjitha mangësitë.

Më shqetëson një konstatim i shpeshtë i zotit Kryeministër kur thotë për botën akademike të përfaqësuar në Qeveri. Unë jam i bindur se kjo botë akademike nuk e ka lexuar këtë program, përndryshe nuk kishte për ta sjellë para nesh. E ka hartuar, sigurisht, ndonjë asistent me ndonjë shkollë të mesme dhe ka kaluar nëpër ministri pa u lexuar fare.

Ky nuk është program i një qeverie, që i ofron këtij vendi një pasqyrë se ku fillon dhe në cilën pozitë të të gjitha parametrave fillon kjo shoqëri sot dhe ku do të arrijnë të gjithë ata parametra pas katër viteve.

Unë do të ndalem në disa çështje paksa më konkrete. Iu drejtohem ministrave Ahmet Shala dhe zotit Lutfi Zharku. Janë dy sektorë të tregtisë në Kosovë, në të cilët bëhet kontrabandë dhe krim i organizuar, i paparë, edhe në shtetet në tranzicion. E kam fjalën për distribuimin dhe tregtinë me shumicë e pakicë të naftës dhe të derivateve të naftës dhe tregtinë me shumicë dhe pakicë të arit dhe të metaleve të çmuara.

Zoti ministër, Zharku, në faqen 189 të informatës apo të raportit të Qeverisë për 100 ditë, te Inspektorati i tregut, pika 5, citoj çka keni shkruar: “Kontrolli inspektues në pikat e shitjes së derivateve të naftës në 14 pika. Qëllimi i inspektimit ishte marrja e mostrave për analizë të produktit dizell.”. Për 100 ditë, deputetë të nderuar – qytetarë të Kosovës, kjo Qeveri – Ministri ka arritur që t'i marrë mostrat në 14 pika dhe atë vetëm për produktin dizell – të naftës. Qytetarët e Kosovës dhe ne vetë, qe 8 vjet, i jemi të nënshtruar plaçkitjes së paskrupullt, gati në të gjitha pikat e shitjes së derivateve të naftës me pakicë. Ai që e kupton mirë çka do të thotë bazhdarimi i aparaturave matëse që duhet obligativisht të kryhet në çdo 6 muaj dhe që duhet të jetë kontrolli i vazhdueshëm ditor dhe disa herë në ditë në një pikë të karburantit, ne i jemi të nënshtruar plaçkitjes që i bëhet qytetarëve të Kosovës. Në vend të 10 litrave naftë apo benzinë merren 9 apo 8, sepse rregullohet pistoletat për mbushje të rezervuarve, të nderuar deputetë, asisoj që të furnizohet më pak sesa e paguan. Kur do t'i garantoni, zotëri ministra, qytetarit të Kosovës se do të marrë sasinë e naftës për atë që ka paguar dhe do të marrë kualitetin e asaj që ka paguar. Këtu është çështja. Unë nuk dua të hyj atje se të kujt janë pompat e benzinës, kush i ka marrë dhe çka ka marrë. Por, kontrollin ligjor për to e dua.

Mos të flasim për tregtinë me ari dhe metale të çmuara. Po i them këto dy segmente që fare nuk ka as inspektim të agjentarive, as nuk dimë fare se sa ari hyn në Kosovë, as sa

shitet. Kryeministri tha, biznesi – partner i favorizuar. Dua t’i marr dy shembuj. Çdokush prej nesh dhe qytetari i Kosovës, nëse hyn në cilëndo kafene me mbi 80% të bufeve në Kosovë, së bashku me një kafe që kushton 50 centë, kur të porositë e merr edhe tiketën fiskale ku shkruan sa është TVSH-ja. Në asnjë pikë të karburantit nuk ka tiketë fiskale. Në asnjë argjendari nuk ka tiketë fiskale dhe qytetari i Kosovës bëhet hallkë e krimit të organizuar. Bëhet hallkë e krimit të organizuar edhe ai që blen.

Krejt këtë, këto dy segmente dhe kontrabanda që bëhen në këto dy segmente dhe dy artikuj reflekton direkt, të nderuar deputetë dhe ministra, në sigurinë në Kosovë. Këto të holla të pista jashtë kontrollit qeveritar që merren me kontrabandën e këtyre dy artikujve janë futur në tregun e fajdeve, të nderuar ministra. Janë futur në tregun e pasurive të patundshme që do të ketë Kosova pasoja të paparashikueshme si për shtresën e mesme dhe të ulët, sepse janë ngritur çmimet, bëhen shpëlarje të parave dhe të mos flasim për reketim dhe pasurim të një numri të vogël të qytetarëve të Kosovës.

I drejtohem ministrit të Punëve të Brendshme, i cili nuk është këtu dhe nuk po e pyes se në programin qeveritar sa ka paraparë rritjen e standardeve dhe përkushtimin për 8.500 pjesëtarë të Shërbimit Policor të Kosovës dhe për kujdesin që duhet ta ketë kjo Qeveri ndaj tyre. Nuk po e pyes a është në këtë plan-program qeveritar edhe përkujdesja ndaj familjeve të atyre policëve që janë rënë në detyrë nën rrethanat dhe kushtet më të vështira që ka kaluar ky vend. Dua vetëm një segment: Për këta tre muaj, a e ka evidencën sa tiketa pra janë shqiptuar nga policia rrugore ndaj qytetarëve të Kosovës për shkelje të ligjit në komunikacion. Nëse po, sa ato tiketa kanë përfunduar të papaguara, të parealizuar nga gjykatat për kundërvajtje, që nuk ndodhë askund në botë që një tiketë, e cila shqiptohet me caktim të gjobës, që ajo të përfundojë dhe të shfuqizohet nga gjykatësi për kundërvajtje. Në qoftë se e gjen këtë barazim ministri i Drejtësisë dhe ai i Punëve të Brendshme do të shohin se për këta tre muaj sa e kanë dëmtuar buxhetin e Kosovës. Nuk është gjoba vetëm për t’u fryrë buxheti i Kosovës, por të gjithë ata shkelës të ligjit në komunikacion që kanë të njohshëm në gjykatat për kundërvajtje rrezikojnë komunikacionin ata janë rrezik në komunikacion sepse nuk i përmbahen rregullave, sepse kanë të njohshëm në gjykatat për kundërvajtje. Këto gjëra, të nderuar ministra dhe Kabinet qeveritar, pa dashur t’ju akuzoj fare që ju jeni qoftë neglizhentë apo të implikuar në këto marifete, qoftë që jeni peng të bosëve dhe petrolmafisë në Kosovë, sepse është krijuar pletrol-mafia. Këto çështje, deputetët e pozitës tani do t’i përkujtoj dhe kthej në vitin e kaluar në këtë Kuvend ku është debatuar raporti i Qeverisë 2006 – të Qeverisë Çeku. Këto çështje i kam ngritur edhe atëherë, por nuk kam marrë përgjigje as nga ajo Qeveri. Opozita e atëhershme ka heshtur dhe ka qenë indikative shumë, a kuptoni. Nuk e kam ndërmend të akuzoj askënd, mirëpo Kosova nuk mund të shkojë në Konferencë të Donatorëve me këtë mospunë në ndaljen e evazionit fiskal dhe të kontrabandës. Rrugët e kontrabandimit të arit janë rrugët

(Ndërprerje nga regjia – tejkalim i kohës për diskutim)

KRYETARI: Faleminderit për debatin dhe mendoj se ministrat duhet të përgjigjen në shumëçka që u tha dhe do të falënderojë edhe Qeveria për fjalët që i thatë. Fjalën e ka ministri Ahmet Shala.

AHMET SHALA: Faleminderit, zoti deputet!

KRYETARI: Ministër, më fal! Do t’i dëgjojmë, pastaj në fund përgjigjet. Urdhëroni, edhe pse s’keni të drejtë, por për një minutë bën.

AHMET SHALA: Vetëm një minutë, meqë u thirra nga zoti Naim dhe sinjerisht për 90% të gjërave që i ke thënë pajtohem. Me 90% të gjërave që i keni thënë, pajtohem.

Ju keni konstatuar një gjë, të cilën duhet ta citoj: “Qe tetë vjet”, përafërsisht kështu keni thënë “Qe tetë vjet na kanë rrjepë – plaçkitë”. Dakord! Kjo nuk është bërë që tre muaj, por që tetë vjet. Unë të garantoj, pra, që në periudhën më të shkurtër të mundshme dhe në javën e ardhshme do të jetë një paketë e tërë për të luftuar, siç e ke quajtur “petroll-mafinë”, për të luftuar invazionin fiskal dhe për të ndërprerë të gjitha ato gjëra. Ndërsa, në gjashtë muajt e ardhshëm do të vendosen taksat fiskale, arkat fiskale, pardon, të cilat pastaj ne do t’i shohim secilat. Një program që kemi këtu, në fakt, nuk është një program i detajizuar për aksione për një vizion

(Ndërprerje nga regjia – tejkalim i kohës për diskutim)

KRYETARI: Ju lutem! Fjalën e ka deputetja Sanije Aliaj. Më falni, ka replikë anëtari i Kryesisë, Naim Maloku.

NAIM MALOKU: Zoti ministër Shala, faleminderit për pranimin se kritikën e mia ishin me vend. Unë po e përsëris, lexova raportin tuaj për 100 ditë çka keni bërë. Ministri, që e keni afër, i ka kontrolluar 14 pika të karburantit në tërë territorin e Kosovës. Kjo është mospuna e juaj, zoti ministër. Të mos flasim për ari e ato të tjera, që fare nuk i përmendët, sepse as nuk dini se sa ari hyn në Kosovë e as sa shitet në vit, a po kuptoni.

KRYETARI: Urdhëroni, ministër Zharku.

LUTFI ZHARKU: Faleminderit, zoti Kryetar!

Parimisht, të them, edukata ime familjare nuk më lejon për t’u marrë unë me të kaluarën çfarë është bërë. Unë vetëm mund t’ju njoftoj se fatkeqësisht njeriu që udhëheq Inspeksionin është ish kandidati juaj për kryetar komune të Drenasit. Kryeministri e përmendi se nuk duam të merremi me stafin civil, nuk duam të paragjykojmë kush duhet të shkojë prej pune e kush jo, jemi në shqyrtim të krejt rastit dhe të të gjitha rasteve të tjera dhe me siguri se me kohë do të ndërmarrim masa. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Sanije Aliaj.

SANIJE ALIAJ: I nderuar, zotëri Kryetar!

Zëvendëskryeministra, ministra të respektuar, deputetë,

Njëqind ditë pune janë shumë pak për të parë sukseset dhe mospushtet e cilitdo institucion të Republikës së Kosovës.

Sot fjala e Presidentit, informata për punën 100-ditëshe të Qeverisë si dhe programi i saj për periudhën 2008-2011 lënë shpresë për progres ekonomik dhe mirëqenie të qytetarëve.

Konsideroj se tremujori i parë i vitit 2008 do të jetë faza më e suksesshme dhe më krenare e veprimtarisë së institucioneve të Kosovës, sepse janë marrë vendime kapitale që i bënë një popull për t’u bërë dhe njohur shtet. Më 17 shkurt 2008 institucionet e Kosovës i dërguan mesazh qytetarëve të Kosovës dhe botës demokratike se jemi të përkushtuar të ndërtojmë një shtet funksional dhe demokratik.

Në këtë rrugëtim të sukseseve e konsideroj edhe programin e Qeverisë së Republikës së Kosovës që sot e kemi në rendin e ditës në këtë seancë plenare. Vlen për t'u theksuar se përveç që paraqet një pasqyrë për punën që do të bëhet, përfshirë prioritetet dhe sfidat, nënkupton përkushtimin e vazhdueshëm dhe transparent të Qeverisë, duke marrë shembullin e vendeve në demokraci të zhvilluar e duke zhvilluar vendin tonë si demokraci në tranzicion drejt ekonomisë së tregut.

Programi ka objektiva të përgjithshme. Do të ishte mirë sa më tepër të ishte ilustruar edhe me objektiva të sektorëve të Qeverisë. Është dashur t'i paraprijë një pasqyrë e të arriturave që i kanë bërë institucionet e mëhershme të shtetit të Kosovës. Njëherit, është dashur të potencohen se cilat resurse mundësojnë zhvillimin ekonomik në Kosovë.

Unë do të ndalem në pjesën e programit që mundëson ndërtimin e mirëbesimit qytetar dhe që është lufta kundër korrupsionit, puna transparente, llogaridhënien dhe kursimet në Qeveri.

Qeveri e nderuar, zero tolerancë korrupsionit me të cilën sot lidhet ryshfeti, keqpërdorimi i detyrës, keqmenaxhimi i buxhetit – vlen për t'u përshëndetur. Me luftimin e këtij fenomeni ndihmohet zhvillimi ekonomik dhe demokratik i Kosovës sepse obligimet e kryera të qytetarëve ndaj institucioneve kthehen në shërbime për një jetë më të mirë të tyre.

Për rritje ekonomike, Qeveria e Republikës së Kosovës, programin e saj e ka fokusuar në 7 fusha, në mesin e të cilave, arsimi është konsideruar projekt institucional, nacional dhe vendimtar për zhvillimin e Kosovës, mirëpo në raport është radhitur i fundit.

Reformimi dhe arritja e një sistemi arsimor efikas dhe cilësor është projekt afatgjatë dhe kompleks sepse kërkon investime të mëdha dhe menaxhim të mirë. Objektivat për ngritjen e nivelit të arritshmërisë përmes testeve kombëtare, rishikimi i plan-programeve, zgjerimi i hapësirave shkollore, aftësimi dhe arsimimi profesional gjatë tërë jetës, vazhdimi i trajnimeve, reformimi i sistemit të pagave dhe gradimi në bazë të licencimit, pajisja me kompjuterë dhe jetësimi i strategjive të hartuara – lënë shpresë për rritjen e cilësisë së arsimit që bazohet në standardet krahasuese me vendet e zhvilluara të botës.

Zotëri ministër,

E vlerësoj përkushtimin tuaj për investime në arsim, por kërkoj nga ju të ketë më tepër higjienë në shkolla, më tepër poligone sportive, më tepër hapësirë ku nxënësi do të ushtrojë aktivitete të lira, më tepër laboratorë dhe kënde të gjelbëruara që mësimi teorik lidhet drejtpërdrejt me atë praktikë dhe se vetëm kështu do të largohet nxënësi nga rruga dhe nga dukuritë devijuese që janë në rritje e sipër në shoqërinë tonë.

Është obligim institucional që edhe më tepër të angazhoheni, edhe pse nuk dyshoj në këtë drejtim, në ruajtjen e dinjitetit të arsimtarit, duke ia shpërblyer punën e shenjtë që e bën gjatë ushtrimit të profesionit, por edhe pasi të dalë në pension, sepse këtë e meriton.

Këto ditë, jemi dëshmitarë që Sindikata e Arsimit shpreh shqetësimet për gjendjen në arsim.

Zoti ministër,

Kërkoj me kohë të vihen kontakte dhe të ndërmerren hapa konkretë për aq sa lejojnë mundësitë e në veçanti për fillimin e jetësimit të Kontratës kolektive.

Konferenca e shumëpritur e donatorëve lë për të dëshiruar që një numër i madh i këtyre projekteve që janë në programin e Qeverisë së Republikës së Kosovës do të implementohen.

Në fund, do të potencoj se garantimi i të drejtave të grave me ligj dhe hartimi i strategjisë për ngritjen e numrit të femrave në institucione vendimmarrëse 2008-2015 është shpresë për një të ardhme më të mirë, por duhet hartuar dhe zbatuar programe në të gjitha fushat sepse Kosova nuk do të bëhet demokratike pa e pasur femra vendin e saj të merituar.

Me këtë rast, i drejtohem Kryeministrit, dhe kërkoj angazhim konkret në këtë drejtim, sepse, edhe pse për një përqindje është rritur numri i femrave në Qeveri dhe institucionet e nivelit qendror të Kosovës edhe më tepër dhe edhe më tej duhet që ky numër të rritet.

Gjatë ecjes, ka vështirësi. Por, me vullnet dhe seriozitet në punë, objektivat dhe projektet sektoriale do të shndërrohen në vepra. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Numan Baliq. Le të përgatitet deputeti Haki Shatri.

NUMAN BALIĆ: A mund të filloj? Faleminderit, zoti Kryetar!

Taman sam se pobjao da ću dobiti riječ negde oko pola noći i setio sam se da je Slaviša govorio o izgubljenom vremenu, a i sam se setio da smo izgubili danas džuma i ikindiju pa ću nastojati da kažem nešto što kraće.

Ja ću nastojati da, pošto smo dobrim dijelom zamoreni, obratim pažnju na neka pitanja koja do sada nisu spominjana, sa najboljim namerama da doprinesem ovoj diskusiji i da dam neke dobre prijedloge.

Vlada Kosova, institucije Kosova u odnosima sa javnošću, bazirajući se na Ustavu, vrlo su često i u programu Vlade i u svakodnevnom dijelovanju predstavljale sve ovo što smo stekli, odnosno Kosovo kao građansku državu.

Moram da skrenem pažnju da s obzirom da je riječ o aktima koji su bazirani na Ahtisarijevom dokumentu, a koji inače nisam podržao i za koji nisam glasao, da u tom dokumentu ne stoji formulacija i nije određeno da Kosovo bude građanska država, nego da bude višetetnička država. Tako da, ustavotvorci, Vlada, vodje institucija, treba da obrate pažnju ovom važnom fakti koji može biti predmet budućih sporova u situaciji koja se može u budućnosti komplicirati vezano za naredne događaje koje nas očekuju.

Ako je u pitanju program Vlade, i ako je u pitanju ekonomski aspekt, obratiću pažnju na nešto što je do sada manje spominjano a to je da Vlada, naravno ponovću ono što su mnogi rekli – ne nudi jasne konkretne odredbe oko toga kako će se riješiti mnoge stvari, uglavnom se nalazi na terenu teoretiziranja i oko toga šta bi bilo, kako bi bilo i kako bi trebalo - nema jasnih odgovora. Jedno od važnijih pitanja jeste ubiranje poreza. Vidio sam da je zadnjih dana upravo oko ovog pitanja bila podignuta neka mala kampanja pa su proganjani neki piljari ili vlasnici trafika zbog toga što nisu platili porez. Ako je u pitanju plaćanje poreza, onda se treba prvo obratiti, da tako kažem, velikim ribama – onima koji imaju najviše novca i oni koji trebaju pomoći društvu. Dakle, cjelokupna akcija Vlade treba biti usmjerena ka jednom pravednom oporezivanju i efikasnijem sistemu poreza. Takodje, i dobrim sistemom carina, koji bi izbjegavao sve one stvari koje

je spomenuo kolega Maloku i takodje da se obrati pažnja da se poveća proizvodnja i da sve to vodi jednom putu pogaćenja kosovskog društva a ublažavanja opšteg siromaštva koje postoji.

Naravno, pitanje svih pitanja, koje mislim da je neko od kolega spomenuo, ali nedovoljno jasno, povećanje plata. Ja vas molim i moram vas podsjetiti po ko zna koji put, u cijelom regionu i u Makedoniji, Crnoj Gori i svuda u zemljama koje potencijalno su siromašnije od Kosova, svuda su plate nekoliko puta veće. Od 99. godine do danas na Kosovu nismo imali povećanje plata. Ne može se govoriti o društvenom napretku niti o blagostanju ako ne dodje do povećanje plata. Tačno je da postoje ograde koje su vezane sa Međunarodni monetarni fond, za pravila koje propisuje Svetska banka, tačno su i sve druge stvari koje se spominju i koji znaju eksperti koji se time bave, ali ovo je osnovica svakog budućeg društvenog blagostanja.

Da se kratko osvrnem na još nekoliko pitanja koja su spominjana. Pitanje KEK-a i moguće privatizacije ili davanje na koncensiju. To je pitanje koje smo prvi put ponovo čuli ovih dana a za koje smo mislili da pripada prošlosti. Imajući u vidu kako je bavljen privatizacija odnosno naravno izuzimajući one objekte - privredne subjekte koje su, da tako kažem, relativno uspješno privatizirani, ako se izuzmu dakle oni i ako se uzima u obzir da apsolutna većina posla u oblasti privatizacije obavljena apsolutno na taj način da javnost nije zadovoljna – u tom smislu ne bih se složio, odmah treba krenuti sa privatiziranjem KEK-a ili sa davanjem na koncesiju.

Medjutim, ono što je vrlo bitno, iz oblasti energije i rudarstva jeste da nisam čuo, bukvalno sada govorim, nijednom danas da se spominje Rudnik Trepča. I ovo je pitanje i za Premijera i njegove ministre i odgovarajuće resore šta je sa Trepčom. Moramo obratiti pažnju na najveći rudnik na Kosovu, na najveće bogatstvo i šta Vlada hoće da uradi sa njom, imajući naravno u vidu da je 9 desetina toga objekta na „teritoriji srpskog“ da tako kažem, eto jezik hoće istinu – nije entitet, ali lako se može desiti da bude entitet. Dakle, šta Vlada misli da radi po tom pitanju, ono što je vrlo važno pitanje i što je osnovica bugućeg ekonomskog razvitka Kosova.

Da napomenem, naravno vrlo kratko, nešto oko obrazovanja. Tu jesu učinjeni značajni napretci, da jesu napravljeni neki sistematični potezi i u još nekim oblastima, ali da nedostaje odgovor za visoko-školsko pitanje drugih zajednica i da nedostaje pitanje jedinstvenog plana udžbenika za sve zajednice. Nedostaju takodje udžbenici za Bošnjake i druge zajednice, nešto što zahteva jedan minimalni budžet od nešto više od 100 hiljada evra. Mislim da je sramota za Vladu da posle toliko godina nije riješeno pitanje štampanja udžbenika i jedinstvenog plana. To je pitanje koje se mora odmah riješiti.

U vezi sa vladavinom zakona, o odnosu policije i sudova, po pitanju saradnje, ja bih istakao da je Policijska služba, koja je značajno poboljšala svoju aktivnost, ali ono što često možemo čuti, jedan tipičan primjer – dobri uspešni policajci, naravno moramo razlikovati one dobre od onih loših, koji su korumpirani, ali to je osnovica dobrog uređenja i dobrog organiziranja, da odlikujemo uspješne, hrabre i dobre. Često smo čuli da policajci privedu izgređenika, nasilnika, čoveka koji je učinio neko teško krivično delo ili neko drugo, a da ga sud odmah oslobodi, zbog korupcije, zbog veza ili zbog posredovanja ili bilo čega. Ta kordinacija između policije i sudova, efikasnost policije i sudova, ono što je ključno za funkcionisanje pravnog sistema ove zemlje je nešto što konačno mora da počne da radi, i bez čega, naravno nema budućnosti u ovoj zemlji.

I da spomenem jednu famoznu formulaciju, koje je gospodin premijer upravo ovih dana često spominjao, citiraću ga, zoti Kryeministër ka thënë: “toleranca zero ndaj korrupsionit”, kështu që dua ta përsëris, megjithëse Kryeministri nuk është këtui, por është me rëndësi. Derisa kemi punë për korrupsionin dhe kriminalitetin e organizuar, kundër kriminalitetit të organizuar mundemi vetëm me aksion efikas dhe të organizuar. Jo me fjalë. Fjalët nuk mjaftojnë. Atëherë, mjaft me fjalë, duhet aksion i vendosur dhe efikas.

U vezi sa ovim pitanjima koja su puno spominjena, kao zdravstvo, socijalna pitanja, penzije, veoma dobro znamo. Situacija je u zdravstvu katastrofalna, lijekova nigde nema ni za lijek. Sistem menažiranja je potpuno propao. Klinički centar jednostavno je u fazi vegetiranja. Sistem finansiranja zdravstvenog sistema i budžet zdravstva je totalno pao i sva ona pitanja za koja, moram da podsjetim sadašnju Vladu, vrlo često je govoreno oko toga da u prethodnim mandatima ovo pitanje nije riješeno zato što su navodno „bili ministri is drugih zajednica“. Sada imamo ministra iz većinske zajednice i stanje u zdravstvu nije pomjereno ni za jedan milimetar naprijed, naprotiv, ide, bukvalno ka dnu i uskoro će definitivno biti u pravom kolapsu.

U vezi sa nekim pitanjima koje se tiču implementacije statusa, da dodam još nešto što je kolega Gjini već spomenuo, ali ja moram da podsjetim i takodje ću ovom prilikom da citiram. Kryeministri i ka thënë: “Në javën e parë Kosovën do ta njohin 100 shtete”. Tani, pas tetë javë, ose pas dy muaj, ne duhet të pyesim dhe Kryeministri duhet të na japë përgjigje, ku është premtimi i dhënë. Ku janë 100 shtete që kanë premtuar ta njohin Kosovën për 3-4 ose një javë ditë.

Ovde takodje želim da obratim pažnju na jedno pitanje, koje je vrlo simptomatično i koje je bitno za celokupnu strukturu institucija Kosovske vlasti. Kosovo je priznala Amerika, najveći broj zemalja G-8, priznale su ga najveći broj Evropskih zemalja, ali šta je sa najvećim brojem zemalja Azije, Afrike cijele, iz koje ga je priznala samo jedna zemlja, i Latinske Amerike nemamo nijedno priznanje odatle. To je problem koji je zabrinjavajući. I sa onim pitanjem, koje su spominjali upravo zapadnjački ili američki analitičari – kako se desilo da od 57 islamskih zemalja, Kosovo prizna samo 4 zemlje a sve ostale ga u opšte nisu priznale. To je pitanje i za Premijera i za sve nas. Dakle, da politika mora biti sistematska, mora biti ona koja će biti svestrana i naše oči ne trebaju biti okrenute samo prema Zapadu nego i prema Istoku...

(Ndërprerje nga regjia, për shkak të kohës së tejkaluar për diskutim)

KRYETARI: Faleminderit! Radhën e ka për fjalë deputeti Haki Shatri, le të bëhet gati deputeti Rasim Selmanaj.

HAKI SHATRI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar të pranishëm, deputetë, ministra,

Kisha dëshiruar që ky prezantim imi lidhur me programin të kuptohet drejt dhe pozitivisht, sepse mendoj që ajo që në parim është thënë nga shefi i Grupit tonë Parlamentar vlen edhe për mua, por paraprakisht kisha dëshiruar dhe kjo vlen edhe për udhëheqësit e grupeve parlamentare në koalicion: Ta bëjmë një marrëveshje korrekte dhe të përmbahemi nga kritikata joparimore qoftë për koalicionin qeverisës të kaluar, qoftë të parakaluar, qoftë për të paraparakaluar. Nuk është mirë që ne të merremi me gjëra të kaluara dhe t’ia kthejmë shpinën të ardhmes.

Prandaj, për disa vërejtje që do t'i jap, do të përqendrohem në çështje profesionale, për të cilat mendoj se, në aspekt profesional, jam i kualifikuar për t'ia dhënë këtij programi me qëllim që programi të jetë më i mirë. Përndryshe, po të ishte program i ndonjë qeverie të një vendi jo mik, unë do ta lavdëroja pa asnjë vërejtje.

Në parim, ndoshta po përsëritet, i gjithë teksti është mjaft ekstensiv, përshkruet dhe në shumë pjesë ka përsëritje të shumta. Do të përqendrohesha në sferën e politikave zhvillimore.

Termet dhe gjuha e përdorur nuk mundësojnë që qartë të nxirret qëllimi i këtij programi në këtë sferë. Disa pasuese janë fare pa përmbajtje, si ai në fillim të faqes 6, që do t'i precizoj, me qëllim që të jam konkret, pastaj kapitulli 3.4, 4.4 dhe 4.8. Është kjo e fundit diaspora, që duket tepër jo serioze.

Mendoj se dokumenti do të përfitonte në përmbajtje dhe kualitet, nëse do të përcaktohej qartë që objektivi kryesor i Qeverisë në këtë periudhë është: rritja e shpejtë dhe e qëndrueshme ekonomike me synim mirëqenien për të gjithë qytetarët e Kosovës.

Ndërtimi i shtetit efikas, sundimi i rendit dhe ligjit, infrastruktura ligjore, infrastruktura ekonomike duhet të konkretizohen me afate kohore. Mungesa e shifrave dhe e termineve kohore, e shndërron natyrën e këtij dokumenti nga programi në shprehje dëshirash. Në këtë dokument duhet të pasqyrohet qartë cili do të jetë niveli i zhvillimit në fund të periudhës qeverisëse, të dhënat për punësimin, papunësinë, importin, eksportin, investimet dhe burimet e tyre, investimet publike, donacionet, pakoja sociale. Nga programi, unë s'po i përmendi anët pozitive, po i përmendi vetëm ato si vërejtje që do të mund ta begatojnë programin. Në program mungon një segment i rëndësishëm i tranzicionit, çka me privatizimin, nuk përmendet hiq, thjeshtë. Nuk përmenden as ndërmarrjet shoqërore, por si shkarazi, ose në mënyrë fragmentare ristrukturimi i ndërmarrjeve publike.

Politikat makroekonomike.- Tash kemi mundësi, me themelimin e Bankës qendrore, të merremi me disa segmente të politikave monetare, politikat kreditore, politikat buxhetore, politikat sociale, marrëdhëniet ekonomike me jashtë dhe politikat e çmimit. Këto janë shumë, si të thuhet, me turp të përmendura dhe shumë pak, dhe nuk janë të konkretizuara por e përbëjnë thelbin e qëllimit të parë të zhvillimit dinamik ekonomik.

Prioritetet sektoriale të përcaktuara nga Qeveria për afërsisht janë identike me prioritetet e përcaktuara në kornizën e shpenzimeve dhe unë mendoj se kjo është mirë, sepse me këto prioritete janë pajtuar edhe donatorët kryesor: Fondi Monetar, Banka Botërore dhe Komisioni Evropian dhe kjo është mirë. Mirëpo, ka një ndryshim të vogël në prioritetet dhe ky ndryshim kërkoj ose rekomandoj të harmonizohet me donatorët, sepse ata me datën 3 tetor 2007 janë pajtuar me strukturën e prioritetëve dhe është e mundshme që të na rrezikojnë Konferencën e donatorëve që pritet të mbahet në të ardhmen.

Nuk pajtohem me një ndryshim që është bërë në prioritetet qeveritare. Mendoj se heqja e shëndetësisë nga renditja e faktorëve me prioritet dhe vendosja e politikave tatimore në vend të saj, nuk është veprim i qëlluar. Shëndetësia duhet të ketë prioritet në politikat e Qeverisë.

Po ashtu, edhe vendosja e prioritetëve brenda sektorëve, në disa sektorë, duket se nuk është rregulluar konform nevojave që ka Kosova. Konkretisht,

sektori i energjisë, si sektor me më shumë probleme aktuale, është përcaktuar me prioritet dhe kjo është mirë. Ajo do një përmirësim edhe brenda të prioriteteve të sektorit. Ristrukturimi vertikal i këtij sektori, është domosdoshmëri.

Funksionimi plotësisht i pavarur i rregullatorit të energjisë, po ashtu është parakusht që ky sistem – sektor të mund të zhvillohet në të ardhmen në drejtimin që dëshirojmë.

Më tej, duhet ta kemi të qartë që këto probleme kërkojnë kohë për t'u zgjidhur. Minierat ekzistuese, pothuaj janë shterë. E dimë Bardhin dhe Mirashin. Hapja e minierës së re në Sibovcin jugperëndimor kërkon kohë, minimum 2 vite, këtë e di Ministria e Energjisë dhe e Minierave.

Çështja e eskavatorëve, sa kërkohet ofertimi i tyre e tjerë, rrezikojnë shumë seriozisht që kapacitetet ekzistuese të furnizohen me thëngjill. Një gjë është krejt e qartë. Kosova shpenzon më shumë energji sesa prodhon. Ndryshimi sigurohet nga importi. Çmimi i importit të energjisë është 5 fish më i shtrenjtë sesa prodhimi në vend. Prandaj është dashur që në program të jetë e qartë koha dhe mënyra e ndërtimit të kapaciteteve të reja. Nuk po prejudikoj a do të jetë C, a A-6, A-5, por ndërtimi i kapaciteteve të reja.

Dyshoj se me këtë që është shkruar në këtë program në sektorin e energjisë do të arrijmë rezultate në afat të shkurtër dhe afat katërvjeçar. Dyshoj, sepse e njoh natyrën e problemit.

Edhe një gjë tjetër. Ajo që është ofruar si zgjidhje në afatin e shkurtër dhënia me konsension prej A-1 deri në A-5, edhe minierat, është shumë e diskutueshme dhe e dyshimtë a do të ketë rezultat. E para, kemi folur keq shumë për KEK-un – publikisht Qeveria dhe ka thënë “është vatër e korrupsionit” e tjera. Një send që donë me shit dhe e shanë përpara, s’di qysh do të shitet ai. Po, po veç për mua është e pakuptueshme. E dyta, dy minierat Bardhi dhe Mirashi, janë shterë. Banka Botërore e ka projektin për t’i mbuluar me hi ato gropa. S’di kush i blenë. Unë po flas konkretisht për sektorin e energjisë dhe nuk di a jep rezultat kjo, inshalla jep dhe ishalla i blenë dikush.

Ka edhe diçka që mungon në këtë projekt. Rreth Aeroportit. Ne kemi biseduar edhe me Qeverinë, janë marrë disa masa edhe administrative, por nuk është folur konkretisht si të bëhet me të ardhmen e Aeroportit dhe çfarë me të ardhmen e ndërmarrjeve tjera publike. Këtu, në projekt, nuk shkruan asgjë për Aeroportin e Prishtinës. Ekziston një analizë, me të cilën ka vlerësime se në qoftë se autostrada për Maqedoni realizohet para dhënies me konsension të Aeroportit, Aeroporti i Shkupit mund të zë një vend qendror dhe të bëhet aeroport qendror për regjionin.

(Ndërprerje nga regjia – tejkalim i kohës së paraparë për diskutim)

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Rasim Selmanaj, le të përgatitet Memli Krasniqi.

RASIM SELMANAJ: Faleminderit, zoti Kryetar!

Këtë fjalë timen do ta nis me fjalimin historik të Presidentit, Fatmir Sejdiu dhe kisha pasur ta çmoj shumë guximin e tij që në fjalimin e tij e përmendi komandantin legjendar Adem Jasharin, por harroj të përmend edhe emra të mëdhenj tjerë të UÇK-ës, si Zahir Pajaziti, Luan Haradinaj e tjerë. Po ashtu, e çmoj guximin që ta përmend emrin e

presidentit të ndjerë Ibrahim Rugova, por besoj se për këtë e ka pyetur Kryeministrin Hashim Thaçi.

Meqenëse Presidenti i harroj ngjarjet e vitit 1968 dhe 1981, atëherë unë ia kujtoj atij këngën, më vjen shumë keq por dua ta them: “Druže Tito, mi ti se kunemo”! Po ashtu, zoti Kryetar i Parlamentit, zoti Jakup Krasniqi, Hydajet Hyseni, Berat Luzha, Ramë Buja, Ali Lajçi e tjerë, të koalicionit qeverisës ju pyes si e ndieni veten në këtë Kuvend kur nga fjalimi i struktë i tij harrohen ngjarjet dhe vuajtjet tuaja që i keni pasur për mbi 10-15 vjet burg.

KRYETARI: Rasim, nuk e kemi fjalën e Presidentit për debat, të lutem shumë!

RASIM SELMANAJ: Pra, po vazhdoj për atë që është në program, zoti Kryetar. Dikur Kabineti i qeverisjes së mirë, një emërtim mjaft simpatik, për 100-ditëshin e parë, do të duhej të emërtohej – Kabineti i qeverisjes joefikase për të mos thënë Kabinet i qeverisjes së keqe. A nuk e vërteton një qeverisje joefikase argumenti se kjo Qeveri, pas 100 ditëve Kuvendit ia paraqet programin qeveritar.

Në program s’ka objektiva të qarta dhe mekanizma të realizimit të këtyre objektivave. Kjo Qeveri, kujtoj e që në start është në hall për premtimet që i ka bërë gjatë fushatës zgjedhore dhe ka pak telashe të përballet me realitetin në Kosovë, me varfërinë e skajshme, me papunësinë, me krizën energjetike e tjera.

Paaftësia dhe pamundësia për të stabilizuar, ta zëmë, krizën energjetike, ditë më parë zoti Thaçi dhe kabineti i tij, kanë zbuluar “fajtorin kujdestar”, pra sabotimin në KEK. Respekt për zotin Thaçi, i cili sot këtu nuk është prezent, por po ia kujtoj – 24 orë rrymë, ka thënë. Ku janë premtimet? Praktika e gjetjes së fajtorëve “përmes sabotimit”, është praktikë e tejkaluar e vendeve të Lindjes në epokën e socializmit. Kjo praktikë e punës së Qeverisë sikur ngjallë tek qytetarët ndjenjën e pasigurisë dhe të frikës se vendi ynë po shkon kah një diktaturë “moderne”.

Ky konstatim bëhet edhe më i qëndrueshëm kur kihet parasysh fakti se edhe mediat, gjithnjë e më shumë janë të disiplinuara ndaj Qeverisë dhe një pjesë e tyre veç janë shndërruar në zëdhënës të saj.

Unë do të ndalem pak te programi qeveritar për lëmin e kulturës. Me kujdes dhe me kureshtje e kam lexuar dhe, t’ju them të vërtetën, jam zhgënjyer shumë nga ajo që kam lexuar. Nëse ky program do të përkthehet në gjuhë të huaj dhe do të shikohet nga ekspertë të këtij lëmi, do të vërejnë varfërinë mendore dhe intelektuale të atyre që e kanë përpiluar këtë program. Unë kujtoj se këto dy faqe të programit të kulturës më shumë i ngjajnë një hartimi shkollor, që unë do ta quaj “Pranvera po vjen”, por me këso hartimesh tepër të dobëta, pranvera kurrë nuk do të vijë në kulturë dhe as në sportin e Kosovës.

Unë mendoj se duhet shpresuar në zhvillimin e kulturës, ngase do të shpreh kënaqësinë time që zoti Skender Hyseni nuk është më ministër i kulturës dhe megjithëkëtë ka ardhur një njeri që merr vesh në kulturë. Sidoqoftë, zoti Skender Hyseni mbahet mend mirë si përkthyes dhe e njeh gjuhën angleze dhe gjithnjë e kujtojmë kur ia mbante letrat në duar Presidentit Ibrahim Rugova. Ministri i Kulturës mund të mos e njohë gjuhën angleze, por s’prishë punë ngase aty do të jetë ministër e nuk do të jetë përkthyes. Pra, sidoqoftë zotit Skender Hyseni i dëshirojmë sukses në punën e diplomatit, pasi e njeh gjuhën angleze, por a do të ketë rezultate në këtë punë mbetet të shihet.

Për në fund, zoti Kryetar, unë mendoj se ky program, meqenëse nuk i ka premisat e një programi qeveritar, por është mirë të kërkon falje para qytetarëve për premtimet pa mbulesë nga se po shihet nuk mund të realizohet dhe do të ishte mirë të zbritet pak në tokë dhe të përballej me probleme dhe me gjëra konkrete.

KRYETARI: Faleminderit, deputet! Unë kisha uruar që pranvera të na vjen edhe në Parlament. Fjalën e ka deputeti Memli Krasniqi.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar zëvendëskryeministra, ministra,

Zonja e zotërinj deputetë e deputete,

Para se të koncentrohem në atë që desha të them, realisht sot qëllimi dhe shpresa e shumicës prej nesh ishte se do të kemi një debat konstruktiv, argumentues, mirëpo, si duket, disa përfaqësues të opozitës e kanë marrë me zell të tepruar pozitën e tyre të re si opozitë dhe pa fakte e pa argumente po mendojnë se vetëm duhet kritikuar. Sidoqoftë, nuk ka ndonjë problem, besoj se do të adaptohen në muajt dhe vitet në vijim. Po të kishte ndonjë farë instrumenti që mat cinizmin, ndonjë cinizmetër ose ironimetër, ma merr mendja se s’e kishte bajt këtë nivel, ose të kishte pasur ndonjë kampionat botëror reprezentacionin e paskemi të gatshëm – e fitojmë vendin e parë për njerëz ironikë dhe cinikë, por për argumentues s’ma merr mendja se mund ta çojnë këtë opozitë, të paktën një pjesë të saj.

Unë dua ta përgëzoj Qeverinë e Kosovës për punën e deritashme 100-ditore, shumë voluminoze. Gjithashtu për një program cilësor dhe, çfarë është më e rëndësishmja, shumë adekuat dhe të realizueshëm, që mbulon të gjitha fushat e jetës në Kosovë, një program që është me projekte konkrete dhe projekte të realizueshme dhe absolutisht jo me “fontanë dëshirash” dhe në fakt nëse dita e mirë dihet në mëngjes, unë mund të them se jemi shumë të lumtur që e kemi një Qeveri të tillë, sepse do ta kemi një ditë shumë të bukur dhe ma merr mendja se kanë për ta kaluar programin, sepse për 100 ditë kanë arritur të kryejnë shumë më shumë punë sesa që kemi pritur ne prej tyre.

Tjetër, dua t’ju uroj për vendosjen e një shembulli të prezantimit të programit në Parlament, sepse deri tash s’kemi pasur një shembull të tillë. Ka pasur do prezantime të ekspozeve, por jo të programeve substanciale dhe të detajuara sikur programin që e kemi përpara. Prandaj, në emër të konstituentëve të mi dhe të votuesve, dua t’ju falënderoj për këtë dhe do të flas për disa pika që ndërlidhen edhe me 100-ditëshin, por edhe me programin në përgjithësi. Dua t’ju falënderoj, siç thashë, për menaxhimin efikas të ceremonisë së shpalljes së pavarësisë, në përgjithësi. Këtë e thanë shumë të tjerë këtu që shpallja e pavarësisë së Kosovës shtet të pavarur dhe sovran është meritë e shumë gjeneratave dhe shumë qytetarëve, jo veç e neve që jemi gjallë, ndoshta edhe më shumë e atyre që s’janë gjallë më, prej së paku 1912 e këndeje. Por, sidoqoftë, menaxhimi aq efikas është meritë e Qeverisë, kësaj Qeverie, jo vetëm për shpalljen, por edhe të festimit denjitoz edhe të procesit të njohjes dhe është shumë me rëndësi. Normalisht, qytetarët këtu e meritojnë një notë maksimale, sepse kanë qenë partnerë të institucioneve në festimin të dinjitetshëm të kësaj pavarësie.

Në anën tjetër, nga punët e panumërta ditore të kësaj Qeverie, siç po shihet edhe në këtë prezantim me më mbi 100 vendime për 100 ditë, mesatare shumë efikase kisha për të thënë, kisha për ta veçuar transparencën e plotë të punës së Qeverisë që për shembull, ne s’kemi pasur rast përpara që mediat të kenë qasje të plotë në mbajtjen e mbledhjeve të Qeverisë së Kosovës, e tashmë e kanë dhe qytetarët përmes medimeve, por edhe

mediumet drejtpërdrejt e kanë absolutisht një qasje të pabllokuar, siç ka qenë më herët. Kjo është për çdo lëvdatë dhe për përshëndetje. Po ashtu, edhe mbajtja e mbledhjeve në qytete dhe, shembulli me Mitrovicën, besoj ka qenë shembull shumë i mirë, i cili tregon se Mitrovica është ndër prioritetet e kësaj Qeverie dhe besojmë se do të jetë kështu edhe me projektet që janë paralajmëruar për Konferencën e donatorëve, që është shumë me rëndësi dhe po ashtu sa i përket transparencës, shembulli i thirrjes për fillimin e auditimit të punës së Qeverisë që nga dita e parë, definitivisht ka të bëjë me transparencën e madhe që kjo Qeveri po e tregon.

Në planin e politikës së jashtme, Qeveria edhe në programin që e ka paraqitur, por edhe në hapat që i ka treguar deri tash, shpresojmë do ta ndjek këtë punë që e ka bërë deri më tash dhe besoj se prezenca në Samitin e Ministrave të Jashtëm në Bërdo nuk ka nevojë shumë të përmendet, sepse e dimë të gjithë që ka qenë për mburrje për secilin qytetar të Kosovës. Edhe njohja prej 37 shteteve që përfaqësojnë më shumë se 70% të ekonomisë botërore besoj mund të hyjë në këtë fushën e politikës së jashtme.

Qeveria deri tash, shpresojmë edhe në të ardhmen, sipas programit që ka prezantuar ka arritje të prekshme dhe arritje të matshme që është shumë me rëndësi, jo frazeologji, siç kemi mësuar në një të kaluar, në çdo fushë kisha me thënë, por unë do të ndalem pak te fusha e arsimit dhe vetëm për t'i cekur ndoshta, për dallim prej disave që me cinizmin e tyre u munduan t'i relativizojnë ose minimizojnë këto arritje.

Vetëm raporti i MASHT-it në mënyrë shumë telegrafike tregon se janë përmbi 70 pika për 100 ditë si projekte, vendime, realizime dhe fillime të projekteve të mëdha, kjo Qeveri, si edhe në fusha tjera, e ka rritur dukshëm buxhetin për pikat prioritare të programit qeveritar dhe ta zëmë në arsim, po ta krahasojmë me vitin e parë të Qeverisë së kaluar, në vitin 2005 kur kanë qenë 23 milion sot kemi rritje për 150% ose më shumë dhe kemi 56 milion shumë më shumë viti i parë i qeverisë së kaluar ose buxheti i vitit të kaluar në arsim dhe ne veç sivjet kemi më shumë në investime kapitale.

Do të thotë, ashtu siç është paralajmëruar, siç ka qenë fushatë edhe e dy partnerëve të koalicionit por edhe e Qeverisë pas formimit, arsimi me të vërtetë është prioritet nacional i kësaj Qeverie dhe është fakt që na gëzon të gjithëve sepse me të vërtetë është ndër pikat më strategjike për zhvillimin e gjithmbarshëm të vendit tonë.

Si prioritet nacional, arsimi prej një të kaluar kur ka qenë arsim i cili është financuar prej Qeverisë tash ka dalë investim i Qeverisë për në të ardhmen dhe normalisht edhe rritja e këtij buxheti flet por në veçanti kisha për ta veçuar ndërtimin e mbi 70 objekteve shkollore që është më shumë se i gjithë mandati i kaluar që ka ndërtuar shkolla qoftë fillore, qoftë të mesme. Dhe vetëm nxjerrja nga kontejnerët 16 shkolla mjafton e lëre më ndërtimi edhe më shumë se 50 shkollave të reja. Është turp për qeverinë e kaluar që i ka lënë në 16 shkolla - konteinera fëmijët e Kosovës të mësojnë në kushte për gjynah.

KRYETARI: Të lutem, duhet të rezervohesh në kualifikime!

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit dhe kërkoj falje! Nuk mund të ketë reformë arsimore pa pasur objekte, sepse, ju e dini që deri më tash shumica e shkollave në Kosovë kanë mbajtur mësim në 3-4 orare dhe përmbi 300 metra katror llogaritet që brenda këtij mandati ky program thotë se do të ndërtohen dhe kjo padyshim se do të krijojë mundësi për një reformë efikase dhe efektive, e cila do të japë fryte, pa dyshim, shumë shpejt.

Në anën tjetër, projekte tjera në fushën e arsimit, siç është licencimi dhe gradimi i mësimdhënësve, një projekt i përmendur por i vonuar, që tashmë po fillon, do të japë mundësi për rritje të pagave të arsimtarëve, të mësuesve, të mësimdhënësve në përgjithësi sepse ky ka qenë një premtim i kësaj Qeverie dhe po shihet e veç ka filluar puna.

Arsimi i lartë, i cili po ashtu është një fushë tepër e rëndësishme dhe që ka pasur probleme të vazhdueshme, besoj se tanimë ka hapa konkretë. Qysh para dy ditësh tash më veç është punë e kryer autonomia e plotë e Universitetit të Prishtinës e që do të jetë shumë me rëndësi për ofrimin e një kualiteti më të lartë. Ulja e taksave për studentët, që ka qenë shumë e rëndësishme dhe mbi të gjitha edhe akreditimi i universiteteve private për të siguruar një cilësi në arsimin e lartë privat, i cili ka qenë shqetësim i shumicës së qytetarëve të Kosovës. Po ashtu, edhe premtimi tjetër, ndërtimi i një universiteti të teknologjisë së lartë – të informacionit, tregon se me të vërtetë ajo që është thënë se informatizimi dhe kompjuterizimi, teknologjia e lartë në arsimin e Kosovës, do të bëhet prioritet. Këtu po e përmendi për fund, fushën e arsimit, kompjuterizimi i të gjitha shkollave dhe përdorimi i këtyre kompjuterëve në mësimdhënie dhe mësimzënie, që tashmë ka filluar definitivisht është hap shumë i qëlluar dhe besojmë që programin, ashtu sikur e ka paraparë, do ta realizojë.

Mua më gëzon fakti që kaq shpejt ka filluar realizimi i këtyre premtimeve dhe i këtij programi, sepse vërtet ka pasur ngjarje tepër të rëndësishme, të rëndësisë historike, siç ka qenë shpallja e pavarësisë, miratimi i Kushtetutës së Kosovës e tjera dhe meqenëse këto kanë konsumuar energji të mëdha të Qeverisë, është më shumë se sa pritjet, që unë personalisht, si deputet i këtij vendi, i kam pasur për kaq shumë arritje. Dhe, më e mira është që ky trend po vazhdon në çdo dikaster. U përmend transporti e telekomunikacioni, ku për herë të parë kemi rastin kur në rrugët e Kosovës punohet me dy turme dhe kompanitë e Kosovës do të thotë ashtu sikur në gjithë botën po punojnë me një intensitet të shtuar për ta rregulluar infrastrukturën rrugore. Normalisht në energjetikë, tashmë, strategjia e përmend se ka përfunduar dhe dje kemi pasur hapa konkret të Qeverisë për shprehjen e interesimit për....

(Ndërprerje nga regjia – tejkalim i kohës për replikë)

KRYETARI: Për replikë, është lajmëruar Lutfi Haziri.

LUTFI HAZIRI: Kryetar, kërkoj falje, sepse për shkak të Delegacionit të Parlamentit të Evropës kam qenë në mungesë këtu, por është lakuar emri im nga një deputet dhe unë kërkoj të sqarohet, përkundër që unë nuk e kam fjalën e tij komplet, por ai e ka përmendur fjalën time në rrafshin e fjalës time në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së. Nuk kam replikë me të tjerët, kam replikë me atë që e ka përmendur emrin tim.

Është fjala për deputetin Sllavisha Petkoviq.

(Reagim)

Nuk është këtu dhe unë e rezervoj të drejtën, për ta ftuar s'mundem, por unë dua të sqaroj, nëse më lejohet, sipas procedurës do ta sqaroj. Faleminderit shumë! Në radhë të parë, unë kam folur në emër të Grupit Parlamentar të LDK dhe duke qenë përfaqësues i këtij Grupi politik, edhe kësaj here, edhe në legjislaturën e kaluar dhe edhe në të parën LDK ka qenë në qeverisje. Andaj, personalizimin e raporteve, terminologjia e përdorur nga deputetët dhe kualifikimet që përdoren nga deputetët janë të papranueshme, mendoj

se reagimet duhet ndodhur nga të gjithë ne, sepse LDK, me përfaqësim qeveritar edhe në këtë mandat edhe në mandatin e kaluar me AAK, dhe në mandatin e parë në bashkëqeverisje me PDK e ka pasur rolin e vet, obligimet e veta, detyrat e veta dhe zhvillimet kanë ndodhur në proces, mendoj se në këtë rrafsh do të duhej në të ardhmen nëse ka nevojë për sqarim më shumë, por të mos lejohet që të keqpërdoret roli i LDK, i individëve që kanë përfaqësuar LDK-en dhe vazhdojnë të jenë pjesë e kësaj politike dhe terminologjia si korrupsion, devijim, krim i organizuar dhe gjithçka që përdoret sot, edhe dje, edhe nesër – nuk mund të adresohet dhe nuk guxon të lakohet vetëm si pjesë e politikës dhe angazhimeve të sotme. Prandaj, gjithçka ka emër, mbiemër në Kosovë. Gjithkush ka pasur, ka detyra dhe përgjegjësi....

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Të nderuar deputetë, mendoj se më tepër se dy orë jemi duke debatuar, kemi dy mundësi të zgjedhim. Një, ta shtyjme debatin për të hënë, ose të marrim një pauzë 30 minutëshe. Për këtë, le të deklarohej shfat e grupeve parlamentare. E ka fjalën deputeti Ramë Buja.

RAMË BUJA: Faleminderit, zoti Kryetar!

Në një dakordim që patëm me kryetarin e Grupit Parlamentar të AKR-së dhe të LDK-së, u dakorduam që seancën ta shtyjme për të hënë.

KRYETARI: Jeni dakord?

Kush është “për”? Faleminderit!

A ka “kundër”?

Konstatohet se me shumicë votash, u vendos që seanca të vazhdojë punën të hënë, në orën 10,00.

E hënë, më 21.04.2008

Vazhdimi i seancës plenare

KRYETARI: Mirëmëngjesi, mirë se keni ardhur në vazhdimin e seancës.

Të nderuar deputetë,

I nderuar Kabinet qeverisës,

Në sallë janë 64 deputetë. Ne, nga e premtja e kemi një listë me emra, siç kanë qenë të paraqitur, por edhe sot kemi një paraqitje të re. A po fillojmë me paraqitjen e re apo nga emrat që i kemi bërë në seancën e së premtes? Mirë, faleminderit!

Atëherë, ftoj deputeten Synavere Rysha, për diskutim. Të përgatitet Xhezair Murati.

SYNAVERE RYSHA: Faleminderit Kryetar,

Unë e kam kërkuar fjalën të premten, herët, kështu që asnjëherë nuk ma ke dhënë fjalën. Faleminderit që sot në mëngjes po ma jep fjalën. Unë, krejt çka kam pasur të flas ka të bëjë me informatën, kurse për programin mendoj të flas pak më vonë. Prandaj, do ta kërkoj fjalën dhe sipas radhës e marr më vonë.

KRYETARI: Kjo është radha e së premtes. Unë në bazë të regjistrimit që e kam e kam bërë ti e ke radhën të flasësh.

SYNAVERE RYSHA: Mirë, faleminderit, atëherë po vazhdoj.

Si duket Qeverisë dhe pushtetet aktual shpjet u ka rënë energjia dhe elani, gjithherë po i referohem seancës të së premtes, sepse jemi në vazhdim të asaj seance. E filluam seancën në orën 11,00, pas gjysmë ore pauzë, një orë e gjysmë, prapë një orë seancën dhe vazhdojmë prapë pauzën tjetër dhe krejt në fund, të lodhur dhe të rraskapitur presim të diskutojmë. Mirëpo, sido që të jetë, sot jemi pak më të përgatitur.

Tash do të kaloj te Programi. Materiali i cili na vjen, na vjen me 56 faqe, që po të ishte shkruar në formën apo shkrimin qysh është dashur të jetë si shkrim akademik, është dashur t'i ketë 25 faqe dhe kur nga ato 25 faqe hiqen konceptet, teoritë dhe ato që janë përsëritur gati në secilën pjesë apo në secilën sferë, atëherë i bie 10 deri 12 faqe. Ky është volumni i programit të Qeverisë për katër vjet.

Dokumenti i cili na paraqitet na vjen me koncepte dhe teori të papranueshme dhe të pakontestueshme dhe ka zënë, gati gjysmën e vendit në Program. Herë-herë ky dokument na përshkruhet si Raport, por kuptohet i Qeverisë së kaluar, sepse raportet zakonisht bëhen në fund të vitit apo në fund të çdo periudhe dhe shpeshherë konceptet e përsëritura siç e thashë në gjuhën apo raportet që janë marrë nga raportet e mëparshme që janë paraqitur në program që në gjuhën e kompjuterit i bie copy-paste.

Objektivat e padefinuar dhe mungesat e strategjisë e karakterizojnë këtë program. Që në fillim vërehet një qasje joprofesionale dhe një renditje jo e mirë e fushave apo sferave të cilat paraqiten në hyrje apo në përmbajtjen e Programit. Ja si fillon hyrja. "Programi qeveritar paraqet bazat për një Kosovë –shtet", që vazhdon edhe më tutje. Unë nuk e di në cilin program paraqiten bazat. Programi, zakonisht është një objektivë apo një orientim që synohet të arrihet e jo një bazë. Prandaj, për mua kjo është e papranueshme.

Më tutje thuhet se synimi, vullneti dhe destinacioni është Bashkimi Evropian, mirëpo nuk tregohet si do të arrihet kjo dhe në çfarë faze.

Ndër prioritetet e Qeverisë të paraqitura në këtë program janë katër: rritja ekonomike, implementimi i statusit, qeverisja e mirë, zbutja e varfërisë dhe stabilitetit ekonomik, që e para dhe e fundit janë plotësisht të papranueshme. Mirëpo, implementimi i statusit është diçka që domosdo po ecën dhe çfarë kjo ka të bëjë këtu me Programin? Kurse, qeverisja e mirë, më tepër mund të konsiderohet si koncept apo një parim që mund ta ketë secila qeveri, qoftë kjo e tashmja, e kaluara apo kjo më tepër mund të kuptohet si një koncept e jo si prioritet në Programin e Qeverisë.

Sipas këtij programi, Qeveria synon që rritjen ekonomike ta arrijë në sektorin e energjetikës dhe krejt angazhimet e veta synon t'i realizojë në këtë sferë që është projekt shumë i kushtueshëm dhe vështirë i realizueshëm, kur dihet buxheti me të cilën disponon Kosova dhe trendët e zhvillimit të vendit. Qeveria edhe gjatë fushatës zgjedhore premtoi rrymë 24 orë në muajin e parë të udhëheqjes së saj, mirëpo nuk po ndodh as pas gati 5 muaj pas zgjedhjeve dhe në këtë mënyrë e arsyeton me problemet e trashëguara, sikur këta njerëz nuk kanë jetuar në një realitet të tillë.

Ndër të tjera në këtë pjesë përmendet edhe mosinkasimi i faturave dhe borxheve të energjisë së shpenzuar, madje-madje si politikë këtu përdoren gjykatat dhe policia. Kjo është politika dhe strategjia e Qeverisë së ardhshme.

Bujqësisë, si një aktivitet mjaft i rëndësishëm ekonomik, i është kushtuar vëmendje e pamjaftueshme. Duhet pasur parasysh faktin se në rrethanat në të cilat po kalon Kosova, bujqësia duhet të jetë prioritet, sepse është projekti që më së paku kushton dhe më së

lehti arrihet te zhvillimi ekonomik apo edhe te zbutja e papunësisë e cila është edhe synim i kësaj qeverie.

Sa i përket ekonomisë së vendit dhe uljes së papunësisë këtu të paktën përmenden disa objektiva të cilat si koncepte apo si fjali janë të papranueshme dhe atë kur thuhet. Në Raportin e bujqësisë thuhet: “Rritja e të ardhurave për bujqit dhe banorët rural përmes rritjes së prodhimtarisë”, diçka e pakuptim dhe e formuluar jo mirë. Ndoshta, këtu mendohet në stimulimin e bujqve përmes subvencioneve dhe masave tjera përkrahëse, me qëllim të rritjes së prodhimtarisë së produkteve bujqësore, ose objektiva tjetër e katërt ose e pestë me radhë, ku thuhet: “Përmirësimi i cilësisë dhe standardeve higjienike në fermë apo në fabrikë”, ku këto lirisht në bazë të kësaj fjalie Qeverinë mund ta kuptojmë si, apo e shohim si një biznes, që absolutisht, nuk ka të bëjë kjo me biznesin që, ndoshta, do të ishte më mirë të thuhet: “Shtimin e kontrollit, me qëllim të përmirësimit të kushteve higjienike në ferma apo edhe fabrika.”

Politika tatimore, më tepër aty përshkruhet situata aktuale dhe thuhet se politikat tatimore do të përmirësohen, por edhe kjo nuk tregohet se si do të përmirësohet dhe cilat do të jenë hapat apo çka do të bëjë Qeveria në këtë drejtim?

Në fund të përshkrimit të politikës tatimore një paragraf shumë i pasqaruar konfuz dhe i mangët që mendoj se duhet të korrigjohet apo edhe të hiqet fare.

Kur analizojmë sektorin financiar që na është paraqitur në këtë program, del se përshkruhet puna e bankave komerciale si biznese private që operojnë në Kosovë. Dhe, ku gjendet roli i Qeverisë këtu dhe çka ofron Qeveria në këtë drejtim për qytetarët e saj? Asgjë konkrete. Qytetarët presin ulje të kamatave dhe interesave nga bankat komerciale të cilat janë më të larta në regjion dhe më gjerë dhe për shkak të rrezikut të kthimit të tyre ato janë shumë të larta.

Dhe ku janë këtu mjetet e grumbulluara nga Fondi i Privatizimit? Kush po i menaxhon mjetet e Trustit Pensional të Kosovës? Pse nuk ka asgjë konkrete në këtë drejtim nga ana e Qeverisë?

Nga faqja 39 deri 43 e këtij programi ku fillon menaxhimi i financave publike, luftimi i korrupsionit, përmirësimi i ekzekutimit të shpenzimeve kapitale, vjen ajo copy-paste nga Raporti në program që e thashë në fillim. Do ta citoj vetëm një paragraf nga faqja 39, paragrafin e tretë, dhe shiko çka thuhet: “Në përgjithësi ky raport vë në dukje rezultatet e arritura deri më tani sa i përket menaxhimit të shpenzimeve publike dhe përgjegjësiive financiare dhe ka vlerësuar së fundi se Kosova nëpërmes Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave ka arritur të krijojë një disiplinë dhe një rregull sa i përket kësaj fushe”. Raport apo program, më tepër raport.

Zbutja e varfërisë dhe stabiliteti social. Pas zhvillimit ekonomik problem tjetër që kërkon zgjidhje të shpejtë dhe duhet të trajtohet shumë seriozisht nga ana e Qeverisë, mendoj se duhet të jetë zbutja e varfërisë. Është për çdo kritikë, por edhe për ardhur keq hapësira dhe qasja çfarë Qeveria i ka kushtuar këtij problemi në Programin e saj, problem ky me të cilin po ballafaqohen gati gjysma e popullatës së saj rreth 43%. Dhe këtë problem Qeveria në Programin e saj mundohet ta zbutë me pensione dhe ndihma sociale e jo me forma të tjera si angazhim dhe përkushtim më të madh rreth punësimit, sidomos të rinjve dhe femrave.

Zhvillimi i sektorit privat, përkrahja dhe zhvillimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, pak gjejnë hapësirë në programin qeveritar e dihet mirë roli dhe rëndësia e zhvillimit dhe përkrahjes së tyre se sa mund të ndikojnë në rritjen e buxhetit të Kosovës. Një hyrje shumë e pakuptimtë, pa logjikë dhe pa strategji të hartuar e përcjellin këtë sektor. Kjo tregohet edhe në program dhe thuhet nga vetë hartuesit e këtij programi.

Dhe krejt në fund, duke e përmbledhur këtë material, lehtë është të vijmë te përfundimi dhe te konstatimi se Qeveria e Kosovës edhe pse më tepër se 4 muaj e gjysmë pas zgjedhjeve, ende është pa një program të qartë. Ky që na është ofruar sot në Kuvend nuk i plotëson kriteret për t'u miratuar, i mungojnë objektivat dhe strategjia implementuese që edhe nga vetë hartuesit e tij përmendet. Kërkoj që t'i kthehet edhe një herë në shqyrtim Qeverisë dhe të plotësohet me vërejtje dhe propozimet e deputetëve, të kalojë nëpër komisionet e Kuvendit dhe mandej të miratohet.

Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Fjalën e ka Xhezair Murati, le të përgatitet Vlora Çitaku.

DŽEZAIR MURATI: Hvala, gospodine predsjednice!

Dozvolite da vas pozdravim, kao i zamenike premijera, ministre, kolege,

Mi smo u prilici da detaljnije analiziramo ponuđene informacije iz izveštaja ali programa Vlade. Tako da se ne može izdvojeno govoriti o 100 dana rada Vlade i o programu Vlade do 2011. godine, s obzirom na to da izveštaj obuhvata jedan duži period, dakle do kraja mandata predviđeno. Ja ovom prilikom ne želim da uzdižem Vladu do zvezda, kako je to jedan naš kolega uradio pre nekoliko dana, ali niti da je kritikujemo bez mnogo argumenata. Naše kritike će biti konstruktivne u cilju poboljšanja nekih rešenja, sugestija koje će dovesti do boljih rešenja, i tako dalje.

Naravno, da ću ovom prilikom izneti stav da se daju umerene i realno ostvarive prognoze, ali da nam Vlada ponudi možda i predvidi ponuđene rizike unutar Kosova, ali i predviti rizike i opasnosti koji su mogući iz okruženja i tako dalje, mislim da smo i time mogli da se pozabavimo.

Gradjani, to ću ovde ponoviti, moraju imati više informacija oko uloge UMNIK-a i EULEX-sa, jer je u javnosti prisitno dosta dilema i kontradiktornih tumačenja uloge ovih dveju struktura, dakle dosadašnje i buduće. Iz tih različnih tumačenja često se stvara nedoumica i mogućnost propagande raznih vrsta koja nam dolazi, i tako dalje.

Ja ću ovom prilikom, kada govorimo o ministarstvima, krenuti od onog ministarstva koje smatram da treba da pripada svim zajednicama, o čemu sam i do sada u više navrata i u prethodnim mandatima govorio i da pohvalim napore sadašnjeg ministra za povratak, koji vidno pokušava da ovo Ministarstvo pretvori Ministarstvo za zajednice, ali je sigurno da neće moći sam ukoliko ne bude više podrške i Vlade i nas koji smo ovde, i tako dalje. Ja bih takođe ovom prilikom naveo da je evidentno da je izveštaj u nekim segmentima preopširan i da sadrži neke podatke koje su za takvu priliku možda nepotrebni, no ako smo toliko žurili, normalno je da mogu da pokradaju i tako neki detalji koji nas možda preopterećuju, i tako dalje. Ja ću takođe ovde spomenuti jedan problem koji se takođe ovde, ne ovde nego u nekim drugim sredinama, drugačije tumači. Naše zajednice, ja ovde govorim u ime Bošnjačke i Turske zajednice, su preko svojih političkih subjekata spremne da problemu decentralizacije priđu ovde u ovoj zakonodavnoj Skupštini, u ovom

telu, a ne da neki to zloupotrebljavaju u javnost nazivajući nas ne znam miljenicima ili provladinim, pa mi smo deo Vlade, a ne provladini, i da, šta ja znam, govore za neke izvore, kritikujući nas da smo to trebali da urdimo u Beču.

Mislim da je ovaj Izveštaj trebao da sadrži više podataka o decentralizaciji i mi smo dali jedan amandman u kojem stoji u Ahtisarijevom dokumentu da treba prići razgovoru i pripremi decentralizacije sa predstavnicima zajednica nakon prelaznog tranzicionog, dakle ovog perioda, a ne nakon popisa, za koji ne znamo kada će biti. Mislim ta nejasnoća, mi smo stupili u razgovore i imamo dobru saradnju sa Ministrom za lokalnu upravu, i mislim da ćemo sa više podataka da diskutujemo u periodu koji je pred nama. Ali ja ću ovom prilikom takodje iznijeti još nešto što svi građani Kosova vide veoma smeće poteze Ministra za saobraćaj, koji je krenuo zajedno, normalno sa svojim saradnicima, u nešto što svi vide i pozdrvljaju. I neko će reći, pa to ga sleduje po zakonu. Mislim da su i prethodni ministri tog sektora bili u prilici možda, a nisu možda imali hrabrosti ili smelosti ili čega već, i zaista to pozdravljamo. Ali ću takodje našeg Ministra za saobraćaj i komunikacije ovom prilikom upoznati sa jednim problemom koji imamo i koji nam se dogo vuče, i ja znam da je on sa time upoznat, ali je moja dužnost zbog građana da ovo pomenem.

Sredine gde mi živimo nemaju još uvijek signal RTK, a građani plaćaju televizijsku pretplatu. Doneli smo amandman na Zakon o tome, da sve dok nam ne bude taj signal omogućen, građani ne plaćaju ono što ne primaju. Medjutim, ne znamo kako, iz neke možda više sile ili kako, ponovo je nametnut taj danak i naši građani zaista su veoma razočarani jer se njima na taj dug isključuje struja. I onda su dodatno ubačeni u kategorije koje su nepovoljne po građane koji su uredni platiše potrošene struje, i tako dalje. No, ja sam ubedjen da ćemo i ovaj problem rešiti, bar sam takvog mišljenja.

Vidite gospodo, činjenica je da je Vlada imala i da je u ovih 100 dana bila u periodu kada je krenula sa radom, kada smo imali proglašenje nezavisnosti, dakle državnosti, kada smo imali usvajanje Ustava, i ta zauzetnost je bila evidentana, ali je došlo do toga da i pored obećanja, nisu mogli da nadju vremena da obidju sredine u kojima živimo i pored želja koje su istaknute i od premijera, i od zamenika premijera i od nekih ministara koji su potrebni da obidju te sredine. I moja je sugestija danas ovde usmerena na to da ćemo morati manje zajednice da obidjemo, da ih ohrabrimo, jer zajednice koje Kosovo doživljavaju kao svoju državu, jer drugu nemaju, treba im u počecima razvoja državnosti malo više moralne podrške i u tom smislu ja se nadam i pojedini ministri izrazili su spremnost da nas obidju, i ministar unutrašnjih poslova, i ministar obrazovanja i ministar saobraćaja, ja se nadam i ministar zdravstva i tako dalje. Oni koji budu mogli da nas obidju, da obavimo razgovore sa građanima, da možda građanima pružimo malo veću perspektivu na moralnom planu, s obzirom na to da nam je ekonomska situacija takva kakva jeste i da ne možemo više da ponudimo građanima nego što ostali građani imaju priliku, i tako dalje. Ali, ovih dana, ja ću upoznati ovo telo, našu Vladu da u sredinama gde mi živimo, valjda zbog naše zauzetnosti, vršljaju neki ministri iz susednih zemalja. Dolaze, ko ih poziva ne znamo, dolaze, obilaze, posećuju, seju, prodaju neku maglu i prašinu, i tako dalje, i ko ih poziva, za koje ciljeve ne znamo, ali naša Vlada sigurno o tome more povesti više računa.

Prekjuče sam prisustvovao jednoj tribini o našem novom Ustavu, gde su neki bili spremni i da pljuju, i tako dalje, i ko je prisutan, niko drugi do Bugarska televizija, a čitali smo nedavno u novinama čak i o nekoj Bugarskoj manjini na Kosovu.

Znate, to su odredjene propagande, placene iz nekih izvora, ne znamo za ciji racun, ali je evidentno da postoji.

Evo, na kraju da kazem da mi u svakom slucaju i Program i Izvestaj Vlade podrzavamo uz zajednicka obecanja da cemo zajednickim radom pokusati da neke od problema koji su pred nama zajednicki resimo. U to ime, hvala vam na paznji!

KRYETARI: Faleminderit! Radhen e ka deputetja Vlora Çitaku, le të përgatitet Gjynaze Syla.

VLORA ÇITAKU: I nderuari, zoti Kryetar,
Të nderuar zëvendëskryeministra, ministra,
Të nderuar kolegë deputetë,

100 ditshi që lamë pas shënon përfundimisht fillimin e një epoke të re për Kosovën dhe qytetarët e saj. Kosova u bë shtet i pavarur dhe sovran dhe me njohjen e shpejtë dhe masive shënoi një rast unikat në historinë e formimit të shteteve në 30- vjetshin e fundit.

I nderuari Kabinet qeveritar. Pa dyshim që jetësimi i kësaj objektive historike është siç thoni edhe ju vetë rezultat i punës dhe i sakrificës së gjithë qytetarëve të Kosovës. Po nuk mund të mos e përmendim faktin se menaxhimi i suksesshëm i procesit, para e gjatë dhe pas shpalljes së pavarësisë ka ndikuar dukshëm në rritjen e vendosmërisë së partnerëve tanë për të qenë pranë nesh në procesin drejt zhvillimit ekonomik dhe integriteteve evropiane.

Institucionet dhe populli i Kosovës kanë prodhuar shumë lajme pozitive gjatë këtyre 100 ditëve. Është miratuar akti më i lartë juridik- Kushtetuta e Kosovës, ndërkohë që, pa dyshim, që Qeveria me angazhimin e saj ka diktuar një dinamikë më të madhe të punës edhe në Kuvendin e Kosovës.

Përkundër faktit që para vetes keni pasur një përgjegjësi historike dhe kombëtare e cila sinqerisht besojmë të ketë marrë fokusin dhe energjinë tuaj më të madhe gjatë kësaj periudhe, rezultatet e arritura edhe në sfera tjera janë mbresëlënëse.

Të nderuar ministra,

Me keqardhje them se një nga trashëgimitë më të rënda nga qeveritë paraprake nuk ka qenë as mungesa e zhvillimit në: infrastrukturë, ekonomi, arsim apo shëndetësi, por ka qenë një imazh totalisht i rrënuar i qeverisjes. Qeveria kishte degjeneruar nga funksioni i saj primar, shërbimin ndaj qytetarit dhe ishte reduktuar në një hapësirë ku paraja publike, taksa e qytetarit shpërdorohej në mënyrë më të vrazhdët.

Të nderuar ministra,

Dua t' ju përgëzoj para se të gjithash për faktin që institucioneve të Kosovës ua keni kthyer integritetin dhe pa dyshim që reduktimet e shpenzimeve marramendëse në karburante, telefona, darka e të tjera të ngjashme kanë ndikuar në rivendosjen e një raporti më të besueshëm mes institucionit, mes Qeverisë dhe qytetarit. Ju nuk vazhduat praktikën e arrogancës së skajshme dhe si rezultat i këtyre vendimeve nuk është vetëm përmirësimi i imazhit të institucioneve dhe Qeverisë, por edhe miliona euro të kursyera të cilat do të destinohen në projekte për arsim dhe shëndetësi.

Lufta kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit kudo që ai të shfaqet më në fund pushoi të jetë prioritet vetëm i qytetarëve. Me kënaqësi konstatojmë që përkushtimi i Qeverisë suaj po jep rezultate. Është evidente që nuk ka më azil politik për ata shpërdorojnë paratë publike në çfarëdo forme.

Mbështetja e vazhdueshme që po i ofroni Auditorit Gjeneral, Agjencionit Antikorrupsion dhe vullneti politik i shprehur për t'i luftuar këto dukuri presim që të pasohet nga organet e drejtësisë të cilat fatkeqësisht deri më tani kanë punuar në një presion të vazhdueshëm politik.

Të nderuar ministra,

Qeveria që ju përfaqësoni ka vendosur një varg standardesh të cilat besojmë të jenë të pakthyeshme, duke filluar nga integriteti dhe profesionalizmi i ministrave, deri tek raporti i detajuar dhe programi që sollët para nesh.

Posaçërisht dua t'ju përgëzoj për angazhimin serioz për t'i përmbushur objektivat dhe prioritetet e dhëna gjatë fushatës zgjedhore. Rezultatet e para jo të pakta të qeverisjes së suaj tash më janë të prekshme. Tetë shkolla të filluara, ndërkohë që ekzistojnë mjete dhe projekte të ndara edhe për 72 të tjera. Po thuaj se përgjysmimi i taksave për studentët, vendosja e autonomisë financiare për Universitetin e Prishtinës, aktivizimi i Agjencionit për Akreditim si dhe fillimi i procesit të licencimit të mësimdhënësve, janë vetëm hapat e parë të prekshëm në sferën e konsideruar nga ju dhe ne si prioritet nacional.

Impenjimet serioze të Qeverisë në përmirësime dhe investimet në infrastrukturën rrugore gjatë këtyre 100 ditëve kanë qenë të jashtëzakonshme. Në më pak se 100 ditë, Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit ka nënshkruar 78 marrëveshje me 22 komuna, dyfishë më shumë se në mandatin e kaluar, në të cilat Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit merr pjesë me mbi 90% investime.

Një dimension tjetër i rëndësishëm është, padyshim, fakti i patjetërsueshëm se më në fund po shihet dora e shtetit, më në fund po shihet se Kosova ka zot shtëpie.

I nderuari ministër Limaj, rrënimi i objekteve të ndërtuara në hapësirat publike përgjatë magjistrave që po zgjerohen me ritëm të shpejtë na ka bindur se më në fund Kosova ka një qeveri që i shërben qytetarëve e jo vetvetes.

Të nderuar ministra,

Shembuj të ngjashëm të përparimit të dukshëm mund të gjendet në të gjitha dikasteret qeveritare. Unë jam e inkurajuar me programin që keni ofruar para nesh dhe kam besim që me ritmin që keni filluar brenda mandatit qeveritar ju do ta përmbushni atë në plotëni. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

E ka fjalën deputetja Gjylnaze Sylja, le të përgatitet deputeti Berat Luzha.

GJYLNAZE SYLA: Faleminderit!

I nderuari zoti Kryetar,

Të nderuar qeveritarë,

Të nderuar kuvendarë,

Imagjinoni jetën në Kosovë sikurse të ishin përmbushur premtimet e dhëna gjatë fushatës: 24 orë rrymë, paga për mjekë, paga për arsimtarë, pensionet dinjitoze, shkolla të kompjuterizuara, mirëqenie, zhvillim ekonomik.

Por premtimet s'u mbajtën dhe qytetarët u zhgënjyën. Prandaj, hapi i parë që duhet kjo qeveri të bëjë është që të ballafaqohet me vetveten dhe ta pranojë realitetin se premtimet i ka shumë më të mëdha se realizimet.

Debati i sotëm për Programin e Qeverisë është i vonuar, është i vonuar 3 muaj. Ju jeni e vetmja Qeveri që keni punuar pa program, por vendimet i keni marrë në baza ditore dhe ato vendime të rëndësishme për jetën e qytetarëve të Kosovës, vendime ad-hoc, jo vendime të bazuara në program. Shumë kohë zotërinj qeveritarë keni humbur në funksione simbolike, në veçanti Kryeministri i është përkushtuar ceremonive dhe ndërtimit të imazhit të vet.

Arsyetimi i Kryeministrit se programi nuk ka mund të hartohet për shkak të statusit, ky argument nuk qëndron aspak, janë së paku dy arsye. Arsyeja e parë është që ne 9 vjet presim statusin. E dyta, vetë Kryeministri ka deklaruar shumë herë në media se ai e din datën e pavarësisë.

Të nderuar deputetë,

Më lejoni tani që të fokusohem në vetë Programin që unë nuk e konsideroj Program, por e konsideroj një udhërrëfyes pa kornizë. Pse? Është shumë i përgjithësuar, nuk ka afate kohore. Kisha dash ta di kur do të kemi rrymë, në muajin tjetër, në 2008, 2009, 2010, 2011. Kur do të rriten pagat, sa do të rriten ato paga: 10€, 20€, 50€ të mësuesve si dhe të mjekëve ose sa do ta ulni varfërinë 5%, 2% brenda viti? Kjo tregon se nuk keni program konkret i cili do të na bind ne se ju do të përmirësoni jetën e qytetarëve të Kosovës.

Vetë titulli i programit që thotë se përfshin periudhën 2008 – 2011, nuk mbështetet në atë në çka ju jeni zotuar se do ta përmbushni plotësisht Planin e Ahtisarit, sepse sipas Planit të Ahtisarit, të nderuar qeveritarë, 9 muaj pas fazës tranzitore duhet të mbahen zgjedhjet.

Si është dashur të punohet, e para në Kryeministri, meqenëse është e dukshme se nuk e keni pasur kapacitetet. Për të hartuar një program është dashur në Ministri të keni një njësi të veçantë për hartimin e politikave dhe strategjisë. Ky do të ishte hapi i parë,

Hapi i dytë, do të ishte artikulimi i vizionit kah do të shkojë Kosova, pavarësia u krye duhet ta dimë se kah duhet të shkojë shteti?

Çështje tjetër është se është dashur të hartohen politika të mirëfillta, afatshkurta dhe afatgjata dhe strategji të cilat do t'i mbështetnin këto politika.

Caktimi i këtyre katër prioriteteve nga qeveritarët nuk më bind se është i zbatueshëm. Pse? Sa kushtojnë këto? Këto, gjithashtu, do të jenë prioritete të cilat do të prezantohen në Konferencën e Donatorëve dhe ju nuk e dini çmimin sa do të kushtojë paketa e Ahtisarit? Nuk e dini, sepse nuk keni punuar një plan të veprimit në të cilën do të shkoqitshin secili pjesë të Planit të Ahtisarit dhe se do të dini se çka do të bëni në ditën e ardhshme.

Çështje tjetër, mënyra e qeverisjes është më se shqetësuese. Është shqetësuese, sepse në vend që të punoni për fuqizimin e qytetarëve, ju zotërinj të nderuar, po qeverisni në mënyrën e kontrollit. T'ju kujtoj të premtën nuk patëm debat, por më tepër Kryeministri kushtëzoi- tha: "Nëse fillon debati, atëherë secili prej ministrave duhet të prezantojë pjesën e programit të vet" Ndryshoni këtë mendje, filloni t'i trajtoni qytetarët si partnerë.

Nuk ka pasur asnjë të vetmen fjalë kaq të rëndësishme për shtetin e Kosovës-familja. A keni politika për familjen? Shteti i aftë dhe i fuqishëm duhet të ketë politika për familjen dhe, po ashtu ,Qeveria e aftë.

Tani do të përqendrohem në disa pjesë konkrete të këtij programi- shëndetësia. Në program thuhet se do të shqyrtohet mundësia për shpërblimin e profesionistëve shëndetësorë, por nuk ceket konkretisht se si do të shpërblehen, sa do të jetë ai shpërblim? Për më tepër thotë do të bëhet një projekt gjithëpërfshirës për zbatimin e informimit shëndetësor e informimi shëndetësor është shumë i rëndësishëm se në te bazohen politikat e shëndetësisë.

Zoti Ministër kur e kam bërë pyetjen më keni thanë se është "si me hyp në Mercedes," pasi hipni në biçikletë më mirë ia filloni.

Çështje tjetër është se asnjë ligj në vitin 2008 Ministria e Arsimit nuk e ka paraparë, asnjë ligj të vetëm. Sa i përket arsimit, ministri ka punuar dhe shihet përkushtimi i tij. Por, Zoti Ministër, është me rëndësi që të krijoni kushte ku të gjithë do të shkollohen. Vajzat janë të pashkolluara, sidomos në zonat rurale, mundësitë për këto duhet të krijohen. Po ashtu, thuhet se do të mbështetet arsimi privat, nëse mbështetet ju kërkoj Ligjin për arsimin dhe trajnimin privat. Nuk janë të definuara politikat për nxitjen e cilësisë së arsimit para universitar dhe universitar, megjithatë, unë dëshiroj, posaçërisht, të përgëzoj ministrin për punën.

Sa i përket buxhetit, nuk e dini koston e këtij programi qysh doni ta zbatoni nëse s'e dini sa do t'iu kushtojë kjo. Në njërën anë thotë ministri se i ka kursyer këto të holla, në anën tjetër nuk ka as më të voglën masë qysh do ta parandalojë kontrabandën- miliona euro humbin në veri dhe në lindje të Kosovës për shkak të kontrabandimit.

Dhe për një shtyllë shumë të rëndësishme të shtetit të Kosovës dhe të shoqërisë së Kosovës - Trupat Mbrojtëse të Kosovës. Në program i keni 3 reshta, 3 reshtja janë, është vetëm transformimi i TMK-së në një forcë profesionale të sigurisë. Kaq ka për TMK-në.

Dhe në fund sa i përket barazisë gjinore, është absolut qesharake të flasë ministri për barazinë gjinore, kur të gjithë këshilltarët i ka meshkuj. Le të fillojë pak ta ndërrojë për t'i besuar që ai do të jetë i përkushtuar për politikat e barazisë gjinore.

Të nderuar qeveritarë,

Është koha të jeni të sinqertë ndaj qytetarëve të Kosovës. Është koha që politikat tuaja të jenë në interes të qytetarëve të Kosovës, të jenë politika për qytetarët, jo pushtetarët. Në fund i sugjeroj Qeverisë që takimin e ardhshëm ta mbajë në veri të Mitrovicës
Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka Berat Luzha, le të përgatitet deputeti Xhevdet Neziraj.

BERAT LUZHA: Faleminderit, zoti Kryetar!

Është e vërtetë se Qeveria këtë herë na pruri me vonesë mjaft të madhe një program që ishte i përgatitur dobët. Vonesa edhe mund të arsyetohet pasi në ndërkohë zhvillohej procesi i përcaktimit të statusit, por për mospërgatitjen e programit ashtu si duhet, Qeveria duhet të marrë një vërejtje nga Kuvendi. Është indikative se më mirë ishte përgatitur informata apo raporti për 100- ditshin e parë të punës së Qeverisë, sesa programi i saj.

Programi është sot një fakt pas të cilit po kapet opozita. Nëse i përmbahemi fjalës së urtë “se dita e mirë shihet në mëngjes”, atëherë mund të përfundojmë se Qeveria ka filluar punën mbarë, ka filluar dukshëm më mirë se secila Qeveri e deritashme. Ky përfundim më së mirë argumentohet jo shumë me deklarata sa me veprimet konkrete, me punën e Qeverisë kundër korrupsionit, me veprime për zvogëlimin e shpenzimeve të parasë publike, me veprime për transparencë institucionale, me tërheqjen e organeve qeveritare nga objektet privat etj.

T’ju përkujtojmë se ndërprerja e paarsyeshme e punimeve për meremetimin e Pallatit të Shtypit nga Qeveria e atëhershme, në fillim të vitit 2005, i ka kushtuar buxhetit të Kosovës miliona euro, si për dëmshpërblimin e punë kryesit rreth 800 mijë euro, ashtu edhe për pagesën e qirasë në objektet private që ishte bërë një biznes i Qeverisë.

Kujtoj se është meritë dhe përkushtim i qeverisë ndërtimi i infrastrukturës rrugore dhe të asaj shkollore.

Shfrytëzoj rastin ta falënderoj, posaçërisht, Qeverinë për projektet për ndërtimin e rrugëve dhe shkollave që ka marrë përsipër t’i financojë sivjet në komunat e Kaçanikut dhe të Hanit të Elezit. E përkujtoj opozitën se gjatë 3 vjetëve të kaluara kjo komunë ishte lënë padore, ishte e diskriminuar plotësisht nga Qeveria e mëparshme në kuptimin e financimit të projekteve të ashtuquajtura kapitale. Ky diskriminim bëhej nga shkaku i vetëm se aty radhazi dhe asnjëherë nuk kishin fituar partitë që në mandatin e shkuar ishin në koalicionin qeverisës. Jam i bindur se Qeveria e sotme nuk do të diskriminojë asnjë komunë.

Më gjithë fillimin e mirë dhe premtues Qeveria duhet t’i kushtojë kujdes më të madh zhvillimit të bujqësisë, degës më të rëndësishme ekonomike pa të cilën realisht nuk mund të ketë zhvillim të vendit. Aq më parë kur prodhimi i ushqimit po zvogëlohet edhe në përmasa më të gjëra, kurse çmimet po rriten në mënyrë rapide.

Në program nuk është shkruar asnjë fjalë për pylltarinë, për ruajtjen, zhvillimin dhe kultivimin e pyjeve që kanë rëndësi të madhe ekonomike dhe mjedisore. Së pari duhet ndërruar Ligji për pyjet, i cili tashmë paraqet pengesë serioze për zhvillimin dhe kultivimin e pyjeve, njëkohësisht, duhet filluar edhe me ristrukturimin e sektorëve të pylltarisë.

Edhe përkundër përpjekjeve të Qeverisë për përmirësimin e gjendjes në fushat e energjisë dhe të shëndetësisë, të dy fushave shumë problematike, gjendja nuk ka ndryshuar dukshëm. Aty janë trashëguar, janë grumbulluar dhe shtresuar aq shumë problemet sa tashmë janë shqetësuese për shoqërinë tonë.

Të gjithë jemi të vetëdijshëm për problemet e trashëguara në fushën e energjisë, të cilat nuk mund të kalohen aq lehtë dhe shpejt dhe jo sigurisht për 100 ditë. Është vështirë t’i

gjendet filli lëmshit të problemeve apo të gjendet çelësi i suksesit në KEK, ku drejtues vendorë dhe ndërkombëtarë për afro 9 vjet me radhë vetëm se kanë mbështjell lëmshin, duke i bërë dëme të mëdha vendit jo vetëm me mungesë të energjisë, por edhe me humbjen e parasë publike.

Edhe vetë Qeverisë i duhet një ristrukturim tjetër fare, duke i bashkuar disa ministri dhe duke formuar edhe ministri të reja, sidomos atë të Mërgatës. Kosova ka një mërgatë të zhvilluar e cila prit dorën tonë dhe e cila, sikur në të kaluarën, ashtu edhe në të ardhmen, mund të bëhet shumë e dobishme për vendin.

Jam i bindur se kjo Qeveri në mandatin e saj do të arrijë t'i përmbushë dhe t'i tejkalojë detyrat që i ka marrë para shoqërisë sonë. Përkushtimi, serioziteti dhe përgjegjësia që e karakterizojnë atë, japin shpresa për sukses të plotë.
Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka Xhevdet Neziraj, le të përgatitet Fehmi Mujota.

XHEVDET NEZIRAJ: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar zëvendëskryeministra,

Të nderuar ministra dhe kolegë deputetë

Do të fokusohem në disa çështje që i njoh më mirë dhe që nga fillimi dua të kyçem. Do të bisedoj për Ministrinë për Komunitete dhe Kthim dhe lëmin e ekonomisë. Ajo që është bërë nuk duhet të nënçmohet, por ajo që është thënë nga ky koalicion qeverisës dhe nuk është bërë, duhet të thuhet mu në këtë vend se këtu është vendi që të thuhet.

Sa i përket Ministrisë së Komuniteteve dhe Kthim, unë nuk shoh ndonjë ndryshim pozitiv edhe pse ne jemi të gatshëm si anëtarë të Komisionit për Komunitete t'i ndihmojmë ministrit që të dalë nga kjo situatë.

Për këtë dua t'i tregoj disa fakte. Të gjitha projektet të cilat janë paraqitur në këtë raport dhe që mund të them që është një raport shumë i shpejtë i punuar, shihet nga raporti, sepse ka insistuar opozita dhe është bërë shumë shpejtë dhe kanë dalë disa gabime, që me siguri Qeveria do t'i përmirësojë në të ardhmen.

Të gjitha projektet janë projekte të kaluara dhe janë të cekura dhe të gjitha projekte të ardhshme janë ato projekte që janë cekur më herë dhe kryesisht janë vetëm për komunitetin serb. Duhet t'i përmend këtu vetëm projektin e Novobërdës, në komunën e Prishtinës, në Fushë Kosovë, në Graçanicë, në Gorazhdec. Kjo ministri kryesisht është duke punuar vetëm për komunitetin serb. Këto janë argumentet, këto janë të shkruara në program. Këto i ka thënë ministri edhe në transparencë se po mbani debate Qeveria shumë mirë dhe më vjen mirë dhe i përgëzoi, por këto janë deklaruar nga vetë ministri. Shtroj pyetje se ku janë komunitetet tjera. Shtroj pyetjen ku është integrim që aq shumë flitet? Dhe duhet të them diçka për integrim. Unë nuk kam ardhur në Kosovë si azilant dhe të integrohem. Unë jetoj këtu me shekuj dhe me vite të tëra dhe duhet të më jepet mundësia jo që të integrohem. Mund të integrohen kinezët kur për 5 vjet mund të jenë qytetarë të ardhshëm të Kosovës.

Gjithashtu, mund të ndalem në një rast tjetër këtu ku Ministria për Komunitete dhe Kthim, që them që 4 – 5 vjet një departament për qeverisje të mirë është duke punuar një

strategji për komunitetin rom, ashkalinj dhe egjiptian. Nuk di ajo strategji është lodhur më, i ka rënë pluhuri, është shqyer dhe nuk di çka ka bërë. Dhe veç dilni në faqen tjetër në 214, në strukturën e punësimit në këtë Ministri janë të punësuar 47 shqiptarë dhe 31 serbë dhe nuk është i punësuar asnjë rom. Atëherë, shtrohet pyetje, kjo Ministri e Komuniteteve, kjo Ministri mund ta quaj e vëllazërim-bashkimit të shqiptarëve dhe serbëve.

Unë për këtë transparencë, që është duke e bërë Qeveria është mirë që kur të shkojë në komunën e Gjakovës, le të shkojë në Kolini në Gjakovë dhe të mbajë një debat me ata qytetarë ku këtu janë të pranishëm zoti Nait Hasani dhe zonja Sanije Aliaj, ku ne si komision i kemi vizituar dhe i kemi parë se ata njerëz jetojnë në tmerr. Dhe kjo Qeveri le të shkojë, le të urdhërojë, pa prezencën time, le të shkojë dhe le të shikojë se si jetojnë qytetarët e Kosovës, të integruar.

Duhet kjo Qeveri të ndërmarrë hapa konkret. Nëse deri me tani jemi marrë rreth statusit dhe komuniteti egjiptas, në çdo pjesë të historisë ka përkrahur dhe do ta përkrahë që Kosova të ecën përpara, duhet që Qeveria dhe ministrat e ardhshëm të jenë më të kujdesshëm.

Paramendoni çfarë strukture e punësimit mund të jetë në ministri tjera, ose në ndërmarrjet publike siç janë: KEK-u, PTK-ja dhe siç janë ndërmarrjet tjera. Nuk vyen ekspertë në PTK të shesin kartela Vala 900. Nuk vyen shkollë e madhe, mirëpo në KEK ose në PTK, ku janë të ardhurat e mira, duhet të jesh ose familjes së mirë ose i ndonjë partie shumë të fortë, shumë thjeshtë. Unë e di që zoti Stollaj është inxhinier i informatikës, konkurron në PTK dhe nuk thirret as në intervistë. Unë e di se doktori Abdullah Safani është kirurg dhe është i papunë në Gjakovë, ndërsa pranohet pastruese. Atëherë si të integrohet komuniteti egjiptas? Komuniteti egjiptas ka gjuhë shqipe, tradita dhe zakone shqiptare dhe e ka këtë origjinë.

Unë dëshiroj, që Kabineti për Qeverisje të Mirë ta heqë këtë fjali që 5 vjet që e ka. Nëse e ka marr nga Këshilli i Evropës strategjinë për komunitetin rom, le ta vazhdojë atë strategji, jo për komunitetin tim. Është duke bërë hajgare të them me komunitetin rom, por mos të bëjë hajgare me komunitetin egjiptas, se komuniteti egjiptas nuk është analfabet, nuk ka kujdes që të kujdeset shumë ai, por duhet të veprojë pozitivisht.

Në çështjet e ekonomisë, unë shpresoj që në pikëpamje ekonomike është përshkruar gjendja ekonomike. Unë nuk pres nga kjo Qeveri, që për 100 ditë ta zbusë papunësinë. Nuk pres që për 100 ditë të bëjë investime. Nuk pres për 100 ditë të rregullohet energjia, se nuk mund të ketë energji Kosova pa ndërtimin e termocentralit C, dhe kjo është që e dimë të gjithë. Prandaj, sa i përket zhvillimit ekonomik, unë them se këtu janë bërë shumë strategji, siç është strategjia e sektorit privat, është përmendur, strategjia për investime, strategjia për turizëm, zhvillim industrial, mbrojtje të konsumatorëve dhe strategji të shumta, por është një problem se ne të gjithë ekonomistët duhet të ulemi dhe ta bëjmë strategjinë e zhvillimit ekonomik për Kosovën, dhe ajo është duke na munguar. Tani është Konferenca e donatorëve dhe ne shkojmë në Konferencë të donatorëve pa strategji të zhvillimit ekonomik. Unë jam i sigurt, duke pasur për bazë profesoreshën Justina Pula dhe disa ekonomistë që i njoh, jam shumë i qartë se dalin tash për 5 minuta, do ta bëjmë një program shumë më të mirë të zhvillimit ekonomik se sa është ky program këtu. Jam i sigurt.

Sa i përket, do të kthehem prapë te Ministria për Komunitete dhe Kthim. Aty janë të punësuar vetëm 2 pjesëtar të komunitetit egjiptas, vetëm ata dy pjesëtarë njëri në Pejë edhe njëri në Gjakovë, udhëton me autobus, ndërsa të tjerët udhëtojnë me kerre të Ministrisë, kështu që kjo Qeveri po i ruan derivatet, por në mbremje asnjë kerr nuk është aty, përveç 2 kerreve që janë 00 janë të tjerët me tabela të thjeshta dhe udhëtojnë për çdo ditë për Graçanicë, për Ferizaj, për ku ta di unë. Kjo është e sigurt, për këtë kam argumente.

Prandaj, unë shpresoj nuk e kemi qëllimin që ta kritikojmë këtë Ministri, por ne si Komision, ku janë të gjithë anëtarët e tyre komuniteteve, do t'i afrojmë që të dilet nga kjo gjendje dhe nëse kështu vazhdohet, atëherë nuk di ku është perspektiva e komuniteteve tjera në shoqërinë kosovare.

Dua ta lexojë edhe diçka në programin në të cilën është shkruar rreth integritete ku edhe NDI-ja, UNHACER-i dhe shumë organizata merren me integritete, por nuk di çka kanë bërë. Është mirë të thuhet se kanë bërë këtë. Nuk kanë bërë asgjë. Tani përveç Ministrisë të Komuniteteve dhe Kthim që ka një buxhet, është edhe Zyra e Komuniteteve që vepron në kuadër të UNMIK-ut edhe ajo ka mjete të caktuara dhe asnjë cent nuk e ka harxhuar për komunitete tjera. Gjithashtu, tani edhe në kuadër të Zyrës së Kryeministrit një milion është ndarë për komunitete. Është mirë, që nga zyre të veprohet në disa komunitete. Zoti Thaçi, zotit Sllavisha, jo këtij Sllavisha Petkoviçit po një Sllavisha tjetër i jep një traktor. Është shumë mirë, është shumë pozitive, por me traktor di të punojë edhe komuniteti egjiptian. Është mirë ta marrë Xhavit Halitin e ka një shok të komunitetit egjiptas t'ia çojë edhe atij një traktor dhe do të punojë në Novosellë. Thjeshtë, është një proverb që gjithë e dimë:” Nuk po kërkoj që ta kemi peshkun në tryezë, por të kem mjete që ta zëmë atë peshk”. Të punohet toka duhet traktori, atëherë, le të urdhërojë Qeveria dhe le t'ju shpërndajë edhe komuniteteve tjera mjete që të veprojnë dhe të punojnë.

Unë jam ithtar i asaj se kjo Qeveri të jetë e suksesshme. Jam ithtar i asaj që ky ministri i Komuniteteve dhe Ministria për Komunitete të kontribuojnë se është në të mirë të gjitha komuniteteve. Mirëpo, dua ta parafrazoj zotin Hoxhaj i cili pat thënë kur zoti Çeku u zgjedh kryeministër:” Në politikë hyhet për dy çështje, ja për të bërë ndonjë ndryshim pozitiv, ja përfitim”. Unë në këtë Ministri nuk po shoh ndryshim pozitiv dhe dua t'i besoj se është njëri akademik dhe dua t'i besoj në atë thënie. Prandaj, në disa dikastere, shumë pak, po shoh ndryshime pozitive, atëherë kur nuk shihen ndryshime pozitive, duhet të besoj që vlen ajo e dyta.

Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Fjalën e ka Fehmi Mujota, le të përgatitet Besa Gaxherri.

FEHMI MUJOTA: Faleminderit, zoti Kryetar!

Zotërinj zëvendëskryeministra,ministra,

Kolegë deputetë dhe deputete.

Me të drejtë kemi pritur që fillimin e punës së mëngjesit të sotëm për vazhdimin e debatit për programin e Qeverisë ta kemi edhe më të qetë edhe më të saktë, po edhe me vlerësime më të drejta për të gjitha zhvillimet që kemi pasur dhe për të gjitha zhvillimet që mund t'i kemi, bazuar në Programin e Qeverisë.

Me të drejtë, ndoshta, thuhet:” Një të burgosur nëse e afron afër parmakëve dhe të shikojë, njëri nga ata mund të shikojë baltën, tjetri mund t’i shikojë yjet, por ka të tjerë që shikojnë realisht ashtu si është natyra”.

Dua të them që kjo Qeveri bazën e ka jashtëzakonisht të qëndrueshme në mënyrën më të mirë të mundshme që ka dëshiruar çdo qytetar i Kosovës. Ka filluar punën mbarë me shpalljen e pavarësisë së Kosovës, me njohjen ndërkombëtare të Kosovës, me miratimin e dokumentit, përkatësisht, aktit juridik më të lartë- Kushtetutës së vendit. Po vazhdon punën me miratimin e ligjeve të cilat vërtet janë të domosdoshme për bazën shtetërore dhe pse jo në këtë kuadër duhet të shikojmë edhe vështirësitë që mund të vijnë për zbatimin e këtij statusi.

Të nderuar kolegë,

Vlerësimi i kapaciteteve menaxhuese të Qeverisë, por edhe i qytetarëve të Kosovës nuk është më vetëm një e thënë nga dikush që ka dëshirë ta shohë kështu, por është një realitet i vlerësuar kombëtarisht dhe ndërkombëtarisht. Kjo çështje nuk është meritë personale as grupe, është meritë e të gjithëve dhe këtu nuk kemi asnjë dallim. Besoj se këto gjëra nuk është mirë t’i hapim në debatet tona në anime jo korrekte.

Objektivat kryesore dhe politikat me përparësi, për mendimin tim, në bazë të studimit që i kam bërë këtij programi, del se objektiviteti, racionalizmi do të thosha, profesionalizmi dhe vendosmëria e Qeverisë për ta bërë Republikën e Kosovës një vend partner dhe të dobishëm për vlerat e civilizimit dhe demokracisë, reflektohen fuqishëm. Por, reflektimi i fuqishëm në këto vlera nuk nënkupton që të gjitha çështjet janë paraparë me saktësinë më të madhe ose në kohën se si do të realizoheshin ato dhe me cilën kosto ose cilin buxhet.

Të nderuar kolegë,

Këtu mund të ketë, ndoshta, arsye për të debatuar dhe për të dëgjuar secilin mendim që jep ndonjë vlerësim kritik ose ndonjë propozim të caktuar për këto çështje. Por, koha e nevojshme për kthimin e besimit në Qeverinë e Kosovës dhe tek qytetarët e Kosovës, do të jetë më e gjatë se sa që aktualisht po e shoh.

Kemi parasysh se Qeveria nuk e ka bërë saktësisht një prerje të saktë të gjendjes, të cilën e ka marrë në momentin e marrjes së qeverisjes. Dhe, vërtet, ndoshta, do të ishte, jo ngarkesë po të thuheshin disa fjali për gjendjen e marrë në gjithë sektorët veç e veç dhe për momentet që tani po kalon Qeveria dhe plani që e ka bërë.

Jemi shumë të bindur se programi i përmban ato objektiva dhe orientime programore, por në përmbushjen sektoriale, përkatësisht, secila ministri me planin e punës, programin e vet që ka, do të mund ta përmbushte plotësisht kohën dhe dinamizmin e realizimit të projekteve të parapara.

Prezantimi ndryshe i një projekti ose i një programi të Qeverisë, do të ishte jo objektiv për mendimin tim. Ne të gjithë jemi dëshmitarë që kemi vlerësuar programe qeveritare edhe në të kaluarën dhe në një mënyrë apo një tjetër, kemi uruar që të realizohen projektet dhe programet e tilla, por shumë herë kemi pasur ngecje edhe arsyet dihen, që nga aspekti i sundimit të ligjit e deri tek, ndoshta, vullnetet politike të caktuara.

Programi, ndoshta, mban pak shkrim dhe pak parashikim, por është shumë me rëndësi që ai të jetë i realizueshëm dhe t'i tejkalojë këto objektiva dhe për këtë besojmë se baza është krijuar dhe ecjet do të jenë jashtëzakonisht të mira.

Sfidat në rrugën e zbatimit, kolegë të nderuar, nuk do të jenë të vogla. Veç sa kemi prekur në shtetin e ri të Kosovës dhe veç sa kemi prekur në realitetin, i cili donë partneritet me bashkësinë ndërkombëtare, donë partneritet me qytetarin dhe donë një qasje profesionale të këmbëngulur për t'i realizuar të gjitha këto nevoja të qytetarëve të cilat nuk janë të vogla.

Vërtet, të gjithë presin që ne tani ta fillojmë punën mbarë ashtu si e kemi filluar për këtë 100 ditësh si Qeveri, që të kemi stabilizim të gjendjes në të gjitha kuptimet sociale. Pastaj të kemi një zhvillim ekonomik të qëndrueshëm, i cili do të mundësonte punësim dhe zbutje të varfërisë, por pse jo edhe dinjitet të arsimitarit, të nxënësit, dinjitet të mjekut, dinjitet të pacientit dhe të gjithë qytetarëve të Kosovës.

Vlerësimi në kohë i faktorëve objektivë dhe i faktorëve subjektivë për Qeverinë është shumë me rëndësi. Faktorët objektivë të cilët do të jenë të parashikuar në bazën e buxhetit që e kemi, dhe mbi bazën e projekteve, përkatësisht, donacioneve që do të kemi, presim në qershor të këtij viti, duhet të shikojmë se kemi mundësi të bëjmë edhe më tepër sesa që kemi parashikuar, sikur që ka mundësi në ndonjë rast të mos përmbushet krejt objektivi i paraparë. Por, faktorët subjektivë, kolegë të nderuar, janë më të rëndësishëm në këtë rast. Qeveria ka bërë një gabim elementar për mendimin tim, që në momentin kur e ka nxjerr një mendim shumë pozitiv, se s' do të ketë asnjë telashe, asnjë problem me shërbyesit civilë, është shumë korrekte, është shumë e drejtë, normë shumë e pranuar. Por, mos harroni faktin se në qeveritë e kaluara ka pasur edhe ardhje, kontrabandë dhe njerëz jo profesionistë në sektorë të caktuar. Prandaj, duhet të kemi parasysh, realizimi i programit profesionalizëm, vullnet politik dhe kompaktësi politike. Këtu jemi të bindur se ka zbrazëtira të cilat Qeveria duhet t'i përmbushë dhe jo me qëllimin e ndjekjes të ndonjë individi, apo ndonjë grupi, po me qëllimin më të mirë për të pasur një qeverisje të mirë, për të pasur një stabilitet politik dhe për të pasur një objektivitet në realizimin e asaj që kemi parashikuar.

Zërat që dëgjohen, si zëra kritik në Parlamentin e Kosovës, vërtet duhet t'i dëgjojmë me kujdes si Qeveri dhe si pozitë në këtë rast dhe atë e them në këtë kuptim. Të gjithë ata që kanë një propozim të mirë, që kanë një qëllim të mirë, duhet t'i dëgjojmë ashtu si po i dëgjojmë dhe ju admiroj për kulturën e dëgjimit të tyre. Por, mos i dëgjoni të gjithë zërat, as ju dhe as ne, sepse po dëgjojmë njerëz që janë fëmijë fillestarë në politikë dhe të motivuar politikisht, nuk është një gjë e duhur dhe nuk është mirë të përgjigjem në to, por t'i dëgjoni njerëz të pjekur në politikë, por që prodhojnë politika frustruese, që për pasojë kanë frustrimin, nuk kisha dashur që Qeveria dhe pozita të përgjigjet në asnjë mënyrë.

T'i falënderojmë të gjithë ata njerëz që kanë konstruktivitet opozitar dhe të gjithë ata njerëz të cilët ndihmojnë realizimit të programit të Qeverisë së Kosovës.

Kolegë të nderuar,

Realizimi i projekteve nacionale veç sa ka filluar. Urojmë që ato të vazhdohen edhe më tutje me realizimet praktike dhe me një qeverisje ndryshe, që në Kosovë ka filluar. Po e përsëris, qeverisja ndryshe ka filluar dhe ajo vetëm do të vazhdojë.

Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!
Fjalën e ka Besa Gaxherri, le të përgatitet Nait Hasani

BESA GAXHERRI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!
Të nderuar kolegë deputetë,
I nderuar Kabinet qeveritar,

Përpara vetes e kemi Programin e Qeverisë së Republikës së Kosovës 2008-2011. Po dua ta filloj në këtë formë, për katër vjet program i kemi 56 faqe, dhe dua t' i lexoj tre rreshta të ballinës së këtij materiali, që janë shkruar nga kryeministri. Kështu thotë: "Duke u nisur nga fakti se thelbi i qeverisjes sonë bazohet në transparencë dhe llogaridhënie, unë kërkoj nga Kryesia e Kuvendit të Republikës së Kosovës futjen e këtij programi si pikë të veçantë për diskutim në Parlamentin e Republikës së Kosovës".

I nderuar Kryetar i Kuvendit, një gjë e tillë nuk ndodhi, edhe pse Qeveria u vonua tre muaj për t' i hartuar këto 56 faqe, në seancën plenare u futën edhe informimi për 100 ditë, edhe fjalimi historik e politik i Presidentit e kështu me radhë, kështu që na ka mbetur krejt pak, ose ashtu kështu i ka humbur rëndësia për diskutim këtij materiali. Megjithatë, në çdo shtet demokratik, legjislativi, pra, Kuvendi monitoron ekzekutivin, Qeverinë. E si bëhet kjo? Qeveria është e obliguar, sjell para Kuvendit programe dhe duhet të raportojë për to në periudhat e rregulluara me ligj apo rregullore.

Për herë të parë ne po ballafaqohemi me një dukuri që po instalon ky regjim, që jo vetëm nuk i jap llogari Kuvendit, por me këtë sjellje fyen rënd institucionin më të lartë të shtetit. Presidenca dhe Qeveria, Kuvendin e Kosovës e kanë kthyer në një tribunë apo amfiteatër ku vijnë dhe na mbajnë fjalime të thata politike e historike.

Kuvendi i Kosovës është kthyer në një robot që kërkon të duartrokitet dhe të pohojë vendimet e juaja në mënyrë edhe aklamative. Ju keni zgjedhur metodën, praktikën që Qeveria të shfaqë drama të tipit monolog para mediave aty ku mund të dëgjohet vetëm një zë, me të cilin mund t'ia bëni qejfin vetëm vetvetes dhe atë në orët e vona të mbrëmjes, në shenjë respekti për "qytetarët"

Programin të cilin deputetët e kanë marrë të hënën, jemi duke e diskutuar edhe sot dhe natyrisht, jashtë procedurave të rregullave të Kuvendit. Kjo Qeveri për 100 ditë ka vepruar pa program ad-hoc, s' ka çka të raportojë dhe në bazë të këtij materiali që na e keni ofruar, pretendoni që të vazhdoni dhe në të njëjtën mënyrë të punoni pa program.

Programi apo ky materiali juaj është edhe ashtu i vonuar, është një material i cili përshkruan gjendjen reale, aktuale në Kosovë, si dhe dëshirat si do të ishte mirë të jetë Kosova në të ardhmen. Në këtë program, në asnjë nga ministritë nuk përmendet ndonjë projekt konkret dhe ndonjë afat i përkufizuar për realizimin e tyre.

Është qesharake që ky program, me këtë përmbajtje në vetëm 56 faqe përfshin periudhën 2008-2011, ndërsa informatën që e morëm të premtën, kishte, domethënë, katër herë më shumë- ishte informata për 100 ditë se sa ky program, të cilin e kemi apo ky material të cilin po e shqyrtojmë.

Unë, dua në krejt në pika të shkurtra të fokusohen në çështjet ekonomike, pasi që në këtë material, Qeveria i ka dhënë prioritet, politikave prioritare, pra rritja ekonomike, implementimin e statusit, qeverisja e mirë, zbutja e varfërisë dhe stabilitetit social.

Të nderuar kolegë deputetë,

Përveç rritjes ekonomike, po e prek edhe implementimin e statusit. Nuk e di çka keni menduar në implementimin e statusit, por së paku në qoftë se i keni dashur t'i hyni kësaj pike, është dashur konkretisht për të cekur çka po ndodh dhe çka do të ndodhë dhe çfarë projekti, çfarë programi ka për Mitrovicën dhe çfarë po ndodhë, çka do të ndodhë dhe çfarë do të vendoset për kufirin me Maqedoninë? Këto gjëra nuk preken fare, natyrisht. Ndërsa, sa i përket rritjes ekonomike ju fokusoheni në: energjia dhe minierat, transporti, sundimi i ligjit, edukimi, bujqësia, politika tatimore dhe administrimi dhe sektori financiar.

Të nderuar kolegë,

Bile së paku këto pika është dashur që të shkruhen kështu pak më mirë në gjuhën edhe profesionale, por edhe letrare. Ta marr shembull, transporti. Me transport kuptojmë bartjen e mallrave dhe njerëzve, ndërsa këtu flitet për komunikacionin rrugor, komunikacionin ajror dhe atë hekurudhor. Flitet me ka 10 reshta, por megjithatë, flitet për komunikacion, ndërsa këtu thuhet vetëm për transport, e që për transport nuk kemi realisht asgjë.

Pastaj, sundimin e ligjit që realisht, unë mendoj që duhet, është dashur të thuhet kompletimi i infrastrukturës ligjore dhe implementimi apo monitorimi dhe respektimi i ligjit e jo sundimi i ligjit. Ndoshta e keni shkruar ashtu siç po e kuptoni bukvalisht që ju e sundoni ligjin jo ligji juve, megjithatë, unë po ndalem pak tek energjia dhe minierat, më shumë tek energjia.

Të nderuar kolegë, në veçanti ju Qeveri e nderuar, realisht nuk kërkon askush prej juve të bëni mrekulli se janë 100 ditë, ani pse më befasoni se sikur të mos kishit qenë asnjëherë në pushtet edhe pse keni qenë opozitë e keni parë si shkon sistemi. Domethënë, ju patet propozuar se do të ketë rrymë 24 orë, ju patët propozuar që zgjidhja do të bëhet shumë shpejt dhe realisht edhe një herë po them nuk po kërkojmë mrekulli, por nuk është bërë asgjë. Çka është më e keqja, ne nuk dimë ende as nuk e dimë gjendjen reale qysh është, përveç asaj që është shpallur një krizë nacionale për energjinë dhe na duhet të pajtohemi se është krizë nacionale dhe nuk dimë çka tutje.

Në bazë të këtij materiali, ju thoni Qeveria do ta vazhdojë reformën e nisur në sektorin e energjisë. T'ju them të vërtetën unë nuk e di cilën reformë, a atë që nuk e ditkam ne s'e keni prezantuar fare apo atë të cilën e quani të dështuar nga ish- Qeveria e Kosovës. Pastaj, thoni: "Qeveria do të mbështesë përgatitjen dhe realizimin e një fushate gjithëpërfshirëse ndërgjegjësuere për rritjen e faturimit dhe inkasimit të energjisë elektrike". Do të rrisë ose do të bëjë fushatën për faturim, të nderuar kolegë dhe Qeveri e nderuar, nuk shkojnë më këto gjëra me fushata me. Unë mendoj se duhet të jeni konkret edhe në këtë aspekt, në kuadër të kësaj çështjeje duhet të keni gjykatën e posaçme për inkasimin e rrymës dhe për inkasimin apo për zgjidhjen e problemeve informate, që janë në energjetikë- janë të shumta. Gjykatat tona nuk mund t'i përballojnë problemeve të KEK-ut dhe ka shumë mundësi, shumë lehtë, është shumë çështje e lehtë që një gjykatë të punojë drejt për çështjet e KEK-ut, në qoftë se doni të bëni zgjedhje në atë drejtim.

“Qeveria do të gjejë forma më të përshtatshme për privatizimin e KEK-ut.” Tash ne shohim se ju keni filluar edhe mendoni për ta privatizuar KEK-un, dhe bile keni, keni cekur këtu njësinë prodhuese A-1, A-2, A-3, A-4, njësinë prodhuese B-1, B-2, minierën në Mirash, minierën në Bardh, minierën Sitnica, minierën në Sibovc, sipas kësaj duam ta privatizojmë KEK-un, okej. Duam ta privatizojmë, por deputetët e Kuvendit të Kosovës dhe qytetarët e Kosovës, duhet ta shohin platformën qysh, çka mendoni të privatizoni dhe qysh mendoni ta privatizoni një kompani të cilën çdo ditë e shpallni si dinozaur, një kompani që nuk vlen, një kompani që nuk funksionon, dhe natyrisht që, në qoftë se kështu është prezantuar KEK-u, nuk di se kush do ta blejë. Dhe, në anën tjetër nuk di kujt po i konvenon që kompanitë publike që janë pronë kombëtare të vijnë në nivelin e falimentimit e pastaj të shiten sipas ose të falen për asgjë. Kjo është e papranueshme.

Natyrisht, edhe një herë po them, privatizimi i kësaj kompanie dhe të gjitha kompanive, të cilat konsiderohen pronë publike, duhet të bëhen në mënyrë transparente. Jo qysh po thoni ju që ka transparencë dhe pastaj na sillni neve nga 10 rreshta për çështje shumë të rëndësishme, por vërtet duhet të debatohet për këtë çështje mirë me ekspertë, por edhe Kuvendi fundi i fundit Kuvendi, ju Qeveri e nderuar, duhet të kuptoni që Kuvendi është mbi Qeverinë. Kuvendi duhet të marrë vendime, siç është për shembull privatizimi i KEK-ut, e jo ju të vendosni atje edhe me ke të bëni pazar edhe çfarë mënyre i privatizoni dhe krejt, nuk shkon kjo një gjë e tillë nuk bën, në afat të gjatë. S’ po ua lexoj këta tre reshta si i keni çka mendoni në afatgjatë, veç po ju them që në bazë të privatizimit, atëherë se këtu e përshkruani ndërtimin e Termocentralit C. Në bazë të privatizimit juve nuk ju mbetet, nuk di krejt asetet doni për t’ i shitur. Nuk di ku doni të filloni me ndërtimin e termocentralit, nuk e di, domethënë në bazë, në qoftë se e shitni, atëherë nuk dimë çka, ku duam të ndërtojmë as çka duam të ndërtojmë

Dhe krejt në fund, për përfundim, domethënë e keni bërë përfundimin për energjetikë-Implementimi i kësaj strategjie do t’ju ndihmojë qytetarëve dhe bizneseve të Kosovës për të pasur furnizim të vazhdueshëm me energji elektrike brenda 9 deri 15 muaj, duke i përfshirë tash këtu edhe energjinë alternative që është qesharake çfarë mënyre na e keni prezantuar neve, ndoshta. në kokat e juaja edhe në sirtarë e juaj keni projekte shumë të mira, por çka keni prezantuar këtu është shumë qesharake dhe është krejt e pamundshme që për ...

KRYETARI: Ju faleminderit!

Te unë janë kryer minutat. Fjalën e ka Nait Hasani, le të përgatitet Gani Geci, Ganiu nuk është këtu, atëherë Bajram Kosumi.

NAIT HASANI: Po më vjen mirë që tash opozita e pa vetën se kur ka qenë në pushtet nuk mund të fliste e tash po flet dhe, natyrisht, kanë mbetur pa energji e kanë mbetur pa sende.

Të nderuar deputetë, të nderuar zëvendëskryeministra

Për të folur këtu, para jush nuk pata dëshirë të dal, sepse folën mjaft kolegë për temat edhe për Programin. Ata me vlerësimin e tyre e vlerësuar Programin e Qeverisë në forma të ndryshme. Dikush tha mirë e dikush keq, por kjo nuk ishte edhe nuk është arsyeja e plotë pse dola të flas këtu para jush. Unë dola të flas pikërisht se ky program i Qeverisë së Kosovës nuk është, ndoshta, prefekt, por është më i miri. Ndërsa në këtë pajtohëm me sugjerimet e kolegëve për plotësime, sepse ka vend edhe për plotësime, por ka edhe nga

kolegët që quajtnë program propagandistik. Duke mos vlerësuar objektivat e Programit, ata kanë vlerësuar vetëm faqet e para të tij, që përfshinë dhe 100-ditshin e Qeverisë.

Në angazhimin e saj dhe disiplinën prefekt në shfrytëzimin e situatës politike, për mua kjo legjislaturë është me fat, sepse është pjesë e historisë më të ndritur shqiptare në bërjen e Kosovës shtet dhe nxjerrjen e Kushtetutës së Kosovës. Këto dy attribute kryesore të shekullit për shqiptarët, për të cilët për 100 vjet shqiptarët derdhën gjak dhe vuajtën dënime me miliona vjet burg- gjeneratat e tëra, prandaj ka mundësi, sepse ata kolegë tanë adoleshentë, politikë akademikë, ju duket atyre si propagandë e shfletime propagandistike që e justifikojnë kohën e tyre. Por, për fat ka edhe prej atyre që thanë që nuk përmban asgjë, sepse është një program inxhioje vërtet, sepse në gjykimet e disave Qeverinë e kanë pasur si inxhio në shfrytëzimin e tyre, dhe thanë se mediat janë bërë zap. Unë mendoj se ato janë të pavarura e çështje e tyre është se, ka mundësi që ato duhet vetë të jenë në bazë të politikës redaktuese e nevojave të tyre të varura. Ndërsa, te ne, ju të gjithë e dini se kemi lirinë e shtypit, të fjalës, ndoshta, ato media nuk mund ta gjejnë veten në ekonominë e tregut, në lirinë mediatike, për këtë, vërtetë, ka faj Qeveria.

Vërtet Qeveria ua ka ngrehur veshin, ndoshta, tamam dikujt jo, por kësaj radhe ua ka ngrehur veshin me punë dhe aktivitet dhe veprime konkrete nëpër rrugë dhe shkolla. Pra, Kosovën e ka kthyer në vend punishte dhe ua ka mbyllur gojën fjalëve dhe fjalamanëve. Pra, deri me tani Qeveria vërtet është në ofensivë të punëve dhe ruajtje të jetë dhe në të ardhmen kështu në këtë ofensivë të realizimit të objektivave. Ndërsa, Qeveria e reklamës, thotë duhet ta bësh prezent qëllimin dhe idenë tënde me të gjitha mjetet e të plasosh në treg idenë dhe këtë e arriti kjo qeveri. Ajo ka vendosur objektivat e vet për zhvillimin e ekonomisë: të arsimit, transportit, bujqësisë dhe drejtësisë. Por edhe sipas opozitës disa që deklaruan këtu, del se opozita kërkon t'i rritë tatimet dhe ta rritë varfërinë e qytetarëve të Kosovës. Pra, shikimi i politikës fiskale, që Qeveria e ka paraparë në uljen e taksave dhe në rritjen e buxhetit, kjo më jep mundësi të kuptoj se Qeveria edhe pse edhe për të rritur mirëqenien e qytetarëve edhe po punon për ta, ndërsa opozita kërkon t'i rritë taksat në dëm të qytetarëve, gjë që do të thotë ta rritë varfërinë e qytetarëve tanë të varfër.

Po ashtu mund të them me keqardhje se disa deputetë, tash ish- drejtues të dikastereve të Qeverisë së kaluar flasin pa mbulesë këtu për dhunë e krime në të shkuarën, duke menduar se ende jetojnë në të kaluarën. Ndoshta kanë të drejtë kur flasin, sepse duke akuzuar duan ta fshehin krimin e bërë nga vetë ata, sepse gjykata e di, se për rastet e përmendura këtu ka pasur të akuzuar që gruaja e vet e ka denoncuar rastin dhe ata janë nxjerrë nga burgu politikisht, sepse ata kanë qenë të angazhuar politikisht në parti politike. Po për këto raste, përsëri do të ketë drejtësi, sepse drejtësia mund të vonojë, por kur nuk harrohet.

Ndërsa unë dhe njerëzit e së ardhmes, gjeneratës së re në Kosovë dhe të kësaj Qeverie, nuk duhet ta kthejmë kokën mbrapa, se grekët e vjetër kanë thënë: "Ai që kthen kokën prapa, prapa do të shkojë dhe ai që shikon përpara, përpara do të ecën". Ju faleminderit.

KRYESUESI IBRAHIM GASHI: Ju faleminderit deputet Hasni. Fjalën e ka deputeti Bajram Kosumi, le të përgatitet Gani Koci.

BAJRAM KOSUMI: Ju faleminderit i nderuar kryesues,
Të nderuar kolegë deputetë, anëtarë të Qeverisë së Republikës së Kosovës,

Debati rreth programit të Qeverisë, që prej fillimit është shndërruar më tepër në një duet politik, i cili duet politik vështirë të gjenerojë diçka të vlefshme për Programin. Në njërin anë opozita e kritikon programin dhe i nxjerr në shesh mangësitë e programit, edhe pozita në anën tjetër po rrinë hazër aty për çdo moment ta mbrojë programin. Derisa opozita e ka detyrë ta kritikojë programin e ka detyrë t'i nxjerrë në shesh mangësitë e programit, është interesant sjellja e pozitës në këtë moment, sidomos sot kjo po vërehet gjatë debatit kur po menaxhohet seanca një me një, një deputet i pozitës një i opozitës flasin në mënyrë që debati të jetë i ballansuar në kuptim “i ballansuar”.

Është interesat qëndrimi i pozitës për një arsye. Pozita nuk vjen në Kuvend për t'u mbrojtur, pozita i ka përgjegjësitë për të udhëhequr me projektet në një kohë të caktuar në mandatin e vetë dhe nuk duhet të vuajë prej kompleksit që të mbrohet nga kritikët e opozitës. Ajo që duhet ta bëjë pozita në këtë moment është që të argumentojë për çdo kritikë të opozitës të thotë se kjo kritikë është e pavend për këtë arsye ose të thonë po kjo kritikë është me vend dhe e marrim do ta inkorporojmë.

Të nderuar miq të pozitës dhe të opozitës, politika nuk është inat. Ju nuk jeni pozitë për inati të opozitës edhe as ne s'jemi opozitë për inatin tuaj. Ne kemi në diskutim një program të Qeverisë, i cili gjatë tërë debatit deri tash u tregua se ka disa shpërputhje, i ka disa kundërshti. Unë nuk po e cilësoj tash programin, as nuk po them që është i mirë, as nuk po them që është i keq, por po them që ka disa kundërshti që janë pengesë për pozitën në radhë të parë, për Qeverinë janë pengesë dhe Qeveria duhet t'i marrë shumë seriozisht diskutimet, sado që mund të jenë këto diskutime edhe me tone të theksuara kritike, por duhet t'i marrë për bazë që të shikojë t'i eliminojë ato kundërshti. Por, ndaluni dhe shikojeni programin, ka kundërshti thelbësore që nuk duhet aq Qeveria vetë t'i lejojë të tilla e as Kuvendi i Kosovës t'i lejojë të tilla.

Prandaj, diskutimin tim unë nuk po e ndali më tek dobësitë, tek mangësitë e programit të Qeverisë, sepse pjesa dërmuese janë thënë, ka edhe tjera që janë shumë thelbësore dhe nuk janë përmendur, por unë do të mundohem ta bëjë ndryshe diskutimin, t'i sugjerojë Qeverisë ta plotësojë programin me disa çështje thelbësore që duhet të jenë për çdo qeveri që qeverisë Kosovën në këtë mandat tash për 2, 3, ose 4 vjet ose 5, 6 vjetët e ardhshme.

Çështja e parë e sugjerimit tim është marrëdhënia e Qeverisë, por edhe e Kuvendit të Kosovës ndaj strategjive që janë hartuar nga qeveritë e mëparshme dhe të miratuara në këtë Kuvend të Kosovës.

Të nderuar kolegë,

Qeveritë e mëparshme të gjitha, pa dallim, e kanë orientuar një pjesë të madhe të punës në hartimin e strategjive zhvillimore. Disa janë më të mira disa më pak të arrira, por të gjitha ato, pa përjashtim, janë hartuar prej ekspertëve më të mirë vendorë dhe ndërkombëtarë, janë diskutuar në Kuvendin e Kosovës me ditë të tëra dhe janë miratuar. Heqja dorë prej këtyre strategjive nuk e dëmton opozitën e sotme ish- Qeverinë e kaluar, e dëmton Qeverinë e sotme, e dëmton procesin politik dhe ekonomik në Kosovë, e dëmton popullin e Kosovës. Janë harxhuar shumë para dhe shumë mund dhe shumë djersë në hartimin e strategjisë zhvillimore të Kosovës, në hartimin e strategjisë për arsim, në hartimin e strategjisë për energji, strategjisë për bujqësi, strategjisë për ngritjen e kapaciteteve njerëzore dhe ne duhet ta bëjmë një normë. Strategjitë nuk hartohen për

një Qeveri, strategjitë afatmesme dhe afatgjata zhvillimore nuk hartohen për një Qeveri dhe duhet ta kuptojmë se instalimi i modelit të rikthimit në zero nuk e çon Kosovën përpara.

Çdo qeveri, pas çdo zgjedhjeve që mbahen në Kosovë, nuk mund ta kthejë Kosovën në pikën zero dhe themi prej neve fillon historia. Jo, historia nuk fillon as me zgjedhjet e fundit, as me zgjedhjet e përparshme, historia e Kosovës dhe punëve që janë bërë dhe punëve të cilat i bëjmë ne edhe i bënë ju tash si Qeveri, fillojnë shumë më herët.

Çështja e dytë është një problem i jashtëm, por që është thelbësor për proceset e brendshme, është anëtarësimi i Kosovës në mekanizmat ndërkombëtarë, sidomos në mekanizmat financiar ndërkombëtarë siç janë: Fondi Monetar Ndërkombëtar, Banka Botërore etj.

Kjo çështje nuk është trajtuar në program, por mendoj se Qeveria duhet ta trajtojë. Duhet, bashkë me bashkësinë ndërkombëtare, të krijojë një strategji apo një plan të veprimit më mirë se si Kosova mund të anëtarësohet në këta mekanizma ndërkombëtarë, sepse zhvillimi dhe qëndrueshmëria ekonomike e Kosovës është e pamundur, pa qenë Kosova anëtare dhe pa u përkrahur prej këtyre institucioneve ndërkombëtare financiare.

Ne mund të japim maksimumin tonë, ju si Qeveri, ne si opozitë dhe populli i Kosovës, por qëndrueshmëria ekonomike e Kosovës nuk është e garantuar, prandaj në këtë drejtim Qeveria duhet të harxhojë më shumë kohë dhe të mendojë më shumë se si do ta krijojë vizionin dhe planin e veprimit për anëtarësim të Kosovës në këto mekanizma.

Një çështje tjetër, që nuk është trajtuar në Program dhe duhet të trajtohet, është ndërtimi i Ministrisë së Jashtme dhe i Ministrisë së Mbrojtjes dhe me këtë shkojnë edhe ndërtimi i Forcave të Sigurisë së Kosovës, Shërbimit Inteligent të Kosovës e tjera. Janë përmendur në program, por meqenëse janë projekte madhore për Qeverinë, për Kosovën, këto çështje duhet të kenë një projekt se si do të ndërtohen në të gjitha këto çështje.

Ndërtimi i Shërbimit Diplomatik të Kosovës, nuk është një çështje që mund të kalohet me një fjali, me një fjali të përmendur. Ndërtimi i Forcës së Sigurisë së Kosovës, nuk është projekt që mund të kalohet me një fjali, është përmendur veç me një fjali. Prandaj, këtu duhet Qeveria, besoj të krijojë një plan të veprimit dhe një vizion të qartë se si do ta ndërtojë edhe Shërbimin Diplomatik, por edhe Forcën e Sigurisë së Kosovës.

Çështja tjetër, sugjerimi im tjetër për Qeverinë dhe Programin e saj është privatizimi. Privatizimi është thelbi i ekonomisë së Kosovës në këto vitet e fundit dhe besoj do të jetë pak edhe disa vjet. Nuk është thënë qartë, nuk është krijuar, Qeveria nuk ka arritur të krijojë një vizion se çka do të bëjë me privatizimin. Mirë, nëse ka qenë privatizimi i mirë deri tash, mund të thotë Qeveria, po- e vazhdojmë kështu, por nëse ka çaluar diçka, unë mendoj se po ka çaluar, atëherë Qeveria duhet të krijojë vizionin qysh do të përmirësojë atë që është pengesë e privatizimit deri tash.

Çështja tjetër e radhës, sugjerimi im tjetër është zbatimi i ligjeve,

Të nderuar anëtarë të Qeverisë dhe kolegë të opozitës, në Kosovë ka shumë ligje, por mungon zbatimi i tyre. Çdo qytetar i Kosovës e din këtë të vërtetë. Qeveria po ju propozoj që të orientojë një pjesë të vet, një pjesë shumë të rëndësishme, në zbatimin e

ligjeve, kjo do të thotë në hartimin e akteve nënligjore që i bëjnë ligjet e zbatueshme. Mungon kjo në program, do të ishte mirë për juve edhe për Kosovën që ta keni këtë.

Çështja tjetër e radhës është lufta kundër korrupsionit. Veç të kuptohemi mirë, do të thotë të gjithë anëtarët e Qeverisë prej kryeministrit e kanë plotë gojën luftë kundër korrupsionit. Ne nuk po ju themi ndaleni luftën kundër korrupsionit, opozita po ju thotë-vazhdoni luftën kundër korrupsionit, por mos e bëni me tupanë. Mos e bëni duke shpallur kryeministri sabotatorë, por bëni luftën e vërtetë kundër korrupsionit, goditeni korrupsionin dhe ne do t'ju përkrahim. Por, nëse lufta bëhet me zhurmë kundër korrupsionit, duke i shpallur kryeministri sabotatorët, atëherë na bëni për të dyshuar se e keni seriozisht luftën kundër korrupsionit.

Çështja e parafundit që dua t'ju them është funksionimi i shtetit, siguria në gjithë territorin e Kosovës dhe funksionimi i demokracisë.

KRYESUESI: Ju faleminderit, deputet Kosumi! Fjalën e ka deputeti Gani Koci, le të përgatitet deputeti Driton Tali.

GANI KOCI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të mos dal atje unë, diskutimin tim do ta bëj në këmbë, kështu që drejtohem prej të gjithë deputetëve,

Të nderuar zëvendëskryeministra dhe ministra të Kabinetit qeveritar. Me vjen keq që nuk e kemi Kryeministrin këtu që t'ia drejtoj një urim të veçantë Kryeministrit tim dhe kryeministrit të gjithë qytetarëve të Kosovës, Kryeministrit të parë të Republikës së Kosovës, i cili sot vazhdon aktivitetin e tij politik dhe si kryeministër i parë i shtetit të Kosovës mban edhe fjalën e tij në Këshillin e Sigurimit, gjithsesi, duke respektuar dhe duke ndjekur realizimin e qëllimeve të tij programore dhe politike për shtetin e Kosovës.

Të nderuar deputetë, dy ditë po dëgjojmë fjalë të mira, të gjitha janë të mira, dhe secili nga këndvështrimi i tij dhe për programin themi se është i mirë dhe është keq, do të thotë bardh e zi. Nuk dua të përmend kush e ka thënë se mos ngjitni ndonjë etiketë, por thuhet se më mirë është një veprim konkret se sa një dyzinë programesh dhe veprimet konkrete ose për veprimet konkrete Qeveria e tashme e tashme veç është dëshmuar dhe ato veprime janë të prekshme dhe janë shumë të perceptueshme. Nuk janë vetëm iluzione dhe vetëm fjalë që dikush i paraqet këtu. Nëse nuk është kështu po të marrim pak edhe opinionet e qytetarëve dhe kemi mundësi edhe si deputetë të dalim në rrugë dhe kemi dalë dhe jemi takuar me të tjerët.

Vërtet asnjë program nuk mund të përfshijë gjithë atë që ne duam ta bëjmë në këtë fazë dhe as Qeveria dhe unë konsideroj që asnjë program nuk mund të jetë i përsosur siç nuk është as ky i përsosur, por që janë vënë konturat kryesore të zhvillimit të Kosovës në të gjitha fushat e veta, mendoj se po. Të nderuar deputetë, kemi harruar ne që më 15 shkurt kemi miratuar një buxhet të Kosovës me një shumë të caktuar buxhetore dhe ai buxhet, dua t'ua përkujtoj që nuk e keni pasur, ndoshta. në dorë akoma ju, ka disa faqe të fundit bukur shumë që quhen tabela numër katër dhe në ato tabela numër katër i keni të gjitha projektet që ka parashikuar dhe ka paraparë edhe me bazën e vet buxhetore që kjo qeveri do të realizojë këtë mandat, në këtë po them vit fiskal të 2008, po me parashikime, sepse projektet nuk janë vetëm të një viti, por në vazhdimësi edhe për vitin 2009, 2010 edhe për vitin 2011. Natyrisht se në çdo vit fiskal do të revidohen edhe projekte të tilla edhe do të shtohen edhe të tjera dhe unë dua t'ju përkujtoj se Qeveria këto është dashur të na i sjellë, nuk na i keni sjellë, i keni pasur, sepse ka mbi

400 milion buxhet për projekte kapitale dhe po të shndërrohen këto në numra janë mbi 313 projekte kapitale të mëdha dhe të vogla dhe në të gjitha fushat e keni projektbuxhetin. Merreni, i keni faqet e fundit, tabela numër katër dhe pa dashur të hyjë për secilin ministri veç e veç, secilin sektor veç e veç, është dashur ju të na i bëni, por unë dua të përmendi vetëm edhe një fakt. Këto ditë ne së shpejti këtu do të diskutojmë raportimin fiskal ose buxhetor ose të shpenzimeve për vitin 2007 dhe do të shohim pastaj, vërtet, se si është realizuar gjithë ai projekt ose program qeveritar në vitin 2007 dhe në vitin 2006 edhe më herët dhe pastaj ta krahasojmë me projektimet që i ka kjo qeveri në këtë mandat dhe për sukseset e saj mund të flasim mirë ose keq vetëm kur ta shqyrtojmë raportimin e realizimit të këtyre projekteve në afatin kohor, në afat që e thotë ligji.

Këtu u përmend shumëçka nga e kaluara, nga mandati i kaluar dhe i tashëm. Këtu kryeministri ka deklaruar se kjo qeveri vazhdon kontinuitetin e qeverisjes së kaluar, sepse asnjë qeveri nuk fillon prej zeros, por vazhdon aty ku e kanë lënë të tjerët dhe është lënë aq keq sa vërtet po t'i duheshin edhe tri mandate të tjera, jo vetëm një, është vështirë të rregulloheshin të gjitha ato mbrapshti që kanë qenë në mandatin e kaluar.

Po përmendim, se u përmend shumë vetëm sektori i energjetikës. Dua t'ju them, deputetë të nderuar, se një mandat të tërë ministri i Energjetikës ka pasur vetëm një qëllim si të ndryshohet Ligji i energjisë elektrike, si të ndryshohet Ligji i Rregullatorit të Energjisë Elektrike, për të vetmin qëllim që t'i realizojë qëllimet e veta dhe interesat e veta dhe të grupeve të veta dhe të atyre grupeve që sot është këshilltar ose konsulent dhe paguhet shumë vështirë që ka emër dhe mbiemër dhe shteti i atij grupi i atij konzorciumi akoma nuk e ka njohur shtetin e Kosovës këtu. Dhe sikur të ishte interesuar në këtë sektor dhe të merrte vetëm raportet e auditimit të brendshëm të KEK-ut, atëherë vërtet gjendjen në energjetikë do ta kishim sot më mirë se sa që e kemi. Është absurde të mendohet që për dy muaj të ndryshohet kjo gjendje.

U përmend këtu çështja e sabotimit. Unë zotit Kosumi do t'ia lexojë vetëm një raport që ka ndodhur këto ditë në KEK, sepse punojnë njerëzit. Sa herë që kjo qeveri do të ndërmarrë diçka në fushën e energjetikës, atje ndodh diçka, sepse janë lënë të instaloim njerëzit që të veprojnë sikurse me pullë. Është një elektromotor i montuar i një shiriti, që ka shkaktuar rënie edhe nga sistemi dhe kur kanë shkuar të konstatojnë, në tabelën komanduese që është me çelës, është gjetur gozhda e 18 centimetrave. merre me mend. Ja fotografitë, ja sikur ka ndodhur, por kjo qeveri e ka për detyrë vërtet që t'i angazhojë gjithë mekanizmat e shtetit, duke përfshirë këtu, në radhë të parë: hetimet, hetuesinë, policinë dhe gjyqësinë dhe KEK-u dhe jo vetëm KEK-u, por të gjitha kompanitë publike të lirohen nga sabotatorët, nga keqpërdoruesit, nga hajnat. me një fjalë.

Një çështje tjetër që dua të them që është shumë e rëndësishme. Këto ditë ne do ta diskutojmë Raportin e Agjensionit Antikorrupsion dhe do të shohim pastaj në atë raport, sigurisht e keni të gjithë në dorë se sa do t'i kushtonte qytetarëve të Kosovës sikur të mos ishin veprimet e atij agjencioni. Para llogaritjet e tyre janë 30 milion, 30 milion euro të buxhetit të Kosovës, të parasë publike që do të shpërdoroheshin dhe po të krahasohen tash masat që po ndërmerren në këtë drejtim, po, them ndoshta, edhe propaganda që bëhet, vërtet unë konsideroj një punë të mirë të Qeverisë e cila nuk do të duhej të ndalet për asnjë çast dhe pavarësisht prej presioneve.

U përmenden çështjet e rrugëve- Ministria e Transportit. Zotëri, është një rrugë nëse ju kujtohet këtu, i pata thënë ish- ministrit ta qesë kafën kur të më shkel këmba në asfalt, para tri vjetëve ka qenë dhe për tri vjet është ndarë buxhet dhe para publike nga buxheti i Kosovës dhe ajo rrugë është në atë gjendje, nuk është ndërtuar fare dhe nuk ka filluar të ndërtohet. Fatmirësisht në këtë fazë, në këtë periudhë shpresojmë shumë, duke pasur parasysh veprimet që i ka marrë ministri i Transportit dhe i Telekomunikacionit.

Ministria e Arsimit, që këto dy ministri, mendoj që më së shumti perceptohen ajo që kthehet buxheti, paraja publike kthehet te qytetari, te Ministria e Arsimit. Unë nuk di ndonjë mandat, në një vit fiskal të ketë 18 shkolla të reja. Dua të përmendi se te kjo ministri ka mbi 70 projekte që janë shkollat e reja, që janë renovimeve të shkollave, që janë kabinete, që duke u përfshirë pastaj edhe institucionet e tjera të arsimit të lartë atje dhe arsimit fillor.

Unë mendoj që gjithë atë që duhet ta themi për këtë program, mund ta themi se ka vend që të plotësohet dhe për mendimin tim, duhet të plotësohet pikërisht në sferën që u përmend të çështja e privatizimit.

KRYESUESI: Ju faleminderit deputet Koci!. Për një minutë replikë ka të drejtë, Zoti Çeku e ka kërkuar fjalën.

ET'HEM ÇEKU: Unë dua ta përgëzoj deputetin, kolegun tim Koci, se siç duket, e ka bërë një praktikë të mirë për të mbajtur tabela dhe shënime. Unë dua ta pyes vetëm një pyetje publike kolegun tim të nderuar se sa e ka rrogën që e merr në KEK dhe sa metra katror e ka banesën që e ka marrë gratis nga KEK-u, dhe e bëj publike, që jam shumë i gatshëm në çfarëdo rrethane të përballem me gjithë punët, të cilat i kemi kryer gjatë periudhës kur unë e kam udhëhequr KEK-un, dhe sa i përket çështjeve të sabotimeve le t'i lënë ato dokrra dhe le të merren organet e drejtësisë me çështjen që ka të bëjë me sabotime.

Çfarë Qeverie aktuale e fuqishme, e organizuar, transparente është kur...

KRYESUESI: Ju faleminderit, zotëri Çeku!
Urdhëro, regjia, fjalën e ka Gani Koci, për replikë.

GANI KOCI: Zotëri Çeku, të gjitha veprimet e mia në KEK janë publike. Unë në KEK kam shkuar para se të bëhem deputet. Paga ime neto është 520 euro. Banesën nuk ma ka fal KEK-u gratis, por ma ka dhënë në shfrytëzim me qira, për të cilën paguaj qira mujore 84 euro me TVSH. Këto banesa ka dëshiruar zotëri Çeku t'i shesë që ta nxjerrë prej krize KEK-un, por nuk i ka shkuar dhe ato banesa janë të ndërtuara nga fondet e përbashkëta të punëtorëve, jo nga fondet e zotëri Çeku, dhe si të tilla duhet të trajtohen. E kemi edhe Ligjin tash si trajtohen, prandaj nuk e kam vjedhur, nuk e kam marrë, e kam marrë me konkurs, janë dokumentacionet dhe nuk ma ka falë askush, pra as zotëri Çeku. Zoti Çeku do të duhej të jepte llogari...

KRYESUESI: Ju faleminderit, deputet Koci!
Vazhdojmë me diskutimet pa replika në të ardhmen. Ju lutem!
Fjalën e ka deputeti Driton Tali, le të përgatitet Gani Geci.

DRITON TALI: Ju faleminderit, zotëri kryesues!
Të nderuar të pranishëm,

Unë po habitem, kam qenë më duket i pari nga të parët që kam kërkuar fjalën të premtën, por siç po duket, kjo aparatura këtu po çalon. Sidoqoftë, shumë gjëra u thanë, për mos t'i përsëritur ato që u thanë deri më tani, unë do të thosha vetëm se, këtë ese të cilin na keni servuar, jam i bindur se disa anëtarë të Kabinetit qeveritar, këtu i kam parasysh disa ministra dhe zëvendësministra, nuk e kanë parë fare, se po ta kishin parë, jam bindur po ashtu, apo të paktën ashtu do të doja të besoja, që nuk do ta linin të publikohet, për shkak se mund, ashtu siç u tha, mund ta quajmë si të duam, por jo program afatgjatë.

Është shkruar, tashmë u tha disa herë, në mënyrë shumë abstrakte, do me thënë në stilin blla, blla, blla, e mos të thuhet asgjë, dhe ato statistika të cilat janë përdorë, janë përdorë të vjetruara, duke filluar nga rritja ekonomike. Këtu përdoret një statistikë 30% deri në 40% të papunësisë, është një statistikë e moçme, ka ndryshuar, kjo është rritur. Unë çuditem pse nuk ka dashur Qeveria të kapitalizojë në këto statistika, pastaj 15% i varfërisë ekstreme po ashtu nuk qëndron, ka kohë që nuk qëndron më. Për të vazhduar me paragrafë, ku më shumë gjasojnë me analiza apo artikuj gazetaresk, sesa me program politik. Për shembull, ka fjali këtu ku thuhet se Kosova nuk ka politikë të pavarur monetare, rritja e produktivitetit arrihet përmes investimeve kualitative, e eureka të tjera.

Tash, mos ta vazhdojmë për çdo faqe, u tha tashmë për energjinë që nuk ka asgjë konkrete. Flitet se do të bëhet, por jo se si do të bëhet. Flitet për ndërtime të kapaciteteve të reja, por sa janë ato nuk e dimë. Unë do të vazhdoj te faqja 30, apo në realitet te bujqësia, ishte një paragraf këtu, thjeshtë i kopjuar dhe i ngjitur nga interneti, marrë nga ndonjë deklaratë misioni, që në anglishte i thuhet State mission, ku thuhet se vizioni i përgjithshëm për bujqësinë e tjera, e tjera, që mendoj se nuk është dashur të jetë fare këtu. Pastaj, ka sihariqe të tjera të politikave tatimore. Kemi këtu një fjali ku thotë: “tani jemi duke i rishikuar politikave tona fiskale”.

Ky koalicion qeveritar është në politikë, të paktën që nga '99-ta, e dinë shumë mirë se çka mungon në politikën tatimore, në politikën fiskale. Kemi pasur programe parazgjedhore, ku i kemi caktuar të gjitha ato mangësi të politikës tatimore. Andaj, unë nuk po e shoh të arsyeshme që edhe më tutje të rishikohen ato politika, e mos të thuhet se janë edhe nja tri strategji, në të cilat, që të dy këto parti të cilat e bëjnë koalicionin qeveritar, kanë marrë pjesë. Këtu e kam parasysh strategjinë e MTI-së, të ashtuquajtur të Ali Jakupit, EPIG dhe strategjinë e vitit të kaluar, që kurrë nuk u debatua për te. U harxhuan atje miliona euro buxheti, kuptohet.

Pastaj, sistemi financiar. Këtu, te sistemi financiar, kryesisht është kopjuar dhe ngjitur nga interneti. Ka fjali të cilat thjeshtë janë demode, janë të tejkaluara, siç thuhet aty: “forcimi i mëtutjeshëm i autoritetit mbikçyrës” e kanë huq krejt, se do të kemi në të ardhmen Bankë Qendrore. Thuhet se: “procesi i konsolidimit të sistemit bankar në të ardhmen do të rezultojnë edhe me ofrimin e produkteve të reja”. Qeveria nuk merret me këto punë, bankat janë private. Nuk është punë e Qeverisë kjo.

Pastaj thuhet më poshtë se: “në vijim duhet bërë fuqizimi i autoritetit qendror bankar” po ashtu një përsëritje e panevojshme edhe e tejkaluar më. Ajo që më la përshtypje për kah syralizmi i saj është qeverisja elektronike, e-GOV që thuhet apo digjitale. Këtë po më duket se e ka shkruar ndonjë kuller, që ka dashur të bëhet “i trentë” kështu, “i sertë”. Thjeshtë, në këtë Qeveri nuk mund t'i shohë, të paktën disa ministra, të aftë të kyçen

në këtë filozofi menaxhuese, andaj e kanë qitur këtu vetëm të kallëzojnë se sa i mençur është ai, kush do që e ka bërë këtë, për ta inspiruar, kushdo që ta lexojë.

Pastaj, vazhdojmë te menaxhimi i financave publike. Po ashtu është marrë, është kopjuar edhe është ngjitur “copy paste” dhe, që doni, ua jap edhe Ueb faqen ku e kanë marrë.

Te lufta e korrupsionit nuk thuhet në mënyrë konkrete se si, pos në atë stilin blla, blla, blla, përsëri. Duke i marrë parasysh këto dy eksese të fundit, po them atë pavarësinë, krenatën e pavarësisë dhe media solution, fare nuk përmendet mënyrën se si do të luftohet korrupsioni.

Unë, për fund, sa i përket kësaj eseje, kisha për të thënë se sinqerisht nuk ia vlen që të paguhet, ishalla nuk e keni paguar sikur që e keni paguar Media solution 600.000 euro. Ky ese nuk vlen më shumë se disa qindra euro dhe nuk është dashur fare të na e sillni këtu.

Por, sidoqoftë, të kthehem pak, nëse kam kohë, të qeverisja 100 - ditëshe e Qeverisë. Për të gjitha ato kritika që mund t’ia japim, megjithatë kjo Qeveri, për ndryshim nga Qeveritë e tjera, ka një kryeministër, do me thënë ka një shef, ka një zot, ashtu sillet të paktën, na jep përshtypjen. Që është për t’u lavdëruar.

Është bërë punë në disa dikastere, të cilët po ashtu duhet aplauduar. Tash, për mos t’ua rritur mendjen ministrave, nuk po i përmendi, por po them është bërë një punë e mirë në krahasim me qeveritë e tjera, ndonëse kanë ngelur shumë në luftën kundër korrupsionit, është folur më shumë, do me thënë është bërë më shumë propagandë mediave, ashtu siç u tha, sesa që janë marrë vendime ekzekutive, të cilat e dimë se janë të zorshme, nuk janë të kollajshme. Këtu unë do të pajtohem me deputetin e nderuar, Gani Koci, i cili tha se punën e sabotimit duhet Qeveria ta çojë deri në fund. Padyshim, duhet ta çojë deri në fund, aq më shumë kur e kemi parasysh se ai sabotim, gjithmonë i referohem Qeverisë, është bërë në kohën e pavarësisë, apo para shpalljes së pavarësisë dhe ajo mund të merret si tradhti kombëtare, nëse me të vërtetë ka qenë sabotim, dhe duhet të trajtohet si i tillë. Po, po them duke i ikur kësaj farë PR.

Pastaj, do të doja që në të ardhmen Qeveria të marrë vendime të zorshme, po them po ashtu, sidomos në energjetikë, por edhe në luftën kundër korrupsionit. Këtu e kam parasysh Ligjin për qasjen në dokumentet publike, që me të vërtetë të funksionalizohet dhe të shndërrohet në një ligj për shpalosjen e informatës me interes publik, që e kemi çdo kund në botë, e mos të jetë kështu i mangësuar dhe që t’i jepet hapësirë korrupsionit institucional. Pastaj, të vazhdohet me ato punët e mira që janë bërë në disa dikastere, edhe në Ministrinë e Shëndetësisë. E kemi atje, siç e dimë të gjithë, një situatë shumë të keqe. Të vazhdojnë reformat në arsim dhe të bëhet ajo farë reforma fiskale, të paktën jeni duke e rishqyrtuar, shpresoj që së shpejti do të vini me një zgjidhje për interes të afarizmit dhe të ekonomisë.

KRYESUESI: Ju faleminderit, deputet Tali!

Është një propozim që të bëjmë një pauzë 15 minuta dhe të vazhdojmë punën deri në orën 13,30, pastaj të shkojmë pauzën e drekës.

Ju faleminderit!

Vazhdimi i seancës pas pauzës

KRYETARI: Të nderuar deputetë, vetëm një sqarim të shkurtër. Nëse kemi tentuar ta bëjmë një balancë, atë e kemi bërë në favor të opozitës dhe në bazë të Rregullores, natyrisht.

Fjalën e ka deputeti Gani Geci, le të përgatitet deputeti Gani Buçinca.

GANI GECI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Ju lutem, të nderuar kolegë deputetë,
Zëvendëskryeministër, ministra.

Edhe Presidenti, edhe Kryeministri i Kosovës, gjatë fjalimeve të tyre të së premtes janë marrë pak a shumë me histori. Që të dy, të premten e përmendën Kushtetutën, ndërsa Kryeministri e përmendi Kornizën Kushtetuese. Unë kisha dashur ta përkujtoj në rend të parë Kryeministrin, se Kornizën Kushtetute e ka sjellë pikërisht PDK-ja dhe LBD-ja e atëhershme, duke u ndihmuar nga AAK-ja, edhe pse nuk ishte parti politike.

Këto parti i shuan institucionet e Kosovës, e shuan Kushtetutën e Kaçanikut dhe Kosovën institucionalisht e ofruan në pikën zero. Gjithashtu, u shua edhe Ushtria Çlirimtare e Kosovës. Pasi u shua Kuvendi, u formua një farë KPA-je, e në atë KPA-në erdhi gjithë kush, turli farë popi, turli farë hoqe, turli farë kryetari i partisë dhe ne institucionalisht mbetëm në zero. Fillimi nga zero i kushtoi shumë Kosovës, i kushtoi me vonesa të mëdha. Zotërinj, 5 vite e keni vonuar pavarësinë e Kosovës dhe me këto veprime destruktive të vonesave gjithashtu për të gjitha këto që kemi folur më herët, populli i Kosovës u vu në lajthitje dhe erdhi deri te një përçarje e madhe brenda popullit, ku pas luftës u bënë edhe disa vrasje, vrasjet e pas luftës le që nuk u zbuluan kurrë, por janë edhe harruar.

KRYETARI: Të lutem, jemi duke folur për Programin e Qeverisë.

GANI GECI: Tash do të kthehem, zoti Kryetar.

KRYETARI: Ani, kthehu në program!

GANI GECI: Tash, veç mos u ngut, ju lutem mos më ndërpreni!

Partia e juaj sa ishte në opozitë apo në Qeveri nën hije, pat deklaruar se i dinë me emra e mbiemra ata që i vranë disa burra të Kosovës, por tash i ka shti veshët në lesh dhe po hesht. Nuk po i dëgjohet zëri për ato krime që u bënë pas luftës. Tani po lavdëroheni se e keni sjellë pavarësinë, por popullata e di se kush e solli pavarësinë dhe ne ishim me fat që e nënshkruam këtë dokument të pavarësisë. Edhe pse disa këtu nuk e kanë bërë as hapin më të vogël për këtë pavarësi, apo më mirë të themi, këtu janë edhe me 38 vota.

Para se të vdiste Presidenti Rugova, të nderuar, ju nuk lat gurë pa gjuajtur mbi të, por pas vdekjes po doni ta shtirni atë gurin e mermerit duke shkuar dhe duke u përkulur para varrit të tij.

Ajo që u pa dhe u diskutua të premten nga koalicioni i juaj qeveritar, jep të kuptohet se Lidhje Demokratike e Kosovës në koalicionin e juaj qeveritar është vetëm për t'i qar

pak më vonë, po themi duart, dhe nuk është aspak në dijeni se çka po ndodh me këtë Qeveri.

Kur flasim për Programin e Qeverisë dhe 100-ditëshin e kësaj Qeverie, kemi shumë për të thënë. Kjo Qeveri ka sjellë para nesh një dokument prej 50 faqesh, që për mua nuk është kurrfarë programi, por është vetëm një dokument këshillues, sepse një firmë e vogël private, nëse do t'i marrë 50 mijë euro kredi, duhet ta bëjë një program dhe një plan biznesi më të mirë se Qeveria që e ka sjellë këtë program prej 50 faqeve dhe do ta qeverisë vendin deri në vitin 2011. Në këtë "program", dokument apo si doni ta quani, këshillues, nuk ka asnjë datë, asnjë shifër, asnjë përqindje se çka do të punohet, ta zëmë, në vitin 2009, apo 2010, apo në vitin 2011.

Flitet për rritje të ekonomisë në këtë program dhe nuk jepen kurrfarë statistikash se sa do të rritet ekonomia, ta zëmë, në vitin 2009 në krahasim me vitin 2008, apo në vitin 2011 në krahasim me 2009 apo 2010.

Flitet për energjinë dhe minierat, por askush se di në çfarë gjendje i kemi sot minierat dhe në ç'gjendje do t'i bini ju pasi ta përfundoni mandatin.

Për energjinë elektrike s'kemi çka të flasim se këtë është duke e parë e gjithë popullata. Kjo Qeveri nuk e ka përgatitur asnjë plan me shifra, as statistika se si do ta kalojë kolapsin energjetik, kolaps të cilin e ka shpallur vetë kjo Qeveri dhe nuk ka plan për ta kaluar këtë.

Këtu kemi filluar të ndërtojmë rrugë. Është shumë e vërtetë se ne po vonojmë duke ardhur në Kuvend, sepse ka filluar ndërtimi i rrugëve, por edhe rrugët duhet ta kenë një kalendar se në vitin 2009 do të ndërtohen këto rrugë, ndërsa në vitin 2011 do të ndërtohen këto rrugë të gjata kaq kilometra.

Flitet për hekurudhat se çfarë rëndësie kanë, kurse plan konkret se çka do të bëhet me to, nuk ka.

Flitet, gjithashtu, për fushën e aviacionit, për arsimin. Mund ta falënderojmë ministrin Hoxhaj për hapat që i ka marrë për arsimin e Kosovës.

Në Programin e Qeverisë flitet, gjithashtu, edhe për sundimin e ligjit se si do të sundojë ligji në Kosovë, apo si do të sundojë Qeveria me ligjin, këtë nuk e dimë.

Të nderuar, si do t'i shuani ju organet paralele në veri të Kosovës, këtu nuk e keni shkruar asnjë gërme. Unë që në mbledhjen e parë kam thënë se ne, të paktën, politikisht duhet t'i ndihmojmë kryetarit Rexhepi, por as nuk e keni përmendur Mitrovicën fare. Problem ky i gjithë Kosovës. Çfarë sundimi të ligjit do të ketë kur në territorin e Kosovës ende ka automjete që 9 vjet pas lufte ecin pa targa dhe ka kalim ilegal të kufirit. Çfarëdo kalimi ilegal, gjithçka kalon aty ilegalisht, nuk ka funksionim të shtetit në tërë territorin e Kosovës.

Flitet për politikën tatimore, por nuk përmenden kurrfarë statistikash në asnjë sektor dhe asgjë rreth sektorit privat, rritje apo ulje të taksave për këtë sektor.

Politika e jashtme, asgjë konkrete. Të paktën është dashur kjo Qeveri të marrë mësim prej vendeve që e njohën pavarësinë e Kosovës, që të paktën deri në fund të vitit 2009 apo në

fund të vitit 2008 të fillojë me ambasadat, por asgjë nuk është shkruar në programin e juaj.

Për bujqësinë mos të flasim, sepse ju nuk keni shkruar asgjë. Të paktën është dashur që për kohën e korrje e shirjeve të shkruhen disa fjalë për stimulimin apo për lirimin nga taksat të bujqve deri sa t'i kryejnë korrje – shirjet, por ju nuk keni shkruar asgjë.

Reforma në administratë publike, çfarë reformash do të bëhen, nuk di askush.

Luftimi i korrupsionit nuk bëhet, të nderuar, duke i ndërruar njerëzit për shkak se nuk po vjedhin për ju dhe në vend të tyre t'i veni ata që do të vjedhin për ju. Nuk ndalet korrupsioni me këso forme. As zbutja e varfërisë nuk bëhet nëse ju nuk keni asnjë plan për të krijuar vende të reja të punës. Si mund ta zbusim varfërinë, kur në programin e juaj nuk është shkruar asnjë gërmë se çfarë vendesh të reja të pune do të bëhen deri në vitin 2011, ta zëmë.

Kur flasim për pensionistët, ju i keni gënjyer ata në fushatën parazgjedhore se do t'ua ngritni pensionet. Ndërsa, asnjë përqindje nuk është shkruar në programin e juaj se sa për qind do të rriten pensionet, ta zëmë, në fund të vitit 2009 apo në fund të vitit 2011 sa do të qeverisni ju.

Shëndetësia është katastrofë. Ishalla i ndihmon zoti ministrit Gashi, se atje katastrofa më e madhe është në krejt Kosovën. Unë nuk di se si mund të funksionojë shëndetësia, kur asnjëri nga ne, si deputet, nuk paguajmë për sigurim shëndetësor. Merreni me mend, secili prej nesh i paguan nga 200 euro për ta siguruar automjetin që e ka, ndërsa nuk paguajmë për ta siguruar kokën dhe fëmijët tanë. Absurde! Ne kërkojmë llogari prej ministrit që ky të na japë sqarime se çfarë plani do të ketë. Nuk mundet as ministri, as askush të bëjë kurrfarë plani, nëse ne nuk paguajmë për shëndetësi, një sektor i veçantë i gjithë popullit të Kosovës.

Për kulturën dhe sportin, ishalla nuk i përziheni Valton Beqirit, e ai besojmë se do të bëjë diçka, se në Programin tuaj mozomëkeq se çka ka për ta gjetur kulturën për këto 4 vite sa keni për të qeverisur ju.

Të nderuar deputetë,

Kur e analizojmë 100-ditëshin dhe raportin 100 - ditësh këtu në aspektin politik, kjo qeveri ka dështuar plotësisht. Pse? Nën një, në kohën kur nuk ishin në Qeveri, pra nuk ishin në pushtet, ne atje i kishim në Mitrovicë gjykatat, kurse tash nuk i kemi më. Në kohën kur ju nuk ishit në pushtet, në Mitrovicë apo në kufirin verior në pikën 1 dhe 33 i kishim doganat, kurse nuk i kemi më, i kanë djegur huliganët serbë. Merrni me mend se sa gjatë e kemi mbajtur në burg Albin Kurtin se gjëja paska dashur t'i djeg do automjete të UNMIK-ut, të cilat kurrë nuk i dogji, por u mbajt në burg, ndërsa huliganët serbë që i dogjën doganat, automjetet e policisë së UNMIK-ut, lënduan dhe vranë policë të UNMIK-ut dhe të KFOR-it, nuk u arrestuan kurrë.

Si do t'i arrestoni ata kur ju s'keni mundur, apo ata që kanë qenë më herët, nuk kanë mundur t'i mbajnë në burg ata që i kanë pasur në burg, e lëre më të arrestohen këta që janë në liri.

Huliganët serbë i kanë dyert çelur që të ikin në Serbi dhe shteti nuk funksion, askush askënd nuk e kontrollon në veriun e Kosovës.

Është interesant të përmendet se në kohën kur PDK-ja ishte në pushtet, fjala është për Qeverinë e Përkohshme, dhe ne e kishim nën kontroll Mitrovicën e pasluftës, doktorët ikën dhe e lëshuan spitalin e Mitrovicës. Pasi ikën, ata u avancuan në drejtorë në QKUK, dhe QKUK-së ia bënë më zi se Mitrovicës, katastrofë e kanë bërë. Ju për 100 ditë vetëm bëtë akuza për ata që ishin në pushtet dhe asgjë konkrete për tash e tutje, se çfarë do të bëni.

KRYETARI: Faleminderit, Gani!
Fjalën e ka deputeti Gani Buçinca.

GANI BUÇINCA: I nderuari zoti Kryetar,
Të nderuar kolegë deputetë dhe ju Kabinet qeveritar,

Disa herë gjatë kësaj periudhe e konceptova diskutimin tim, çka do të flas për opinionin e gjerë dhe për ju kolegë. Mirëpo, megjithatë nuk arrita të përkufizoj në letër. Do të vazhdojë të flas duke u nxitur edhe nga debatet që i dëgjova këtu.

Nuk do të merrem shumë me programin për arsye se programi është i qartë, se është një program me vizion të qartë për zhvillimin e Kosovës, për integrimin e saj, për forcimin e rendit dhe të ligjit në Kosovë, për forcimin e institucioneve demokratike, për ndryshimin e mendësisë tribaliste qeverisëse, për ndryshimin e mendësisë së informalitetit dhe të vendimmarrjes politike, për ndryshimin e mendësisë mesjetare kanunore që mbretëronte te disa drejtues qeveritarë të ish legjislacionit të kaluar dhe për pasojat e mëdha që patën ato në vonimin e procesit të definimit të statusit të Kosovës dhe për pasojat e mëdha që ato patën në zhvillimin ekonomik dhe rritjen e besueshmërisë në aftësinë qeverisëse të institucioneve të Kosovës.

Nuk do të dëshiroja të flas as për informalitetin e vendimmarrjes dhe për të gjithë atë papërgjegjësi në zbatimin e ligjeve që i karakterizoi disa ministra, disa dikastere të Qeverisë së kaluar, por dëshiroj të përqendrohem tek mendësia të cilën e ka shfaqur dhe e ka dëshmuar në praktikë kjo Qeveri gjatë 100-ditëve të qeverisjes së vet.

Ndryshimet e mëdha në standardet e qeverisjes që kanë ndodhur në Kosovë, duke unifikuar me partnerin qeverisës standardet të cilat garantojnë funksionimin e ligjit, zhvillimin ekonomik të Kosovës të bazuar në procese komplementare, siç është privatizimi, siç është siguria, siç janë edhe një varg çështjesh të tjera të cilat ndërlidhen me hapjen e tregut të punës dhe investimet e kapitalit. Unë do të dëshiroj të ndalem vetëm te disa vërejtje të disa ish eksponentëve të Qeverisë, të cilët mundohen të shfrytëzojnë prestigjin e subjektit politik të cilit i takojnë, prestigjin e disa liderëve, edhe të të ndjerit ish Presidentit Rugova për të fshehur të gjitha ato dobësi që i kanë manifestuar gjatë qeverisjes dhe duke e komprometuar dhe duke shpërdoruar vullnetin, jo vetëm të votuesve, por edhe të subjektit politik.

Unë po ju them atyre se ata të cilët sot këtu dhe të premtën morën rolin e prokurorit dhe të gjyqtarëve, po ju them atyre se do të jenë vetë objekt të prokurorisë dhe të gjyqeve në Kosovë. Disa vetëm edhe janë objekt, por që nuk kanë guximin të thonë këtu publikisht para qytetarëve, nuk e kanë guximin të thonë publikisht para qytetarëve. Proceset të cilat po ndodhin në Kosovë, janë procese spektakulare të cilat kanë për ta ndryshuar

mendësinë e qeverisjes. Sundimi i ligjit, jo regjim, siç po thotë këtu një pjesë e opozitës, të Hashim Thaçit, por diktaturë e ligjit në Kosovë. Koha e diktaturës së ligjit në Kosovë po vjen dhe të gjithë ata që kanë rënë ndesh me këtë, me ligjin në Kosovë, pa dyshim do të përgjigjen për veprat e veta. Të tillë ka edhe në këtë Kuvend, të tillë ka edhe në këtë Kuvend, po ua them me përgjegjësi të plotë.

KRYETARI: Jemi duke diskutuar për Programin e Qeverisë!

GANI BUÇINCA: Pa dyshim. Programin e Qeverisë dhe askush mos të mendojë se zbutja e varfërisë, zbutja e papunësisë dhe prosperiteti ekonomik dhe shoqëror në Kosovë mund të vijë pa sunduar rendi dhe ligji në Kosovë, pa u bindur faktorët tonë, partnerët tanë ndërkombëtarë, investitorët e jashtëm dhe të brendshëm se në Kosovë funksionon ligji dhe kapitali i tyre është i mbrojtur. Këto përpjekje që po i bën Qeveria e Kosovë që të sjellë investitorë të ri në Kosovë, të sjellë kapital, e ka shqetësuar një pjesë të opozitës për arsye se ata kanë pasur shansin që të dëshmojnë si qeveritarë të mirë të përgjegjshëm, të ndërgjegjshëm, por kanë dështuar, dhe për këtë arsye elektorati i Kosovës e ka dhënë verdiktin e vet më 17 nëntor. Atyre të cilët po mendojnë se në një vend demokratik mund të organizohen zgjedhje vetëm për 100 ditë të qeverisjes, por ju them se mësohuni dhe adaptohuni në pozitën e re që e keni si opozitë, se do të mbeteni aty 4 vjet, 4 vjet do të mbeteni dhe besoj që shumë shpejt do të liroheni nga frustrimet të cilat ju kanë kapluar për shkak të sukseseve evidente të cilat i ka shfaqur Kabineti qeveritar.

Konsolidimi i institucioneve demokratike dhe funksionimi i institucionit të Presidentit dhe të Kryeministrit, që është një arritje shumë e madhe në Kosovë, i ka shqetësuar një pjesë të opozitës dhe të eksponentëve të qarqeve parapolitike në Kosovë që gjenden këtu dhe të grupeve të interesit. Mirëpo, partnerët qeverisës aktualë, bashkë me minoritetet, janë marrë vesh për një standard të qeverisjes dhe njëjtësimi i standardeve të qeverisjes pa dyshim do të jetë me shumë perkusione pozitive në jetën tonë ekonomike, politike dhe kulturore.

Disa të cilët pretendojnë se me individë, të cilët kanë zbatuar në Qeveri politika klienteliste, do të destabilizojnë partnerët qeverisës, po ju them- harroni, harroni këtë çështje se individë të caktuar brenda, me mision të caktuar brenda dy partnerëve strategjikë për integrimin e Kosovës në strukturat euro-atlantike dhe për të nxjerrë Kosovën nga varfëria, nuk do të dështojnë për shkak të interesave të disa individëve brenda këtyre dy subjekteve politike.

Unë, i nderuar Kabinet qeveritar, i kam dy fëmijë dhe shpresoj dhe jam i bindur se me këtë nivel të përgjegjësisë, me këtë nivel të ekspertizës që kemi treguar, me këtë ndjeshmëri të madhe për problemet e qytetarëve, me racionalizimin e shpenzimeve të buxhetit dhe shumë masa të cilat i kemi marrë, perspektiva e fëmijëve të mi dhe të qytetarëve të Kosovës dhe të fëmijëve të Kosovë do të jetë më e mirë.

Unë mund t'ju them, se ju keni kaluar nëpër një proces shumë intensiv, procesi i shpalljes së pavarësisë së Kosovës, procesi i aprovimit të legjislaturës nga pakoja e Ahtisarit dhe procesi i aprovimit të aktit më të lartë juridik dhe politik të shtetit të Kosovës nuk ka qenë proces i lehtë. Dhe, Programi i Qeverisë, pavarësisht nga të metat që mund t'i ketë, ka ardhur në kohën e duhur. Ky debat është dashur të zhvillohet pikërisht pas kësaj periudhe dhe, siç po shihet, ka qenë shumë mençuri edhe nga ana e Qeverisë, Kabinetit qeveritar, që ky dokument “është vonuar”.

Ju duhet të kuptoni se Qeveria ka paraqitur një plan të buxhetit për këtë vit dhe destinacionin e parashë publike për projektet të cilat tash veç kanë filluar të implementohen. Unë jam i bindur se qytetarët e Kosovës kanë një vetëdije të lartë politike. Ata kanë vuajtur shumë dhe do të jenë shumë të ndërgjegjshëm për vështirësitë që i ka Kabineti aktual qeveritar dhe e perceptojnë realisht ambientin politik dhe ekonomik në të cilën gjendet Kosova.

Dhe, unë, zoti Kryetar i Parlamentit, i kisha lejuar opozitës të flasë deri në mëngjes, se ndihma më e madhe për Kabinetin qeveritar dhe vetë pozitën janë diskutimet të cilat po i bën opozita deri më sot, deri në këtë moment në këtë Parlament.

Me pikëpamje të saja futuriste dhe nihiliste për të gjitha të arriturat, duke i mohuar edhe vetë të arriturat që ka qenë pjesë e atyre të arriturave, ka qenë edhe vetë opozita sidomos në procesin e implementimit të statutit dhe legjislacionit që del nga pakoja e Ahtisarit. Nga pasioni dhe nga frustrimet për shkak të sukseseve dhe të konsolidimit të institucioneve demokratike, ka harruar edhe kontributin e vet. Ju dëshiroj sukses dhe jam i bindur se në të ardhmen ato vërejtje që janë të arsyeshme do t'i keni parasysh dhe do t'i korrigjoni dobësitë gjatë procesit të qeverisjes dhe ju dëshiroj shumë sukses.

KRYETARI: Faleminderit!

Vazhdon debati, deputeti, anëtari i Kryesisë, zoti Sabri Hamiti e ka fjalën, le të përgatitet Zafir Berisha.

SABRI HAMITI: Zotëri Kryetar i Kuvendit,
Zotëri zëvendëskryeministër, ministra të Qeverisë së Kosovës,
Zotëri e zonja kolegë deputetë,

Ne kishim mbrapa disa muaj një periudhë të vendimeve historike, politike konstitucionale, të cilat, për fatin e mirë tonin, kanë mbaruar dhe unë mendoj që pikërisht kjo seancë është koha kur do të shkëputemi përfundimisht nga festiviteti, i cili është normal në një situatë politike, shoqërore në të cilën ishim dhe të kalojmë në kohën e komunikimit me realen. Unë mendoj që kjo mbledhje është koha kur duhet të bëhet kjo prerje, sepse festat sado të bukura që janë, ato mbarojnë dhe fillon puna. Mendoj që edhe Kuvendi, edhe Qeveria dhe të gjitha agjencionet që lidhen me zhvillimet në Kosovë, duhet të nisen nga puna.

Unë nuk dua të bëj vlerësime të diskutimeve tjera, se edhe nuk më lejohet. Megjithatë, e kam një sens, duke dëgjuar që po funksionon ajo dyshja e famshme e mohimit total, e pohimi total, që janë forma më të këqija të diskutimit për çka do qoftë, e aq më tepër për një program qeveritar, i cili zakonisht propozohet nga mazhoranca, por kritikohet ashpër e me argumente nga opozita, sepse qoftë edhe me votën “kundër”, opozita në vërtetë merr përgjegjësi për programin zhvillimor dhe unë uroj që në këto banka të Parlamentit të rezonohet kështu.

Mendoj që s'është rezonuar kështu, sepse këtu pak a shumë edhe diskutantët, qoftë pozitës, qoftë opozitës kanë rënë në grackën e tipit të diskursit të programit që e kemi përpara, i cili, unë kujtoj qëllimisht ka ikë nga referencat konkrete, ndërsa deputetët e kanë pranuar këtë tip diskutimi dhe kanë diskutuar prapë për tekstin pa referenca. Edhe opozita dhe të tjerët, po të jepnin referenca konkrete, vetë do të ishin shumë më të bindur, shumë më produktiv për veten, për alternativat e veta, por edhe për alternativat e Qeverisë. Unë nuk jam ekonomist, por kam logjikën e dijeve për ekonominë, që unë

mendoj që si kapitull elementar i këtij programi është dashur të jetë artikulumimi i filozofisë ekonomike të këtij programi, të cilin unë shumë kam shpresuar dhe ende shpresoj që ekonomistët, për kah zanati, këtu do ta kërkojnë më thellësisht të artikullohet filozofia zhvillimore e këtij programi trevjeçar, apo njëvjeçar, apo dyvjeçar, a po krijojmë filozofi zhvillimore, apo filozofi të asistencës sociale. Kështu siç është programi, pak a shumë është një thes universal i të gjithave, po asnjëra nuk është shqyrtuar deri në konsekuencat e fundit.

Po e zëmë, unë vetëm po lexoj në faqen 41, ku flitet për zbatimin e planeve kapitale dhe në mënyrë përgjithësuar thuhet që është problem i madh zbatimi i planeve kapitale. Kjo është send shumë me rëndësi dhe unë kisha kërkuar që në Program të thuhej, sa për qind janë zbatuar problemet kapitale, po e zëmë deri tash, dhe sa për qind do t'i zbatojë kjo qeveri. Kjo është esenciale, se për ndryshe, ndodhë siç po ndodhë edhe në rajon dhe po ndodhë edhe te ne që nuk zbatohen planet kapitale. Ne bërtasim, s'kemi të holla, ndërsa këshilltarët tanë të jashtëm thonë, ngadalë, bëni vepër ato të holla që i keni ju në buxhetin tuaj të konsoliduar.

Në këtë kohë Qeveria na del si një tagrambledhës i zellshëm, i cili paratë i çon në shtëpi, por s'di qysh t'i harxhojë dhe ky është problem i hatashëm zhvillimor.

E dyta, s'po hyjë tutje, por do të kisha dëshirë, si njeri jo i zanatit, të më thuhet në program sa është GDP-ia e Kosovës dhe sa do të jetë pas një viti, sa do të jetë pas 4 vitesh. Ajo është elementare, është një shifër atje, ka zhvillim 3 deri 4% dhe kurrëgjë tjetër nuk ka. Sa për qind ka ekonomi formale, sa informale në Kosovë, kjo analizë është e domosdoshme për të paraparë program zhvillimi dhe program korreksioni.

Dhe, unë dua të dal në dy-tri lami, ku ndihem mirë, sepse i njoh më mirë se këto të parat. Te problemi i arsimit, të kulturës, të shkencës, ne e kemi një situatë në arsim që u thanë fjalë të mira për iniciativat e ministrit dhe mandej do diskutime të sërta qysh sa mirë po punon ky, e sa keq të tjerët. Jo, përkundrazi. Pse te arsimit ka shans të duket edhe veprimi i ministrit, të cilin e përgëzoj! Ka sepse ky resor ka trashëguar një sistem të strukturuar të ri. Ky ministër i ka trashëguar dy strategji zhvillimore, të cilat i konsideron moderne dhe janë moderne sepse ka marrë pjesë edhe vetë në hartimin e tyre, edhe pse s'ka qenë ministër, në ekipet profesionale, dhe e dyta, pse e ka bërë një gjest konkret që duket, ka thënë, duhet të mbarohen shkolla. Unë e inkurajoj tutje që të vazhdohet në këtë Ministri, sepse mbulon $\frac{1}{4}$ e popullsisë së Kosovës, direkt, që pas ndërtimit të shkollave të shkohet shpejtësisht në kodifikimin e gradave në të gjitha nivelet e mësimdhënies, prej fillores deri në universitet, grada të kualitetit, po u quaj unë, që krijojnë diferencimin në kualitet dhe, e dyta, të krijohet kontrolli i cilësisë. Dikur i thoshim inspektim, fjala s'është me rëndësi. Shkolla jonë sot vuan nga mos kontrolli i rregullt. Shikoni ju shtetet shumë të forta në arsimim dhe tradicional, këtë sektor e kanë forcuar, te ne nuk është forcuar.

Kalojmë në kulturë. Ne e kaluam dje a pardje një ligj për financimin e mundshëm të kulturës, për sponsorizimin. Kjo është kategori tjetër. Unë them që në gjendjen që është kultura jonë në Kosovë, shteti, qeveria, duhet të financojnë ende planet kapitale të kulturës nacionale. Këtu hyjnë: botimet e librave kapitale, filmat, teatri, e të tjera.

Ne kemi ndërtuar një legjislacion, po legjislacioni është gati i kopjuar nga vendet perëndimore dhe thuhet: Kinematografia është veprimtari dobiprurës, Teatri veprimtari dobiprurës. Jo, në kushtet e zhvillimit të Kosovës këto nuk janë, nuk ka shans që edhe filmi ekzemplar që bëhet në Kosovë, ta nxjerr veten me shfaqje, as shfaqja e teatrit, as

librat kapital, se për kah natyra, librat kapital i financon edhe Franca sot. Tjetër është ku i gjen burimet, burimet ndoshta i nxjerr, i gjen duke tatimuar ashpër literaturën që është shumë e madhe, por shteti intervenon në degët e domosdoshme për nevojat e kulturës nacionale. Unë mendoj se kjo duhet të bëhet, sepse ne e kaluam dhe a pardje një ligj, ku e institucionalizuar financimin e një ansambli të valleve dhe të këngëve. Nëse ky shtet financon institucionalisht këngë dhe valle popullore, le të jenë nacionale a çfarë të donë, duhet të jetë i zoti të financojë dhe vepra fundamentale të artit dhe të kulturës. Mendoni vet për këtë.

Unë mendoj që tek puna e transformimit të sektorëve të ndryshëm të veprimtarisë, sidomos të shërbimeve civile, është mirë që të krijohet kodi i punëtorit të shtetit, si e quajnë shtetet perëndimore, që ju e dini qysh kalohet nëpër ato shkallë, atëherë ne do të krijojmë një administratë profesionale. Nëse do, ma jep edhe një minutë, po e shoh se po lëvizë këtu, por, do me thënë, punëtorin profesional të shërbimit, në mënyrë që ideologjitë dhe partitë që ndërrohen në pushtet, mos t'i ngucin njerëzit profesional nëpër vendet, shërbimet civile. Kjo bëhet me kod, mund të bëhet dhe ne nuk e kemi, por unë mendoj se duhet ta bëjmë.

Dhe, në fund, rreth implementimit të statusit, një punë që e pret Qeverinë dhe na pret, jo Qeverinë, por edhe Kuvendin. Unë i shoh dy probleme: problemin që ne i themi paprekshmëria e kufijve, që po del si çështje në Jug dhe në Veri, që është shumë aktual, dhe problemi i një bisede të padeklaruar, tinëz, të UNMIK-ut me Beogradin, i cili po gatuhet. Unë mendoj që...

KRYETARI: Ju faleminderit! Koha për debat është harxhuar. Fjalën e ka deputeti Zafir Berisha, le të përgatitet Drita Maliqi.

ZAFIR BERISHA: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë, nganjëherë, duke i dëgjuar disa fjalime, po e ndiej veten keq që jam pjesë e një Parlamenti ku përdoren disa shprehje, por megjithatë unë konsideroj se ky Parlament duhet të flasë atë që duhet të flasë, por jo vetëm për opinion të tregohet se kush çka tha. Konsideroj se pjesa dërmuese e fjalimeve më shumë kanë retorikë boshe, se ndonjë vërejtje dhe sugjerim konkret. Ajo që ka paraqitur Qeveria, ndoshta nuk është ideale, por konsideroj se janë shpresat, simptomat për një shpresë më të mirë, për një jetë më të mirë për qytetarët e Kosovës, por edhe për vetë opozitën që është shumë kritikuese. Këtë e bazoj në angazhimin dhe punën që është bërë deri tash, dhe kur bëhen krahasimet nga programet ose edhe nga raportet e 100-ditëve të qeverive të kaluara, realisht nuk ka shumë koment, sepse ndryshimet janë evidente, sepse vetë puna voluminoze që është duke u bërë veçanërisht në disa ministri, tregon se ata që sot kritikojnë, kritikojnë vetëm nga ajo se kanë humbur privilegjet, por jo edhe nga ajo se kanë fakte dhe argumente.

Mua më vjen keq për disa ish ministra që janë aq të zëshëm, kur vetë e dinë se kanë qenë në pushtet dhe realisht e dinë mundësinë dhe kapacitetin për tre muaj sa mund të bëhet.

Unë dëgjova shumë shprehje nga ata që kanë humbur privilegjet dhe realisht të gjitha akuzat shkojnë në atë që kalon 100-ditëshin e kësaj Qeverie, që faktikisht e akuzojnë vetveten. Prandaj, unë kisha kërkuar edhe nga opozita që, me gjithë sugjerimet, të jenë më konkret dhe realisht këtë program ta bëjnë edhe të tyre, ta përvetësojnë dhe t'i japin një mundësi kësaj Qeverie, që ta dëshmojë veten, siç e ka dëshmuar deri tash, sepse

megjithatë nuk mund të themi se nuk është bërë punë nga kjo Qeveri, sepse paralel me angazhimet për të krijuar një mirëqenie më të mirë për të gjithë qytetarët, realisht është kaluar edhe sfida më e madhe për qytetarët e Kosovës, bërja e shtetit të Kosovës, që pa dyshim një pjesë të meritave e ka edhe vetë edhe opozita. Por, megjithatë, e gjithë kjo ngjarje historike nuk ka mundur të tejkalohet pa angazhimin e sinqertë dhe shumë këmbëngulës të institucioneve, e veçanërisht të Qeverisë, sidomos në një drejtim ku është pritur shumë nga faktori ndërkombëtar se sa do të jetë në gjendje Qeveria dhe institucionet të menaxhojnë realisht në aspektin e sigurisë. Prandaj, gjithë puna që është bërë, nuk bënë vetëm të hidhet poshtë, po realisht duhet të pranohet ajo që është për t'u pranuar dhe në rast se ka ndonjë vërejtje, që për mendimin tim, deri tash nuk pati ndonjë vërejtje serioze.

Ajo që pak është interesante për këtë Parlament, vijnë kritika edhe nga vetë ata që janë në Qeveri. Unë nga parafolësi kisha kërkuar që të gjitha ato sugjerime dhe vërejtje t'i kishte dhënë dhe do ta kishte forcuar programin qeveritar, sepse ka pasur mundësi përmes ministrave, por megjithatë edhe brenda koalicionit është një demokraci e theksuar dhe kjo po vërehet, evidente është në këtë Parlament.

Një gjë nuk duhet ta harrojmë se Qeveria është përballuar dhe vazhdon të përballohet edhe me një staf që ka mentalitet socialist të qeverisjes dhe është një burokraci e theksuar në të gjitha nivelet, kjo realisht nuk mund të mos jetë pengesë për punën efektive, që duhet të bëhet në të gjitha sektorët.

Ne realisht sot kemi të instaluar në institucione ministra, zëvendësministra dhe ndonjë këshilltar dhe nga sekretari permanent e teposhtë, do me thënë dihet se kush është, do me thënë stafi i cili është vendosur nga ata që sot janë shumë më të zëshëm për kritika dhe stafi, i cili, edhe me fakte zoti Koci foli, dhe shumë fakte tjera tregojnë se mundohen në forma të ndryshme ta sabotojnë këtë Qeveri.

Unë, nuk po dëshiroj shumë të futem në akuza, por megjithatë nuk po mundem të rri indiferent ndaj disa shprehjeve që janë përdorur, veçanërisht ditën e premte, ku u përdor shprehja “mafi”. Ne duhet ta kemi të qartë, jemi në një shtet i cili është në konsolidim e sipër dhe, në fund të fundit, po kritikohet një Qeveri që e ka marrë mandatin para 100 ditëve, dhe mafia a petroll-mafia, si është quajtur më herët, duhet të kihet parasysh se realisht rrënjët i ka diku tjetër ose, thënë ndryshe, rrënjët i ka te ata që po kritikojnë. Vetë fakti se në këtë segment ku u përmend edhe ari edhe nafta, derivatet, duhet të keni parasysh se nga Qeveria e kaluar me çdo kusht është insistuar që një institut shumë i rëndësishëm që e kontrollon këtë fushë, do me thënë Instituti Meteorologjik, që ka qenë i vetmi në Kosovë, në Prizren, me çdo kusht nga Qeveria e kaluar është insistuar të futet nën kontroll, që pastaj faktikisht edhe të menaxhohet, kushtimisht them.

Unë po pres shumë nga opozita që të jenë më konstruktiv në raport me programin e paraqitur, dhe realisht të kontribuojnë me propozimet e tyre konkrete që ky program të jetë jo vetëm i koalicionit qeveritar, jo vetëm i qytetarëve, por të jetë edhe programi i opozitës. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Fjalën e ka deputetja Dritë Maliqi, le të përgatitet deputeti Ismet Beqiri.

DRITË MALIQI: Ju faleminderit, zotëri Kryetar!

E nderuar Kryesi e punës,

Të nderuar qeveritar dhe ju kolegë deputetë,

Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës, lëre që është vonuar, por edhe pasi na është vë në dispozicion, shkaku i vonësës së madhe, e kanë futur me nguti në rendin e ditës, siç po shihet, më shumë për mos të na lënë kohë të përqendrohemi në të në mënyrë pak më kritike dhe kjo praktikë nuk po më pëlqen.

Tjetra, po na servohet bashkë me Informatën e 100-ditëshit të këtij koalicioni qeveritar dhe kjo po bëhet me qëllim të krijimit të hutimit të deputetëve. Mendoj që 100-ditshi i Qeverisë është dashur të debatohet në seancë ndaras nga programi i Qeverisë, pikërisht për të pasur mundësi, që ne të përqendrohemi si në 100 - ditëshin e kësaj Qeverie, ashtu edhe në programin e punës që këta e kanë projektuar deri në vitin 2011, duke harruar se në Pakon e Presidentit Ahtisari, të cilin e kemi pranuar që të gjithë me konsensus, parashihen zgjedhjet brenda 9 muajve dhe këtë fakt mos ta heq prej mendje fare kjo Qeveri.

Unë po përqendrohem në dy – tri fusha të këtij programi, për shembull, konkretisht te arsimi, kultura dhe barazia gjinore. Është shumë interesant se gjatë fushatës parazgjedhore, Partia Demokratike e Kosovës, e kishte ndër prioritetet kryesore fushën e arsimit. Përveç kompjuterizimit, pati premtuar edhe ngritjen e pagave për punëtorët e arsimit. Tash po e shoh që nuk është përfshirë ndër katër prioritetet e kësaj Qeverie. Si duket, e paskan kuptuar që nuk e kanë lehtë me arsimin dhe e paskan lënë diku në shkallën e dytë apo të tretë të prioritetëve, meqë nuk e paskan përfshirë në këto katër projektet kryesore të programit qeveritar.

Kjo nuk është asgjë tjetër, pos lajthim nga premtimet elektorale dhe këtë le ta shohin mirë të gjithë ata punëtorë arsimorë, që kanë votuar për këtë koalicion qeverisës, përkatësisht për PDK-në dhe mos ta harrojnë edhe LDK-në.

Tjetra, pa i mohuar disa projekte të këtij 100 - ditëshi, në stabilizimin e gjendjes në arsim dhe sidomos në nisjen e gurë themeleve nëpër disa shkolla, e planifikimit edhe të dhjetëra sosh brenda këtij viti shkollor, që ishalla dhëntë Zoti e ndodhin! Është ngritur pluhur i madh nga ky koalicion dhe sidomos nga PDK-ja për kompjuterizimin e të gjitha shkollave.

Siç duket, këta zotërinj nuk i paskan vizituar shkollat e Kosovës që pas zgjedhjeve të para lokale e parlamentare. Një pjesë e mirë e shkollave të Kosovës, madje edhe nëpër disa fshatra të mëdha, janë të kompjuterizuara dhe nuk e di këtë fakt pse po e heshtë LDK-ja, që një kohë të gjatë ka udhëhequr me arsimin.

Ky kompjuterizim në të shumtën e rasteve ka qenë donacion i institucioneve dhe organizatave ndërkombëtare dhe nuk është mirë ta fshehim, por që ndoshta kanë nevojë të ndërrohen këta kompjuterë, këtë mund ta pranoj si dhe të pajisen edhe ato shkolla që më nuk kanë, gjithsesi. Por, sikur po tentohet të krijohet bindje përmes këtij aksioni, se në këto vitet e pasluftës, shkollat tona nuk paskan parë fare kompjuter. Këtë logjikë nuk mund ta pranoj.

Në komunën time, qysh para luftës kemi pas vendosur një qendër kompjuterësh, në të cilën janë trajnuar dhe aftësuar si arsimtarët, ashtu edhe nxënësit, e të mos flasim pas luftës. Po këtu, si duket, është një mundësi e mirë për ndonjë firmë kompjuterësh. Sigurisht që është donatori i PDK-së, për të arritur edhe më shumë biznesin, duke e

ndarë një përqindje të fitimit edhe për partinë që po ua mundëson një gjë të tillë, dhe ne do ta kemi nën vëzhgim gjithmonë këtë çështje.

Sa i përket sërish arsimit, unë nuk vërejtja ndonjë synim që Ministria e Arsimit mëton t'i bartë do kompetenca nëpër komuna, të cilat që moti janë garantuar me ligj. E kam fjalën për kompetencat në paga dhe në punësim. Kompetencat, të cilat në dy tri vitet e fundit i kanë sjellë shumë telashe, si bie fjala, për shembull, e di ministria e mëhershme e Gjilanit, nga se është përpjekur për ta shfrytëzuar këtë mundësi ligjore, por Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë gjithnjë ia ka mohuar pa të drejtë, ndërsa komunat e tjera kanë qenë më të pazëshme. Mendoj që këtu ministri i Arsimit do të duhej të jetë më dorëlidhur në respektimin e kompetencave, që janë në përputhje me ligjin edhe sa ju përket komunave.

Gjithashtu, çështja më e rëndësishme sa i përket mendimit tim, po edhe mendimit prej nga vi, është çështja e depolitizimit të kuadrit udhëheqës nëpër shkolla. Kam pritur që do të jetë ndër prioritetet e kësaj ministrie, por nuk e pashë. Përkundrazi, në disa emërime që kanë ndodhur kohët e fundit nëpër shkolla, qoftë vitin e kaluar, qoftë këtë vit, shkollat edhe më tej tepër janë të politizuar pikërisht nga këta që sot janë në të njëjtin koalicion, pavarësisht pse një pjesë e madhe e këtyre kuadrove partiake nëpër shkollat tona kanë mungesë të madhe të shkathtësive organizative, menaxheriale, po edhe mosnjohje të vet kompetencave dhe të akteve normative të fushës arsimore.

Ministria e Arsimit, nëse pretendon kualitet, profesionalizëm dhe avancim të dijeve, duhet të heqë politikën nga shkollat, e jo ta përforcojë, siç po bën realisht.

Te kultura, vazhdon avazi i vjetër, manipulimi përmes premtimesh të gjithë ata që krijojnë dhe organizojnë kulturën. Ministri i deritashëm i Kulturës dha premtime, e premtime dhe iku apo shkoi. Tash sa do të mundet që premtimet e tij t'i zbatojë ky tjetri që do të vijë, ose sa do të pajtohet edhe me këtë program qeveritar të kësaj fushe?

Po thuhet që kanë bërë borde të ndryshme dhe kanë filluar zbatimin e Ligjit për teatër e për kinematografi, e që tre muaj gati nuk po mund ta zgjedhin një drejtor të Teatrit Kombëtar të Prishtinës, ndërsa i kanë harruar teatrot e tjera profesionale, ju lutem! le ta shikojnë ligjin edhe për të tjerët që veprojnë jashtë Prishtinës, duke e pasur përgjegjësi të tyre si ministri, mos t'ua lënë këtë barrë vetëm komunave, bie fjala, si Gjakovës, apo edhe e Gjilanit.

Komunat, në mungesë të qartësimeve ligjore të Ministrisë, po ndajnë vetëm subvencione, e ende nuk e dimë shumën e 49 përqindëshin si komunë që e kanë ndaj teatrit, nga se Ministria asnjëherë nuk i ka përzgjedhur dhe aprovuar projektet teatrore të cilitdo teatër profesionist dhe nuk i ka bërë, pastaj për mungesë të kësaj marrëveshje me komunat. Prandaj, le ta kenë këtë pak më shumë nën përkujdesje.

Edhe te trashëgimia kulturore historike, sikur jemi përqendruar vetëm në trashëgiminë që ka të bëjë me një minoritet, në këtë rast të serbëve, ndërsa e kemi lënë anash së tepërmi trashëgiminë kulturore të shumicës, po edhe brenda kësaj shumice nuk kemi bërë një hartë më gjithëpërfshirëse të hulumtimeve dhe të investimeve.

Ndërsa, sa i përket barazisë gjinore, nuk kemi çka të flasim. Le të shikohet vetëm garnitura qeveritare, apo edhe vetë programi prej 4 – 5 rreshtave për ta parë se sa jemi të vëmendshëm në aplikimin, madje edhe të bazës ligjore që e ka aprovuar vite më parë

Kuvendi i Kosovës. Ose, le të shikohet prania e femrave brenda radhëve të këshilltarëve të cilëndo ministri apo të vet Kryeministrit. Femra vazhdon të mbetet dekor i shoqërisë sonë. Vetëm pozitat e asistentëve nuk e përmbushin kriterin e barazisë gjinore dhe këtë opozita ditë e më shumë po e bën fyese për femrën.

Sa i përket kësaj fushe të barazisë gjinore, unë kisha kërkuar dhe nga kolegët e mi, që pjesën brenda këtij programi ta refuzojmë në tërësi. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Fjalën e ka Ismet Beqiri, le të përgatitet Ibrahim Makolli.

ISMET BEQIRI: Ju faleminderit, zotëri Kryetar!
Përshëndetje juve zëvendëskryeministër, ministra,
Kolegë deputetë,

Sigurisht që të flasësh për Programin e Qeverisë së Kosovës, edhe është përgjegjësi e asaj se çfarë do të thuash, dhe a do të dish diçka të thuash, kushtimisht të them, apo do të flasësh vetëm sa për të thënë diçka.

Unë, ndoshta do të pajtohesha që në fillim me atë që është thënë edhe të premtën, aty këtu nga disa deputetë të nderuar. Ne të gjithë do të duhej të kishim kujdes ta kemi një gjë të qartë dhe besoj që e kemi të qartë se asnjëherë historia nuk fillon as me këtë Qeveri, e as me atë para kësaj Qeverie, por as edhe me atë që do të vijë, por është një kontinuitet. E kam fjalën për veprimin dhe punën, si që Qeverisë, ashtu edhe të Parlamentit dhe është shumë e domosdoshme dhe e mirë të merret ajo që është e mirë nga e kaluara, gjithmonë për t'i pasuruar programet tona dhe, normalisht, të mos marrim atë që nuk është mirë, kushtimisht të them, nuk është në të mirën e qytetarëve të Kosovës.

Unë do t'i them, nëpër disa faqe, disa vërejtje që i kam në kuptimin më shumë ndoshta, sepse në atë të përmbajtjes edhe disa gjëra do të mundohem të mos i përsëris që u thanë, por disa formulime që mund të japin dykuptimësi apo edhe janë keq të formuluar, që ndoshta nuk e kanë vendin në një program qeverie, në programin e Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Po e marrim, në faqen 6, e keni formulimin në fillim të faqes atje: “Qeveria është e përkushtuar që sa më parë të përfundojë ndërtimin e mirëbesimit me qytetarët tanë”. Unë ju lus që këtë fjali fare ta hiqni ose ta riformuloni. Mirëbesimi me qytetarët, të nderuar, nuk është një proces që përfundon, që ndërtohet, përfundon, por është një proces i cili gjithmonë duhet të ekzistojë, sepse nuk kemi të bëjmë me asfaltimin e një rruge 100 – metërshe, dhe kryhet. Thënë thjeshtë, formulimi për mirëbesimin, kjo pjesë të hiqet fare ose të formulohet pak më ndryshe, sepse le të kuptohet diçka që nuk është e qëndrueshme.

Po ashtu, në faqen 6, “politikat prioritare të Qeverisë”, mendoj që tek formulimi që “këto prioritete kanë dalë nga procesi i konsultimit me komunat dhe me ministrinë e linjës, në Qeveri, si dhe me shoqërinë civile”, mendoj se nuk është formulim i drejtë, nëse është kuptuar se çka do të thotë kjo ministrinë e linjës, nëse është nënkuptuar që kanë të bëjnë me këto fusha, që përmenden: rritja ekonomike, implementimi i statusit, qeverisja e mirë, zbutja e varfërisë dhe e stabilitetit social, po ashtu nuk qëndron edhe nëse është menduar kështu, sepse qeverisja e mirë nuk i nënkupton vetëm disa ministri, por krejt shoqërinë në këtë rast, dhe krejt institucionet, do të thotë Qeverinë dhe institucionet e tjera, prandaj

edhe këtu duhet shikuar, po e përsëris, në riformulim të saj, sepse është e paqëndrueshme ashtu siç figuron.

Në faqen 13, po ashtu, e keni një formulim që “Qeveria e Kosovës”, në mes tjerash thuhet: “do të punojë në mënyrë agresive në zvogëlimin e humbjeve komerciale etj. etj.” Mendoj që nuk qëndrojnë formulimet e tilla, sepse mund të thuhet në mënyrë efektive, po jo agresive, sepse mendoj shqip si bie bash mirë, kushtimisht ta themi.

Po ashtu, në faqen 25, pjesa që ka të bëjë me të zhdukurit, siç thuhet në program. Meqenëse unë po e keqpërdori ndoshta, por po e them, po e kryesoj këtë Komision, ku bën pjesë edhe kjo çështje e ndjeshme, është një diçka që kërkohet vazhdimisht, së paku të hiqet fjala të “zhdukurit” dhe të thuhet: “të pagjeturit”, kështu është kërkuar vazhdimisht nga familjarët.

Pastaj, është një fjali e vetme, të nderuar, për këtë problem dhe unë i bashkëngjitëm, ndoshta ka qenë edhe dikush që ka pasur vërejtje më herët, që është e papranueshme, të mos them është nënçmim për familjarët, thuhet vetëm ajo fjali. Unë konsideroj që për këtë problem shumë të ndjeshëm, sensitiv është dashur të shkruhet më shumë se cilat janë planet e Qeverisë në këtë drejtim dhe cila është strategjia, duke e kuptuar qartë se çdo gjë nuk mund të futet këtu, por më shumë ka mund të thuhet diçka.

Në faqen 44, e keni sistemin pensional, në me tjerash. Një problem që unë mendoj do të duhej të ngrihet, është çështja e asaj se çka tash, Qeveria e Republikës së Kosovës, tanimë shtet, do të mund të bënte eventualisht dhe cila është strategjia të bënte diçka më shumë në aspektin e problemit që e kemi me pensionet e vjedhura nga Beogradi, mospagesën e tyre. Nuk do të thotë që ata do të pranojnë diçka të tillë, por si shtet i kemi tjera mundësitë të luftojmë në këtë drejtim që pensionistëve t’ju kthehen paratë që thjeshtë janë vjedhur ose nuk janë paguar nga Beogradi.

Në faqe 45 e keni shëndetësinë. Thuhet ai formulimi shumë i përgjithësuar që është përmendur: “Do të shqyrtohen mundësitë që profesionistët shëndetësor të shpërblehen për ofrimin e kujdesit shëndetësor cilësor”. Mendoj që është një formulim shumë i përgjithësuar. Kjo, “do të shqyrtohen mundësitë”, me falni, por pak do të thotë, mos të them se nuk thotë asgjë. Prandaj, duhet të jemi pak më konkret se çka do të mund të parashihej në këtë drejtim.

Dhe, pjesa tjetër, në faqen 51, që ka të bëjë me Mjedisin dhe Planifikimin Hapësinor.

Të nderuar deputetë,

Legjislaturat e mëhershme, në mes tjerash e kanë nxjerrë edhe Ligjin për planifikimin hapësinor. Mendoj se kjo materie këtu është fare pak e trajtuar, duke e ditur se pak është bërë në këtë drejtim në të kaluarën. Çka dua të them? Sot e kësaj dite Kosova nuk e ka planin hapësinor të saj, dhe këtu nuk thuhet se çka do të bëhet në të ardhmen, a do të hartohet ky plan hapësinor, apo nuk do të hartohet.

Po ashtu, në ligj shkruan qartë që komunat janë të obliguara t’i hartojnë planet e tyre komunale, urbanistike dhe hapësinore të qytetit dhe planet rregullative. Nëse kjo nuk ndodhë, atje në ligj figuron që brenda dy viteve, të mos gabohem, do ta bëjë Qeveria. Kjo nuk ka ndodhur dhe po e shoh, nëse nuk e fusim si prioritet, nuk do të ndodhë as në të ardhmen. Prandaj, gjithsesi duhet angazhuar, sepse komunat tona, shumica e tyre nuk i

kanë planet urbanistike dhe si pasojë e kësaj, ose si shkak del pasoja e degradimit që mund të ndodhë, edhe në vazhdim, të qyteteve tona dhe të pjesëve të qyteteve tona.

Po ashtu, edhe unë i bashkëngjitem asaj që ka të bëjë me kulturën, rininë, sportin dhe diasporën. Unë ju lutem që të jeni më konkret dhe të jeni më gjithëpërfshirës, sepse janë sfera jashtëzakonisht të rëndësishme. Shpeshherë ne e themi në punën tonë që, kultura, por edhe sportistët janë ambasadorë tanë jashtë Kosovës, e mendoj që ambasadorëve do të duhej t'iu kushtohet më shumë rëndësi me projekte dhe me përkrahje që do të duhej të bëjmë karshi punës që ata e bënë dhe rëndësisë që e kanë për Kosovën dhe imixhin e Kosovës.

Dhe, fare në fund, disa herë u përmend stafi civil. Unë ju lus, një gjë duhet ta kemi të qartë. Në Kosovë nuk punojnë në shërbimin civil njerëz vetëm pas luftës. Nëse hyjmë në komunat tona, por dhe në nivelet qendrore kemi njerëz që punojnë prej kohës, të mos them ish sistemit të Titos e këndeje. Në ato shërbime kemi laryshi njerëzish në kuptimin e përcaktimeve partiake e të tjera. Prandaj, e udhës është, edhe unë pajtohem me atë, që këta njerëz brenda mundësive, e di që një numër i tyre është i vjetër, por duhet siguruar edhe ekzistencën e tyre për t'i larguar pastaj, por është mirë të bëhen përpjekje. Iu bashkëngjitem të gjithë atyre që thonë që njerëzit profesionistë, qoftë edhe nëse dikush ka ardhur sipas vijës partiake, ai bën edhe të dërgohet në shtëpi, por njerëzit profesionistë është mirë për t'i lënë, sepse janë për të mirën e Kosovës dhe të ardhmes sonë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Fjalën e ka Ibrahim Makolli, por nuk di si është disponimi i juaj. A po e bëjmë pauzën një orë e gjysmë? Mirë, deri në orën 15,00 po punojmë. Atëherë, Ibrahim Makolli e ka fjalën, e pastaj pas pauzës në orën 15,00, fjalën e ka deputeti Et'hem Çeku.

IBRAHIM MAKOLLI: Ju faleminderit, i nderuari zoti Kryetar!

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Kolegë të nderuar,

Do të doja që në fillim të paraqitjes sime t'ju përkujtoj edhe njëherë, jo për t'iu përgjigj njerit nga kolegët tanë të pozitës, i cili në seancën e kaluar kërkoi nga opozita që të zgjohet nga gjumi, por t'ua bëjë me dije se njëri nga liderët e opozitës, konkretisht zoti Pacolli, ditën e zgjedhjes së kësaj Qeverie pat deklaruar se për 100 ditët e ardhshme opozita nuk do të kërkojë llogari të përditshme, por këtë do ta bëjë në 100 - ditshin e jetës së saj.

Edhe pse ju nuk keni lejuar të zhvillohet debat për të arriturat tuaja gjatë këtyre 100 ditëve të qeverisjes, ashtu sikur do të ndodhte në çdo vend demokratikë, megjithatë mungesa e debatit nuk do të mund t'i fsheh edhe dështimet që janë shënuar, sikurse as nuk do të mund t'i mohojë të arriturat tuaja në fusha të caktuara, sidomos po e potencoj edhe unë, në fushën e arsimit.

Sa i përket 100 – ditëshit, do të doja të nënvizoj vetëm dy çështje: e para, shpallja e Kosovës shtet të pavarur dhe sovran më 17. shkurt të këtij viti nga Parlamenti i Kosovës, nuk është sukses dhe meritë as e vetëm kësaj Qeverie, sikurse është përpjekur shpeshherë të paraqitet, as vetëm e këtij Kuvendi, e as vetëm e subjekteve politike apo të institucioneve të tjera, por në radhë të parë është meritë e breznive të tëra, jo vetëm të këtij 100 vjetëshi, është meritë e qindra mijëra të atyre që nuk janë më në

jetë, e qindra mijëra dëshmorëve, të cilët nuk pushuan asnjëherë së luftuari për liri dhe pavarësi.

E dyta, gjithsesi duhet të jemi të vetëdijshëm dhe të përgjegjshëm duke mos mohuar asnjëherë përkushtimin e gjithë neve gjatë kësaj periudhe 100 - ditëshe, për t'i mundësuar koalicionit qeveritar veprim të pa presion, duke treguar kështu konstruktivitet dhe përgjegjësi për proceset, andaj ky konstruktivitet nuk do duhej asnjë herë të kuptohej si dobësi apo përgjumësi e opozitës. Natyrisht, të priturat e qytetarëve të Kosovës edhe të opozitës në këtë 100 - ditësh, kanë qenë shumë më të mëdha, andaj është edhe i kuptueshëm toni kritik që po dëgjohet gjatë këtij debati, i cili për më tepër ka të bëjë me përgjegjësitë, të cilat i kemi secili prej nesh.

Të nderuar kolegë,

Programi, sikurse u tha nga shumë deputetë këtu, përcillet me një mori të metash. Pasi që koha e paraparë për debat është e limituar, unë do të përpiqem që të paraqes disa sugjerime konkrete, të cilat po që se pranohen nga Qeveria, besoj se do të jenë me dobi për të ardhmen e vendit. Natyrisht, krejt kjo varet nga gatishmëria e Qeverisë për të ndërtuar një program qeverisës funksional.

Sa i përket sektorit të bujqësisë, që është një ndër sektorët e rëndësishëm, Qeveria duhet të ketë qasje serioze për të mundësuar zhvillimin e saj, që do të ndodhte përmes regjistrimit të kualitetit të tokës bujqësore, kategorizimit të saj dhe përkrahjes me mikro - kredi për familjet që do të merreshin me bujqësi. Do të arrihej që Kosova të shndërrohej në një vend eksportues të prodhimeve bujqësore sikurse do të mund të thithte edhe investime të mëdha nga investorët e interesuar.

Sipas analizave dhe studimeve, në këtë sektor do të mund të inkuadroheshin drejtpërsëdrejti apo indirekt me mijëra punëtorë. Ministria e Bujqësisë do të duhej të ndërtonte programe të veçanta, duke iu sugjeruar edhe fermerëve se çka mund të kultivojnë, sikurse do të mund të kontribuonte në ndërtimin e platformave bujqësore.

Procesi i privatizimit paraqet hallkën kryesore të shkatërrimit të ekonomisë së Kosovës, burimin kryesor të korrupsionit dhe të papunësisë, si dhe të abuzimeve dhe të keqpërdorimeve të tjera. Andaj, duke i ditur këto, ne i sugjerojmë Qeverisë se duhet ta ndalojë këtë formë të privatizimit, duke i hapur rrugë dhënies me investime të ndërmarrjeve që nuk janë privatizuar, duke paraparë edhe lehtësira për investorët, sikurse janë lirimet nga taksat për një periudhë të caktuar kohore, e të tjera.

Duhet identifikuar investorët që kanë kapacitet edhe material, edhe krijues për të garantuar qëndrueshmëri dhe investime, të cilat do të rrisnin prodhimtarinë dhe numrin e të punësuarve. Në vend që të merren paratë e të deponohen jashtë vendit, sikurse ka ndodhur deri tash, t'i jepet mundësia blerësit të rimëkëmbë ndërmarrjet dhe të rrisë numrin e të punësuarve. Forma të tilla do të mund të angazhonin fuqi punëtore dhe rritje të prodhimtarisë së tyre.

Për investorët e jashtëm duhet të ndërtohen programe për lirime nga taksat për 5 vite, t'u sigurohet infrastruktura ligjore dhe logjistike për të garantuar qëndrueshmëri. Ka investorë të interesuar që të sillen në Kosovë.

Qeveria, po ashtu, duhet të parasheh uljen e taksave. Kosova sot, sa u përket këtyre taksave është vendi më i papërshtatshëm për investime në rajon. Qeveria, gjithashtu,

duhet të parasheh lirim nga dogana dhe TVSH-ja për lëndën e parë derisa ajo të përpunohet për të kontribuar në rritjen ekonomike.

Qeveria duhet të parasheh formimin e një banke investive, ku shteti do të ishte i involvuar në këtë bankë përmes Agjencionit për participim, që do të duhej të formohej në të ardhmen.

Në sferën e energjetikës nuk do të duhej të guxonte ta shiste pronën, që është pronë e gjeneratave të ardhshme të Kosovës, në mënyrë që kjo pasuri të tjetërsohet. Blloqet e Kosovës A, duhet të jepen me koncesion, ku Agjensioni i participimeve do të ishte prezentë, që përmes aksioneve të saja do ta luante rolin e rregullatorit, e sidomos për rregullimin e çmimit për tregun e brendshëm dhe të sasisë që duhet të mbetet në këtë treg.

Të bëhet planifikimi për shfrytëzimin e minierave të linjtit, rivitalizimi i rrjetit distribues. Sot Kosova humb deri në 33% të energjisë elektrike, që e quajnë humbje teknike, një pjesë tjetër nuk mund të inkasohet, prandaj menjëherë duhet të fillojë digjitalizimi i rrjetit, investimet në të cilin do të mund të ktheheshin brenda tri vjetësh.

Si fazë e katërt e intervenimit, duhet të planifikohet, pasi Termocentrali “Kosova A” mund të jetë në funksion të plotë, renovimi i blloqeve të Termocentralit të “Kosova B”.

Në krejt këto intervenime, shteti i Kosovës nuk duhet të humbë kontrollin e vet, mirëpo nuk duhet të interferojë në menaxhimin profesional të tyre, sikurse ka ndodhur deri më tash.

Sot Kosova importon energjinë me çmimin më të lartë që vjen si rezultat i çmimit që ofrojnë dilerët dhe jo vendi i origjinës. Është e patolerueshme që Kosova edhe më tej të mbetet në errësirë.

Qeveria, po ashtu do të duhej të shqyrtojë mundësinë ose të shlyerjes së borxheve për amvisërinë, ose shtyrjen e tyre për periudha afatgjate, për shkak të pamundësisë së tanishme të borxhlinjve për t’i shlyer ato.

Në infrastrukturën rrugore, Qeveria do të duhej të parasheh mundësinë që rrugët të jepen me koncesion dhe të gjenden investitorë në këtë sektor, nga se Kosova nuk ka kapacitete financiare për të investuar vetë në to.

Sa i përket shëndetësisë, fushë më e madhe e operimit do të duhej t’i jepej shëndetësisë primare, sikurse edhe asaj sekondare, ndërkah spitalet të mos shërbejnë edhe më tutje për nevoja elementare, sikurse ka ndodhur deri më tash.

Qeveria do të duhej të ndalojë importin e barnave nga vendet e ndryshme që nuk kanë qasje në vendet e Bashkimit Evropian. Sot në Kosovë kemi import të barnave me afat të skaduar dhe nuk është e rastësishme që kemi prani të sëmundjeve të ndryshme.

Krijimi i fondit shëndetësor duhet të jetë prioritet qeveritar, në të cilin do të duhej të kontribuonin edhe subjektet që dëmtojnë shëndetin.

Në fushën e arsimit desha të them që tash e 8 vjet po bëhen eksperimente, andaj edhe është krijuar gjendja në të cilën kërkohen investime edhe materiale, edhe mendore. Megjithatë, hapat pozitiv të ndërmarrë në këtë 100-ditësh nuk mund të jenë të efektshëm po qe se vazhdon gjendja e njëjtë me punëtorët e arsimit dhe nivelin e pagave të tyre.

Ky Program, gjithashtu, nuk parasheh politika për disa kategori të rëndësishme në shoqëri, siç janë pensionistët, të zhdukurit, familjet e tyre, invalidët e luftës, personat me nevoja të veçanta, etj.

Edhe në planin politik, Programi qeveritar nuk parasheh politika të qarta për sigurinë e Kosovës, e në veçanti për pjesën veriore të asaj, duke përfshirë edhe qytetin e ndarë të Mitrovicës, sikurse edhe tendencat e Serbisë për ta serbizuar atë pjesë të Kosovës përmes blerjes së pasurive të shqiptarëve.

Rendi dhe ligji nuk do të mund të mbizotërojnë në Kosovë përderisa kemi këtë gjendje me pjesëtarët e Shërbimit Policor, të Gjyqësisë dhe të autoriteteve të tjera të thirrura për ta zbatuar ligjin dhe garantuar rendin dhe sigurinë. Rritja e pagave në këto fusha, sikurse edhe në fushat e tjera, është e domosdoshme.

Për fund, të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar, ne kemi programe dhe projekte të qarta të studiuara për të gjitha këto fusha që i përmenda më lartë dhe jemi të gatshëm që t'ua ofrojmë, natyrisht, nëse jeni të interesuar. Faleminderit shumë!

KRYETARI: Faleminderit! Në mënyrë racionale e ke shfrytëzuar kohën.

Në orën 15,00, vazhdojmë punën.

KRYETARI I KUVENDIT: Mirëdita. Mund t'ia fillojmë punës. Fjalën e ka deputeti Ethem Çeku, le të përgatitet Berim Ramosaj, e nëse Berimi nuk është këtu, mund të paraqitet ndokush tjetër në vend të tij.

ETHEM ÇEKU: Faleminderit, zoti Kryetar! Ndoshta më duhet të përsëris, e të them dy herë – faleminderit! Edhe pse kemi punuar nja 3 vite bashkë, ma ke shty orarin, sepse kam qenë në radhë për të diskutuar.

KRYETARI: Jo, ua kam shpejtuar orarin, se për ta shtyrë, jo, garantoj.

ETHEM ÇEKU: Kemi qenë në radhë të diskutimit që nga fillimi, por ju e keni vlerësuar ashtu dhe besoj se më nuk do të na shtyni kaq shumë.

I nderuari zëvendëskryeministër, kolegë deputetë, ministra,
Më lejoni që në fillim t'i dëshiroj punë të mbarë Ministrisë së Energjisë dhe Minierave dhe sukses të plotë.

Besoj se, së paku kjo nuk do ta mbajë epitetin “ministër i territ”, por do të bëjë shumë më tepër se sa kemi bërë ne, prandaj me plotë dëshirë mbështes që kjo Ministri të ketë progres në punën dhe në zhvillimin e sektorit të energjisë, e po ashtu edhe të minierave.

Një nga çështjet kryesore është se unë do të doja t'i ndihmoja programit qeveritar dhe t'i japë sugjerimet si ish ministër me mandatin prej tri vjetësh, duke punuar në sektorin e energjisë dhe të minierave dhe duke themeluar një ministri e deri te zhvillimi i programit

ministror dhe projektet konkrete. Mund të them se Sektori i energjisë dhe i minierave është sektor bazik i zhvillimit ekonomik të Kosovës. Nga strategjitë e kaluara është përcaktuar se baza e zhvillimit ekonomik të Kosovës është energjia dhe minierat. Mirëpo, unë nuk e shoh se në këtë program ka zënë një hapësirë të tillë dhe që sektori i energjisë dhe i minierave të jetë sektor zhvillimor, sepse problemi ndoshta më i madh tani paraqitet tek minierat metalike.

Unë e di që disa kolegë deputetë dhe ministra kanë përvojë të konsiderueshme nga e kaluara për qasjen në miniera, posaçërisht në kompleksin e Trepçës. Nga e kaluara, të gjithë jemi dëshmitarë, se një pjesë të madhe të të hyrave në ish-Jugosllavi kompleksi i Trepçës i ka realizuar.

Në Qeverinë e parë, bashkë me kolegun tonë, zotin Bajram Rexhepi, kryetarin e Kuvendit të tashëm aktual të Mitrovicës, kemi punuar që të ristrukturohet sektori i minierave. Po ashtu, në qeveri të kaluar, është investuar një shumë e konsiderueshme për t'i sjellë minierat nga ana e një shpenzuesi buxhetor në anë të të hyrave që mund t'i krijojnë minierat.

Në këtë program qeveritar, me keqardhje më duhet të them se kompleksi i minierave metalike nuk ka zënë hapësirë adekuate çfarë duhet të zinte si një strategji zhvillimore ekonomike të Kosovës. Prandaj, do të lusja ministrat, posaçërisht ministrin e ekonomisë dhe financave, Ministrinë e Energjisë dhe të Minierave dhe tërë kabinetin qeveritar që t'i përkushtohen më shumë kësaj, sepse e dimë sa janë duke bërë minierat dhe sa ka arritur çmimi i mineraleve në treg dhe bursë dhe se Kosova mund të jetë, me disa investime të cilat i kemi lënë në strategjinë zhvillimore të Kosovës, për të krijuar pastaj të hyra buxhetore.

Unë nuk dua të ndalem në shifra. Shifrat i kemi lënë të gatshme, por mendoj se ministrinë mund t'i marrin ato dhe t'i përpunojnë e të shohin se sa mund të realizohen në atë drejtim.

Një problem tjetër, i veçantë, është çështja e ndërlidhshmërisë në mes Universitetit të Prishtinës dhe çështjes siç janë resurset minerale që i posedon Kosova. Ne mund të bëjmë strategji e programe, por jemi larg harmonizimit të këtyre dy projekteve të rëndësishme: të edukimit dhe arsimit në realitet, që duhet të shkojnë në favorin e zhvillimeve të sektorit të energjisë dhe minierave.

Ne kemi pas ndarë bursa për studentët, të cilët kanë kryer këto dy drejtime dhe lus po ashtu ministrinë përkatëse që t'i vazhdojnë ato bursa për studentë të cilët i studiojnë energjinë dhe minierat. Ne kemi pranuar ekspertë nga vende të ndryshme, por ka ardhur koha të vazhdohen ato projekte të cilat kanë qenë të rëndësishme për sektorin e energjisë dhe minierave, posaçërisht për mbështetjen e bursave.

Problemi tjetër është se, duke investuar në miniera metalike, posaçërisht në kompleksin e Trepçës, ne mendojmë se problemet që kanë të bëjnë me Mitrovicën dhe me atë pjesë të Kosovës, deri diku, përmes investimeve qoftë të sektorit privat apo investimeve nga buxheti i konsoliduar i Kosovës - mund të arrijmë edhe progrese të tjera në fusha të caktuara, për të cilat sot po kemi problem. Prandaj, për mua është pak vështirë dhe jo e kuptueshme nga ana profesionale, që këtu nuk ka zënë hapësirë më të madhe sa i përket kësaj - çështja e minierave.

Më duhet shkurtimit të ndalem edhe te projektet e energjisë. Më vjen mirë që një pjesë e atyre projekteve janë duke vazhduar, edhe pse disa nga ato projekte të cilat janë vendosur, shoh se janë projekte të prodhimit të energjisë nga era, sikur që e përmendi edhe Kryeministri, dhe për disa prodhime të tjera dhe shohim se nga të gjitha analizat që janë bërë deri tani -janë dalë joprofitabile dhe jo të mundshme.

Kemi një sektor shumë të rëndësishëm, është pasuria në fushën e linjitit. Do të ftoj Kryetarin dhe do të ftoj Kryeministrin që të vazhdojnë strategjinë e aprovuar nga ky Parlament i Kosovës, siç është strategjia për zhvillimin e sektorit të energjisë, posaçërisht i zhvillimit të Projektit “Kosova C”. Mund të thuhet dhe flitet, por janë katër konzorciume më të mëdha botërore të cilat janë në këto gara të këtij projekti dhe nuk do të dëshirojmë që ky sektor vital zhvillimor për ekonominë e Kosovës të parcializohet përmes sektorëve apo përmes “A-1” dhe “A-2” por të shkohet sipas projekteve të cilat janë të planifikuara.

Ne mbështesim edhe Qeverinë që ka paraparë të hyjë kapitali privat në KEK, mirëpo duhet të shohim këtë, sepse nuk është më problemi se nuk kemi kapacitete gjeneruese në blloqet e “Kosovës A” dhe “B”. Problemi i parë dhe thelbësor qëndron në mungesë të linjitit apo të mundësive për t’i furnizuar blloqet me thëngjill. Prandaj, në radhë të parë, na nevojitet që ta përshpejtojmë çështjen e hapjes së minierës së re të Sibovcit, rehabilitimin e eskavatorëve, çështjen e hapjes së minierës së Sitnicës.

Unë shoh se aty, kur flitet për dhënien në koncesion për Bardhin dhe Mirashin, besoj është bërë gabim teknik, sepse janë dy miniera të shpenzuara dhe nuk kemi kujt t’ia japim me koncesion ato dy miniera, por ato janë në Program nga Banka Botërore i cili parasheh të rehabilitohen ato dy struktura të minierës së Bardhit dhe Mirashit dhe duke u hapur miniera e Sibovcit ato - dy gropa të mëdha që janë lënë me dekada të tëra - të rinovohen dhe kthehen.

Më vjen keq, ndoshta këtë strategji të energjisë nuk e kanë diskutuar më thellë apo në mënyrë më analitike edhe njerëzit e Ministrisë, sepse nuk besoj që do të kishte dalë një gabim i tillë kur thuhet: të jepen me koncesion minierat e Bardhit dhe Mirashit.

Problemi tjetër është se ne na nevojitet edhe privatizimi apo hyrja e kapitalit privat në një sasi të caktuar sa i përket çështjes së distribucionit. Prandaj, këto do të ishin disa nga veprimet të cilat duhet t’i marrë Qeveria që të mund të arrijë të tejkalojë situatën relativisht të vështirë që ka të bëjë me energjinë dhe posaçërisht të rikthehet sektori i energjisë në një sektor profitabil.

E vetmja mundësi të rikthimit të sektorit në profitabil është që të kyçet edhe sektori privat, të vazhdohet projekti “Kosova C”, të rehabilitohen sa më shpejt eskavatorët dhe gradualisht të hyhet në konceptin për të përmbyllur dhënien e mjeteve buxhetore nga ana e Qeverisë.

Edhe njëherë, sa i përket të gjitha mundësive tona, ne do t’i mbështesim, mirëpo shoh se Qeveria dhe në këtë rast institucionet përkatëse i lë larg sektorit dhe njohjen e problematikës në sektorin e energjisë.

Edhe një kërkesë, e fundit, është që të bëhen raportet e mira me institucionet ndërkombëtare, posaçërisht me USAID-in, Bankën Botërore dhe me Komisionin Evropian që kanë qenë sponzor kryesor dhe përkrahës kryesor të projekteve të energjisë.

Kryetar, faleminderit për fjalën që më dhatë, edhe pse, them e kam kërkuar fjalën që nga fillimi, por e keni shtyrë.

KRYETARI: Mua më vjen keq, por duhet të them se s'është e vërtetë.

E ke marrë fjalën para kohe. Këtë e them me bindje të plotë, mund të vish këtu e të shohësh radhën, përndryshe unë jam duke bërë një renditje mbi bazë edhe të Rregullores, por duke favorizuar opozitën. Andaj, nuk është mirë të flitet përmendësh.

Urdhëro, është lista. Eja shikoje listën e djeshme dhe s'je askund këtu. Urdhëro! Ethem Çeku e ka fjalën.

ETHEM ÇEKU: Unë për këtë, e pashë listën. Pas Driton Talit kam qenë. Sido që të jetë, unë kam prapë konsideratë dhe të respektoj për udhëheqjen që je duke e bërë.

KRYETARI: Jemi duke punuar me listën e së premtes dhe në renditje je i favorizuar, jo vetëm ti, por të gjithë nga opozita. Ndoshta keni të drejtë, sepse i kam kapërcyer rendet - në favor tuajin. Fjalën e ka Naser Rugova, le të përgatitet deputetja Zylfije Hundozi.

NASER RUGOVA: Faleminderit, zoti Kryetar!

Zotëri zëvendëskryeministra, anëtarë të kabinetit qeveritar,

Të çmuar kolegë deputetë,

Më në fund Qeveria e vendit, pas 100 ditëve nga formimi i saj, sjell Programin e vet të punës para deputetëve të Kuvendit të Kosovës. Është lajm i mirë ky për qytetarët dhe për deputetët.

Qytetari i thjeshtë, i cilitdo shtet evropian do të pyeste: Vallë, ko qeveri nuk ka pasur program të punës që nga dita kur e ka marrë mandatin qeverisës? Përgjigja do të ishte: Ky është mentaliteti i qeverisjes në Ballkan!

Kemi para veti një Program qeveritar, të hartuar në mënyrë shumë sipërfaqësore dhe me gabime të shumta gjuhësore. Së paku është dashur të lekturohet si duhet, sepse kemi emra nga bota akademike në Qeveri.

Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2008-2011 do të tingëllonte bukur, por si duket, zotërinj qeveritarë, nuk e paskeni të qartë që statusi i Kosovës dhe bërja e Kosovës shtet del nga dokumenti gjithëpërfshirës i Ahtisarit në të cilin thuhet në mënyrë recidive se: pas fazës së tranzicionit – 9 muaj, do të thotë kur fillon faza e tranzicionit, brenda kësaj kohe duhet të organizohen zgjedhje të reja në Kosovë. Le të shpresojmë se fazat e tranzicionit për Kosovën nuk do të zgjasin deri në fund të vitit 2011.

Kemi para veti një Program qeveritar me 56 faqe, ku për 50% të tij, kemi përshkrime dhe konstatime të gjendjes. Një pjesë e këtij Programi për shumë sektorë është marrë nga strategjia zhvillimore e qeverisë së kaluar. Objektivat kryesore të Qeverisë: Asgjë e re nga angazhimet e qeverive të mëparshme.

Ky Program më shumë i ngjanë një programi të dobët partiak sesa një programi qeveritar. Shumë më të mirë e keni pasur programin kur keni qenë “nën hije” sesa ky program që iu ofrohet tani qytetarëve dhe deputetëve të Parlamentit të Republikës së Kosovës. Është me

objektiva të përgjithësuara, po them, pa plan të veprimit konkret dhe pa filozofi zhvillimore shtetërore nacionale.

Po e citoj Programin:

“Rritja ekonomike do të realizohet përmes intensifikimit të investimeve, privatizimit të mëtejshëm dhe ristrukturimit të ndërmarrjeve publike, shtimit të aftësisë konkurruese të ekonomisë dhe rritjes së eksportit”.

Si do t’i arrini këto objektiva? Me çfarë mekanizmash? Nuk ceket në këtë program dhe, cila është dinamika kohore e jetësimit të këtyre objektivave.

Te energjia dhe minierat. Ja disa nga synimet kryesore të Qeverisë në këtë sektor:

“Vazhdimi i reformimit dhe ristrukturimit për ta bërë sektorin energjetik të qëndrueshëm dhe financiarisht atraktiv për investime”.

Si, kur dhe me çfarë masash do ta arrini këtë?

Po citoj, te strategjia:

“Është ndarë në objektivat zhvillimore afatshkurta dhe afatgjatë”. Po citoj, “Skenar zhvillimor afatgjatë është, për shembull, ndërtimi i Termocentralit të ri “Kosova C” dhe eksporti eventual i energjisë elektrike”.

Të nderuar qeveritar, Qeveria nuk merr shembuj, por cakton objektiva dhe i jetëson ato. Ky është shembulli më i mirë që tregon se nuk keni vizion të qartë për zgjidhjen e krizës energjetike në vend. Kur në një sektor shpallet krizë nacionale, atëherë duhet të ekzistojnë objektivat, dinamika kohore dhe mekanizmat për zgjidhjen e asaj krize.

“Në afat të shkurtër”, po citoj: “Qeveria do të gjejë format më të përshtatshme për të privatizuar KEK-un përmes një procesi transparent, mirë të menaxhueshëm që do të sjellë përfitime të shumëfishta Kosovës”. Cilat janë këto forma të përshtatshme, nuk ceken. Kur parashihet të ndodhë kjo? Cilat janë benefitet? Ky program qeveritar nuk ka përgjigje në këto dilema të mëdha për qytetarët e Kosovës.

“Implementimi i kësaj strategjie”, po citoj: “do t’iu ndihmojë qytetarëve dhe bizneseve në Kosovë për të pasur furnizim të vazhdueshëm me energji elektrike brenda 9 deri 15 muaj”. Kjo, do të thotë - edhe 15 muaj terr për Kosovën.

Çka keni bërë rreth “planit A,B,C”, të nderuar qeveritarë? Sigurisht, asgjë dhe ende nuk e keni të qartë se si do të orientoheni.

Kam një pyetje për Qeverinë: A do ta fillojë Qeveria ndërtimin e “Termocentralit Kosova C” me kapacitet 2100 megavate? Nëse po, gjë që nuk thuhet në mënyrë të prerë në këtë program, kur dhe pse nuk po procedohet me këtë projekt kur dihet se nuk ka zgjidhje tjetër për të dalë nga kjo situatë. Sidomos, jo deri në vitin 2011, me këtë çka po shohim në këtë program.

Sa iu takon minierave, sektorit minerar? S’përmendet Trepça askund dhe po ashtu as pellgjet e linjitit në Rrafshin e Dukagjinit, kur dihen kapacitetet që janë të studiuara dhe janë të licencuara ato studime, e që s’i keni cekur fare.

Mos të harrojmë se, atje diku, gjenden me miliarda ton linjit, shumë kualitativ që do të ishte për një zgjidhje shumë adekuate në aspektin e energjisë në nivel nacional.

Te bujqësia dhe zhvillimi rural. Po citoj: “Që të gjitha këto objektiva” – domethënë, që përmenden për zhvillimin e bujqësisë, agrobizneset e tjera”, të gjitha janë kopjuar nga Plan i zhvillimor rural dhe bujqësor 2007-2013 të qeverisë së kaluar.

Zoti zëvendëskryeministër, duke parë se nuk keni dhënë një koncept konkret të zhvillimit të bujqësisë që do ta ulte shkallën e varfërisë dhe të papunësisë në vend, nuk keni cekur as se si do të subvencionohet agrobiznesi dhe bujqësia.

Po ju propozoj idenë për themelimin e bankës agrare që do të ishte ndihmë e madhe për agrobiznesin në Kosovë. Përndryshe, forma tjera, nuk ekzistojnë.

Zbutja e varfërisë dhe stabilitetit social.- Duke ditur gjendjen e rëndë sociale dhe shkallën e varfërisë në Kosovë, objektivat e këtij programi jo që janë joprofesionale dhe të zbehta, por nuk përkojnë fare me realitetin e jetës në Kosovë.

Po citoj, te sistemi pensional: “Vazhdim i sigurimit të pagesave të pensioneve”. Ju lutem, këtë e keni obligim dhe këtu nuk parashihet asgjë konkrete për ngritjen e cilësisë së jetës të kësaj kategorie të përbuzur të shoqërisë sonë.

Shëndetësia.- Ministri i shëndetësisë ka deklaruar se me këtë buxhet mund të përmbushen vetëm 30% të nevojave të qytetarëve të vendit. Po citoj: “Qeveria do të angazhohet të aplikojë Ligjin e sigurimeve shëndetësore dhe do të përshtatet me mundësitë reale të implementimit”. Si? Cilat janë format dhe kur pritet të ndodhë kjo?

Synimet kryesore të sektorit të shëndetësisë, edhe pse ministri ka një qasje shumë moderne dhe tjetër fare nga ministrat e qeverive të kaluara, në këtë program duke ditur gjendjen tejte të rëndë të sistemit shëndetësor, kam drojë se do të mbesin vetëm dëshirat e mira.

Në këtë program nuk vërejta objektiva të qarta për zhvillimin dhe avancimin e shërbimeve të reja shëndetësore, sidomos të nivelit të kujdesit tretësor. Për tre vjetët e ardhshëm, pacientët kosovarë, do të drejtohen jashtë Kosovës për shërim, sidomos për rastet e sëmundjes së lëmisë së kardiokirurgjisë, onkologjisë, hematologjisë, neurokirurgjisë dhe lëmvive të tjera dhe do të shpenzojnë shuma të mëdha, sepse shteti i tyre, nuk është në gjendje t’u afrojë përkuqjesje shëndetësore normale.

Kultura, rinia dhe sporti.- Gjendja, në të cilën është kultura dhe institucionet kulturore në vendin tonë, është më tepër se dëshpëruese. Në të njëjtën situatë ndodhet rinia dhe sporti.

Bazuar në këtë program qeveritar, komuniteti i artistëve, rinia dhe sportistët do të përballen edhe për një kohë të gjatë me të njëjtën situatë të vështirë.

Po citoj programin: “Projektet kapitale, si teatri dhe opera, muzeu i artit bashkëkohor janë në përfundim e sipër dhe do të prezantohen edhe në Konferencën e donatorëve e cila do të organizohet nga Qeveria e Kosovës”.

Unë e kam një pyetje, zoti zëvendëskryeministër:

Nëse nuk financohen nga Konferenca e donatorëve këto projekte, cila është zgjidhja? Do të mbesin artistët prapë në mëshirën e fatit? A i ngjanë programit qeveritar ky konstatim?

Ndërkombëtarizimi dhe infrastruktura e sportit.- Fatkeqësisht nuk është bërë asnjë hap konkret në këtë drejtim.

Zoti zëvendëskryeministër, ministri i kulturës do të marrë së shpejti Ministrinë e Punëve të Jashtme. Çfarë ka bërë ministri dhe Qeveria për ndërkombëtarizimin e sportit që nga 17 shkurti i këtij viti? Të gjithë e dimë! Asgjë! Komiteti olimpik dhe federatat kanë bërë dhe po bëjnë përpjekje individuale, pa një koordinim konkret dhe mbështetje institucionale.

Të shpresojmë se diplomacia kosovare nuk do ta përjetojë të njëjtin fat.

Dhe, për fund, ky program ka nevojë që të rishqyrtohet në detaje. Ftoni ekspertë të mirëfilltë, zoti zëvendëskryeministër. Bëni ndryshime më të duhura. Hartoni projekte konkrete fizibile që përkojnë me nevoja të shumta të qytetarëve të vendit tonë. Konferenca e donatorëve është shumë afër dhe ne nuk presim zgjidhje të problemeve jetike nga Konferenca e donatorëve. Po dështuat me projekte të dobëta, pasojat do të jenë të mëdha - për të gjithë qytetarët dhe për vendin tonë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit për fjalën! Fjalën e ka deputetja Zylfije Hundozi, le të përgatitet deputeti Haredin Hyseni.

ZYLFIJE HUNDOZI: Zoti Kryetar,
Zoti zëvendësministër, ministra,
Deputetë të nderuar,

Të na ishte prezantuar ky program 100 ditë më herët, atëherë kur është dashur, me siguri do të gjenim edhe arsye t'ju kuptojmë se nuk keni pasur kohë ta shkruani ashtu si duhet. E bini tash, 100 ditë më vonë, kështu në këtë formë si e keni shkruar – është e pafalshme, dhe sidomos sot kur sytë e të gjithë qytetarëve të Kosovës, po edhe të krejt botës, janë të drejtuar nga ne dhe Qeveria.

Këtë material, që na e keni dhënë, e që e quani Program, paraqet një grumbull tezash të parashtruara sipas ministrive që në realitet në të nuk thuhet se kur e çka do të bëhet, kur do të kryhet dhe si do të bëhet.

Ne si opozitë, por jo vetëm ne si opozitë, por edhe deputetët e pozitës, nuk do të jemi në gjendje ta kryejmë atë rolin dhe punën tonë që kemi këtu si deputetë të Kuvendit të Kosovës dhe ta kontrollojmë punën e Qeverisë dhe që do të ishte për të mirën e të gjithë qytetarëve të Kosovës.

Unë do të ndalem sot në Programin lidhur me punën dhe mirëqenien e shëndetësisë. Për programin e punës dhe mirëqenies sociale, mund të them, kanë mund me një fjalë ta shkruajnë se do të vazhdojnë punën e Qeverisë së mëhershme, sepse është program i njëjtë, faktikisht. Ndërsa, për pensionet, ajo çfarë është më dëshpëruese, është se gjatë fushatës parazgjedhore është premtuar shumë se ato do të rriten. Është aty një fjali, të cilën s'e kam mbajtur në mend përmendësh – se “do të gjenden mjete të cilat do t'i përshtaten shportës së ushqimit”. Po shporta qysh sot është rritur për 20%, pensionet kanë mbetur të njëjta dhe nuk gjendet e përshkruar në këtë program alternativë se si do të gjenden të hollat për t'u rritur pensionet.

Edhe herën e parë, në mandatin e parë, kur është caktuar vlera prej 25 eurove, është thënë se u caktua në bazë të shportës, por në realitet shporta 100 herë ka qenë më e lartë se 25 eurot e atëhershëm.

Sikur Qeveria ta kishte shkruar në Program se do ta bëjë ligjin për pensione, me siguri se do të ishte shumë më shpresëdhënëse për pensionistët edhe për ne, sepse atëherë do të dimë që diçka me të vërtetë dhe konkretisht do të bëhet. Mirëpo, askund nuk përmendet se tash për tash është Trusti për pensione.

Sa i përket shëndetësisë, në Programin e Qeverisë për shëndetësi premtohet krijimi i një sistemi të qëndrueshëm financiar i cili është paraparë qysh me Ligjin për shëndetësi në vitin 2004 dhe që nuk paraqet kjo kurrfarë risie. Kuptohet se të gjithë qytetarët dhe punëtorët shëndetësorë, por edhe qeveritarët, e dinë se financimi vetëm nga buxheti i konsoliduar i Kosovës nuk është i mjaftueshëm. Këtë, praktika e ka treguar.

Prandaj, duhet ditur se, vetëm financimi i mangët nuk është problemi kryesor por është edhe keqmenaxhimi.

Pas luftës kanë ardhur mijëra e mijëra marka, atëherë, por edhe euro dhe ndihma materiale, ndihma materialshpenzuese, barna e tjera, por ato krejt tani janë zhdukur. Domethënë, shëndetësia ka qenë si një pus pa fund ku vazhdimisht janë derdhur mjete por kinse s'dihet ku kanë shkuar. Po zotëri, të gjithë e dimë ku kanë shkuar ato mjete – janë keqmenaxhuar dhe deri më sot për atë punë nuk ka dhënë askush përgjegjësi.

Njëri prej konstatimeve, në realitet të definimit të problemit në shëndetësi, është edhe premtimi se do të bëhen sigurimet shëndetësore. Në mandatin e kaluar ka kaluar nëpër këtë Kuvend Ligji për sigurime shëndetësore, dy herë. Aty faktikisht është gjetur ku janë gabimet dhe për 100 ditë Ministria e Shëndetësisë, e tashme, ka mund t'i zgjidhë ato probleme, sepse veç janë të definuara dhe e vërteta është se Ligji për sigurime shëndetësore ka ardhur ndesh me Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe ju keni mund të inicioni - ose ndërrimin e ligjit ose të gjeni arsye tjetër, për shembull: një vijë të posaçme buxhetore që të krijohet fondi i sigurimeve shëndetësore. Kjo do të thotë se është më mirë qytetarëve t'u ndahen prej rrogave nga 2 euro sesa, kur të sëmuret ndokush i familjes, t'iu shkojnë 2 mijë a 3 mijë euro dhe faktikisht familjet e varfra do të bankrotojnë kur t'iu sëmuret ndokush. Këtë e kemi realitet dhe unë për çdo ditë jam atje në Qendrën Klinike Universitare, që punojë aty.

Mendoj po ashtu se, edhe sikur të ishin bërë llogaritë adekuate prej ekspertëve financiar që i kanë Ministria e Financave dhe Ministria e Shëndetësisë, ndoshta kishte për t'u gjetur ndonjë zgjidhje adekuate për të parë se si do të bëhet ai fond.

Edhe një çështje, shumë me rëndësi, se pse nuk po funksionon shëndetësia ashtu si duhet - janë pagat shumë të ulëta. Ju e dini që, njeriu për të punuar, duhet të ketë motiv. Motivi kryesor i punëtorëve shëndetësorë përnjëmend është humanizmi, por ai nuk hahet. Duhet punëtorët shëndetësorë të kenë për të hëngër bukë dhe të paguhen për atë punë, shumë të rëndë, që e bëjnë dhe për edukimin superior që e kanë. Ata, përkundrazi, me këto rroga, janë të përbuzur.

Dhe tjetra, shumë me rëndësi për shëndetësinë është se qysh në vitin 2004, është dhënë strategjia e shëndetësisë për vitin 2005-2015, ku potencohet rëndësia e sistemit

informativ në shëndetësi. Ai sistem, ka dështuar deri më sot dhe tani mendoj se për 100 ditë ende asgjë nuk është bërë. Ju keni pasur vetëm t'i përmirësoni disa gabime këtu, kështu që atë nuk e keni bërë, kurse në Qendrën Klinike Universitare ende shkruhet me dorë, kurse konsiderohet se është Qendra më prestigjioze shëndetësore në Kosovë.

Zoti Ministër, kur mjetet e informimit ju bombardojnë vazhdimisht për gjendjen në shëndetësi, kuptohet se sistemi informativ ka dështuar, gjegjësisht informatat nga terreni ose vijnë ose nuk vijnë fare te ju dhe ju nuk jeni në gjendje ta testoni realitetin në shëndetësi. Informatat për punën e çdo resursi shëndetësor kishim për t'i marrë gjatë hapjes së kompjuterit me aktivizimin e programit adekuat.

Këto që i keni shkruar, dëshiroj t'i realizoni dhe të gjithë së bashku të punojmë për të mirën e qytetarëve të Kosovës. Opozita nuk ka asgjë kundër Qeverisë, por përkundrazi ne do t'ju përkrahim dhe, sa më mirë që punoni, do të keni edhe përkrahjen tonë, për të mirën e të gjithëve. Faleminderit!

KRYETAR: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Haredin Hyseni, le të bëhet gati deputeti Adem Salihaj.

HAREDIN HYSENI: Faleminderit zoti Kryetar!

I nderuari zëvendëskryeministër, ministra të pranishëm,
Të nderuar deputetë,

Përpara veti kemi në shqyrtim Programin e Qeverisë, një Program i cili synon që me politikën e vet ta drejtojë Kosovën për një zhvillim ekonomik dhe integrim Evropian, pas një faze të suksesshme menaxhuese për 100-ditëshin që po e lëmë pas, një fazë e cila bartte rreziqet e veta duke pasur parasysh çastet vendimtare nëpër të cilat kalonte Kosova.

Një nga parakushtet që një Qeveri të jetë demokratike, është transparenca para qytetarëve të saj. Ky element demokratik e bën një qeveri që të jetë e kontrollueshme në primet e saj dhe të sillet konform normave dhe ligjeve demokratike në fuqi, për çka është e obligueshme para qytetarëve të saj.

Duke pasur parasysh këtë element, unë përgëzoj Qeverinë për praktikën e futur në Kosovë që mbledhjet e kabinetit të saj të jenë transparente para qytetarëve dhe mediave, që mediat të jenë prezent në ato mbledhje dhe vendimet e puna e Qeverisë të mund të kuptohet, përcillet dhe vlerësohet nga qytetarët. Një praktikë e tillë ishte shumë e nevojshme dhe e domosdoshme që ekzekutivi dhe puna e tij të dilte në dritë dhe qytetarët të jenë të informuar për punën e jo, si më parë, kur qytetarët njoftoheshin vetëm nga zëdhënësit e saj për atë që duhej ditur. Një transparencë e tillë ka bërë që qytetari sot të është i informuar për punën dhe angazhimin që e ka bërë Qeveria dhe kabineti i saj në 100-ditëshin e parë, për synimet e saj në të ardhmen dhe realizimin e atyre synimeve.

Vendimi i Qeverisë për reduktimin edhe të telefonatave të panevojshme, makinave e karburanteve – ka bërë që qytetarëve t'u rikthehen shpresat se, më në fund, kemi një Qeveri që është e përgjegjshme për veprimet e veta dhe për shpenzimet buxhetit të konsoliduar të Kosovës.

Një element tjetër, që e përcakton suksesin e një qeverie, është aftësia e saj menaxhuese dhe tejkalimi i sfidave me të cilat përballlet.

Duke pasur parasysh se para dhe pas shpalljes së pavarësisë Kosova po përballëj me provokime, si ato në kufij, që dëshirohej ta destabilizonin atë dhe të krijonin anarki për të krijuar terren të përshtatshëm për ta sfiduar pavarësinë e saj, veprimi i matur dhe dinamik i Qeverisë dhe institucioneve të saj, koordinimi i saj me faktorin ndërkombëtar – tregoi se ajo është e aftë të menaxhojë këto kriza dhe t'i tejkalojë ato për t'i kthyer në të mirë të të përgjithshmes.

Një nga detyrat më të shenjta të një qeverie është siguria e vendit dhe e qytetarëve të saj, për çka mendoj se, në këtë fazë, këtë detyrë Qeveria dhe institucionet e saj e kanë kaluar me sukses.

Të nderuar deputetë,

Një nga detyrat e vazhdueshme të një qeverie, është zhvillimi ekonomik dhe mirëqenia e qytetarët të saj. Të gjithë jemi të vetëdijshëm se me çfarë gjendje përballë Kosova në këtë fazë të saj: me papunësi të lartë dhe varfëri. Për dalje nga kjo gjendje përpos Programit qeverisës duhet ballafaquim konkret me disa fenomene që e pengojnë këtë zhvillim, si korrupsioni, shpërdorimi i detyrës – fenomene që kjo Qeveri ka filluar t'i godasë që në ditët e para dhe ne duhet ta mbështesim e përkrahim Qeverinë në realizimin e kësaj detyre, shumë të rëndësishme për të ardhmen tonë.

Unë besoj se ky program, që po e shqyrtojmë sot, duke bërë analogji me punën e Qeverisë në këtë 100-ditësh, tregon se kjo Qeveri me veprimin e saj si në arsim, ku kemi fillim të mbarë të ndërtimit të dhjetëra shkollave, si në infrastrukturë rrugore, autostrada dhe rrugë në komuna e në fusha të tjera, po krijon kushte të mira për një progres të vazhdueshëm. Këtë bindje e sforcon veprimi qeveritar në ruajtjen e buxhetit të konsoliduar të Kosovës, shfrytëzimin e tij si dhe krijimin e besimit dhe ambientit që po krijon për investitorët e brendshëm dhe të huaj.

Të nderuar deputetë,

Tani nuk shtrohen rrugë siç ishte praktikë vetëm nga vinte ministri, për ta regjionalizuar Kosovën dhe duke krijuar një debalans, që po e trashëgon kjo Qeveri si një pengesë në zhvillimin e gjithmbarshëm të Kosovës, por kjo Qeveri është e ndërgjegjshme për besimin që ka marrë nga të gjithë qytetarët e Kosovës dhe këtë obligim e ka para të gjithë qytetarëve.

Zonja dhe zotërinj,

Veprimi dhe përmbushja e obligimeve ndaj qytetarit është programi më i mirë i një qeverie që dëshiron të jetë e suksesshme dhe jo programi i bukur pa mundësi realizimi. Unë besoj se kjo Qeveri është koshiente për besimin e dhënë dhe me punën e saj do ta arsyetojë këtë besim ndaj qytetarëve. Realizimi i premtimit dhe programi shpesh ngatërrohen me 100-ditëshin. 100-ditëshi është fillim i realizimit të këtyre premtimeve dhe kjo Qeveri është në rrugë të mirë të realizimit të këtyre premtimeve për çka duhet ta mbështesim e jo ta ngatërrojmë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka Adem Salihaj, le të përgatitet Kaqusha Jashari.

ADEM SALIHAI: Zoti Kryetar,

Anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Kolegë deputetë,

Në këtë seancë u ballafaquam me një situatë interesante, e cila, siç duket, do të mund të na përcjell gjatë tërë mandatit tonë. Tërë kohën kërkuam dhe pritëm nga Qeveria që ta

paraqet para nesh programin e saj të punës në mënyrë që sot, kur janë mbushur 100 ditë të punës së saj, ne ta bëjmë një vlerësim të asaj pune.

Ne morëm një material nga Qeveria, por edhe Kryeministri edhe Kryetari i Parlamentit janë plotësisht konfuz dhe kundërtshënës. Kryetari i Parlamentit thotë se është informatë, në material shkruan raport për debat, kurse vetë Kryeministri, i cili e ka nënshkruar këtë raport - thotë se është informatë.

E vërteta mund të jetë se Kryeministri nuk e ka shikuar as titullin e materialit dhe nuk e din çka ka nënshkruar. E kur nuk di çka ka nënshkruar, të mos flasim se a e di çka ka punuar Qeveria.

Këtë e ilustron edhe një fakt shumë interesant. Ose Kryeministri ose Kryetari i Kosovës nuk e dinë ende sa shtete e kanë pranuar Kosovën, sepse Kryeministri para pak ditësh tha se e kanë pranuar 28 shtete, Kryetari i Kosovës tha, në seancën që e filluam 37 shtete, kurse Kryeministri e tha rreth 40 shtete. Pra, të thuhet rreth 40 shtete, thotë vetëm ai që s'është i sigurt saktësisht sa shtete e kanë pranuar Kosovën. Pra, nuk e din numrin e saktë, e nëse nuk e din, atëherë kjo tregon se sa është ai i përkushtuar por edhe i interesuar realisht për këtë proces shumë të rëndësishëm për shtetin e Kosovës.

Unë, së pari, nuk e kuptoj frikën e madhe të kësaj Qeverie dhe mungesën e guximit që të na japë së pari një informatë - apo raport, si të doni quani, me shkrim së paku 2-3 ditë para kësaj seance të Parlamentit. Vetë ky fakt tregon se kjo Qeveri, po e ndien veten ngushtë për mungesën e deritashme të programit dhe për punën e pamjaftueshme që ka bërë gjatë këtij 100-ditëshi.

Në anën tjetër, këtë bindje e forcon edhe më tepër fakti se brenda kësaj seance ishte paraparë njëkohësisht paraqitja e kryetarit të Kosovës dhe dy herë paraqitja e Kryeministrit që mund të nënkuptohet se janë bërë përpjekje që sa më tepër të shpërqendrohet vëmendja dhe të kemi sa më pak hapësirë për diskutim.

KRYETARI: Ju lutem, në rend dite është Programi qeverisës!

ADEM SALIHAI: Unë nuk mund ta kuptoj një frikë kaq të madhe të koalicionit qeverisës, por unë mund t'ju siguroj se efektet e përpjekjeve tuaja do të jenë të kundërta me atë që i keni paraparë.

Si do ta vlerësojmë sot punën 100-ditëshe të Qeverisë kur nuk kemi pasur para veti as programin as synimet e saj. Aspektet e zhvillimit dhe të punës mund të vlerësohen në bazë të asaj se çka është planifikuar dhe çka është arritur. Pra, ne nuk kishim parametra dhe nuk dimë si do ta krahasojmë këtë punë që është bërë deri tash.

Vetë mungesa e deritashme e një programi të punës tregon mospunën dhe mosefikasitetin e kësaj Qeverie. Megjithatë, duhet theksuar se kjo Qeveri ka ndërmarrë disa veprime në kufizimin e shpenzimeve të tepëra të dikasterëve të saj dhe unë dëshiroj ta përshëndes për këta hapa pozitiv. Por, i gjithë ky angazhim dhe kjo vetëreklamë para ekraneve televizive, nuk ishte aspekti kryesor dhe më i rëndësishëm i punës së Qeverisë.

Kjo Qeveri i la plotësisht anash aspektet kryesore të punës dhe u dha pas improvizimeve të rastit dhe si pasojë u ballafaqua me dështimet e para të mëdha, veçanërisht me furnizimin me energji elektrike si njërin ndër problemet më të mëdha në Kosovë. Prej një situatë të keqe të furnizimit me energji elektrike, kjo Qeveri e solli Kosovën në një krizë

nacionale të energjisë, ku më nuk vlen asnjë rregull dhe askush më nuk di kur do të kemi e kur nuk do të kemi energji elektrike.

Kryeministri u gëzua, si duket, për këtë krizë dhe me shpresë se mos ndoshta kjo situatë do t'ia mundësonte që ta ndërronte menaxhmentin e KEK-ut jo për ta përmirësuar situatën, por për t'i vendosur njerëzit e tij atje, sepse priten investime të mëdha në energji elektrike dhe Kryeministri duhet t'i ketë atje njerëzit e tij kur të vijnë këto investime. Ujku, thonë, do mjegull, dhe si duket Kryeministri dhe Qeveria vetë po krijojnë mjegull për të përfituar nga kjo. Në këtë rast, pra Kryeministrit dhe Qeverisë, ndoshta po iu duhet terri, sepse në terr mund të kryhen më lehtë disa punë.

Gjatë kësaj periudhe Qeveria paraqiti para nesh strategjinë legislative, duke dashur të na tregojë se sa shumë e ka ndërmend të punojë në hartimin e ligjeve të reja. Ky ishte një projekt shumë ambicioz, në të cilin, afro gjysma e ligjeve, janë të hartuara nga qeveria e mëparshme. Pra, nuk janë rezultat i punës së kësaj Qeverie. Kjo tregon se kjo Qeveri nuk po krijon të arritura me punën e saj, por po konsumon punën e tjerëve. A është kjo pasojë e paaftësisë së kësaj Qeverie për të punuar apo është diçka tjetër – këtë do ta shohim në proces. Jam i bindur se ky komoditet, kaq i madh, do t'i kushtojë shumë kësaj Qeverie por edhe vetë Kosovës dhe zhvillimit të saj.

Kosova, gjatë kësaj periudhe 100-ditëshe, shpalli pavarësinë e saj, u bë me flamur dhe me Kushtetutë. Besoj se kjo Qeveri nuk pretendon se e solli pavarësinë e Kosovës vetëm brenda pak ditësh të punës së saj. Pavarësia ishte rezultat i punës, angazhimit dhe sakrificës së madhe të shumë gjeneratave dhe ne jemi shumë të lumtur që patëm fatin të jemi pjesë e këtij procesi dhe e kësaj aspirate të madhe.

Mirëpo, unë dëshiroj ta shpreh brengosjen time lidhur me mënyrën se si u vendos për flamurin e Kosovës dhe lehtësinë e madhe të këtij koalicioni qeverisës në braktisjen dhe mungesën totale të përpjekjeve të tyre për ta ruajtur së paku ndonjë element të simbolit tonë kombëtar.

Ne jemi dëshmitarë të shkëlqimit brutal të një simboli, të cilin e respektonte një pjesë e madhe e popullatës së Kosovës. Ky shkëlqim primitiv u bë në emër të asaj se ne kemi flamurin kombëtar dhe se ai do të jetë simbol i Kosovës. Unë nuk do ta shkelmoj asnjë simbol të asnjë personi e lëre më të një simboli të përdorur nga Presidenti i Kosovës - doktor Ibrahim Rugova.

Pyetja është se çfarë bëri kjo parti politike për ta ruajtur vërtet këtë simbol. Sa ishin përpjekjet e saj që ai, ose ndonjë element i tij, të jetë simbol i shtetit të ri të Kosovës. Pra, asnjë përpjekje e vetme, asnjë fjalë e vetme në mbrojtje të tij, por një injorim total dhe harresë totale historike. PDK-ja nuk duhet të mendojë se këtij populli i është fshirë kujtesa historike dhe se ai nuk mban mend asgjë se çfarë ka ndodhur në të kaluarën e afërt dhe kjo, zotëri, është në kuadër të rendit të ditës sepse bën pjesë në 100-ditëshin e Qeverisë.

Shpresoj shumë se kjo Qeveri, në të ardhmen, do të jetë shumë më e përgjegjshme dhe nuk do të na vë as ne, as Kosovën para sfidave të tilla, siç na ka vënë deri tash.

Të nderuar kolegë deputetë,

Me Rregulloren e Punës të Kuvendit, siç dihet, parashihet që më së largu 15 ditë pas formimit të Qeverisë ajo të paraqesë programin e saj të punës. Sot është data 21 prill,

kurse prej datës 9 janar, kur është formuar Qeveria kanë kaluar 100 ditë dhe ne sot diskutuam për informatën e 100-ditëshit të punës së Qeverisë, kurse nuk e kishim ende programin e punës së saj. Kjo tregon se kjo Qeveri ka një komoditet të tepruar dhe nuk brengoset fare për shkeljen e Rregullores së Punës së Kuvendit, nuk brengoset dhe nuk ndjen përgjegjësi të duhur as para qytetarëve e bile as para anëtarëve të vetë partive që janë në koalicion qeverisës.

Fakti se kanë bërë koalicion dy partitë më të mëdha dhe se votat mund t'i kenë të sigurt në Kuvend edhe nëse nuk punojnë mirë e me ndërgjegje, e bën këtë koalicion qeverisës jo mjaft të përgjegjshëm dhe i lejon një komoditet të tepruar.

Cili është programi që e kemi sot para nesh këtu në Kuvend? Qeveria ka paraqitur një program pune për katër vitet e ardhshme, pra për vitet 2008-2011. Pyetja është se, a e ka mandatin kjo Qeveri për katër vjet apo vetëm deri në zgjedhjet e ardhshme, të cilat, sipas propozimit gjithëpërfshirës të Presidentit Ahtisari, duhet të mbahen 6 deri në 9 muaj nga dita e definimit të statusit të Kosovës pra, në këtë rast, nga dita e shpalljes së pavarësisë së Kosovës.

Vetë paraqitja e këtij programi për katër vjet, tregon se kjo Qeveri dhe ky koalicion qeverisës nuk kanë ndërmend t'i përmbahen këtij plani. Nuk e kanë ndërmend t'i përmbahen këtij plani kur janë në pyetje interesat e ngushta personale e partiake dhe lakmia për të qenë në pushtet.

(Ndërprerje nga regjia – tejkalohet koha e paraparë për diskutim)

(Në vijim jepet teksti i pjesës së mbetur të diskutimit të A.Salihaj, i dorëzuar me shkrim)

Në rastet tjera, po e zëmë, kur është në pyetje dëmtimi i interesave të mëdha nacionale, siç e theksova, dhe kur Maqedonisë duhet t'i jepen 2.500 hektarë të tokës së Kosovës ose të ndahet Mitrovica, atëherë Kryeministri këtu para Kuvendit thotë se do të veprohet sipas planit të Ahtisarit, ndërsa, kur janë në pyetje interesat e tij personale, që zgjedhjet të mbahen në afatin e përcaktuar sipas pakos së Ahtisarit, atëherë kjo nuk vlen, sepse aty cenohen interesat e tij personale, e në këtë rast edhe interesat personale të kryetarit të Kosovës.

Çka përmban Programi i Qeverisë për periudhën 2008-2011, i paraqitur sot para nesh? Sipas këtij programi, Qeveria do të përqendrohet në këto fusha: energji dhe miniera, transport, sundim të ligjit, edukim, bujqësi, politika tatimore dhe administrim, sektor financiar.

Ajo që bie së pari në sy te ky program është se janë hartuar mirë parimet kryesore të tij dhe orientimet programore. Madje ka edhe një gjuhë të rrjedhshme e të kuptueshme, gjë që nuk është karakteristikë e dokumentave dhe materialeve që vijnë nga kjo Qeveri.

Të ndalemi pak konkretisht në këta kapituj të Programit të Qeverisë dhe te zbërthimi i tyre. Kur e shfletojmë atë me kujdes, kot do të kërkojmë shifra konkrete dhe përcaktim të dinamikës së realizimit të këtij programi. Askund nuk janë paraqitur parametra konkrete se sa për qind, po e zëmë, synon të arrijë rritje kjo qeveri në një sektor të caktuar dhe kur, deri në cilin afat synon të arrijë atë rritje të caktuar. Në këtë program, pra nuk gjejmë asgjë konkrete dhe kjo është e meta esenciale e tij. Madje, shihet se pjesë të mëdha të

këtij programi janë kopjuar drejtpërdrejt nga strategjia zhvillimore të cilën e ka hartuar qeveria në vitin 2005-2006.

Programi i një qeverie zakonisht zbatohet përmes ligjeve që qeveria i sjell për aprovim në Kuvend. Një qeveri dallohet nga një tjetër në bazë të faktit se a sjell ligje të mira, përmes të cilave realizohen interesat e qytetarëve. Nëse nisemi nga ky fakt, atëherë e shohim se kjo Qeveri, deri më tash, ka sjell në Kuvend ligje të hartuara nga qeveria e mëparshme.

Një program i mirëfilltë në sferën sociale dhe të arsimit, në zhvillimin ekonomik etj. mundësohet të realizohet përmes ligjeve që i sjell ajo. Vetë fakti se deri më tash kjo qeveri sjell në Kuvend ligje të Qeverisë së mëparshme, tregon se punon dhe, siç e dimë, ende do të punojë sipas programit të qeverisë së mëparshme.

Edhe buxheti për vitin 2008 dhe projektet e mëdha të infrastrukturës rrugore janë planifikuar dhe nisur nga qeveria e kaluar, pra nuk janë të kësaj Qeverie.

Dëshiroj ta cek edhe një aspekt, shumë të rëndësishëm, të punës së Qeverisë. Në këtë program janë thënë tri fjali, pra tri fjali të vetme për aspektet e sigurisë në Kosovë. Për katër vitet e ardhshme sfida kryesore jo vetëm për këtë parti dhe këtë qeveri, por edhe për Kosovën në përgjithësi është e a do të sundojë vërtet ligji dhe institucionet e mirëfillta apo do të sundojë krimi i organizuar, mafia politike dhe nëntoka. Kam frik se ne na kontrollon krimi i organizuar dhe nëntoka e madje i kontrollon edhe disa segmente shumë të ndjeshme të institucioneve të Kosovës, veçanërisht ato të sigurisë. Kjo e rrezikon në masë shumë të madhe të ardhmen tonë dhe ne duhet të jemi shumë të brengosur për këtë.

Mungesat e mëdha të këtij programi në përcaktimin e parametrave të zhvillimit dhe në përcaktimin e dinamikës së këtij zhvillimi na shtyjnë që të kërkojmë nga kjo qeveri hartimin e një programi të mirëfilltë dhe një vizion të qartë të saj për të ardhmen e Kosovës.

E gjithë kjo tregon se kjo Qeveri nuk ka vizion të qartë se ku dëshiron të arrijë dhe si do të arrijë deri aty. Pra, është shumë e qartë se kjo Qeveri synon të punojë edhe më tej pa vizion dhe pa një program të mirëfilltë pune. Këtë e ka treguar edhe deri tash, gjatë këtij 100-ditëshi, kur tërë kohën punoi pa program, me improvizime prej rastit në rast, gjë që rezultoi me dështim në sferat e rëndësishme, veçanërisht në atë të energjisë.

Propozoj që Kuvendi sot t'ia kthejë Qeverisë prapa këtë program pune dhe të kërkojë prej saj që ta paraqesë para nesh një program të shkoqitur mirë, me parametra konkretë të zhvillimit dhe me një dinamikë konkrete të realizimit të tij. Nëse mbetet kështu si është, atëherë kjo Qeveri nuk merr asnjë obligim konkret as para nesh dhe as para qytetarëve të Kosovës dhe ne do të mund të ballafaqohemi në fund me dështimin e madh, i cili nuk do të ishte vetëm i kësaj qeverie, por edhe i vetë Kosovës. Do të mund të ballafaqohemi me një dështim të zhvillimit, të sundimit të ligjit, me një dështim serioz të aspekteve të sigurisë dhe të integritetit të Kosovës në Bashkimin Evropian dhe në mekanizmat tjerë ndërkombëtarë.

Në fund, dëshiroj të them edhe një gjë. Më duket se PDK-ja ende nuk po e kupton se më nuk është opozitë siç duket. Ka qenë shumë gjatë në opozitë dhe nuk po mund t'i përshtatet rolit të ri. Nuk po e kupton se roli i pozitës është të punojë e jo të kritikojë opozitën. Ju faleminderit!

KRYETARI: E keni tejkaluar kohën e paraparë për diskutim. Fjalën e ka Kaçusha Jashari, le të përgatitet Myrvete Pantina.

KAQUSHA JASHARI: I nderuar Kryetar,
Të nderuar zëvendëskryeministra,
Kolegë deputetë,

Për mua, për shembull, në krahasim me informatat e tjera nga Kryeministri, Raporti i punës së Qeverisë dhe Programi i paraqitur është i mjaftueshëm për diskutim, për dinamikën e punës deri më tani, por edhe për programin.

Po harrojmë se kanë kaluar vetëm 2 muaj pas shpalljes së pavarësisë dhe kërkesa para 17 shkurtit e opinionit ka qenë: kur është ajo datë dhe kur do ta shpallim, kurse përgjegjësia që të kalojë ajo ditë sikur që ka kaluar, ka qenë përgjegjësi jo vetëm e Qeverisë, por edhe e Kuvendit, prandaj mendoj se në të ardhmen duhet të jemi shumë më real.

Këtë që përmenda, e përmenda për shkak jo ta mbroj Qeverinë, sepse jemi pjesë e pozitës, por për shkak të bindjes se kemi filluar punën në rrethana shumë të ndryshme dhe rrethana të reja të formimit të shtetit dhe mendoj se më tutje duhet të jemi shumë serioz dhe përgjegjës. Sidomos insisto për vlerësime reale qoftë për punën e shkurtër të Qeverisë e po ashtu edhe për planin. Edhe unë kisha pasur dëshirë të jam e detajuar, por e kam arsyetimin se ka qenë edhe kohë e shkurtër por edhe vëmendje e jonë e përqendruar tjetërkah.

Kishte qenë sukses shumë i madh edhe i Qeverisë edhe i yni këtu, në qoftë se fillojmë implementimin e ligjeve të aprovuara nga Pakoja e Ahtisarit dhe të mos kemi, që mund të ndodhë, pengesa të mëdha në bllokimin e punës, sidomos nga forca destruktive, të them. Prandaj, për mua, brengosja shkon në këtë drejtim si ta aprovojmë atë dhe ta implementojmë e jo në drejtim të asaj sikur që ishin disa diskutime kinse paska premtuar dikush 24 orë rrymë e pse nuk është zbatuar premtimi, sidomos prej njerëzve që e dinë shumë mirë problematikën e KEK-ut dhe lëmitë e tjera.

Kjo Qeveri ka trashëguar gjendje kaotike, jo vetëm në KEK, por edhe në shëndetësi dhe mua po më brengos administrata glomaze dhe joprofesionale të cilat janë në ministri dhe kërkohet tash përnjëherë sukses dhe ndërrim radikal të gjendjes së tërësishme.

Edhe unë u takoj atyre që kërkojnë këtë, dhe do të mundohem të sillem në këtë drejtim më seriozisht, sidomos në ditët e para të formimit të shtetit dhe të japim kontributin për shtetin funksional, sepse standardet ndërkombëtare Evropiane, që ne si shtet t'i bashkëngjitemi atyre, janë shumë të rrepta dhe të vështira.

Prandaj, në këtë drejtim, unë do të sugjeroj dhe propozoj disa prioritetë nga ne socialdemokratët për këtë plan të Qeverisë, të cilin ne në tërësi e përkrahim, por mendoj se duhet të japim edhe kontribut në detajizimin dhe pastaj edhe në zbatimin e tij.

Prioritet mbi prioritetë, mendojmë se është reforma në administratën publike dhe qeverisja elektronike, e cila është e propozuar në plan dhe mendojmë se kriteret të cilat kanë qenë për pranim në administratë të njerëzve, kriteret e problemeve sociale ose përkatësia partiake duhet të jenë të kaluara, kurse kriteret e reja shpresojmë se me reformën në administratën publike do të jetë profesionalizmi, efikasiteti dhe dija, sepse pa to me siguri as Qeveria, as ndonjë ministri s'mund të funksionojë.

Disa propozime konkrete. Në pjesën e kapitullit ku është rritja ekonomike, mendojmë se privatizimi, ani që është gati në përfundim, ka mundësi të analizohet pak më mirë se sa ka qenë deri më tani në funksion të rritjes ekonomike. Ne deri më tani nuk jemi të kënaqur. Rritja ekonomike do të ishte shumë më e lartë sikur të evitoheshin padrejtësitë e mëdha që i janë bërë shtresës së mesme dhe asaj të ulët sociale.

Gjithashtu, për potencialin e tregut të punës, duhet shikuar vlerësimi se a është deficit i fuqisë punëtore në lëmi të caktuara dhe mendojmë se është problem më i madh sepse e kemi popullsinë e re dhe mungesën e vendeve të punës. Ky është problemi më i theksuar këtu.

Propozojmë, po ashtu, që të jepet më detajisht puna dhe politika e punësimit që kemi. Ne propozojmë punësimin aktiv të ndërtuar në mes bashkëpunimit të atyre që janë pa punë, domethënë të papunësuarve, punëdhënësve dhe organeve qeveritare për punësim, atë arsimore dhe hulumtuese. Ky kombinim me siguri do të kishte dhënë rezultate më të mëdha.

Për bujqësi, ka shumë propozime dhe unë mendoj se këtë që e ka dhënë Qeveria e ka dhënë me të drejtë për efekte më të gjata kohore, por mendojmë se kjo lëmi kishte për të ndihmuar shumë në zvogëlimin e papunësisë në qoftë se merren edhe do masa konkrete, duke filluar prej ndalimit të shkatërrimit të tokës bujqësore, përf forcimit të ekonomisë familjare, stimulimit në zonat e varfra malore e gjithashtu edhe stimulimit për pika grumbulluese dhe nuk kisha përmendur për të cilat raste dhe ku, por gjithashtu edhe stimulimi i politikave të favorshme kredituese, e jo sikur deri më tani që kemi komercialen.

Te zbutja e varfërisë dhe stabilitetit social, në program me të drejtë është fokusuar Qeveria në masat afatshkurtra dhe ndihmave emergjente për shkak të situatës në të cilën jemi, por zbutjen e varfërisë dihet se mund ta planifikojmë edhe nga një aspekt të qasjes tjetër më afatgjatë, ku zhvillimi ekonomik është ai që krijon vende të punës dhe gjithashtu një prej mundësive është edhe krijimi i shanseve të njëjta për të gjithë, si dhe edukimi gjithëpërfshirës dhe profesional në veçanti.

Problemi i migrimit fshat-qytet është gjithkund dhe mendojmë se me një program më të theksuar të zhvillimit të integruar rural kishte për të ndihmuar.

Kisha thënë disa fjalë lidhur me sistemin shëndetësor. Dihet se ky sistemi është nga dy komponentë: mbrojtja shëndetësore dhe sigurimi shëndetësor. Tani kemi vetëm mbrojtjen shëndetësore dhe shëndetësia ka shumë probleme të trashëguara dhe e di se kjo Ministri e ka shumë vështirë për të lëvizur por duhet patjetër të lëviz dhe mendojmë se edhe në këtë situatë, që është si është, sigurimi shëndetësor është shumë me rëndësi për shkak të stabilizimit të bazës materiale. Mendojmë se sigurimi shëndetësor, pos buxhetit, mund të sigurohet edhe me vetëkontribute në bazë të një solidariteti shoqëror publik, prandaj në këtë drejtim shpresojmë se Ministria e Shëndetësisë do të ketë hapa të duhur.

Për arsimin, mendojmë se ky program është pak më i konkretizuar se tjerët dhe nuk do të përmend atë që shumëkush e përmendi sepse shihet një punë konkrete duke filluar prej kushteve shkollore dhe kompjuterizimit. Unë posaçërisht do ta përgëzoj ministrin për një veprim se u afrohen fëmijëve kushte të barabarta të shkollimit, sidomos atyre me kërkesa të veçanta, që nuk ka qenë deri më tani. Mirëpo, mendoj se Ligji për arsimin superior duhet të shikohet apo të zbatohet në Universitet edhe pse është i pavarur ai Universitet,

por nuk kanë të drejtë të shkelin ato të drejta të cilat janë në këtë ligj, sidomos te pranimi i asistentëve ose profesorëve, që ministri i shëndetësisë e ka përmendur rastin e mjekësisë....

(Ndërprerje nga regjia – për tejkalim të kohës për diskutim)

KRYESUESI IBRAHIM GASHI: Faleminderit, deputete Jashari! Fjalën e ka deputetja Myrvete Pantina, le të përgatitet Ibrahim Selmanaj, përkatësisht Esat Brajshori, meqë Ibrahim Selmanaj, po shoh nuk është këtu.

MYRVETE PANTINA: Faleminderit, zoti kryesues!

Sa i përket 100-ditëshit të parë të Qeverisë, mendoj se askush prej nesh nuk ka pritur të ndodhin mrekulli brenda kësaj periudhe, duke pasur parasysh rrethanat në të cilat punojmë.

Sa i përket Programit të Qeverisë, të paraqitur para nesh, mendoj se lidhur me këtë program të gjithë deputetët, pa marrë parasysh se a i përkasin pozitës apo opozitës – janë të thirrur që të japin kontributin e tyre, domethënë edhe të jenë kritikë. Këtë e theksoj meqenëse u përmend se vetëm deputetët e opozitës merren me kritika dhe me dhënien e vërejtjeve. Prandaj, mendoj se kjo nuk qëndron.

Parimisht, qëllimi i Programit qeveritar, duhet të jetë që brenda një periudhe të caktuar kohore, për të cilën ofron programi, t’iu ofrojë mirëqenie më të madhe dhe rritje ekonomike për qytetarët e vet, për çka edhe synohet me këtë program. Mirëpo, për realizimin e këtij synimi, përmes programit të paraqitur, mendoj se paraqiten disa mangësi dhe lidhur me të do të jap disa vërejtje.

Nga aspekti përmbajtjesor, mendoj se ky program nuk do të duhej të merrej me konstatime, por me caktimin e aktiviteteve konkrete, me afatet për realizimin e tyre dhe mjetet e siguruar për aktivitetet e parapara.

Në Program thuhet se Qeveria e Kosovës do të krijojë një ambient të sigurt dhe atraktiv për pjesëmarrje të investitorëve privatë në sektorin e energjetikës por nuk cek konkretisht si do ta krijojë atë ambient.

Në kuadër të infrastrukturës rrugore, nuk ceket se cilat rrugë të reja do të ndërtohen apo cilat do të rindërtohen.

Për hekurudha, thuhet se do të bëhen investime për përmirësimin dhe rivitalizimin e infrastrukturës hekurudhore dhe ndërtimin e infrastrukturës së re, por nuk dihet në cilat pjesë të hekurudhave të Kosovës.

Për bujqësi, thuhet se investimi në makineri dhe pajisje të ndryshme nëpër ferma do të rrisë produktivitetin, por nuk thuhet se a janë ndarë mjete për këtë qëllim. Me sa e di, me buxhetin vitit 2008, për këtë qëllim nuk ka mjete të ndara por a do të përsëritet rasti i njëjtë edhe në vitet e ardhshme në kuadër të programit për periudhën e paraparë, mbetet të shihet.

Mbrojtja e tokës, po ashtu paraqitet si çështje e ngritur në këtë program, por nuk tregohet si do të arrihet kjo. E dimë se vite me radhë kërkojmë një gjë të tillë sepse e dimë që tokën bujqësore e kemi rrezikuar shumë, por ende s’ka projekte konkrete si do të mbrohet toka bujqësore.

Norma tatimore, thuhet do të jenë stimuluese për biznesin dhe konkurruese në regjion, por nuk ka konkretizim cilat tatime dhe sa do të ulen.

Në kuadër të politikës fiskale, nuk përmendet aspak ulja e evazionit fiskal, edhe pse e dimë që kemi probleme në këtë drejtim.

Sa i përket Programit të Qeverisë, mendoj se sektori i arsimit është i vetmi sektor në të cilin flitet me të dhëna konkrete, domethënë me shifra tregohet se sa shkolla do të ndërtohen e kështu me radhë, por edhe në këtë sektor mungojnë afatet për realizimin e aktiviteteve.

Lidhur me pensionistët. Qeveria duhet të ketë parasysh se në vitin 2007 në realitet në janar të vitit 2008, krahasuar me janarin e vitit 2007, ka ardhur deri te ngritja e nivelit të çmimeve për 10.7%. Unë nga një prezantues dëgjova rreth 20% mirëpo po bazohem në të dhënat e Entit të Statistikës të Kosovës. Do të thotë në këtë periudhë është një ngritje prej 10.7% e nivelit të çmimeve, që do të thotë se ka ardhur deri te rënia e vlerës reale të pensioneve, prandaj Qeveria duhet gjithsesi të merret me korrigjimin e vlerës së pensioneve në mënyrë që të pengojë rënien e mëtejshme të standardit jetësor të kësaj kategorie të njerëzve por edhe të shtresave tjera të popullatës, të cilët kanë të ardhura më të ulëta gjë që paraqitet në kuadër të Programit si një ndër prioritetet, do të thotë mbrojtja e standardit jetësor. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, deputete Pantina! Fjalën e ka Ibrahim Seljamaj, që mungon dhe në radhë është Esat Brajshori. Le të përgatitet Drita Kadriu.

ESAT BRAJSHORI: Faleminderit, zoti Kryesues!

Si duket i ka humbur kondicioni këtij Parlamenti që të shqyrtojë tamam dhe mirë Programin qeveritar. Dita e sotme ka shënuar rënie në ballafaqimin e fakteve. Unë do të uroja që mënyra e ballafaqimit të këtyre fakteve të koincidente edhe me rastet më konkrete, me shqyrtimet më reale, më serioze, nëse mund të them – të dy palëve, në këtë rast pozitës dhe opozitës.

Seriozisht u shterën në masë të madhe të gjitha ato çka i ka ofruar programi qeveritar nga folësit e mëhershëm, por ajo çka ka ngelur pa u përmendur, ose është përmendur tepër përciptazi, si gjithmonë, është kultura, arti dhe rinia.

Kam pritur nga disa miq të pozitës, domethënë që janë pjesë e rinisë, që të jenë shumë më serioz në pikëpamje të kësaj çështjeje, pra të trajtimit të rinisë sipas programit qeveritar dhe jam habitur me qasjen e tyre karshi këtij problemi, por më vonë do t'i kthehem kësaj çështjeje.

Zoti zëvendëskryeministër, kabinet qeveritar, të nderuar deputetë,

Unë ende besoj se Qeveria ka dëshirë dhe është e interesuar që të ketë një program sa më të përkryer qeveritar. Unë ende besoj se edhe opozita në parametra të njëjtë është e interesuar që të ofrojë vizionin e vet për të gjitha ato çështje që lidhen me jetën e qytetarit të Kosovës.

Nisur nga ky prizëm personal, shpresoj që disa nga ato gjëra që unë do t'i shtroj më poshtë, do të shihen me kujdes nga Qeveria dhe në rastin konkret – nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

Jam pak a shumë i hendikepuar në këtë drejtim, sepse unë akoma nuk e di saktë cili është ministri i kulturës. E di se ka qenë një dhe ka shkuar në një dikaster tjetër, është emëruar një tjetër dhe akoma s'ka ardhur dhe nuk e di kush e drejton Qeverinë përkatësisht Ministrinë e Kulturës. E di se ka zëvendësministër dhe kështu domethënë ky mendim ekziston në gjithë botën e artistëve.

Jam i hendikepuar për rastin se do të më pëlqente që dikush më kompetent t'i dëgjojë këto çështje të cilat do t'i shtroja në vazhdim.

Kultura.- Seriozisht nuk nisem nga ajo që jam opozitar dhe duhet tash të gjuaj gurë e dru në Programin e Qeverisë apo në atë që dikush tjetër e ka punuar. E kam parë me shumë kujdes. Ajo që ka përparësi në këta 15 rreshta të parë të kultura, është se diagnostifikimi i gjendjes në kulturë dhe i komunitetit të artistëve është bërë në mënyrën më të saktë të mundshme, por nuk është ofruar asnjë vizion, asnjë shembull konkret se si të kalohet kjo gjendje. Është e tepërt të lexohen gjithë këta 15 rreshta për t'ju mos mërzhitur, por me të vërtetë nuk ka asnjë gjë konkrete që mund t'i jepte shpresë botës së artit dhe kulturës se e pret një e nesërme më e mirë.

Shkojmë dhe shohim pak edhe atë që u quajt herë raport e herë informatë, të institucionet përkatëse të kulturës. Dihet se në nivelin qendror janë 9 institucione të kulturës të cilat drejtohen nga Ministria e Kulturës.

Teatri Kombëtar.- Si punë dhe angazhim i Teatrit Kombëtar merret një shfaqje që është dhënë premierë dhe është e vërtetë, para 3 javësh “Liria po vjen” e Milazim Krasniqit, me autor ose regjisor Agim Selimi. Po seriozisht! Kjo shfaqje ka nisë punën e vet që në tetorin e vitit të kaluar – “provat e tavolinës”. Përmendet edhe një e arritur tjetër, një shfaqje e mysafirit që ka ardhur nga Teatri i Shkupit. Ai ka ardhur për t'i dhënë 3 shfaqje repriza këtu dhe është kthyer me 2 shfaqje, se në të tretën s'ka pasur asnjë shikues brenda në sallë. Dhe, nuk është vetëm ky problemi i Teatrit Kombëtar. E dini se Teatri Kombëtar nuk ka drejtor tash e 4 muaj. Teatri Kombëtar i Kosovës, drejtohet nga një ushtrues detyre.

Teatri Profesionist i Gjakovës.- Dy-tre shembuj konkret, e jo të jepen gjykime paushall, si të them. Teatri i Gjakovës merret se i ka realizuar disa manifestime përvjetor, si punë. Në fakt, e dini se Teatri Profesionist i Gjakovës që javën e kaluar i ka mbyllur dyert e punës së vet, zoti zëvendëskryeministër dhe këtë, për faktin, për shkak të mostrajtimit të artistëve të këtij Teatri. Në vend që ai tani të festojë 30-vjetorin e punës së vet si Teatër Profesionist, ai i ka mbyllur dyert. Pra, është jashtë funksionit, nuk punon.

Qendra Kombëtare Kinematografike e Kosovës.- Vetëm me dy fjali po e përshkruaj. Kjo Qendër tash e dy vite, prej që ka zgjedhë drejtorin e vet, në fondin e vet ka gjithsej 40 euro. 40 euro tash e dy vjet janë konstant në fondin e kësaj Qendre Kinematografike, me përjashtim se ditëve të fundit u fol diçka se Ministria e Kulturës do të alokojë 300.000 euro për të filluar ndonjë projekt. Ndërkohë, u ndërruan ministrat dhe fare bota e artistëve nuk e di prapë se si ndodhet dhe si është gjendja në këtë drejtim.

Pra, shembuj të neglizhencës ndaj kulturës dhe mostrajtimit, ka shumë. Nëse ndalemi të trajtimi i dinjitetit të artistit, zoti zëvendëskryeministër dhe ju të nderuar ministra, e dini se paga e tyre nuk kalon mbi 22 euro në muaj. Domethënë, po flas për ata aktorë të

shkallës së parë të Teatrit Kombëtar. Kohë pas kohe, në rast se kanë fat, nëse bëhet ndonjë projekt, por ja që jemi në muajin e katërt të këtij viti dhe Teatri Kombëtar akoma nuk ka repertorin e vet, nëse kanë fat të angazhohen në ndonjë projekt, atëherë do të jetë diçka më mirë për të ardhurat e tyre.

Mendoj se nuk është halli këtu pse njerëzit e kësaj fushe janë vetë keq materialisht ose nuk trajtohen si duhet me dinjitet, por mendoj se nuk është mirë për të gjithë kulturën, politikën e këtij vendi dhe nuk është mirë për vetë Kosovën që këta njerëz të trajtohen kështu siç trajtohen sot.

Shkojmë te rinia. Po them edhe një herë, nuk e kam mani që të flas vetëm nga këndi i kritikut dhe të kthehet njeriu kritikist nganjëherë dhe të mos ketë vlerë fare ajo që thotë, por pjesa e Programit të Qeverisë për rininë i ka gjithsej 5 rreshta. Mund ta shohim direkt! Domethënë i ka gjithsej 5 rreshta që Qeveria i kushton rinisë së Kosovës, e cila përbën diku 60% të popullatës së Kosovës.

Nuk e di, nëse më premtan koha, por me shumë dëshirë unë i kisha lexuar edhe ata 5 rreshta se çfarë ofron Qeveria për rininë e Kosovës.

Ja, shumë shpejt. “Struktura e re e popullatës në Kosovë e vendos Departamentin e Rinisë në një pozicion shumë sfidues në raport me kohën dhe nevojat e zhvillimit të politikave multisektoriale me qëllim të favorizimit të rinisë së Kosovës. Puna e këtij Departamenti, në bashkëpunim me OJQ-ët vendore dhe ndërkombëtare, tanimë pjesë të pandara të këtij Departamenti, do të finalizojnë planin kosovar të veprimit për rini”.

Kjo është që i kushtohet rinisë. Tash, cili është ky plan kosovar për rini është çështje tjetër dhe ata që duhet ta shohin duhet të hulumtojnë dokumente tjera, e unë sa e di ky plan është i hartuar në vitin 2006 për periudhën 2007-2010 dhe ky plan parasheh një buxhet prej 300.000 eurosh për gjithë rininë dhe aktivitetin e tyre.

Imagjinoni sa mund të jetë produktive rinia me këtë ofertë që iu ofron dhe bën Qeveria.

Sa i përket sportit.- Sporti sikur kultura dhe arti në përgjithësi, e në këtë rast edhe rinia, është në gjendje shumë të vështirë. U tha këtu dhe s’ka nevojë të duplikohen mendimet. Mirëpo sporti ka edhe një problem tjetër, sepse njerëzit e kësaj fushe duke qenë sportistë, duke ndie veten si duket të fuqishëm kanë aplikuar në fushën e lojës forcën. Domethënë, ka probleme konfliktuale, ka probleme të ushtrimit të dhunës në stadione, në fusha të lojës, kudo që bëhet te ne. Është një segment që duhet t’i kushtohet shumë vëmendje sepse unë e di që sporti duhet të jetë art i cili bashkon njerëzit dhe jo që të bëhet shembull i ndasive rajonale, të qyteteve e tjera.

Ndoshta nuk ju mërzita shumë! Por për mos e bërë që ky Parlament të shkojë në linjën e asaj lojës ping-pong – ta hedha, ma hodhe, u mundova t’i nxjerr seriozisht shqetësimet e mia për gjendjen në kulturë, rini dhe sport që ofron programi qeveritar.

(Ndërprerje nga regjia – tejkalim i kohës për diskutim)

(Reagim i deputetit)

KRYESUESI: Faleminderit, deputet Brajshori. Është kryer dhe nuk e kemi vazhduar fjalën për asnjërin. Fjalën e ka deputetja Dritë Kadriu. Në radhë ishte deputetja Teutë

Hadri, e cila e ka dorëzuar diskutimin e saj me shkrim, për çka inkurajoj edhe deputetët tjerë që dëshirojnë ta bëjnë të njëjtën gjë. Ndërkaq, le të përgatitet deputeti Riza Smaka.

DRITA KADRIU: Faleminderit, zëvendëskryesues!

I nderuari zëvendëskryesues,

Të nderuar deputetë,

Kabinet qeveritar, zëvendëskryeministër,

Vështrimi im në dokumentin e Programit qeveritar të vitit 2008-2011 ka dy paralele të ndërvarura ngushtë njëra me tjetrën. E para paraqet vështrimin teknik në dokument. Kemi marrë një program të përgatitur në mënyrë profesionale, një program që ka një strukturim të rrjedhshëm dhe logjik, një strukturim të harmonishëm që lidhet ngushtë me nevojat dhe prioritetet e qytetarëve të Kosovës, të orientuara nga urgjenca kah e rëndësishmja.

Ky program është i lexueshëm, i qartë dhe i kuptueshëm për të gjithë. Vështrimi i dytë në program, është në përmbajtjen e tij, i orientuar kuptueshëm nga strukturimi i harmonishëm i prioritetëve të Qeverisë, të cilat i dedikohen përmirësimit të cilësisë së jetesës dhe nevojave të qytetarëve.

Katër shtyllat e politikave prioritare të programit të Qeverisë, rritja ekonomike, zbatimi i statusit, qeverisja e mirë dhe zbutja e varfërisë dhe stabiliteti social prezantohen të ndërvarura dhe përplotësohen drejtpërsëdrejti me të gjitha fushat që paraqesin nevojë të jetesës së qytetarëve dhe cilësinë e saj.

Duke çmuar lart procesin e krijimit të strukturës administrative të Kosovës së pasluftës, respektivisht të shtetit të Kosovës, në shtyllën e qeverisjes së mirë, me program keni fuqizuar dy funksione të domosdoshme – atë të kontrollit dhe të vlerësimit të sistemit të cilat po gjenerojnë ndryshime pozitive në të tri shtyllat tjera të programit. Kjo po rritë shkallën e përgjegjësisë së institucioneve në raport me qytetarët dhe, mos harroni, se krejt kjo po ndodhë në tremujorin e parë të qeverisjes së re e dalë nga zgjedhjet e nëntorit dhe fazës së menaxhimit të pavarësisë së vendit tonë.

Ju përgëzoj për një punë të palodhur dhe shumë të përkushtuar.

Secili lexues e vëren fuqishëm ndërvarësinë e tri shtyllave të programit të Qeverisë, rritjen ekonomike, zbatimin e statusit dhe zbutjen e varfërisë dhe stabilitetit social me shtyllën e qeverisjes së mirë. Brenda të njëjtit buxhet, me një riorganizim të brendshëm të tij, ndahen mjete dhe ndërtohen shkolla të reja me theks të veçantë në eliminimin e shkollave kontejner, ndahen mjete disa herë më shumë për investime në infrastrukturën rrugore, krijohet qasja e hapur në problemet e sistemit shëndetësor të krijuara krahas krijimit të kësaj strukture, vendosen hapa të matshëm në identifikimin dhe eliminimin e faktorëve që po i detyrojnë bizneset dhe administratën qofshin ato në kompanitë publike apo bizneset private të jenë të papërgjegjshme në obligimet ndaj shtetit dhe administratës.

Të nderuar kolegë,

Kujtojmë se më pak se 3% e njerëzve që përfitojnë në mënyrën më të vrazhdë të mundshme nga bizneset dhe pozicionimet në sistem nga buxheti kapital i Kosovës, përmes normave jashtëligjore, ta marrin fatin e qytetarëve të Kosovës në duart e tyre për interesa private apo familjare në dëmtimin e përgjithshëm të shërbimeve publike ndaj qytetarëve, si në shëndetësi, në edukim, në infrastrukturë, energjetikë e tjera. Prandaj, me të drejtë po konstatoj se për këto 100 ditë keni filluar ta ndryshoni situatën.

Po thuhet se programe të tilla si model ka kudo në ambientet administrative, qofshin elektronike apo reale. Por, ju lutem, përcjellja e dokumentit me fuqizimin e funksionit të vlerësimit dhe kontrollit të sistemit, vendosmëria dhe profesionalizmi ekipor i kësaj Qeverie janë ngushtë të lidhura me zbatueshmërinë e këtij dokumenti.

Jemi përjetues të fazës së zhvillimit të shtetit tonë dhe kjo fazë kërkon njerëz të vendosur, të përkushtuar politikisht dhe me dije të lartë profesionale. Prandaj, Programi i ndërruar nga fuqia politike dhe faktori njeri, po krijon kushte që rezultatet e tij të përjetojnë nga qytetarët e Kosovës dhe të maten edhe në këtë tremujor.

Ju përgëzoj për një nismë të suksesshme me Programin, rezultatet e të cilit kanë filluar të vërehen dhe maten nga qytetarët. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, deputete Kadriu! Fjalën e ka deputeti Riza Smaka, le të përgatitet deputeti Berim Ramosaj.

RIZA SMAKA: I nderuar kryesues,
I nderuar kryeministër, ministra,
Deputetë të respektuar,

Do të nisem nga modeli i Triadës Hegeliane: pozita – opozita – kompozita, teza – antiteza – sinteza, që do të thotë përafërsisht kjo: do të kisha pasur të drejtë për ta kritikuar çdokënd sikur të nisesha nga pozicioni se unë jam kryeministër apo ministër, apo qeveri. Mendoj se kjo u jep një ton serioz çështjeve kur shtrohen, qoftë edhe të gabuara.

Si objeksion parimor, do të kisha thënë këtë. Programi do të duhej me të vërtetë e pa kurrfarë dileme të operacionalizohet, të jepen temat dhe terminet se kur do të duhej kryer, po e zëmë. Shembull, shëndetësia është në një kollaps, mjerisht sikundër edhe shumë sektorë të jetës shoqërore, ekonomike, arsimore e kulturore në Kosovë. Kur do të bëhej, kur do të themelohej Universiteti i Mjekësisë, bie fjala – shtatori, viti 2009, po e zëmë, këssoj.

Disa objeksione të veçanta, tema që fare nuk janë përfshirë në program ose që vetëm janë cekur: Sigurimi dhe mbrojtja shëndetësore, pikë delikate – e ndjeshme. Ju lutem, organizatat shëndetësore publike dhe private, e dimë gjendjen, e di bujku, e di blegtori, e di tregtari, e di filozofi. Është një konfuzion i madh dhe pësojnë shfrytëzuesit e shërbimeve shëndetësore – qytetarët.

Ambienti ynë degradohet, devastohet pa kurrfarë skrupulli dhe kurrfarë mbrojtjeje nuk ka, nuk janë dhënë kurrfarë instrumentesh, as mekanizmash për ta mbrojtur këtë ambient kaq tepër të dëmtuar, si nëpërmjet ndërtimeve ilegale, nëpërmjet uzurpimeve arbitrare dhe tokat publike që janë uzurpuar, pyjet tona priten pamëshirshëm, ju lutem. Ujërat tona okupohen, kaptazhohen, mbeten bjeshkët tona atraktive pa gurra, sepse dikush është më i fuqishëm dhe i uzurpon.

Universiteti. Kemi Universitetin publik, tepër të centralizuar, tepër të burokratizuar dhe, natyrisht, për aq ineffikas. Kemi universitetet private, numër enorm, të gjitha pothuaj të licencuara, ndërsa nuk kanë as 30% të kuadrit për të qenë të licencuara. Nuk ka nevojë për të dhënë komente si u bë kjo punë që u licencuan.

Në anën tjetër, prodhohen në mënyrën eksprese magjistra të shkencave, doktorë shkencash brenda, bie fjala, një viti, e tjera. Mos më keqkuptoni. Do të japi shembullin

tim. Mua, 7 vjet mu ka dashur të punoj intensivisht për të magjistruar. 7 vjet për të doktoruar. Nuk kam qenë më i dobëti. Kam qenë i pari në gjeneratën e parë që ka magjistruar dhe i pari në gjeneratën e parë të studentëve postdiplomik që kam doktoruar. Është dashur me qindra libra për t'i analizuar. Jam ithtar i asaj dhe ku të marrim për të pasur numër enorm të doktorëve të shkencave, por meritus. Ju lutem, këta bëhen në mënyrë që disa universitete që s'i kanë as parakushtet elementare për të pasur kuadër për t'u licencuar dhe për të bërë biznese.

Sistemi gjyqësor. Gjyqësori është në një kollaps. Me 3 a 4 vite mesatare presin rastet për t'u zgjidhur dhe nuk ka shanse për t'u zgjidhur. Pse? Sepse do të duhej për t'u bërë një reformim radikal i Gjyqësorit, jo ad-hoc, por në konformitet, me analiza dhe me konkluzione të logjikshme duke marrë zgjidhjet ekzistente të shteteve të përparuara.

Ne kemi sistemin gjyqësor çfarë e kemi prej së paku pesë dekada. Kemi gjykata kundërvajtëse, kemi gjykata të qarqeve, kemi gjykata që janë edhe të instancës së parë dhe të instancës së dytë. Ne nuk kemi gjykatës, nuk kemi prokurorë, nuk kemi avokatë të specializuar. Prandaj, duhet ndër tjera, ministri i Arsimit nuk qenka këtu, që ta fuste, po e zëmë, edhe këtë postulat, që të bëjmë studime specialistike, që të kemi gjykatës specialistë për çështje juridike-civile, për çështje juridike-administrative, për çështjet juridike-tregtare, për çështjet juridike-penale. Ne sot kemi ekspertë për gjithçka. Pra dihet kur janë për gjithçka, atëherë janë ekspertë për asgjë – ekspertë specialistë.

Në dokument shkruhet: sundimi i ligjit. Ju lutem, është gabim në shprehje pastaj edhe koncepti dhe është i dhënë tepër cekët. “Sundimi i së drejtës”, sepse e drejta e përfshin edhe ligjin, edhe Kushtetutën – kushtetutshmërinë, ligjshmërinë dhe drejtshmërinë – equity, ju lutem. Prandaj, në asnjë gjuhë që flitet dhe pranohet si gjuhë zyrtare në OKB nuk thuhet sundimi i ligjit, por sundimi i së drejtës.

E tash, krejt që është thënë dhe filozofia e këtij postulati është që do të themelohej një agjencion. Në qoftë se do të ishte asisoj, do të kisha votuar për t'u themeluar 1000 agjensione dhe t'i paguajmë ne ato të gjitha vetëm për t'u bërë shteti i së drejtës.

Në tekst thuhet, ndër të tjera, rregullisht – Qeveria do të angazhohej. Ju lutem, do të duhej të hiqet – fshihet kjo. Unë vetëm sot, prej banesës deri këtu që kam ardhur jam angazhuar dy here në funksion të rregullsisë. Një, sepse jam qytetar i rëndomtë, i pakushtet. Qeveria nuk ka çka të angazhohet – “Do të bëjë”, sepse është ekzekutivi, nuk është e rastësishme që thuhet. Po e zëmë, një zonjushë që ka mund të jetë zonjë, kapërceu rrugën dhe nëpër bar, atë pak bar që e kemi, e shkeli dhe e qortova. Kaq munda, kaq bëra. Domethënë, u angazhova. Po të kisha qenë polic, do të kisha ndërmarrë masa përkatëse, po e zëmë, ju lutem. Rasti tjetër ishte i ngjashëm. Duhej pritur në semafor, nuk priti dhe e qortova. Domethënë, kjo është e atij qytetari ordiner që nuk ka pushtet. Qeveria e ka pushtetin dhe mundësinë për të ndërmarrë masa, instrumente, mekanizma, ju lutem, dhe jo në një vend, por më së paku në 30 vende është që “Qeveria do të angazhohet”. Ju lutem, fshijeni “do të angazhohet”. Duhet “Qeveria do të bëjë”, ju lutem. Ndryshe, nuk i përngjan dokumentit.

Gjithsesi, këto unë i dhashë me qëllimin më të sinqertë për të kontribuar për të mirë. Ju lutem, ambienti ynë. Për ambientin asgjë. Ndërtimet ilegale, asgjë. Për uzurpimet arbitrare, për ujërat tona, për pyjet tona që priten pamëshirshëm e që shterojnë gurrat e burimet dhe shumë gjëra të tjera, por për hir të...

Më lejoni, edhe një pasazh. Ne medoemos duhet të bëjmë Kodin tregtar. Ne medoemos duhet të bëjmë Kodin civil. Sot kemi me qindra rregullore që i kanë bërë ekspertët e shteteve të ndryshme, proveniencave të ndryshme që janë krejtësisht kontradiktore dhe janë të pa aplikueshme. Në praktikë do të paraqesin probleme të mëdha. Ne duhet ta bëjmë Kodin tregtar, ne duhet ta bëjmë Kodin civil, ne duhet ta bëjmë Kodin administrativ. Ju lutem, këto nuk janë thënë në funksion të shtetit ligjor. Ju falënderohem!

KRYESUESI: Faleminderit, deputeti Smaka. Fjalën e ka deputeti Berim Ramosaj, le të bëhet gati deputetja Muzejane Selmani.

BERIM RAMOSAJ: Zoti kryesues,
Zoti Kryeministër, ministra,
Kolegë të nderuar,

Pas këtij debati mjaft të gjatë, gati dyditor, gati që është harxhuar ajo pjesa më e ndjeshme e motivimit për një debat realist në kuptimin e dhënies së kontributit për një program qeverie apo të dhënies së kontributit për një informacion mbi raportin 100-ditor të një qeverie, por edhe unë, për aq sa është e mundur do të mundohem të jap kontributin tim në kuptimin parimor – principiel, jo të natyrës personale. As s’e kam mendjen këtu të jap leksion kësaj qeverie, as ndonjë qeverie tjetër, por në qoftë se donë të marrin diçka nga këto kërkesa, nga këto shënime, nga këto informacione nga deputetët, e kanë mundësinë.

Këtu ishin dy çështje sa i përket raportit 100-ditor dhe nuk kam koment. Krejt periudha 100-ditore e kësaj qeverie ka shkuar në opionencën midis Kryetarit të Kosovës dhe Kryeministrit, cili të duket më i madh apo më i vogël në kuptimin e realizimit të atyre kërkesave të mëdha imediate apo historike, që në fakt vjen si rezultat i mungesës së protokollit edhe të Kryeministrit, edhe të Kryetarit, sepse dihet cili për çka përgjigjet. Prej shpalljes së deklaratës, prej shpalljes së pavarësisë, prej aprovimit të Kushtetutës i ka përshkuar ky moment, ky proces i opionencës midis këtyre dy personave që, në fakt, janë institucione, sepse me qenë vetëm nivel personash, i kuptojmë, por është fjala për institucione të një shtetit tash të pavarur dhe të pranuar.

Me këto fjalë, kisha për ta përmbyllur krejt periudhën 100-ditore.

Sa i përket programit, ky program i kësaj Qeverie në fakt është dashur të jepet në periudhën e duhur dhe ne të debatojmë për të dhe të marrim qëndrim ose, tek e fundit, vendim se a do ta votojmë këtë qeveri duke u mbështetur në këtë program apo jo. Tash është veç ex post, diçka e kaluar, që veç mundemi të japim kontribut në qoftë se duan diçka të marrin nga idetë apo qëndrimet tona.

Programi është tepër deskriptiv, është shumë përshkruar në kuptimin e një vizioni normalisht që diçka i përgjigjet ndoshta më tepër një strategjie afatgjate, respektivisht një vizioni apo një synimi e më së paku një programi operativ të periudhës afatmesme prej 1 deri 3 vjet, çfarë ka synuar apo synon ky program të realizojë. Domethënë, shumica e objektivave, respektivisht ajo pjesa përshkruese që është në program më tepër janë të karakterit strategjik, të karakterit vizionar. Nuk janë të karakterit programor. Këtë nuk e them duke u mbështetur në raportet pozitive – opozitive, por në aspektin krejtësisht profesional.

Në qoftë se ka diçka në kuptimin e mirëvajtjes apo të plotësimit të këtij programi, unë do të ndalesha në disa sfida programore që ishin dashur të jenë pjesë të këtij programi.

Së pari, përgatitja dhe sponsorizimi i ligjeve, të cilat janë urgjente me qëllim të funksionimit të shtetit të Kosovës. Kjo duhet të jetë çështje programore e Qeverisë: cilat ligje, në çfarë kohe, orari i tyre dhe cilat janë imanente për këtë periudhë të zhvillimit në përgjithësi – politik, shtetëror, ekonomik të Kosovës. Domethënë, të definohen saktë.

Deri në këtë periudhë ne kemi, përveç ligjeve që kanë dalë nga Pakoja e Ahtisarit, nuk kemi pasur asnjë ligj të natyrës së implementimit të shtetit, të implementimit të elementeve të caktuara, përveç ligjeve që janë si rezultat i qeverisjes së kaluar, bile në shumicën e tyre kemi gjetur edhe preambula dhe nënshkrime nga qeverisja e kaluar.

Kur është fjala te normat e shtimit. Vërtet vizioni apo synimi i kësaj Qeverie është për normën e shtimit, por në treguesit makroekonomikë as GDP-ia, as JNP-ia - domethënë as brutoproducti kombëtar, as brutoproducti per capita nuk është fare i definuar as për periudhën njëvjeçare, as dyvjeçare, as trevjeçare. Çdo qeveri lidhet edhe me tregues vlerorë, me tregues teknikë dhe me tregues kohorë, se tek e fundit ato janë pjesë të programit. Ne nuk dimë me çka mund të lidhemi në qoftë se themi veç “synojmë zhvillimin ekonomik”. Të gjithë e synojnë atë, jo veç një qeveri, por krejt qytetarët e synojnë atë. Mirëpo, duhet të lidhet qeveria me treguesit ekuivalentë.

Afatet dhe mundësitë e inkuadrimin të Kosovës në institucionet ndërkombëtare - edhe të natyrës politike, edhe të natyrës financiare, kjo qeveri në programin e saj është dashur të definojë saktë: sa është periudha që i ka vë vetit për anëtarësim në FMN, anëtarësim në Bankën Botërore, anëtarësim respektivisht komunikim me bursën dhe me institucionet tjera ndërkombëtare financiare, se tek e fundit, statusi kemi menduar dhe ende mendojmë se na ka dhënë një prejjudksion në kuptimin e anëtarësimit, në kuptimin e komunikimit të drejtë me këto institucione. Nuk mund të thirremi më: nuk kemi status dhe nuk mund të komunikojmë, sepse e vetmja shansë e zhvillimit ekonomik të Kosovës qëndron në anëtarësimin në këto institucione respektivisht në komunikimin e drejtë në raportet huamarrëse-huadhënëse.

Te sfida programore – energjia elektrike. Ndërtimi i kapaciteteve të reja. Synimi në program thirret rehabilitimi i atyre ekzistuese dhe privatizimi. Nuk është e mjaftueshme. Duhet të dihet saktë, cilat do të rehabilitohen, në çfarë forme do të rehabilitohen, cilat do të privatizohen dhe jo të futen aty, krejt basenet e thëngjillit janë të futura për privatizim e në mesin e tyre dy a tri prej tyre veç janë të harxhuara. Domethënë, nuk e kanë parë fare çështjen në terren.

Kur është çështja e ndërtimit të termocentralit, apo siç thuhet në program – energjia do të jetë bazë e zhvillimit ekonomik. Në qoftë se është bazë e zhvillimit ekonomik, le ta tregojnë në program se me çfarë kapacitetesh do t’i ndërtojmë ato termocentrale dhe të marrim normalisht pëlqimin nga ky Kuvend apo nga qytetarët e Kosovës se për çfarë kapacitetesh jemi. A jemi të interesuar që energjetikën ta fusim në prioritet si degë e zhvillimit ekonomik të Kosovës, apo energjetikën ta fusim si sfidë që së pari t’i plotësojmë nevojat tona dhe të mbajmë edhe balancin ekologjik. Kjo është sfidë, sfidë programore, nuk është strategjike.

Te procesi i privatizimit. Goja plot – dëshirojmë privatizim. Dhe, në synimin e të gjithë programit, gati në të gjitha pikat, vërehet: dëshirohet privatizimi, por nuk vërehet koha e privatizimit. Ndërmarrjet shoqërore i ka vu AKM-ja në një proces e që ato nuk janë fare në programin e qeverisë dhe nuk kanë qenë dhe dyshoj se do të jenë për një periudhë.

Është çështja për ndërmarrjet publike dhe cilat ndërmarrje do të kooperativizohen, cilat ndërmarrje do të ndryshojnë strukturën organizative, cilat do të ndërrojnë aspektin e titullarit. Ose, në çfarë forme do të shkojë ky privatizim. Sa do të jetë raporti shtet, raporti privat. Në çfarë forme, a do të shkojë në privatizim të tërësishëm apo të pjesërisht. Prapë, edhe këto mungojnë krejtësisht në program. Këto janë çështje të sfidave programore. Nuk janë vizion.

Roli i NVM-ëve në zhvillimin ekonomik – roli i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Veç thuhet se do të kenë rol të rëndësishëm, asgjë tjetër.

Veç një informacion të shkurtër. 92% të gjithë të punësuarve në Shtetet e Bashkuara të Amerikës që punësohen të ri brenda viti, punësohen në ndërmarrje të vogla dhe të mesme. E ne ende elaborojmë me programe dinozaurësh për të ndërtuar gjigante të mëdha, termocentrale apo diçka tjetër të asaj natyre që vetëm në fazën e ndërtimit mund të kenë efekte të zvogëlimit të papunësisë. Në fazat e mëvonshme, nuk kanë kurrfarë efektesh. Efektet janë te ndërmarrjet e vogla dhe të mesme dhe atë në të gjitha fushat, duke filluar nga bujqësia, nga ekonomia familjare, nga ato shërbimet, nga transporti, ndërtimtaria, e të tjera.

Diaspora, si faktor i integritetit, shumë pak përmendet. Nuk përmendet si faktor i zhvillimit ekonomik, e në fakt diaspora ka qenë faktor i zhvillimit dhe faktor i mbajtjes së krejt sistemit paralel në Kosovë për 20 vite. Sot ne kemi obligim që atë diasporë, atë mërgatë vërtet ta kemi parasysh...

(Ndërprerje nga regjia – tejkalim i kohës për diskutim)

KRYESUESI: Faleminderit, deputeti Ramosaj. Kaq ishte mundësia. Në ndërkohë, ministri i Transportit dhe Telekomunikacionit, zoti Fatmir Limaj, e ka kërkuar fjalën për diskutim. Le të përgatitet Muzejene Selmani.

FATMIR LIMAJ: I nderuar zoti kryesues,

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë së pari shfrytëzoj rastin që t'i falënderoj të gjithë deputetët, pa marrë parasysh grupet politike për kritikën, sugjerimet dhe idetë nga diskutimet e tyre që dolën këto dy ditë.

Mendoj se nga i gjithë diskutimi që kemi dëgjuar kemi shumëçka të marrim, ka pasur sugjerime shumë të drejta, të cilat mendoj se duhet t'i inkorporojmë në punën tonë të vazhdueshme dhe kjo tregon edhe njëherë që kritikën profesionale, kritikën me qëllim të mirë janë më se të domosdoshme për të korrigjuar, por edhe për të përmbushur pjesë programore ose pjesë të përditshme të ministrive përkatëse, veç e veç.

Prandaj, falënderoj të gjithë ata deputetë për sugjerimet dhe kritikën konstruktive, të dobishme. Para se t'i them disa fjalë, më duhet të them se nganjëherë këtu krijohet përshtypja nga disa deputetë se ne – qeverisja aktuale në Kosovë, ka ardhur përmes një revolucionit ose ka ardhur përmes mjeteve të dhunshme, e jo përmes votës demokratike. Nënkuptohej, përmes revolucionit, do të thotë, ai që ka ardhur tash duhet ta rrënojë gjithë atë që është bërë më parë. Kjo nuk është kështu. Normalisht se do të gjeni edhe projektligje, normalisht se do të gjeni edhe strategji, edhe projekte të nisura nga qeveritë e mëparshme në pjesë programore të qeverisjes aktuale, sepse është detyrë e institucioneve të vendit, është detyrë e kësaj qeverie për të vazhduar të gjitha ato projekte, për të vazhduar të gjitha ato strategji për t'i implementuar, sepse ruhet kontinuiteti i qeverisjes

në vend. Ky edhe ka qenë zotimi ynë i parë dhe do të vazhdojmë aty ku kanë mbetur të gjitha punët të cilat duhet kryer dhe kanë qenë në shërbim të vendit.

Normalisht, këtu ka finesa, ka ndryshime të ndonjë prioriteti, por jo aq sa të bëhet asi revolucionari që duhet të shlyhet krejt ajo çka ka ndodhë e tash të nxjerrim diçka të re. Nganjëherë ka një kundërthënie në mes diskutimeve. Thuhet, pse i keni ato të qeverisjes së kaluar, dhe në anën tjetër, atij që s'i konvenon, thotë po pse i keni ato të qeverisjes së kaluar. Kështu që, mendoj, ne po vazhdojmë një traditë të vazhdimit të kontinuitetit të punës sonë institucionale dhe, normalisht, aty ku ne mendojmë se s'kanë shkuar gjërat si duhet, sepse në fund të fundit, ky është opinionin nga jashtë, do të bëjmë ndryshime dhe marrim përgjegjësi për ato ndryshime.

U tha se pozita nuk ka nevojë të mbrohet. Është e vërtetë, aq më pak për këto 100 ditët e para, pozita nuk ka nevojë të mbrohet, s'kemi nevojë për t'u mbrojt. Ne normalisht do të flasim në mënyrë afirmative për ato që ne mendojmë dhe i besojmë këtij programi dhe atyre punëve që i kemi filluar.

Megjithatë, për 100 ditë nuk mendoj se duhet të futemi në garë sa kemi bërë e pse s'kemi bërë, sepse para se gjithash janë 100 ditë dhe të gjithë këtu, e sidomos disa që unë i njoh këtu, njerëzit me përvojë edhe profesionale edhe politike, e dinë se nga 100 ditët e para nxirren disa shtylla që të jepen orientime të qarta se a ka ndryshime cilësore në qasje dhe në atmosferë, në orientimin që do të shkojë, a ka dhënë diçka premtuese kjo qeveri për këto 100 ditë të cilat të japin të besosh se gjërat do të shkojnë në drejtim të duhur. Unë mendoj se po. Do të gjeni shumë elemente premtuese që ka dhënë në këto 100 ditë qeverisja aktuale se gjërat do të shkojnë shumë më mirë se që ka qenë në të kaluarën dhe sigurisht që në të ardhmen do të vjen edhe një qeveri që do të bëjë edhe më mirë se kjo dhe në fund të fundit ne shkojmë në këtë frymë.

Prandaj, nuk kemi nevojë për t'u mbrojtur, por është detyrë e jona normalisht që t'i paraqesim ato pjesë afirmative për të cilat ne mendojmë dhe besojmë se duhet të realizohen dhe janë në interes të vendit tonë.

U fol rreth asaj se a ka qenë informatë apo raport. Të nderuar kolegë, ju e dini, sepse po ashtu keni përvojë edhe në aspektin e letrave oficiale zyrtare dhe dihet çka është letër zyrtare. Letrën zyrtare, e keni secili para veti. Ajo vlerësohet dhe mbi bazën e saj referohet. Letra zyrtare e Kryeministrit e drejtuar Parlamentit është një informatë, ndërsa në dokumentet që i keni përpara ku shkruan raport, nuk ka kurrfarë lidhje. Kurrfarë kundërthënie nuk ka. Është me rëndësi se iu ka drejtuar institucioneve zyrtare dhe në këtë rast i është drejtuar Parlamentit se do të japë një informatë. Prandaj, mendoj se kjo terminologji veç sa humb kohë dhe nuk është shumë e dobishme, ndoshta edhe vetë qytetarët t'i lodhim me këso çështjesh procedurale.

U fol këtu rreth imazhit, që një deputet tha se Kryeministri e ka vetëm një preokupim – ngritjen ose ruajtjen e imazhit të vet. Jo! Kryeministri i Kosovës nuk ka nevojë të ngrit imazhin, sepse e kanë treguar këtë zgjedhjet e kaluara se cili është imazhi i tij. Kryeministri i Kosovës e ka detyrë kushtetuese për t'ia ngritur imazhin vendit të tij. Për t'ia forcuar imazhin qeverisjes së tij, që e kryeson, dhe mendoj se në këtë drejtim, për këto 100 ditë, kjo është një nga pikat më kulmore të qeverisjes aktuale. Ne kemi ndryshuar, kemi përmirësuar dhe kemi ngritur imazhin e kësaj qeverisje dhe të këtij vendi. Kjo nuk është çështje loje debatesh dhe fjalësh, por është një realitet i cili sot pranohet, vlerësohet dhe shprehen mirënjohje nga të gjitha institucionet ndërkombëtare.

Padyshim, kushdo që të futet në ato debate se kush ka bërë më shumë e kush më pak për pavarësinë e Kosovës, është humbje kohe e kotë, e panevojshme. Kjo duhet të harrohet dhe mendoj se në Parlamentin e Kosovës kësio fryme nuk duhet të ketë. Secili ka bërë aq sa ka mundur dhe ka ditur, ndërsa ne si grupacione politike kemi bërë të gjithë së bashku aq sa kemi mundur dhe ditur. Ju e dini se është krejt më se normale, pavarësisht se kush do të ishte në qeveri, për menaxhimin e situatës përgjegjësinë e ka qeveria. I keni bërë pyetje ministrit të Rendit dhe sikur të kishte ndodhur diçka, normalisht e kishit kërkuar ministrin e Rendit për gjendjen dhe problemet në rrugë, për incidentet e mundshme që kanë mund të ndodh e që, fatmirësisht, nuk kanë ndodhur. Domethënë, përgjegjësitë do t'i kërkonin nga organet qeveritare, gjë që plotësisht është normale.

Ne nuk jemi duke folur se kush ka merita më shumë në çështjen e pavarësisë, por ne jemi duke folur se ne, me ndihmën dhe mbështetjen tuaj, të Parlamentit të Kosovës, pavarësisht grupacioneve politike dhe të liderëve tuaj – e kemi menaxhuar në mënyrë të shkëlqyeshme periudhën e pavarësisë së Kosovës, për të cilën, edhe në këtë drejtim, kemi marrë respekt dhe lëvdata. Pra, këtu nuk është nevoja kush do të marrë gjerdanë më tepër. Ka marrë vendi, ka marrë procesi politik dhe ka marrë ajo që thashë më herët, imazhi i Kosovës. Imazhi i Kosovës është ngritur në kuptimin më pozitiv të fjalës.

Imagjinoni skenat e 17 shkurtit. Në Kosovë është festuar pavarësia, ndërsa në Beograd janë sulmuar ambasadat e huaja dhe kjo ka qenë një nga storiet në mediat e huaja. A ka mundur të ndodhin në Kosovë incidente? Kanë mund të ndodhin dhe tërë kemi qenë të shqetësuar për këtë. Nuk besoj që një njeri normal në Kosovë s'ka qenë i shqetësuar se mund të kemi ndonjë incident. Por, duke iu falënderuar përpjekjeve dhe angazhime, mesazheve të qarta të të gjithë neve dhe duke iu falënderuar, përfundimisht, qytetarëve të Kosovës, ne kemi arritur që të kalojmë shumë – shumë më mirë se sa që kanë pritur të tjerët. Dhe, besoni, secili, kudo që keni pasur kontakte, sepse jeni njerëz që keni kontakte edhe me faktorin ndërkombëtar, gjëja e parë që u është thënë, është kjo. Për këtë jam i bindur.

E thashë dhe po e përsëris. Nuk ka nevojë këtu për imixhe personale. Nuk ka pasur nevojë dhe s'ka nevojë as Kryeministri dhe nuk besoj se ka as Kryeministri, as Presidenti i vendit.

U tha se Kryeministri nuk di as çka ka nënshkruar! Unë nuk e di që Kryeministri ka nënshkruar diçka që i ka dëmtuar interesat e këtij vendi. Kryeministri jo që di çka nënshkruan, por paraprakisht Kryeministri mirë e di se çka është duke bërë. Dhe, ajo që është më e rëndësishmja, është se Kryeministri flet për ta kuptuar edhe qytetarët e Kosovës. Qeveria e Kosovës sot po flet dhe po vepron për të parë dhe kuptuar qytetari i Kosovës momentin e marrjes së vendimeve dhe ky është një ndryshim cilësor.

Unë mendoj se për 100 ditë ne jemi duke u munduar të heqim mjegullën, që është mbledhur goxha moti. Këto janë angazhimet tona, për të larguar mjegullën. Mendoj se po hyjnë disa standarde që do të shërbejnë, sepse dje kemi qenë në opozitë, sot jemi pozitë, nesër do të jemi opozitë dhe mund të jetë tjetër kush pozitë, që nënkupton standardet të cilat sot po hyjnë do t'i shërbejnë shumë qeverisjes së ardhshme. Janë standarde të reja, janë standarde të vendit, janë standarde demokratike dhe në shërbim të vendit që besoj se duhet vlerësuar nga të gjithë, sepse do ta kemi më lehtë, sikur që ne sot e kemi më lehtë sesa që e kanë pasur ata kur e kanë marrë udhëheqjen.

U fol shumë për ndërrimet e menaxhmenteve, qoftë të KEK-ut ose të ndërmarrjeve publike. Unë dua të them këtë publikisht, në cilësinë e ministrit, shumë publikisht dhe shumë transparent. Ndërmarrjet publike mbikëqyren, edhe me Kushtetutë, edhe me ligjin për ndërmarrjet publike, nga Qeveria e Kosovës. Ka shkuar koha për të bërë minishtete, miniqeveri. Në qoftë se ju kritikoni Ministrinë time, në këtë rast, mua, për Postën, për Aeroportin...

(Ndërprerje nga regjia – tejkalim i kohës për diskutim)

KRYETARI I KUVENDIT: Fjalën e ka Muzejene Selmani, e pastaj do të bëjmë pauzë dhe, po ashtu, do t'ju njoftoj edhe sa diskutues i kemi.

MUZEJENE SELMANI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Përshëndetje për Kabinetin qeveritar, njëkohësisht përshëndetje edhe për të gjithë deputetët brenda këtu në sallë,

Do të bëja një sugjerim për 100 ditët e para dhe për Programin qeveritar.

Kur para 100 ditësh të formimit të Kabinetit qeveritar, betimi në Parlamentin e Kosovës, që u bë nga Qeveria, shpresuam se disa nga premtimet parazgjedhore do të bëheshin realitet dhe se jeta e qytetarëve do të përmirësohej, me shpresë se në këtë Kabinet qeveritar do të mbizotërojë llogaridhënia, do të funksionojë më mirë se qeveritë e mëparshme, por deri më tani asgjë.

Koalicioni PDK-LDK nuk po duket se kanë ide se nga duhet të nisen të realizojnë qëllimet që i kanë parashtruar para vetvetes. Në realitet, 100 ditët e para të Qeverisë, së bashku me opozitën, mund të përshëndeten për punën e përbashkët për çështjen madhore të Kosovës. Mirëpo, në realitet, për 100 ditët e para të kabinetit ka arsye të shtrohet pyetja – kush e qeverisë në të vërtetë Kosovën - Qeveria, UNMIK-u, apo dikush tjetër.

Tash do të kalojmë te Programi qeveritar. Programi ka mangësi të shumta. Metodologjia e punës është bërë nga disa persona, por nuk është koordinuar puna rreth të gjitha pjesëve të programit. Nuk ka harmoni strukturale. Këtë po e ilustruj me faktin se kapitujt dallojnë në mes veti edhe për nga forma. Për shembull, kapitulli 3.1.1. Energjia dhe minierat, nuk është shtjelluar në të njëjtën metodologji si kapitulli 3.1.3, apo më i theksuar si kapitulli 3.1.4. Secili kapitull duhet të ketë strukturën standarde të përshkrimit, që nënkupton elemente të duhura për secilën fushë të programit.

Programi i Qeverisë 2008-2011 nuk i ka përfshirë të gjitha prioritetet. Për shembull, mungon prioriteti shumë me peshë në këtë fazë që po kalon vendi, e ky është integrimi i vendit në strukturat evropiane dhe me plotë përgjegjësi mund të themi se edukimi dhe sundimi i ligjit nuk e kanë vendin në kapitullin 3.1 – rritja ekonomike. Është dashur që këto dy fusha të jenë të trajtuara si politika prioritare të veçanta.

Në Program mungon fusha e industrisë, industria metalo-përpunuese, industria kimike, industria ushqimore, industria e gomës, e tekstilit, e lëkurës dhe e materialit ndërtimor, të cilat duhet të jenë bartëse të zhvillimit ekonomik të vendit, e janë përmendur vetëm kalimthi.

Te energjia dhe minierat, kapitulli 3.1.1. Programi i Qeverisë në këtë fushë është mjaft i zbehtë dhe kundërtënës.

Nëse në kapitullin 3.1.5 bujqësia dhe zhvillimi rural jep të dhëna të shumta për gjendjen dhe kapacitetet e kësaj fushe, atëherë në kapitullin që flet për energjinë dhe minierat janë dhënë vetëm sipërfaqësisht. Thuhet vetëm se Kosova është e pasur me resurse dhe miniera.

Në kapitullin për energji, flitet për strategjinë 2005-2011, ndërsa në kapitullin 3.1.1.2 thuhet se synim kryesor, sipas strategjisë, dhe një pasus më poshtë thuhet se së shpejti do të përfundojnë përgatitjet për miratimin e strategjisë. Me këtë lihet të nënkuptojmë se strategjia e mëparshme duhet të përmirësohet tash nga kjo Qeveri e re, nëse ka hapësirë. Por, do të thotë se nuk ka strategji për këtë fushë, edhe pse është bërë një shtjellim i aktiviteteve sipas një strategjie, e cila në program thuhet se pritët të miratohet. Ky shtjellim, pa mbështetje në dokumentet e besuara ligjore, në strategji, në planin e veprimit, studimin e dinamikës dhe mënyrën e realizimit, sjell konfuzione për një vend, që thuhet se Kosova është e pasur, e më vonë thuhet se do të bëhet vlerësimi, rivlerësimi i burimeve natyrore.

Njëkohësisht do të ndalem edhe te Termocentrali Kosova C dhe miniera e Sibovcit, ku shumë pak sqarohet puna se si do të vazhdojë puna e këtyre dy sektorëve shumë të rëndësishëm.

Orientimi programor rreth koncesionit dhe privatizimit të KEK-ut, Postës dhe Aeroportit.- Një kujdes shumë të veçantë kisha për t'i propozuar Qeverisë që gjatë procedurës së privatizimit ose koncesionit të KEK-ut, të PTK-së dhe të Aeroportit duhet të jemi të gjithë të informuar se me privatizimin e deritashëm nga AKM kemi prodhuar vetëm probleme sociale dhe njerëz të papunë.

Njëkohësisht duhet në KEK të bëhet korporatizimi e pastaj të hyjë puna në koncesion. Kjo do të ishte e mirëseardhur për Ministrinë e Energjisë dhe të Minierave. Mirëpo, në të njëjtën kohë, në Program thuhet se po ashtu do të hulumtohen mundësitë për projektet me energji të erës, gjeotermale, diellore dhe burime tjera alternative të energjisë elektrike. Propozimi im do të ishte se energjitë alternative në çdo vend të botës janë shumë të shtrenjta, janë shumë të mira për ambientin, por janë shumë të shtrenjta dhe është mundësia shumë e vogël për Kosovën që të hyjë në funksion të këtyre energjive alternative.

Kisha për të sugjeruar Kabinetin qeveritar, pavarësisht se flas prej opozitës. Çdo vërejtje që bëhet në program të jetë e mirëseardhur për qytetarët. Nuk është programi vetëm që opozita të kritikojë, por është në të mirë të të gjithë qytetarëve të Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Mendoj se ka ardhur koha për një pauzë. Të lajmëruar për diskutim kemi edhe 17 deputetë, plus ministrat, që do të thotë se mund të jenë rreth 25 e më shumë diskutues.

(Ndërhyrje nga salla, nuk dëgjohet për transkriptim)

Jo, nesër nuk kemi mundësi. Atëherë, do ta vazhdojmë debatin derisa ta kryejmë dhe kjo është mundësia. Tash, kisha propozuar një pauzë prej 10-15 minutave dhe me këtë rast të zhvillojmë një bisedë me shefat e grupeve parlamentare.

Vazhdimi i seancës pas pauze

KRYETARI: Të nderuar deputetë, po e vazhdojmë seancën. Ne biseduam me shefat e grupeve parlamentare dhe nga ajo bisedë rezultoi që ata të cilët i kanë diskutimet të përgatitura me shkrim, le t'i dorëzojnë, dhe dy, diskutimet të përmbajtësohen dhe të shkurtohen. Nëse ka ndonjë deputet që vërtet do të flasë me çdo kusht, le të diskutojë, por mundësisht diskutimi të përmbajtësohet dhe të shkurtohet, në mënyrë që ta përfundojmë sot, sepse kemi punë të reja nesër, edhe Parlamenti, por edhe Qeveria.

A ka të tillë që dëshirojnë të heqin dorë nga diskutimi, që t'i dorëzojnë diskutimet me shkrim? Mendoj që ju e dini se transmetimi është ndërprerë në orën 17,00.

(Të qeshura në sallë).

Fillojmë me diskutime. Fjalën e ka deputeti Hydajet Hyseni, le të përgatitet Dragisha Miriq.

HYDAJET HYSENI: I nderuari Kryetar,
I nderuari zëvendëskryeministër,
Të nderuar ministra,
Zonja e zotërinj deputetë,

Debati për Raportin e Qeverisë dhe Programin qeveritar, natyrisht që edhe do të merrte këtë formë që ka marrë, bardhë e zi. Nuk ka asgjë të çuditshme, megjithëse, objektivisht po të shikojmë, ne ende nuk i kemi krijuar kushtet për një funksionim të mirëfilltë pozitë-opozitë. As pozita ende nuk mund të thotë se është me plot kuptimin e fjalës pozitë, dhe as opozita nuk është në situatë, në të cilën të ketë rolin opozitar në plan të parë. Për fat të keq, ose të mirë, më shumë të keq se të mirë, ne ende jemi të detyruar të përballemi me probleme e sfida që janë të karakterit universal, që janë elementar, që na përkasin të gjithëve. Prandaj, unë nuk e kam ndërmend të marrë në mbrojtje Qeverinë, as raportin e saj. Mendoj se edhe nuk është i nevojshëm, sepse Qeverinë më së miri e marrin në mbrojtje rezultatet, kur janë ato, të kota janë hilet e sulmet e tjera.

Vërejtjet e kritikave konstruktive e ndihmojnë Qeverinë dhe unë jam i bindur që Qeveria do t'i kuptojë si të tilla. Ato që nuk janë konstruktive, ani, u kthehen bumerang atyre që i bëjnë.

Pa u fiksuar se mund të bie, të shkas në pozicionin apo në gjetje të Qeverisë, megjithatë nuk mund të mos jem i lirë që të theksoj kënaqësinë që Qeveria, vërtet ka pasur një fillim impresiv, të efektshëm.

Më lejoni vetëm t'i referohem rritjes së buxhetit, sidomos investimeve kapitale, zvogëlimit të shpenzimeve në mënyrë të ndjeshme, heqjes së problemit të qirave, absurdit tonë që ndërtesat e Qeverisë të shfrytëzoheshin nga privatët, kurse Qeveria u paguante para të mëdha privatëve për qira, e të tjera. Dhe shumë suksese të tjera që mendoj se janë, vërtet, fillim i mbarë dhe unë jam i bindur që edhe opozita, hapur ose fshehur, nuk mund të mos jetë në favor të tyre, nuk mund të mos i mbështes ato.

Qeveria ka prezantuar një raport të detajizuar që nuk ka qenë praktikë përpara. Është një transparencë e plotë dhe një program solid, do të thosha, orientimet e përgjithshme të angazhimit të saj në të ardhmen. Ajo që më bën përshtypje është se ky program, në pjesën më të madhe është kufizuar në 4 -5 prioritetet, që edhe janë vërtet prioritare, por mendoj se ka edhe prioritetet e tjera që duhet të ishin dhe janë po aq të rëndësishme.

Nuk e kam të lehtë të mësohem me atë sintagmën - implementimi i statusit, shqyrtimi i koston së implementimit të statusit, e të tjera. Së pari, statusi e ka emrin tash të qartë - shtet i pavarur dhe sovran dhe ne duhet tash të punojmë që ta realizojmë, ta bëjmë, ta ndërtojmë shtetin, apo jo, dhe koston duhet ta kishim pasur parasysh edhe përpara. Sfidat janë edhe ekonomike, janë edhe ligjore, institucionale, por janë edhe politike, dhe mendoj se përja për t'i reduktuar këto sfidat politike mund të jetë, po ashtu, me rreze.

Unë mendoj se nuk mund t'i kontestohet Qeverisë orientimi i përgjithshëm për ta vazhduar kursin e finalizimit të plotë të zgjidhjes së çështjes së Kosovës, për të mundësuar institucionalizimin e mëtejshëm dhe kompletimin e funksionimit institucional, konsolidimin e ekonomisë, partneritetin e duhur me faktorët ndërkombëtarë dhe atë që është quajtur me emra të ndryshëm, por që është edhe realizimi i standardeve të avancuara për të drejtat e njeriut dhe veçanërisht për të drejtat e komuniteteve minoritare. Askush këto nuk i ka kontestuar dhe nuk mund t'i kontestojë pa rrezikuar që të gabojë.

Qeveria i ka parashtruar vetes detyra që të dalë e suksesshme në të gjitha këto plane dhe ne i urojmë që në fund të mandatit ajo t'i dhjetëfishojë sukseset e saj, por mendoj se duhet të fokusojmë dioptrinë tonë në këto sfidat edhe politike, të cilat më pak u theksuan këtu.

Programi qeveritar është vlerësuar si bazë për funksionimin e shtetit të Kosovës si shtet i qytetarëve, kështu apo..., dhe është në rregull, por kjo na kthen përsëri te ai konfuzioni që e kishim edhe në Kushtetutë, edhe në disa ligje sistemore rreth asaj kur në një vend përcaktohem për funksionim të shtetit si shtet i qytetarëve, kurse përnjëherë në kapitujt pasues ne shkasim në konceptin e etnicizimit të komuniteteve dhe bëhemi robër të ndarjeve në këto baza. Konsideroj që këto probleme gjatë zbatimit në jetë nuk do të mund t'i anashkalojmë, sado të zhdërvjellët që të tregohemi.

Për të qenë pak më konkret, ne mund të angazhohemi, siç edhe bëjmë në Programin qeveritar, për implementimin e angazhimeve tona lidhur me decentralizimin, por fakti që në këtë çështje ne kemi shkarë në pozita të paqëndrueshme, që janë në kundërshtim edhe me Kartën Evropiane për Pushtetin Lokal, do jetë problem. Mendoj që është e udhës që partneritetin ndërkombëtar tani ta konsolidojmë, ta kthejmë në partneritet të përgjegjshëm, me fakte, me argumente, gjithnjë në funksion të realizimit të synimeve që Kosova të jetë, vërtet, kampione e avancimit të standardeve evropiane edhe në fushën e raporteve komunitare, e të tjera. Mirëpo, nëse ne i ndajmë, ta zëmë, monumentet fetare mbi baza të përkatësisë fetare, marrim në mbrojtje një palë monumentesh dhe i injorojmë të tjerat, ne jemi në kundërshtim me parimet e UNESCO-s dhe këtë duhet ta kemi parasysh, ose, me radhë, edhe në fusha të tjera.

Mendoj se jam në rendin e ditës, sepse janë orientimet e Qeverisë dhe po ashtu nëse flasim për angazhimet e ministrive, secilës veç e veç, nuk mund të mos i mbështesim drejtimit e angazhimit të secilës ministri, por pa përsëritur disa nga theksat që i patëm këtu përpara, nuk mund të mos theksoj faktin që, ta zëmë Ministria e Drejtësisë, vërtet, kufizohet vetëm me një angazhim konkret, një agjencion që, kur të jenë në pyetje paratë, të jetë një agjencion i posaçëm. Unë kam qenë i angazhuar për disa vite në Sektorin e Gjiqësisë, kam qenë anëtar i Këshillit Gjyqësor, për herë të parë e kam parë në këtë dokument një gjë të tillë, e pse u dashka pikërisht kur të jetë puna te paraja, tash të bëhen disa agjencione të tjera.

Për më tepër, shtrohet pyetja: e ku mbeti transformimi i pushtetit gjyqësor, i sistemit të drejtësisë? Çka u bë me sistemin e verifikimit? Çka me padrejtësitë e sistemit të kaluar të drejtësisë? Dhe më lejoni këtu që të jem pak ekskluziv, ka vite që është kërkuar në programin e përparshëm qeveritar, të ligjvënies, ka qenë futur rregullimi me ligj edhe i çështjes së ish të burgosurve politikë. Tani nuk e shohim, në prioritetet e Qeverisë ka qenë e theksuar si një nga prioritetet. Kërkojmë që kjo çështje të gjejë vendin e duhur.

Po ashtu, çështje të rëndësishme, si çështja e pensioneve, po edhe çështja e pasqaruar e Fondit Pensional. Çka u bë me atë Fondin Pensional? A është çështja e pensioneve dhe a duhet të jetë edhe në të ardhmen si ndihmë sociale, përkujdesje sociale, apo është një e drejtë që Kosova ende nuk ka arritur ta realizojë. Unë besoj se Qeveria do të angazhohet më shumë në kompletimin e programit në këto drejtime.

I është kushtuar një vend jo sa duhet, ndoshta, çështjes së zhvillimeve në fushën e ekonomisë dhe u bënë vërejtje. Unë nuk mund të mos i mbështes, por mendoj se edhe situata e krijuar tani me bllokimin e procesit të privatizimit, edhe me të drejtë, sepse në shumë raste ka pasur abuzime që janë kontestuar me të drejtë edhe në këtë Kuvend. Por, situata pa rrugëdalje, pa një alternativë, mund të jetë e rrezikshme. Qeverisë i takon që të ofrojë zgjidhje...

KRYETARI: Ju faleminderit! Dragisha Miriq, nuk është ë këtu. Tani fjalën e ka deputetja Rita Hajzeraj, le të përgatitet Qamile Morina

RITA HAJZERI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

I nderuar Kabinet qeverisës,

Të nderuar dhe të respektuar deputetë,

Në gjithë këtë proces të ndërtimit të institucioneve sa më të qëndrueshme dhe demokratike të Kosovës, shqetësues mbetet fakti se kjo qeveri nuk ka arritur as pas 100 ditëve ta hartojë një program të qartë qeverisës, ku do të projektoheshin veprimet konkrete të tyre në të ardhmen.

Pas 100 ditëve pa program, kjo qeveri na ofron një program qeverisës jashtëzakonisht teorik, të përgjithësuar, i cili nuk tregon në asnjë rast veprimet praktike të Qeverisë për përmirësimin e jetës së qytetarëve të Kosovës.

Është shumë evident fakti se kjo qeveri përmes këtij programi synon t'u shmanget kritikave të opozitës, duke përgjithësuar objektivat e saj dhe duke mos planifikuar veprime konkrete për projekte të caktuara. Çdo kund në këtë program kemi vërejtur se cekën fjalët: do ta arsyetohemi, do të angazhohemi, do të shqyrtojmë, do të analizojmë, e askund rast konkret. Në të njëjtën mënyrë, Qeveria e Kosovë u shmanget edhe datave për fillimin dhe përfundimin e projekteve, duke mos dhënë kështu as shifra për mbulimet buxhetore.

Veprimet e deritashme të Qeverisë i kemi parë të gjithë. Shqetësues mbetet fakti se mbi cilën bazë programore do të punojë Qeveria në ditët e ardhshme. Ndoshta përmes këtij programi ju mund ta kuptoni se ku doni të arrini, por asnjëherë nuk do ta keni të qartë se si do t'i arrini objektivat tuaja?

Ne nuk mund ta kuptojmë se si do ta arrini qëllimin pa ditur rrugën. Nëse keni ndonjë projekt në mendjet tuaja, mund të na tregoni dhe të na bindni se të paktën keni menduar për mirëqenien e qytetarëve të Kosovës.

Programi qeverisës do të duhej të ndërtohej mbi programin elektorale që keni ofruar gjatë fushatës dhe mbi premtimet që keni dhënë kur keni kërkuar votat e qytetarëve, sepse përmes atij programi elektorale dhe atyre premtimeve madhore, ju keni marrë besimin e qytetarëve për të qeverisur.

Është e natyrshme, se nëse nuk i keni menduar mirë premtimet tuaja, të paraqiteni sërish para qytetarëve, ndoshta, jo për t'ju thënë se i keni gënjyer, por për t'ju thënë se keni qenë të painformuar edhe për kapacitetet buxhetore, edhe për funksionimin e institucioneve qeverisëse dhe, për më tepër, keni qenë të painformuar mirë mbi kapacitetet tuaja udhëheqëse.

Andaj, e nderuara Qeveri, nuk do të shkoj aq larg sa të dyshoj se nuk i keni të qarta objektivat tuaja si Qeveri, por duke u bazuar në programin që na keni ofruar, jam e detyruar të besoj se vështirë të keni ndonjë vizion për t'i arritur ato objektiva. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Fjalën e ka deputetja Qamile Morina, le të përgatitet Agim Veliu.

QAMILE MORINA: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Deputetë të nderuar,

Vonesa 100 - ditëshe e Qeverisë së Kosovës për të sjellë programin në këtë Kuvend, duke shkelur të gjitha rregullat, ndoshta do të mund të arsyetohej nëse ne do të na ofrohej një program serioz i detajizuar në afate kohore si dhe me sqarimin e mënyrës së implementimit të tij.

Me ofrimin e një programi të tillë, që më shumë i gjason një vizioni, Qeveria ka humbur sensin dhe rëndësinë që e ka të privilegjes historike për ndërtimin e shtetësisë së Kosovës. Ajo që është brengosëse në këtë program, është që shëndetësinë Qeveria nuk e përcakton si prioritet dhe vizioni i ofruar në fakt nuk ofron asgjë të re dhe në këtë mënyrë paraqet vazhdimësi të qasjes joserioze karshi gjendjes tejte të rëndë në shëndetësi. Këtë e bazoj, duke analizuar pesë synimet kryesore të parapara me këtë program qeveritar për shëndetësi. Këto synime programore ekzistojnë që nga viti 2003, aq më tepër që këto janë të rregulluara me infrastrukturë ligjore ekzistuese.

Synimi i parë. Në programin qeveritar për shëndetësi ka të bëjë me krijimin e sistemit financiar të qëndrueshëm. Dua t'ju rikujtoj se në Ligjin bazë për shëndetësi, në nenin 57, përcaktohet obligimi i nxjerrjes së Ligjit për sigurime shëndetësore, kurse në nenin 124 përcakton obligimin ligjor, që Fondi për sigurime shëndetësore është dashur të fillojë më 1 janar 2005. Gjer më sot nuk është arritur të nxirret ky ligj, që është qenësor dhe jep shans rimëkëmbjes së shëndetësisë dhe, si duket, nuk parashihet as në të ardhmen e afërt, ngase duke pasur parasysh që në strategjinë legjislative për vitin 2008, nuk ka paraparë asnjë projektligj nga lëmi i shëndetësisë, që do të thotë as Ligjin për sigurime shëndetësore, si dhe nuk është paraparë ngritje e fondeve shëndetësore nga buxheti i Kosovës.

Pyetja ime do të ishte: A do të vazhdohet të punohet në shëndetësi me risk të vazhdueshëm financiar, si metodë më e keqe e mundshme e pagesave në një sistem shëndetësor. Thënë thjeshtë, a do të vazhdojmë t'i shohim pacientët tanë duke bredhur korridoreve të spitalit me qese të barnave?

Synimi i dytë në këtë program, ka të bëjë me riorganizimin e sistemit shëndetësor. Dua të theksoj se sipas nenit 122 të Ligjit për shëndetësi, riorganizimi në shëndetësi është dashur të përfundojë deri më 31 dhjetor të vitit 2004. Riorganizimi i sistemit shëndetësor nuk arriti të finalizohet dhe po ballafaqohet me shumë sfida dhe pengesa. Përkundër progresit të bërë, Kosova vazhdon t'i ketë indikatorët shëndetësorë më të ulët në Evropë. Një nga pengesat kryesore është financimi i pamjaftueshëm që rendohet edhe më shumë me nga keqmenaxhimi i mjeteve financiare, si dhe nga mungesa e llogaridhënies horizontale dhe vertikale të institucioneve, që fatkeqësisht janë negativisht të influencuara nga grupet e interesit të hierarkisë politike.

Si konsekuencë, punonjësit, menaxherët dhe organizatat nuk janë përgjegjëse për performansën dhe ekspertizën e tyre, që është direkt e lidhur me gjendjen shëndetësore të popullit të Kosovës.

Për depolitizimin e sistemit shëndetësor që funksion tash e tetë vjet në këtë bazë, përgjigja do të duhej të ishte në programin tuaj.

Synimi i tretë i këtij programi ka të bëjë me funksionalizimin dhe zhvillimin e sistemit informativ shëndetësor. Ju rikujtoj, në nenin 62 dhe 63 të Ligjit për shëndetësi, është paraparë zbatimi i obliguar i sistemit informativ unik dhe i integruar, që fatkeqësisht ende nuk është jetësuar dhe nuk është e sigurt ende, nëse janë nxjerrë aktet nënligjore nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë që mundëson jetësimin e tij. Natyrisht, jetësimi i këtij sistemi informativ kërkon mjete financiare dhe personel të motivuar, gjë që me buxhetin e tanishëm, dyshoj se mund të realizohet.

Sektori i shëndetësisë është kryesisht i centralizuar, dhe ajo që do të mund të pranohet si risi në këtë program, është decentralizimi i buxhetit, të resurseve njerëzore dhe të investimeve që do të kenë efekte pozitive në sektorin shëndetësor. Decentralizimi është mënyrë e preferuar e organizimit shëndetësor të tipit Bizmark, bazuar në ekonominë e tregut dhe është synimi i vendeve në tranzicion. Mirëpo, si do të realizohet kjo në sistemin tonë shëndetësor, nuk është e qyrtë? Tri periudha të shkruara në këtë program, nuk mjaftojnë të kuptohet.

Në këtë program nuk sqarohet si do të bëhet rritja e pagave të punëtorëve shëndetësor për katër vitet e ardhshme, të cilat tash e tetë vjet asnjëherë nuk janë rritur përkundër pakënaqësive të tyre të shprehura disa herë me grevë. Mënyra e pagesës së tillë demotivon personelin mjekësor, rrit mundësinë e pagesës informale, rrezikon degradimin profesional dhe edukimin e vazhdueshëm.

Ato që i mungojnë këtij janë: programi lidhur me sektorin farmaceutik, programi i shkarkimit të institucionit terciar, të Qendrës Klinike Universitare me ndërtimin e spitalit të qytetit, programi për integrimin e sistemeve paralele shëndetësore në sistemin unik për tërë territorin e Republikës së Kosovës, si dhe pika më e ndjeshme në sektorin shëndetësor është mungesa e vlerësimit dhe e kontrollit të cilësisë së kujdesit shëndetësor, duke pasur parasysh se Kosova nuk ka një mekanizëm të vlerësimit të tillë.

Si përfundim, konkludoj se ne jemi shumë të vonuar në krijimin e sistemit të mirëfilltë shëndetësor, jo me programe dhe me letra, por në praktikë. Andaj, Qeveria duhet të ketë plane kohore të zhvillimit të legjislacionit të nevojshëm, me theks të veçantë në Ligjin për sigurime shëndetësore, dhe ajo që është më e rëndësishme, të bëjë zbatimin e legjislacionit ekzistues, si dhe të krijojë prioritete brenda programit të saj. Obligimi i kësaj qeverie është të reformojë sistemin shëndetësor, ashtu si i takon një shteti, sado i ri që është, ta reformojë ashtu si duan ta shohin profesionistët dashamirës të kësaj fushe, ashtu si kanë nevojë ta kenë studentët tonë, ashtu si kërkojnë ta kemi qytetarët e Kosovës, duke kuptuar se çdo njëri prej tyre mund të jetë kandidat potencial për të, e po ashtu ne të gjithë, të nderuar në këtë Kuvend, nuk përjashtohemi nga kjo mundësi.

Çështja tjetër, që është brengosëse në programin qeveritar, është që as me një fjalë nuk përmendet Mitrovica veriore dhe qytetarët e saj. Mitrovicasit pas lufte përjetuan jetën më të rëndë të mundshme në Kosovë. Çdo herë gjatë fushatave shumë u premtuhej që menjëherë më pas harroheshin dhe lireshin të merren me vetveten.

Tani, deputetë të nderuar, me realitetin e ri të krijuar në shtetin tonë, ata më shumë se kurrë me të drejtë presin qasje, veprime dhe vendime të përgjegjshme të institucioneve të shtetit të Kosovës.

Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Agim Veliu, le të përgatitet deputeti Arsim Rexhepi.

AGIM VELIU: Ju faleminderit, Kryetar!

I nderuar zëvendëskryeministër,

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Në fjalën time, që tani do të mundohem ta shkurtoj në masë të madhe, do të mundohem të jap disa komente të përgjithshme dhe do të ndalem në ndonjërin prej sektorëve të Qeverisë.

Objektivat janë të përgjithësuara, duke mos lënë mundësi që të kontrollohen se a janë arritur apo jo. Këto duhet të shprehen në termat e matshëm, në mënyrë që në fund të mandatit të dihet a janë arritur dhe sa për qind janë arritur.

Në faqen katër thuhet se Kosova po transformohet drejt ekonomisë së tregut. Në fakt, me sa unë kam njohuri, në Kosovë është ekonomia e tregut gjatë këtyre viteve dhe është ekonomia më liberale në rajon.

Tek rritja ekonomike nuk janë parashikimet e rritjes ekonomike dhe nuk janë identifikuar burimet e rritjes. Pastaj, gati në të gjitha fushat prioritare përmenden strategjitë e mëparshme, si strategjia në fushën e energjisë, në fushën e arsimit, në fushën e bujqësisë, kështu që programi duhet ta bëjë të qartë se Qeveria do ta çojë më tej programin e Qeverisë së kaluar dhe nuk ka vizion të vetin. Nga një këndvështrim, kjo mund të merret pozitive pasi kjo qeveri e bënë të qartë kontributin e Qeverisë së mëparshme.

Do të kaloj te arsimi. Synimet strategjike në fushën e arsimit mendoj se janë në linjë me orientimet zhvillimore të arsimit në vendet e zhvilluara dhe, si të tilla, janë me vend. Një

gjë e vogël, por jo e parëndësishme, nuk duhet përzier termin “arsimim” dhe “edukim”, pasi këto janë dy gjëra të ndryshme dhe si rezultat nënkuptojnë edhe politika të ndryshme.

Kjo qeveri e ka shumë më të lehtë, sidomos në fushën e arsimit, ku qeverisjet e kaluara patën zhvilluar strategji detale për arsimin parauniversitar dhe arsimin e lartë, si dhe mekanizmat dhe masat për implementimin, bashkë me buxhetin përkatës. Në një masë, objektivat strategjike të parapara nga qeverisja e kaluar janë reflektuar edhe në këtë program qeveritar, që është pozitive. Qeveria duhet ta ketë të qartë se një numër i masave në fushën e arsimit janë të rregulluara me dokumentin e Ahtisarit, kështu që nuk mbetet shumë diskrecion, sidomos tek kompetencat mbi arsimin parauniversitar.

Me rolin në rritje të komunave, Qeveria duhet të bëjë përpjekje, të rrisë kapacitetet lokale për të implementuar reformat në arsim, të cilat i pretendon. Masat që propozohen nuk janë të elaboruara si duhet dhe nuk janë shumë konsistente. Për shembull, masa numër një, krijimi i një sistemi të përbashkët të arsimit dhe të aftësimeve. Duhet ditur se Kosova ka ende nevojë për forcim të arsimit në njohuritë bazë.

Lidhja me ekonominë është tepër e rëndësishme, sidomos në arsimin profesional, por njohuritë bazë arsimore janë kyçe për sukses në tregun e punës. Një person që nuk e din mirë gjuhën dhe matematikën, mendoj është e kotë t’ia mësosh kompjuterin.

Kur jemi te kompjuterët, për hir të donatorëve dhe të informimit publik, unë e them se shkollat e Kosovës sot kanë me mijëra kompjuterë që i shfrytëzojnë dhe është mirë që kjo informatë të jepet edhe prej Qeverisë, pse jo.

Masa numër dy. Një arsim fillon dhe të mesëm për të gjithë qytetarët e Kosovës, është e qëlluar, porse aktivitetet që do të ndërmerren mund të mbesin në listë të dëshirave për shkak të kufizimeve buxhetore dhe të kufizimeve të tjera. Disa nga masat janë arbitrare, për shembull, themelimi i dhjetë mekanizmave të ri dhe cilësorë për jetësimin e shërbimeve efikase, arsimore. Është mirë që të tregohet efekti i ndërtimit të 300.000 m² hapësirë shkollore në përfshirjen e nxënësve në arsim, aftësimi i 27.000 mësimdhënësve, gjithashtu, do të jetë një sfidë, pastaj masa e tretë e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë, të gjitha masat në arsimin e lartë janë adekuate dhe të kontribuojnë, padyshim, në përmirësimin gjendjes.

Problemi është se shumica e këtyre masave nënkuptojnë ngritjen e kapaciteteve institucionale të arsimit të lartë. Këto masa janë të karakterit afatgjatë dhe Qeveria e kaluar ka bërë hapa të konsiderueshëm në këtë drejtim, që kanë filluar tani të japin edhe efekte. Ajo që duhet bërë kjo qeveri, është të ngrit edhe më autonominë universitare, praktikë të cilën e ka filluar Qeveria e kaluar dhe të krijojë, mendoj, mekanizma që sigurojnë llogaridhënie nga ana e universiteteve. Po ashtu, është e nevojshme që në Universitet të krijohen strukturat e qëndrueshme administrative.

Tani, së fundi, Qeveria ka marrë vendim për t’i ulur pagesat e studentëve në Universitetin e Prishtinës. Ne e përkrahim këtë vendim të uljes së pagesave, por presim që Qeveria të dalë me propozim konkret se si do t’i kompensojë ato të hyra për Universitetin e Prishtinës. Qeveria e kaluar ka bërë të pamundurën, që t’i stabilizojë të hyrat e Universitetit dhe të stafit që punon në Universitet përmes një kombinimi të të hyrave nga buxheti dhe nga të hyrat vetanake të Universitetit. U patën vendosur shkallë të ndryshme të pagesave për të bërë të mundur që me taksat e qytetarëve të financohen

kryesisht ata studentë që janë më të mirë. Të tjerët paguanin një çmim, që ishte prapë si subvencionuar. Kjo siguron që mësimdhënësit të jenë më të motivuar për të punuar në Universitet, sidomos kuadrot e reja dhe shkencëtarët e rinj, të cilët tentojnë të largohen nga vendi, duke krijuar efekte negative në gjithë shoqërinë.

Sidoqoftë, unë mendoj, në të gjithë duhet t'i mbështesim përpjekjet e Qeverisë në fushën e arsimit, pasi kjo është e vetmja rrugë drejt progresit ekonomik dhe shoqëror të shtetit tonë. Prandaj, të gjitha kritikët duhet të merren si konstruktive dhe me qëllim të përmirësimit të gjendjes dhe të sigurimit në të ardhme të ndritshme për fëmijët tanë.

Te sundimi i ligjit. Në faqen 26 është lista e strategjive që do të hartohen për luftimin e korrupsionit. Kjo nënkupton se do të shkojë mandati i kësaj qeverie duke përgatitur strategji. Në rastin e korrupsionit, kujtoj se nuk ka nevojë për strategji, aty duhet vetëm vendosmëri dhe aksione të vendosura, dhe mendoj se askush nuk ka të drejtë ta drejtojë gishtin kah tjetri pa i pastruar gjërat në oborrin tij.

Te politikat tatimore dhe administrimi, kjo pjesë është jashtëzakonisht e varfër. Thuhet se politikat tatimore do të ndërrohen, edhe pse pranohet se sistemi tatimor është i thjeshtë dhe efikas. Nuk propozohet asgjë se çfarë do të ndërrohet.

Zbutja e varfërisë dhe stabiliteti social, janë propozuar dy masa për zbutjen e varfërisë, pensionet dhe transferet sociale dhe shëndetësia. Këto janë masa me vend, por këto nuk e eliminojnë varfërinë me këto masa, familjarëve të varfër u sigurohet minimumi i jetesës, por nuk sigurohet që ata të dalin nga pragu i varfërisë.

Po e përfundoj me kaq, në mënyrë që t'iu lë edhe të tjerëve kohë.
Ju faleminderit!

KRYETARI: E ke shfrytëzuar gati krejt kohën. Fjalën e ka deputeti Arsim Rexhepi, le të përgatitet Alush Gashi.

ARSIM REXHEPI: I nderuari zoti Kryetar, Kolege deputete, kolegë deputetë, Oktavat e kritikës ndaj Qeverisë Thaçi, më shumë se substancë kritike janë një panik, të mos të them histeri, e grupeve të caktuara nga historia më e afërt politike e Kosovës, të cilët, siç duket, shumë zor po e përjetojnë daljen në opozitë. Ka shumë argumente që qytetarin e Kosovës, përfundimisht e bëjnë në krenohet me qeverisjen, me seriozitetin, me vullnetin dhe intensitetin me të cilin kjo qeveri e ka marrë këtë punë dhe po e kryen. Po i shkoj me radhë.

U tha edhe më parë, por u tha disi si kalimthi dhe nuk më bëri shumë të lumtur. Menaxhimi i shpalljes së pavarësisë është diçka e paparë dhe e papërsëritshme, një arritje me të cilën do të duhej të krenohesh secili prej nesh, qoftë opozitë, qoftë. Është fakt që shpallja e pavarësisë është sinkroni e flirimeve të pambarim që ky popull i ka falur në altarin e dëshirës për liri dhe demokraci. Por, menaxhimi, mënyra se si është mjeshtëruar deri në fund procesi i shpalljes, ajo është diçka për antologji, jo veç për popullin shqiptar. Ata që kanë pasur mundësinë të jetojnë nëpër botë dhe t'i shohin arritjet e mëdha të kombeve, këtë arritje që ne e kemi mjeshtëruar deri në atë pikë, deri në atë harmoni, është vërtetë antologjike.

Dikush e quajti të premtën, mos gabofsha Reality Show atë që zotëri Hashim Thaçi dhe ekipi qeveritar i tij na e shpërfaqën disa ditë më parë drejtpërdrejt në ekranet televizive. Unë mendoj se tendencat e tilla, inovacioni tillë për të shpërfaqur drejtpërdrejt para opinionit, tregojnë kulmin e transparencës dhe diçka të tillë ata që nuk kanë parë më parë, sigurisht që edhe e kanë vështirë ta kuptojnë.

Si qytetar që kanë kontakte me popullin, edhe ne, veç kush nuk do të thotë, se e kemi të qartë se besueshmëria e institucioneve tona shtetërore, në popull ka filluar të rritet dhe ky është një fakt.

Brenda këtyre 100 ditëve, për ata që po ju duket shumë i shkurtër ky program, unë e shoh ndjeshëm se kam më shumë rrymë dhe më shumë ujë në banesën time dhe ky është edhe një fakt për të cilin unë, bashkë me ju, kam vajtuar para këtyre 100 ditëve. Të gjitha kritikët ndaj kësaj qeverie, fillojnë me pyetje, thashë që në sfondin e tyre kanë një panik. Askush këtu nuk u ndal ta bëjë një analizë se si kjo qeveri e ka gjetur Kosovën, në çfarë gjendjeje. Veç po jua kujtoj, që një ndër eksponentët ministror të kohës së shkuar, thoshte:” I kam harxhuar paratë e babës, e nuk po i harxhoj paratë e ministrisë” Nuk ka pasur restorant në Prishtinë ku ju keni hyrë e nuk e keni gjetur nga një ministër duke ngrënë me para të popullit. Unë veç e di, unë veç e di dhe kam lajme shumë të sigurta nga kjo që e them, zotëri Hamiti, se kanë ngrënë me para tuaja, të miat e të atyre fukarenjve që nuk kanë çka për të ngrënë dhe kjo është krim (reagime dhe të qeshura në sallë). Po, ndoshta edhe ti ke hëngër me ta. Jo, kjo është shumë më serioze se çka pretendohet të thuhet, ju lutem. Janë 30 milion, 52 milionë para i ka harxhuar ish-Qeveria prej njerëzve që luten, që nuk kanë çka të hanë bukë, ju lutem!

Tendencat për t’i kursyer 30 milion është për antologji, është diçka që nuk e njohim, andaj edhe kritikojmë pa vend. A ka më tmerr kur kryetari i një qeverie, siç ishte zoti Çeku, në fund të mandatit të tij, del edhe thotë:” Unë nuk kam qenë kryeministër”. A ka lojë, a ka provokim, a ka nënçmim më të madh për këtë popull, t’i prish ti me muaj, me vite dhe të dalësh e të thuash: “unë nuk kam qenë kryeministër”. Marionetë e kujt ke qenë? Unë nuk di një shtet tjetër në botë që ka institucione arsimore më shumë se ne. Përditë në gazetë kemi lexuar. “u hap një universitet i ri”. Kisha ndjenjën që duhet ta dërgoj edhe gjyshen një ditë të kryej fakultet. Dikush duhet t’i mbush ato banka. Por, e di, nëse askush nuk e di, unë e di.

Një turp tjetër, që ishte made in Kosova, ishte lajmi që rriqrat na i mbysin njerëzit. Ju lutem, kjo flet për vetveten. Në sfondin e këtyre që u thanë, nuk di kush mund të kritikojë tash me kaq zell, me kaq dell këtë qeveri që sapo ka filluar dhe ka filluar shumë mbarë. Nuk po e them për t’ia bërë qejfin askujt, unë jam deputet i pavarur, të kuptohemi. Të lutem, por programi i kësaj qeverie, para se në këto 59 fletë po shkruhet në ato rrugët që nuk janë zgjeruar që 8 - 9 vjet, po shkruhet në rrymën që e kemi më shumë, në shkollat që po ndërtohen gjithnjë e më shumë dhe përditë. Kjo tregon se programi, para se në fletë, është në mendjen dhe në vullnetin e një grupi njerëzish që e kanë marrë fatin e këtij kobi për ta udhëhequr dhe për ta çuar përpara, dhe duhet ta përsëritet jemi apo nuk jemi opozitë. Por, kisha pasur shumë dëshirë që t’i them edhe disa fjalë rreth asaj se çka do të ishte, sipas mendimit tim, që do të duhej bërë që të ishte edhe më mirë. Mendoj se angazhimet në rrafshin diplomatik, ne jemi të vetëdijshëm se ka një ngecje në njohjen e pavarësisë të Kosovës, por kjo ngecje mendoj se nuk po bëhet për fajin tonë, por për shkak të një lëvizjeje gjithë botërore të anti-amerikanizmit. Në këtë drejtim do të duhej të punohej sigurisht më shumë.

U tha se një nga defektet e shoqërisë sonë në rrafshin shëndetësor është edhe mungesa e sigurimeve shëndetësore. Një popull që nuk e ka këtë problem të zgjidhur, e ka shumë vështirë të krijojë, të ketë thjesht shëndet më të mirë.

Ne folëm për shkollat që po ndërtohen, por nuk folëm për programet që duhet, ku do të duhej të fokusohet Ministria e Arsimit dhe unë mendoj që tash është koha e fundit që të fillohet me adaptimn e kurrikulave në të gjitha gjuhët, konform realitetit të ri, do të thotë krijimit të Shtetit të Kosovës.

Universiteti i Kosovës në Prishtinë është e pamundur të funksionojë si një dhe siç është. Ai, mendoj unë, dhe këtë do të ishte mirë ta analizojmë...

KRYETARI: Ju faleminderit!

Valla, merre si replikë, veç e ke lypur! Urdhëro, mere fjalën! (Të qeshura në sallë). Deputeti Sabri Hamiti e ka fjalën.

SABRI HAMITI: Kryetari im, i Kuvendit dhe i imi, tha që e ke lypur. Po, Kuvendi e ka atë punë, se këtu është mënyra e të folurit, e lyp, e merr.(Të qeshura). Ju lutem shumë, unë vetëm dua të them dy fjalë. Unë e pranoj sharmin e të folurit, sepse është interesant. Në Kuvend jemi dhe ekziston edhe figura në të folur. Megjithatë, këtu nuk duhet të flitet fjalamujtas, por duhet të ketë një argument përmbas dhe të mos entuziazmohet kushdo qoftë, qoftë edhe kolegu im që foli përpara, të flasë fjalamujtas, sepse nëse dikush thotë: “jo, me para të mia”, nuk mund t’i përgjigjesh: “pra, ti me ta”, sepse është gabim fantastik dhe, ky farë njeriu, që është i ri në Kuvend, do ta mësojë prej dite në ditë që nuk është kështu qysh po thotë, dhe e dyta, qysh në Antikën e vjetër...

KRYETARI: Ju faleminderit! Ju faleminderit! Arsim Rexhepi, replikë një minutë.

ARSIM REXHEPI: Zoti Hamiti, unë nuk e thashë në atë kuptimin negativ të fjalës: “Ju keni ngrënë me ta”, por thashë, rastësisht keni mund të jeni ulur aty dhe të jeni kënaqur duke ngrënë dhe duke pirë. (Të qeshura).Ju lutem, unë nuk desha që ju ta kuptoni në atë formën pezhorative, në asnjë mënyrë. A u sqaruam?

KRYETARI: Sabri Hamiti.

SABRI HAMITI: Zoti Kryetar, me rregulla të Parlamentit nuk ka të drejtë të më përgjigjet ai, as unë tash. Po, meqë është bërë provë këtu të flitet, po e them, faleminderit! Ai u korrigjua, u bë më finok. Faleminderit!

KRAETARI: Ju faleminderit prej të dyve. Fjalën e ka ministri, Alush Gashi, le të përgatitet deputeti Bujar Bukoshi.

ALUSH GASHI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

I nderuari zoti zëvendëskryeministër,

Ministra dhe shumë të çmuar deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Jam shumë i nderuar me mbështetjen e fuqishme të programit tim nga të gjithë diskutuesit që e kanë marrë në gojë shëndetësinë, qoftë nga pozita, qoftë nga opozita, qoftë të të varurve, qoftë edhe të të pavarurve.

Diagnoza e fillimit të mandatit u verifikua edhe sot, në këtë debat, dhe filluam të premten, se gjendja e shëndetësisë në vendin tonë aktualisht është një gjendje e

papranueshme, për të cilën ekziston një përkushtim i plotë i zyrtarëve të vendit tonë të gjitha niveleve, që në kuadër të mundësive të bëjnë të pamundurën që këtë gjendje ta ndryshojnë.

Unë, si i zgjedhur nga ju, sillem në bazë të kompetencave të cilat i ka Ministria e Shëndetësisë, që do të thotë dizajnimin e politikave të shëndetësisë dhe mbikëqyrjen e tyre, ndërsa nivelet tjera menaxheriale janë strukturat tjera, të cilat në sistemin tonë janë të ndara në tri nivele. Është niveli parësor, që është në nivel të komunës, është një nivel dytësor, ku zhvillohet puna në spitale, që ju takojnë rrethëve, rajoneve, apo tash në kohë të fundit i quajnë edhe distrikte, dhe është niveli i tretë, që është niveli terciar apo mjekësia universitare.

Që në ditën e parë të fillimit të punës, është përcaktuar që të angazhohem, që barërat të cilat merren në vendin tonë, të kenë një kontroll, që ai sistem të jetë i licencuar dhe të jetë i kontrollueshëm në kuadër të ligjit. Mu për atë, vizita e parë ka qenë në Agjencinë Kosovare të Produkteve Medicinale dhe aty botërisht jam zotuar se në tremujshin e parë të qeverisjes, ne do ta hapim Laboratorin kosovar të produkteve medicinale dhe ju ftoj në hapje ditën e enjte, në orën 10,00.

Nën dy, ekspertët për këto çështje kanë pasur shumë ankesa dhe shumë vështirësi me importin e barërave cilësore në vendin tonë. Këto vështirësi kanë qenë të krijuara për keqmenaxhim. Në këtë mënyrë, këto pengesa i kanë krijuar grupet, të cilat kanë dashur që të keqmenaxhohen, të ketë përfitime në kurriz të qytetarëve të vendit tonë. Ilustrim për te, ju ftoj që ta vizitohet Mazgitin. Depoja e Mazgitit, zonja e zotërinj deputetë, është demonstrimi publik i keqmenaxhimit të parasë publike dhe të donacioneve.

Nën tre, kam qenë i bindur se licencimi i të gjitha depove është i domosdoshëm. E kemi bërë licencimin. Kam qenë i bindur se licencimi i farmacisë së vendit tonë duhet të jetë në kuadër të ligjit. Siç jeni në dijeni, ka pasur shumë orvatje teatrale para Ministrisë, nëpër zyra të ndryshme të nivelit tonë, qoftë lokal apo qendror me këtë çështje. Me udhëzim administrativ e kemi bërë një ndryshim, ku e përcaktojmë në mënyrë të qartë se kompetencë e kujt është çështja e inspektimit të farmacive. Edhe këtë çështje e kemi rregulluar.

Problemi i cili ekziston në ekonominë jo të shëndoshë në vendin tonë, manifestohet në mënyrë të drejtpërdrejtë në zhvillimin e shëndetësisë. Nuk ka shëndetësi të mirë pa ekonomi të mirë, por edhe nuk ka ekonomi të mirë pa popullatë të shëndoshë. Andaj, këtë çka e kam dëgjuar këto dy ditë, më lejoni që me dy tri fjalë t'ua them. Është e drejtë që ju keni kërkuar, edhe unë do të kërkoja që këto të fjalë të përshkruara në një ofertë në formë të programit për debat, ta kenë edhe pjesën tjetër të specifikuar. Në Ministrinë e Shëndetësisë, por jam i bindur edhe në të gjitha ministrinë tjera, ekzistojnë dosje komplete për tremujorin, për vitin e parë e deri në fund të mandatit.

Duke qenë i bindur se në vendin tonë, i cili ka kaluar një gjendje të represionit, të aparthejdit dhe të luftës, ne nuk mund të sillemi këtu, sikur..., këtu do të kishte qenë çdo gjë në rregull. Ne nuk mund ta institucionalizojmë vetëm ekonominë e tregut në sistemin tonë. Ne i kemi njerëzit e sakrificës për dekada dhe familjarët e tyre. Sistemi ynë me ligj tonë, është sistem solidar, por me ligj mundësohet edhe mjekësia private, andaj, që të dyja shkojnë paralelisht njëra me tjetrën. Dhe në këtë pjesën e mjekësisë private kemi bërë licencimin e 587 ambulancave të vogla dhe tash ka filluar licencimi i spitaleve private të vendit tonë.

Duke ditur se ky buxhet aktual nuk mund të mbulojë më tepër se 30% të listës esenciale, që në javën e parë të fillimit të mandatit, me vendim të Qeverisë kemi bërë një rishikim të butë të buxhetit në kuadër të kornizave buxhetore, të cilat i ka paracaktuar Qeveria e mëparshme, sepse ne këtu nuk kemi pasur revolucion, në Kosovë ka pasur zgjedhje dhe është ndërruar pushteti dhe kontinuiteti në fusha ku çështjet janë të rregulluara mirë, është çështje shumë normale. Andaj, në kuadër të atyre kornizave, buxhetin prej 9 milionëve për barëra në vitin 2007, të paraparë për vitin 2010/11, e kemi zgjeruar në 11.5 milion. Dhe jam i bindur se është e mundshme që ky buxhet edhe gjatë këtij vitit të rritet. Si? Ne kemi bërë një analizë të saktë se sa litra derivate naftë hyjnë në vendin tonë. Në vendin tonë, në vit janë 412 milion e 716 litra dhe Dogana e Kosovës përfiton nga to 164 milionë e 211 euro, ndërsa duhan importohen 2 milion e 664 kilogram dhe Dogana i përfiton 32 milion. Nga shpenzimet në alkool përfitohen 4 milion e 900 mijë. Sikur një 10% nga kjo pjesë e Doganës në këtë fazë të lidhet drejtpërdrejtë me shëndetësi, ne do t'i përfitonim 25 milion euro për medikamente. Sikur ne të kishim mirëkuptim, e besoj që autoritetet fiskale do ta marrin seriozisht kërkesën tonë, që gjatë regjistrimit të më se 300 mijë automjeteve, ne ta kemi një pako për shëndetësi dhe të gjitha këto i kemi marrë parasysh dhe e kemi përgatitur kornizën afatmesme për këtë çështje dhe e kemi dorëzuar këtë sipas kërkesës së Ministrisë së Ekonomisë së Financave.

Sa për ilustrim, për barëra në vitin e kaluar janë dhënë 9 milion, në këtë vit do të jenë 11.5 milion. Në vitin 2009, parashikimi jonë është 27.13, ndërsa për vitin 2010 do të stabilizohet, do të jetë 27 milion dhe në vitin 2011 e zbrisim në 25 milion, dhe kështu me radhë.

Për përmirësim të shërbimeve, puna e parë që kemi bërë, kemi insistuar që Inspektorati Shëndetësor të jetë në tri ndërrime në atë e cila e komprominton sistemin tonë, e që është emergjenca, Qendra Klinike Universitare. Dhe, krahasimi i muajit të parë me muajin e tretë është shumë inkurajues. Vërejtjet e Inspektoratit Shëndetësor, vërejtjet ditore, ne mund t'ua prezantojmë, kemi raport nga Inspektorati për çdo ditë në fund të orarit. Vërejtjet të cilat janë gjetur në muajin e parë, nuk gjenden sot në muajin e tretë. Do të thotë, punëtorët shëndetësorë, por edhe qytetarët i përgjigjen kësaj përgjegjshmërie të demonstruar këto ditë. Kemi kërkuar që në kuadër të ligjit, ne ta fillojmë gradualisht zbatimin e sistemit, apo të fondit shëndetësor, apo të sigurimit shëndetësor. Ne e kemi votuar në këtë Kuvend, por ai ligj ende nuk është nënshkruar, se është një ligj shumë gjeneroz, është ligj i cili e mbështet zhvillimin nëpër të cilin kemi kaluar, por i cili ekonomikisht ka shumë probleme, sepse nuk do të ekzistojnë ato mjete edhe për një kohë të gjatë. Prandaj, kërkojmë që Kuvendi të na mundësojë fillimin gradual të sigurimeve...

KRYETARI: Respekt për fjalën tuaj, ministër Gashi. Fjalën e ka deputeti Bujar Bukoshi, le të përgatitet Suzan Novobrdaliu.

BUJAR BUKOSHI: I nderuari Kryetar,
Kabinet qeveritar,
Zonja dhe zotërinj deputetë,

Pikësëpari një sqarim këtu. Edhe unë e kam udhëhequr një qeveri, Qeverinë e Republikës së Kosovës. Po sqarohemi, kjo nuk po flas për atë Qeverinë e Republikës së

Kosovës që e kam udhëhequr mbi 8 vjet, por për Qeverinë aktuale, që po ashtu quhet Qeveria e Republikës së Kosovës, dhe është kënaqësi të flasim për këtë kontinuitet.

E dyta, kjo Qeveri mendoj se ka mjaft predispozita të mira edhe ambicie të mira për të dhënë një rendiment. Si ish-kryeministër, nëse pajtohet një zotëri, se nuk po dua t'ia përmend emrin, se mandej bëhen replika, është kah mesi këtu, rreshti i tretë (të qeshura në sallë). Si ish-kryeministër nuk dua ta paragjykoj, pra, këtë rendiment. Mirëpo, synimet e Qeverisë, kur njeriu e lexon këtë program, janë për mua në rregull. E di se është vështirë edhe të bëhet programi. Edhe pse unë jam, po ashtu, kurioz të shohë mënyrën ose mënyrat se si do të arrihen ato objektiva që janë, që figurojnë në këtë program.

Ju lutem, mos pritni që për 5 apo 6 minuta tash, që unë po mundohem ta shkurtoj edhe hisen time të fjalës, zoti kryetar, edhe kësaj radhe mi ke marrë nja 4-5 minuta, dy borxhe po më bëhen. Nuk mund ta analizoj këtë program kështu në detaje, por do ta inkurajoja Qeverinë në renditjen e prioriteteve. Mirë është që ekonomia është kështu prioritet, ka prioritete të tjera, mirë është po ashtu që kjo Qeveri angazhohet për funksionimin e shtetit të Kosovës. Natyrisht, për këtë, mendoj unë, duhet me të vërtetë mençuri politike, guxim, vendosmëri dhe punë, por sidomos duhet një koordinim i mirë me bashkësinë ndërkombëtare prezentë, me atë prezencë të bashkësisë ndërkombëtare, duke e paralajmëruar atë për pasojat e gabimeve eventuale tani, nëse ato vazhdojnë në konsolidimin e shtetit të Kosovës, sidomos në raport me Serbinë dhe me politikën obstruktive të Beogradit.

Kolegë të nderuar dhe kolege të nderuara,

Alfa edhe Omega për këtë vend është sundimi i ligjit, do të korrigjohem, sundimi i së drejtës, si po thotë tash një koleg, më ekspert se unë. Të merr trishtimi kur dëgjon stejment deklaratë të ministreshës për Drejtësi, nuk ka replika, që drejtësia, sistemi juridik në Kosovë na qenka një xhungël. Po ashtu të rrokë trishtimi fizik, më lejon nga provenienca ime profesionale ndaj gjendjes së shëndetësisë, kur përkundër ambicieve dhe, do me thënë, me ta mbush mendjen kolegu ministër i Shëndetësisë, që ka një angazhim me të vërtetë kështu, një përkushtim, por unë do të kërkoja edhe në takimet e ardhshme llogaridhënie nga minsitri që të më tregojë se a mundemi ne, se ne të dytë sot mund të shkojmë në barnatore të blejmë drogë. Shpresoj që nuk ka transmetim tash direkt në televizion, të marrin vesh narkomanët. Ju e dini se narkomanët janë shumë inteligjentë, i gjejnë mënyrat edhe më të pa mundshme si të vijnë deri te droga. Sot, ju lutem, jo vetëm ne të dy, po kush të dojë mund të shkojë në barnatore, të marrë drogë, edhe droga të fuqishme, prandaj do të insistojmë në këtë që të koordinohen punët e Qeverisë, që të merren masat adekuate.

Në fund, edhe zëri i Kasandrës, pra, dhe ky është alarmi im. Ju faleminderit që qenka ashtu. Ju faleminderit, edhe këto janë lozhe zoti ministër. Alarmi im është edhe unë duhet t'ia drejtoj Qeverisë, të nderuara zonja deputete dhe zotërinj deputetë, këtë lloj të paralajmërimit tim që Kosova, ky shtet i ri, shtet foshnje, shtet zaif, zoti Hamiti, pa replika, ka probleme, ka një mal problemesh që do të ndeshen me rezidualet e nacizmit serb. Ju lutem, mos të harrojmë këtë, mos të habitemi me stratagjema. Ne do t'i përballojmë të gjitha këto probleme, por të jemi të vetëdijshëm se do të kemi probleme, do të na bien diellin mbi kokë nacizmi serb, rezidualet, mbetjet e nacizmit serb. Kushtunica bën marrëveshje me fashistin Sheshel që është në Hagë sot e kësaj dite, në bazë të burimeve të informatave serbe, s'di a janë edhe ato kështu, batuta. Por, sidoqoftë, besoj se pajtoheni ju të gjithë me mua për këtë aspekt shumë të rëndësishëm. Ju faleminderit për durim se, më duket, nuk e shkurtova prapë se prapë këtë fjalën time.

KRYETARI: Faleminderit! Jo, mirë e ke shkurtuar.
Fjalën e ka Suzan Novobrdaliu, le të përgatitet Naim Rrustemi.

Urdhëro, Sabri Hamiti, replikë.

SABRI HAMITI: Jo për ta kundërshtuar Bukoshin, por për ta shpjeguar publikisht që unë mendoj se m'u drejtuan duke pasur parasysh diçka që thashë unë në fillim, unë e kuptoj ashtu, për problemet që do t'i kemi në aspektin politik rreth ndodhive, rreth Kosovës dhe përzierjes, ta quaj me gjuhën popullore, të Serbisë edhe rreth atyre bisedimeve në atë, si i quajnë ata, në tokat ku banojnë shumica Serbe në Kosovë. Së paku unë kështu ju kam..., zotëri ish kryeministër i Republikës së Kosovës, dhe me kaq e mbaroj këtë fjalë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Replikë nuk ka. Fjalën e ka deputetja Suzan Novobrdaliu, le të përgatitet Naim Rrustemi.

SUZAN NOVOBRDALIU: Faleminderit, zoti Kryetar!

I nderuari Kabinet qeveritar,
Të nderuar kolegë deputetë,

Siç kanë thënë edhe parafolësit e mi, pa dallim opozitë – pozitë, unë mendoj që programi është shumë sipërfaqësor dhe është i mangët.

Nuk do ta zgjasë më shumë sa i përket kohës kur na është dorëzuar, mirëpo do të përqendrohesha vetëm në disa sfera, duke dhënë disa propozime për plotësime. Për shembull, në shëndetësi. Mendoj se ruajtja dhe parandalimi i sëmundjeve duhet të jetë thelbi i sistemit shëndetësor në Kosovë. Mendoj se shëndetësia e Kosovës duhet të bazohet në disa principe, siç janë profesionalizmi, kujdesi i barabartë dhe jo diskriminues për të gjithë qytetarët e Kosovës, efikasiteti, përshtatshmëria, kualitetet e kujdesit, qëndrueshmëria, përgjegjësia, transparenca dhe disiplina.

Gjithashtu, mendoj se duhet të eliminohen keqmenaxhimet e resurseve shëndetësore, duke krijuar zyra speciale që merren me monitorimin e cilësisë së mjekimit, monitorimin e shpërndarjes së barnave në spitale, monitorimin e pastërtisë.

Mbrojtja e të rinjve nga pasojat e neglizhencës, shkollimi i të rinjve për pasoja që manifestohen nga duhani, alkooli, droga, si dhe shtatzënitë e padëshiruara.

Siç theksoi edhe njëri nga deputetët, e dimë se qytetari i Kosovës për intervenime kirurgjike, siç janë ato të zemrës, të karotideve, apo të zgjerimit të aortave abdominale, anaureza, hemoterapitë dhe shumë e shumë sëmundje tjera, duhet të shkoj jashtë vendit dhe atë vetëm e vetëm për shkak të mungesës së kuadrove. Çka do të bëjë qytetari tek i cili nevojitet intervenimi jashtë vendit dhe i cili nuk ka mjete të paguaj këtë intervenim, i cili zakonisht kushton shumë shtrenjtë. Andaj, në këtë drejtim propozoj që të krijohen institucione të shërbimeve që i mungojnë vendit: Qendra Onkologjike, Reparti për Kirurgji Kardiovaskulare, Qendra e Rehabilitimit nga Përdorimi i Drogave, Instituti për Farmakologji Klinike për testimin e barërave vendore dhe të importuara me qëllim të kontrollimit të barërave që janë në qarkullim.

Gjithashtu, isha ndalur pak edhe në arsim. Mendoj se në nivelin parashkollor fillimi i edukimit të fëmijëve duhet të përkrahet qysh në nivelin parashkollor. Duket të bëhet ndërtimi dhe hapja e institucioneve parashkollore në numër të mjaftueshëm, siç është rritja e numrit të fëmijëve në programe parashkollore, si dhe vijimi qysh nga mosha më e vogël, do me thënë, në moshën 3 vjeçare për të ndikuar në socializmin e tyre, mësimin e hershëm dhe ofrimin e shërbimeve të kujdesit maksimal ndaj fëmijëve, fillimin e mësimin të gjuhëve të huaja, programin e pasur sportiv dhe kulturorë.

Niveli i arsimit fillor, gjithëpërfshirja e fëmijëve në nivelin e arsimit fillor, që do të thotë ofrimi i mundësisë së barabartë të shkollimit për të gjithë fëmijët e Kosovës, pa marrë parasysh dallimet qoftë sociale, etnike, apo vendet ku ata jetojnë.

Ndërtimi i shkollave dhe sigurimi i transportit edhe në viset rurale. Zvogëlimi i numrit të nxënësve nëpër klasa deri në 25 nxënës, duke krijuar hapësirë të nevojshme për secilën klasë dhe ofrimi i programit të mësimin në shtëpi ose spital për fëmijët të cilët për shkaqe shëndetësore nuk mund të jenë të pranishëm në shkollë edhe pse janë të regjistruar, për shembull, tek sëmundjet ku nevojitet një shërim më i gjatë kohor.

Niveli i arsimit të mesëm. Në sferën e edukimit duhet që arsimin e mesëm ta shndërrojmë në edukim të obligueshëm. Të bëhen programe të veçanta për zanate të specializuara në viset rurale me qëllim të përgatitjes së të rinjve për t'u bërë bartës të zhvillimeve në ato vise, si dhe të parandalimit e të zhvendosjes së tyre nëpër qendra të tjera.

Arsimi i lartë. Përmirësimi i gjendjes në Universitetin e Prishtinës, kontrollimi i universiteteve private, krijimi i qendrave universitare të vogla nëpër regjione të ndryshme të Kosovës, varësisht prej afiniteteve dhe traditës që ekziston në këto qendra.

Nxjtja e studentëve për kyçje në aktivitete bamirëse, duke ofruar shërbime vullnetare për pleq, fëmijë dhe të sëmurë, të cilat njëkohësisht rritin përgjegjësitë e tyre si qytetarë. Të sigurohen lehtësime të ndryshme për nxënës në shërbime publike, si mospagesa e biletave në mjete të transportit publik, në fusha sportive, teatër, kinema.

Konsideroj se nuk ju keni kushtuar aq rëndësi personave me aftësi të kufizuara apo me nevoja të veçanta. Ju në program përmendni të ndalohej braktisja e shkollave, do me thanë si preventivë, gjë që është paragjykim nga ana e juaj, zotëri ministër, sepse këtu duhet të mendohet për ofrim të kushteve sa më të mira për ta. Nuk e përmendni arsimimin e lartë për këtë kategori të personave, që e konsideroj si lëshim nga ana e juaj, sepse kemi persona me aftësi të kufizuara vetëm në aspektin fizik, ndërsa në aspektin mendor ata janë mjaftë të aftë ose shumë të aftë.

Pra, t'i kushtohet kujdes i posaçëm formimit të institucioneve, të shkollave në disa qytete të Kosovës, me kushte të cilat ju përshtaten fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe shkollimit të tyre në lëmin ku konstatohet se ata janë më të prirur. Kjo vlen si për arsim fillor, të mesëm dhe të lartë.

Tek sistemi pensional, pensionistëve ju keni kushtuar vetëm 3 rreshta. A mendoni se me rritjen e pagesës prej 40 në 75 euro dhe me ndërrimin e emrit nga ndihma sociale në pagesë pensioni, e keni zgjidhur problemin e pensionistëve. Besoni se jo. Në këtë drejtim duhet të bëni shumë më shumë, duke filluar nga rritja e pagesës së tyre në ndonjë shumë më të lartë, shumë më të lartë se 75 euro, mospagesa e biletave në transporte publike,

mos pagesa e barërave, sidomos te të sëmuret kronikë, duke i përfshirë në listën e të sëmureve, për mospagesë.

Gjithashtu, mendoj se duhet të bëhet edhe përmirësimi i gjendjes dhe i kushteve në shtëpitë e pleqve, si dhe hapja e shtëpive të pleqve, varësisht nga nevoja, lehtësimi i kushteve për pranimin e tyre, si dhe monitorimi i punës së të punësuarve dhe i kushteve në shtëpinë e pleqve. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Naim Rrustemi, le të përgatitet Hajdin Abazi.

NAIM RRUSTEMI: I nderuar Kryetar,
Të nderuar anëtarë të Qeverisë së Kosovës,
Të nderuar deputetë,

Unë sinjerisht do të jem shumë më i shkurtër se të tjerët, po ju premtoj këtë gjë. Diskutimi im sigurisht që ka qenë i nxitur nga diskutimi i shumë diskutantëve deputetë të Kuvendit të Kosovës dhe do të jetë i orientuar kryesisht në tri momente të caktuara. Siç është tema, kur është diskutuar ky Program qeveritar, është thënë se është një program pa plan.

Të nderuar deputetë, kemi parasysh që programet mund të jenë programe në perspektivë, mund të jenë programe si pozicion. Nuk është domosdoshmërisht e thënë që programi qeveritar të jetë program detaj dhe program plan.

Planet detale dhe ato do të kemi rast që t'i shqyrtojmë në kornizën afatmesme të shpenzimeve, që shpresoj se do të vijë te ne deputetët në muajt që vinë, apo në javët që vinë, do me thënë në kohën e ardhshme.

Çka do të thotë, në të vërtetë, që të jetë një program qeveritar si perspektivë dhe që ka një rëndësi të veçantë, gjithsesi mund të thuhet se ka perspektivë zhvillimore, ku u mundëson të tjerëve që të ndajnë idetë e veta dhe që të vendosin prioritetet e tyre në konceptin e qeverisjes së mirë, përfshirjes.

Programi i ofruar nga Qeveria dhe programi në perspektivë ka mundësi që çdo njeri prej nesh, por edhe të tjerët të përfshirë përmes veprimeve dhe /apo dëshirave për të bërë diçka në ndihmë zhvillimit të gjithmbarshëm të Kosovës. Kjo do të ishte një si hyrje teorike mbi teknikat e hartimit të programeve zhvillimore.

Tendenca që programi të konceptohet si plan, nga këndvështrimi im personal më bën që të ngrejë një pyetje: Program për çka? Për cilat resurse dhe për çfarë qëllimi? Ky program që na është ofruar ne, mundet gjithashtu të konceptohet edhe si pozicion që teoricienët do ta quanin pozicionim në kontekst.

Kur ne flasim për këtë program qeveritar, shumë shpesh prej shumë diskutuesve është potencuar se nuk ka limite kohore, se nuk janë dhënë të dhënat të sakta se çfarë zhvillimi ekonomik ne presim. Unë mund t'ju them se të dhëna të tanishme për gjendjen e ekonomike nuk është e mundur që të merren në Kosovë.

Të dhënat e fundit flasin se GDP-ia në Kosovë, që është llogaritur nga Fondi Monetar Ndërkombëtar para disa ditëve, flet për 3.7 miliardë, kurse vetëm disa javë më parë,

është llogaritur si 3.2 miliardë. Nëse veç do të kishim vendosur limite, atëherë në një të ardhme cili do të ishte ndryshimi mes asaj që jemi tani dhe asaj që do të vijë si proces i zhvillimeve të politikave qeveritare.

Gjithashtu, mund të themi se të dhënat statistikore që ekzistojnë në Kosovë momentalisht, flasin për një diskrepancë të madhe në përqindje. Për shembull, ekonomia informale llogaritet që është 30 deri 40%. Çfarëdo procesi, çfarëdo aktiviteti që do të ndërmerret dikush, nëse është një përafrim kaq i gjerë, një përafrim prej 10%, e bën që të jetë jo lehtë i matshëm në një të ardhme të afërt. Kur kihet parasysh të gjitha këto, atëherë sa do të mund të ishte kjo efikasë që të vendosen limitet gjatë procesit të realizimit. Unë mendoj që ky është një prej momenteve kreative, ku programi qeveritar të ofrohet si program në perspektivë.

Kurse, sa i përket programit qeveritar që na është ofruar, mendoj se Qeveria ka bërë një hap të mirë që e ka vendosur pikën 3.3 si qeverisje e mirë, por ta kem parasysh se qeverisja e mirë është ide, ide që është pranuar nga të tjerët, është pranuar nga të gjithë ne. Dhe prapë këtu kemi një moment, që prapë është një novacion. Novacion kur me momentin e krijimit të Kabinetit të qeverisjes së mirë është pranuar ideja e qeverisjes së mirë, jo kategorizim qeveri e mirë, apo qeveri e keqe. Qeveria e mirë, të nderuar deputetë, karakterizohet me karakteristikat e veta, ku pjesëmarrja në procesin e vendimmarrjes është e orientuar drejt participimit, është e orientuar drejt marrjes së vendimeve me konsensus, është e orientuar ndaj efektivitetit dhe efijencës, barazisë dhe përfshirjes, dhe përcjell sundimin e ligjit. Këto janë disa prej karakteristikave që janë adaptuar në Konferencës e Lisbonës nga Komisioni Evropian.

Gjithashtu, me konceptin e qeverisjes së mirë ne jemi pajtuar, si ide, që të kemi mbikëqyrje të veçantë se korrupsioni minimalizohet. Këndvështrimet e grupeve dhe zërat të dëgjohen prej grupeve të cenuara në procesin e vendimmarrjes. Kështu që sugjerimi i imi do të ishte që pika 3.3 edhe nëse largohet prej konceptit, prej programit qeveritar, sepse është pikë që është ndërsektorale nëpër tërë programin zhvillimor të qeverisë.

Këto do të ishin vetëm disa prej pikave që unë desha t'i transmetoj dhe ti ndajë me të tjerët. Faleminderit!

KRYESUESI IBRAHIM GASHI: Faleminderit, deputeti Rustemi!
Fjalën e ka deputeti Hajdin Abazi, le të përgatitet Eset Cakolli.

HAJDIN ABAZI: Zoti Kryesues,
Të nderuar ministra,
I nderuar zëvendësministër,
Të nderuar kolegë dhe kolege,

Ky është një çast në të cilin ne po diskutojmë dhe secili nga këndvështrimi ynë po përpiqemi ta japim kontributin tonë të paktën që të tregojmë dhe të shprehim gatishmërinë tonë për të dhënë ndihmën për aq sa mundemi në këtë kuadër. Megjithatë, Programi i Qeverisë që na është ofruar bashkë me informatën, ne na japin një material vërtetë që na krijon mundësi për të debatuar rreth këtij sikur se që edhe po shihet, ne u detyruam ta zgjasim sot këtë seancë vetëm e vetëm që gjithsecili nga ne të shprehet.

Ajo çka unë do të thosha se ky program ndoshta ka shkaktuar pak më tepër debat, është ajo se i mungon një lloj, ta them si hyrje, ku do të ishin bërë paraqitjet e gjendjes

ekzistuese se në çfarë gjendje konkretisht e ka trashëguar Qeveria e tashme e Kosovës gjendjen në kuadër të Qeverisë dhe në të gjitha ministrinë. Me siguri atëherë do të na pakësohej shumëçka për të thënë sepse do të shihej pasqyra çka kemi trashëguar dhe çka Qeveria planifikon që të shkojë më tutje dhe besoj që kjo të paktën do të bëhet në të ardhmen.

Këtu tani u shtruan një varg çështjesh që duken edhe u shpreh një lloj tendencioziteti në qëndrime ose në perceptime të ndryshme. Për shembull, disa thonë se Qeveria ka bërë mirë që vazhdon kontinuitetin e Qeverisë së mëparshme, të programeve dhe të projekteve që kanë pasur të tjerët për ta, pa ndonjë qëllim të caktuar, por po më duket vetëm sa për folur. Për ta hedhur poshtë këtë, thonë se Qeveria po vepron sipas programit të Qeverisë së kaluar. Ne duhet të mësohemi se jemi institucionalistë dhe si institucionalistë ne do të vazhdojmë atë gamë të punëve që kemi marrë për të ecur më tutje në sendërtimin e pjesëve të reja.

Personalisht, Programin e Qeverisë e konceptuar si një program të sanimit të gjendjes ekzistuese dhe një program të hapjes së perspektivës në të ardhmen, të perspektivës në kuadër të një realiteti të ri të cilin deri më 17 shkurt kemi mëtuar ta bëjmë, më 17 shkurtë e kemi bërë dhe tani ky është realiteti i Kosovës, shteti i pavarur dhe sovran, dhe Qeveria hapë perspektiva pikërisht në kuadër të këtij realiteti që ta ndryshojë dhe avancojë atë.

Ajo çfarë është thënë gjatë fushatës, edhe po realizohet. Një ndër këto është transparenca. Filozofia e transparencës konsideroj se i ka dhënë shumë mundësi qytetarit për të përcjellë punën e Qeverisë, për të parë se sa po angazhohet dhe si po angazhohet. Në vendet me traditë demokratike mbledhjet e Qeverisë transmetohen përmes kanaleve të ndryshme televizive madje, madje jo vetëm të Qeverisë, por edhe të komisioneve parlamentare e të mos flasim për Kuvendin.

Kjo transparenca e Qeverisë ka bërë edhe një ose ka shkaktuar dhe një mundësi tjetër, që opozita që dëshiron të japë një kontribut, të mos mbajë pozita një nihiliste, por të detyrohet të kapë segmente të caktuara dhe të japë kontributin e vet, nëse asgjë tjetër, vetëm ky segment konsideroj se vërtet është reflektuar për të mirë.

Këtu ka edhe shumëçka për të thënë tjetër, por unë do të ndalem në tri dimensione. Dimensionin e parë do të klasifikojë, sipas mendjes sime, dy ministri që shërbejnë si mostra të suksesit, pa dashur për të lënë anash ministrinë e tjera, por me qenë se koha është e shkurtër, konsideroj se edhe këtu u shprehën mendime që Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Ministria e Transportit dhe Postë-telekomit janë mostra se si mund të dinamizohet veprimtaria dhe puna e Qeverisë në dikastere të caktuara.

Sa i përket Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, konsideroj përveç të tjerash, se eliminimi i shkollave konteinerë, ndërmarrja për licencimin e arsimtarëve dhe krijimi i Agjencisë për akreditim, krahas shumë të tjerave, janë ndërmarrje të cilat do ta dinamizojnë edhe jetën në arsim, por edhe do të eliminojnë defekte dhe mangësi të ndryshme.

Ndërkaq, sa i përket Ministrisë së Transportit dhe të Postë-telekomit, mua më vjen mirë se këtu një koleg i imi pati thënë se zoti Thaçi duhet t'i marrë fotografitë e autostradave dhe të fotografohet me to, se ato nuk do të bëhen. Tani të gjithë jemi dëshmitarë se kanë filluar të realizohen dhe kjo ka filluar të bëhet realitet, që do të thotë se kemi një qeveri e cila po përpaket në kuadër të buxhetit që e ka ta menaxhojë atë drejtë dhe të investojë për

të realizuar një pjesë të programeve që nuk janë, konsideroj, vetëm të qeverisë, por janë edhe aspiratë e gjithë popullit të Kosovës.

Ndërkaq, si mostër të ministrive që i presin sfida të mëdha me të cilat do të ballafaqohen dhe që kërkojnë të japin zgjidhje, unë do të klasifikoja këtu Ministrinë e Shëndetësisë dhe Ministrinë e Energjisë dhe të Minierave.

Ministria e Shëndetësisë kërkohet që mbi të gjitha ta korrektojë, ta përmirësojë menaxhmentin e vet në kuadër të të gjitha niveleve të tjera, sepse në të vërtetë këtu duket sikurse ka një lloj diskrepance ose derisa përpjekjet e ministrit me një qasje shumë të avancuar dhe që vërtetë premton, janë të mira, dikush i niveleve të poshtme përpiqet ta pengojë dhe të mos e realizojë këtë ndërmarrje. Unë do ta ilustruj këtë vetëm me rastin e specializantëve, ku janë bërë manipulime dhe, edhe unë si deputet, kam të dhëna nga një qytetare se ato janë manipulime që janë bërë dhe ministri dëshiron ta përmirësojë gjendjen, kurse administrata e brendshme po e pengon.

Ndërkaq, te Ministria e Energjisë dhe e Minierave konsideroj se alternativat të ofruara do të krijojnë mundësi që të dalim nga gjendja në mënyrë graduale. Të gjithë ata që kanë menduar se në afatin 3 mujor ose njëvjeçar do të arrihet të konsolidohet dhe përmirësohet gjendja me energji elektrike, konsideroj se dëshmojnë vetëm paaftësi për të parë realitetin dhe për ta njohur gjendjen ose e bëjnë në mënyrë tendencioze për të krijuar një opinion tek qytetarët se gjëja ka pasur mundësi Qeveria ta bëjë këtë për 3 muaj, por nuk ka dashur ose se po tenton të bëjë diçka tjetër.

Dhe, e fundit është lufta kundër korrupsionit. Konsideroj se Qeveria, në krye me zotin Hashim Thaçi, e pret ose pritet nga kjo sfida ku do ta fitojë betejën ose do ta humbë edhe betejën për një qeverisje të mirë krahas luftës kundër korrupsionit. Të jeni të bindur se të gjithë ne kemi kontakte me qytetarët dhe ajo që më së shumti i brengos është çështja e korrupsionit. Të gjithë e kuptojnë se buxheti është i limituar dhe nuk mund të bëjmë mrekullia, por atë buxhet që e kemi, ta menaxhojmë mirë dhe drejtë dhe të jetë transparent. Pikërisht këtu lidhet edhe transparenca e mbledhjeve të Qeverisë me atë që tregon se si po menaxhohen gjërat dhe jep mundësi, jo vetëm ne si deputetë, qoftë pozitivë, qoftë opozitivë, por edhe qytetari i rëndomtë ta vlerësojë, madje, madje, botimi i Programit dhe i Informatës së Qeverisë në gazetat ditore këtë transparencë veç ia ka afuar edhe drejtpërdrejt qytetarit, ekspertëve dhe shtresave të ndryshme që ta japin edhe ata kontributin e vet përmes formave të ndryshme.

Dhe, duke përfunduar, dua të them se zoti Kryeministër pati deklaruar që vërejtjet e drejta dhe me vend do t'i inkorporojë në Programin e Qeverisë. Për fat të keq, ne dëgjuam shumë kritika, kritika me karakter edhe nihilistë, ndërsa shumë pak alternativa ose mundësi që do të mundet Qeveria t'i inkorporojë. Do të kisha pasur dëshirë që opozita të dëshmohej duke ofruar alternativa, e jo vetëm përmes kritikës. Kritika është e shëndoshë kur bëhet me vend dhe e bazuar, pa fije dyshimi, por ka nevojë që ta luaj rolin e vet duke ofruar alternativa. Disa kolegë këtu vërtetë kanë dhënë një kontribut të denjë. Prandaj, duke përfunduar, konsideroj se Qeveria ka krijuar një bazë të mirë me këtë program, sikurse që e tha një parafolës, një program i cili i cakton vijat se kah do të ecet, por në kuadër të gjendjes që e kemi me limitin e caktuar të buxhetit, nuk ka mund të bëhet më tepër.

Unë uroj që kjo ecje e mbarë të vazhdojë dhe ne të kemi mundësi të diskutojmë për arritjet dhe jo për të tjerat. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, deputetit Hajdin Abazi! Fjalën e ka deputeti Eset Cakolli, le të përgatitet deputetja Sala Berisha - Shala.

ESET CAKOLLI: Faleminderit, zoti kryesues!
I nderuari Kabinet qeveritar,
Të nderuar dhe të respektuar kolegë deputetë,

Ne sot në Kuvendin e Kosovës po debatojmë për programin e Qeverisë për periudhën 2008 – 2011, i cili ka synim kryesor zhvillimin e gjithmbarshëm të Kosovës. Mirëpo, ky program nuk garanton një gjë të tillë nëse nuk bëhen plotësime dhe ndryshime të prioritetëve dhe studime të hollësishme profesionale në dikastere të ndryshme.

Sektori i energjisë elektrike është një nga sektorët që i shkakton pakënaqësi dhe probleme të shumta në jetën e përditshme sot qytetarit të Kosovës.

Sektorët më të rëndësishëm të KEK-ut duhet të riorganizohen, modernizohen dhe të investohet në ta me qëllim të sigurimit të mjaftueshëm të energjisë elektrike për nevojat e tregut dhe për konsumatorë.

Unë po përmendi vetëm një të dhënë. Këto ditë në komunën e Ferizajt janë hartuar projekte ideore vetëm për distribuim dhe transformim të energjisë, të cilat kapin shumë diku rreth 4 milion euro dhe janë vetëm për fazën fillestare, do të thotë, edhe pse do t'i kishim bërë këto investime, nuk do t'i plotësojnë të gjitha nevojat që ka sistemi i distribuimit dhe i transmisionit.

Vetvetiu shtrohet pyetja, sa mjete nevojiten vetëm për përmirësimin e rrjetit shpërndarës të energjisë në tërë territorin e Kosovës ku kemi parasysh gjendjen aktuale?

Unë mendoj se vendimi i Qeverisë për dhënien e koncesion të blloqeve A1 dhe A2 me kapacitete të fuqive aktive të gjeneratorëve me 65, respektivisht 120 megavat duhet përshëndetur, sepse aktivizimi i këtyre dy blloqeve do të ketë ndikim edhe në sektorin e prodhimit të linjitit dhe në sistemin e distribuimit të energjisë dhe kjo do të jetë një sprovë e madhe për të gjithë. Mirëpo, Qeveria duhet të definojë shumë qartë kushtet për dhënien e këtyre blloqeve me koncesion.

Unë mendoj se për një furnizim të sigurt dhe të qëndrueshëm të konsumatorit në Kosovë, rrjeti shpërndarës i energjisë duhet të lidhet sa më parë që është e mundur me sistemin energjetik të Shqipërisë me tension 400 kilovoltësh, me qëllim të këmbimit të energjisë në të dy drejtimet me humbje teknike minimale.

Në rrethanat aktuale, sot në KEK mund të prodhohen diku, mesatarisht të them, 700 deri 850 megavat orë energji, ndërsa nevojat e tanishme për energji elektrike janë shumë më të mëdha. Do të thotë, këto elektrana edhe po të punonin me kapacitet të plotë dhe pa ndërprerje, nuk mund t'i plotësojnë nevojat e konsumatorëve aktualë. Prandaj, lind nevoja për investime urgjente në kapacitete të reja prodhuese të linjitit dhe gjeneruese të energjisë me qëllim të sigurimit të energjisë kualitative për investitorët e mundshëm potencial që pritet të vinë pas zgjidhjes, respektivisht zgjidhjes së statutit të Kosovës.

Në Programin e Qeverisë janë paraparë disa strategji për daljen nga kriza dhe këto janë paraparë në tri faza ku, sipas mendimit tim, ndoshta nuk janë prezantuar në program ashtu si duhet në mënyrë detale.

Unë mendoj se në Programin e Qeverisë gjithashtu është dashur të përfshihet me një detal, me një program kështu më të detajuar, çështja e inkasimit të mjeteve financiare për rrymën e shpenzuar nga konsumatorët, kur kemi parasysh shkallën e inkasimit në nivel vendi.

Unë do të ndalem pak edhe në çështjen e arsimit. Programi i Qeverisë ka disa synime strategjike për përmirësimin e arsimit në të gjitha nivelet. Mirëpo, këto synime do të duhej të zërthehen më shumë dhe duhet që këto synime të garantohen me argumente në mënyrë që të ketë mundësi të implementohen dhe të krahasohen pastaj.

Gjendja materiale e punëtorëve të arsimit, si në arsimin fillor dhe të mesëm, jemi dëshmitarë në çfarë gjendjeje janë dhe është mirë që sa më parë të intervenohet me qëllim të përmirësimit në mësimdhënie dhe mësimnxënie në përgjithësi.

Ministria e Arsimit ka bërë disa hapa konkret për rritjen e hapësirës shkollore në nivel vendi, që duhet përshëndetur.

Por, unë mendoj se duhet bërë shumë edhe në këtë drejtim. Ministria e Arsimit ka bërë gjithashtu një punë të mirë, sepse Universitetit të Prishtinës i ka lejuar një autonomi më të madhe financiare, që unë mendoj personalisht se do të ketë ndikim pozitiv në punën e përgjithshme dhe në zhvillimin e Universitetit të Prishtinës.

Gjithashtu, mendoj se Ministria e Arsimit duhet të hartojë politika zhvillimore konkrete për të ngritur kapacitete të reja për punë hulumtuese, kërkimore dhe shkencore me qëllim të zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të Kosovës, prandaj duhet të ndahen fonde të veçanta për të mbuluar këtë fushë.

Gjithashtu, do t'i potencoj edhe disa çështje rreth bujqësisë dhe zhvillimit rural. Edhe sektori i bujqësisë është me rëndësi të veçantë për zhvillimin ekonomik të Kosovës. Mirëpo, në Programin e Qeverisë shumë pak i është kushtuar kujdes me masa konkrete stimuluese. Nga të dhënat statistikore shihet se 53% e sipërfaqes së përgjithshme në Kosovë janë të punueshme, me çka nuk mund të pajtohem pasi që thuaja 9 vite përafërsisht pas lufte vazhdimisht kemi humbur këtë sipërfaqe duke e shndërruar në tokë ndërtimore.

Fermeri ynë sot është i diskriminuar në raport me fermerët e rajonit. Këtë politikë duhet ndryshuar sa më parë në mënyrë që fermeri ynë të jetë i motivuar për të prodhuar. Që të arrihet ky synim, mendoj se duhet ndryshuar politikat doganore fiskale, subvencionet dhe politikat kredituese. Unë kisha përmendur vetëm politikat kredituese, për shembull, fermerët tanë shfrytëzojnë kredi me kamata diku 12 deri 13%, kurse dihet që profiti në prodhimtarinë bujqësore është i ulët. Prandaj, qeveria duhet të sigurojë fonde të veçanta për subvencione dhe forma të tjera të kreditimit të sektorit të bujqësisë.

Dhe, krejt në fund, dëshiroj që Programi i Qeverisë, pasi të plotësohet me vërejtje dhe sugjerimet nga ana e deputetëve të respektuar, të implementohet sa më mirë që është e mundur. Ju faleminderit, zotëri kryesues!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet Cakolli!

Fjalën e ka deputetja Sala Berisha-Shala, le të përgatitet deputeti Shkumbin Demaliaj.

SALA BERISHA – SHALA: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar zëvendëskryeministër, anëtarë të Qeverisë,

Të nderuar kolegë deputetë,

Gjatë këtij 100-ditëshit të qeverisjes Thaçi, jemi dëshmitarë të privilegjuar dhe s'mund ta mohojmë askush faktin se u menaxhua, u mbyll dhe u kurorëzua me sukses një kapitull i lavdishëm i rrugëtimit tonë historik, siç është kapitulli i pavarësisë së Kosovës.

Ky kapitull u shoqërua me hapa të qëndrueshëm në njohjen e pavarësisë së Kosovës, mandej miratimin e Kushtetutës si akt më i lartë politiko - juridik.

Të nderuar të pranishëm,

Duke u referuar disa kualifikimeve që u dëgjuan këtu në lidhje me Programin e Qeverisë, mendoj se cilësia, vlera e një dokumenti, përkatësisht programi nuk varet se sa rreshta, faqe apo shenja pikësimi ka, vlera e tij varet nga përmbajtja, e mbi të gjitha nga zbatueshmëria e tij.

Të gjitha këto që u thanë gjatë këtij debati dyditorë, kryesisht nga opozita, përveç një parafolësi më herët, zotit Arsim Rexhepit vërtet askush nuk u kujtua të thotë se në çfarë gjendje e mori pushtetin Qeveria Thaçi.

Unë do të ndalem pikërisht këtu. Qeveria e zotit Thaçi e ka të qartë situatën në të cilën e mori pushtetin.

Të nderuar të pranishëm,

Politikat e gabuara dhe qasja ndaj problemeve me inercion monist i ka kushtuar shtrenjtë ekonomisë së Kosovës, ka qenë fatale për të në çdo sferë, e sidomos në fushën e energjisë dhe të minierave. Pasojat nga këto politika i kanë bartur mbi supe, e po vazhdojnë ende t'i mbajnë qytetarët e Kosovës, prandaj edhe Qeveria nuk e ka të lehtë të bëjë riparime.

Të nderuar ish qeveritarë, sot një pjesë opozitarë, me lejoni t'ua përkujtoj disa nga pasojat me të cilat sot duhet të merret Qeveria, si dhe është bërë incizimi i gjendjes momentale të situatës që po e trashëgojnë. Për shembull, vendosja ose instalimi në pikat kyçe në Ministrinë e Energjisë, KEK, përkatësisht miniera e njerëzve tipikë klanorë, militantë partiak, apo edhe borxhli partiak, që synim parësor kishin biznesin individual e klanor. Mandej, udhëheqja e projekteve energjetike nga persona me konflikte të mëdha interesi, bordet e ndërmarrjeve publike kryesisht me përbërje politike, pjesëmarrës ministra e militantë partiakë. Zvarritja e bazës ligjore në veçanti për miniera, futja në privatizim pa bazë ligjore vetëm me rregullore të UNMIK-ut, kontrata tepër të dëmshme për ekonominë e Kosovës.

Ju lutem, ma gjeni vetëm një rast në rajon apo më gjerë ku ndodhë një gjë e tillë që të shfrytëzohen pasuritë minerale pa ndonjë obligim në kuptimin e taksave, tatimeve e tjera, s'besoj se ky fenomen të gjendet dhe në vendet e kolonizuara. Mandej, shkatërrimi gjer e mbyllje i minierave të linjitet, siç është rasti me Mirash dhe Bardh.

Fillimi i procesit për mbyllje e këtyre minierave pa studim, pa hulumtim shtesë gjeologjik, kur dihet se rrjeti i shpimeve hulumtuese ishte i kategorisë së paplotësuar e të papërfunduar në kuptimin e hulumtimit dhe të përcaktimit të rezervave gjeologjike dhe eksploatuese.

Filli i procesit për hapjen e minierës së re në një zonë të pastudiuar mirë, kur në të dy anët e minierave ekzistuese janë të vendosura të ashtuquajtura palosje, përkatësisht djerrina apo sterili, kjo dihet mirë nga profesionistët e minierave se çfarë pasojash mund të ketë.

E kuptojmë se hapja e minierës së re është e domosdoshme, sikurse edhe mbyllja e minierave që janë eksploatuar, por këta hapa do të duhej marrë pas studimeve të mirëfillta gjeologo – minerale, e jo me improvizime e projekte të kryera dekada më parë në kushte dhe rrethana krejt tjera. Nga eksploatimi pa kriter e jo profesionalizmi i tyre, ka ndodhur edhe fatkeqësi me pasoja në njerëz e dëme materiale. T’ua ju rikujtoj përmbytjen e një rotorit që kushton me milion euro, për të cilën gjë askush nuk ka shkua në përgjithësi. Përkundrazi, përgjegjësve u janë ndërruar vendet, janë avancuar në pozita më të larta menaxheriale.

Mandej, gjendja tepër e rëndë e ambienteve punuese të punëtorëve në mihje edhe termocentrale. Miliona euro të shpenzuara për rastin Hade, zhvendosja e banorëve, shkatërrimi i pronave dhe i tërë ekonomisë së tyre familjare pa kompensim, e gjithë kjo në emër të urgjencës së sigurisë. Zhvendosje pa studim të mirëfilltë të rastit, pa bazë ligjore, të gjitha me reflektime negative, me pasoja, iritim të qytetarëve ndaj institucioneve të Kosovës, e që vazhdojnë të mbeten barrë e kësaj Qeverie tani.

Në një situatë të ngjashme apo edhe më keq, qëndrojnë edhe minierat tjera, siç janë ato të plumb-zinkut, magnezitit, nontronitit, e tjera, që i janë nënshtruar ose privatizimit të egër, ose ngufatjes në kuptimin e funksionimit dhe presioneve të tjera. Të gjitha këto, gjatë mandatit tuaj ish qeveritarë dhe një pjesë opozitarë, u përcollën dhe u mbuluan medialisht me projektin e termocentralit Kosova C, projekt ky megaloman, i cili nga babëzia për t’i mbushur xhepat individë të caktuar, u shtyri ta inicioni dhe të bëni ndryshimin e ligjeve të energjisë në mënyrë që të formohet një i ashtuquajtur Komitet drejtues i projekteve energjetike, i përbërë nga njerëzit e politikës klanore, pa began profesional, të profesioneve gjithfarë, e asnjë për energjetikë. Ndryshimi në ligj edhe në kuptimin e kompetencave të këtij farë komiteti, e që ky projekt, fatbardhësisht, mori dhe vazhdon të marrë ndërkombëtarë edhe vendorë.

Të nderuar deputetë,

Kosova ka pasur edhe ka kapacitete njerëzore, fuqi profesionale dhe intelektuale për ta udhëhequr riaktivizuar dhe menaxhuar sistemin energjetik, profesionistë të cilët janë të gatshëm të punojnë me ndershmëri ka edhe në KEK, por kanë qenë të ngulfatur nga politika dhe parapolitika.

Jam e bindur se Qeveria e Kosovës, nën udhëheqjen e zotit Thaçi, do të arrijë t’i riorganizojë këto kapacitete njerëzore, profesionale, do të arrijë duke krijuar politikat e mirëfillta në sektorin e gjeologjisë dhe të minierave, respektivisht në sektorin e energjisë.

Të nderuar deputetë,

Qeveria Thaçi ka paralajmëruar të bëjë auditim në të gjithë mekanizmat e ndërmarrjeve publike, në KEK, në Aeroport, e tjera, dhe kjo është një gjë shumë e mirë, të mos pritet vetëm nga auditori gjeneral, por të bëhen auditime të pavarura.

Mirëpo, defekti i tërë kësaj Qeverie në këto 100 ditë është se është dashur të bëjë publike incizimin e situatës, identifikimin e problemeve, përkatësisht prerjen e gjendjes së qeverisur nga Qeveria e mëparshme, prerjen e zbatimit të projekteve kapitale, përqindjen e tyre, që qytetari ta dijë saktësisht se çka është punuar më herët, e çka dhe si po punohet tani. Unë besoj se Qeveria do ta bëjë një gjë të tillë edhe ne do të kërkojmë të bëhen pjesë debati në Kuvend, kështu do t'i ndihmohet edhe transparencës, mendoj.

Është shumë shpresëdhënëse dhe premtues ky program në fushën e minierave, se do të vendos rregull në këtë sektor. Më lejoni të citoj programin, kapitulli - sektori minierar, faqe 6, pasusi ku thuhet: “Qeveria do të angazhohet për rinegocimin e çdo kontrate të lidhur më herët që rezulton e dëmshme për Kosovën”. Të nderuar, kontrata të tilla gjen mjaftë në çdo segment, në energji, në miniera, në privatizim. Ua përkujtoj kontratën e KEK-ut me Feroniklin në lidhje me furnizimin me energji.

Mandej, dhënia e licencës për hulumtime në asetet e Trepçës një kompanie në të cilën ka edhe konflikt interesi, ngase personi, pronari i asaj firme ka qenë anëtar i Bordit të KPMM-së, ku me Rregulloren të UNMIK-ut 2005/3 u ndalohej veprimtaria në fjalë për një kohë të caktuar personave që merren me licencimin e asaj veprimtarie.

E dyta, sot në një gazetë ditore thuhet se janë zbuluar rezervat minerale të çmueshme të arit, të argjendit, e tjera, nga kjo kompani, çka s'është e vërtetë ngase ato hulumtime janë kryer më herët nga ajo pjesë. Fjala është për vendin e quajtur Çuka e Batllavës ose Drazhnja, ku gjëja tani kjo kompani ka zbuluar xehen. Kjo është pronë e minierave të Trepçës.

Një tjetër pasus në këtë program, e që është premtues, po në faqen 6, ku thuhet: “Qeveria do të synojë lidhjen e çmimit të burimit natyror apo produktet të nxjerrë prej tij me çmime në tregjet përkatëse”, kupto në bursë, shumë drejt.

Ndërsa, praktikat e Qeverisë që shkoi flasin të kundërtën, për të mos hyrë në detale të privatizimit, i cili u bë me Rregulloren të UNMIK-ut, dhe si i tillë, duke shkelur vetë procedurat tenderuese të kësaj Rregullore, por keqmenaxhimi i tyre vazhdoi edhe më tej jashtë këtyre rregullave. Për shembull, ende sot e kësaj dite shfrytëzohen minerale pa vendosur ndonjë taksë, edhe pse grupi punues ndërinstitucional ka hartuar skemat, tabelat që përcaktojnë përqindjen e mineraleve që duhet t'i paguhet buxhetit, si gjithkund në praktikat e vendeve të cilat caktojnë rojalt-in ose taksën mbretërore, si quhet ndryshe, kur bëhet shfrytëzimi i mineraleve të paripërtëritshme.

Grupi punues e ka kryer punën e vet, mirëpo çështja ka mbetur pezull ngase Bordi i Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale nuk e ka vënë në rend dite për ta miratuar. Vetëm mund ta merrni me mend se sa e ka dëmtuar Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës. Shihni çmimet e nikelit në bursë sot, e të tjera minerale, që të mos t'i përmend me radhë.

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Shkumbin Demaliaj, le të përgatitet deputetja, Nurishahe Hulaj.

SHKUMBIN DEMALIJAJ: Faleminderit, zoti kryetar!

Gjithë respektin për zëvendëskryeministrin dhe ministrat e Qeverisë së Republikës së Kosovës,

Të nderuar deputetë,

Ndoshta është bërë pasion në Kuvendin e Kosovës të fliten edhe kundërshtitë, sugjerimet dhe kritikën e opozitës apo çfarëdo deputeti që vijnë nganjëherë e që kundërshtojnë një diçka reale që mund të debatohet në Kuvend, po i marrin shumë afër zemrës dhe nuk po i marrin se mund të jenë një korrigjim apo një filtër që mund t'i kondensojë në të ardhmen ato që mund të konsiderohen të arritura të Qeverisë së Kosovës.

Vonesa e Programit qeverisës 2008-2011 nuk është hapi i parë i Qeverisë që ka rënë në vonesë, mirëpo ne edhe si deputet të Kuvendit të Kosovës kemi filluar punën një muaj pas certifikimit, pas 4 dhjetorit dhe vetëm në fillimin e këtij viti, diku më 4 janar kemi mbajtur seancën konstituive të Kuvendit, por këto vonesa mendoj se s'kanë shkaktuar ndonjë defekt të madh.

Mirëpo, rreth mundësisë se a është 100-ditëshi pozitiv apo rrethanat që mund të vijnë për pozitivitetin e këtij 100-ditëshi në kuadër të Qeverisë, duke lënë anash statusin e Kosovës, aprovimin e Kushtetutës, si dhe ngjarjet tjera që janë me zhvillim politik, besoj se ne nuk kemi pasur një mbështetje aq të madhe për të mund të bëjmë diçka më shumë lidhur me nxjerrjen e një artikulli më të thuktë rreth punës 100-ditëshe të Qeverisë së Kosovës.

Nisem prej kësaj, sepse edhe Ligjin mbi buxhetin e Kosovës e kemi kaluar shumë me vonesë dhe ato prioritete që kanë qenë lidhur me buxhetin dhe përshkallshmërinë e mundësisë së harxhimit të atij buxheti kanë mund të jenë shumë të prolonguara për shkak të vonesës së vetë aprovimit të ligjit mbi buxhetin që i ka krijuar ato defekte.

Duke përfshirë edhe shumëçka, duke u nisur që nga protokoli, do të thotë me rastin e shpalljes së pavarësisë dhe krijimit të shtetit më të ri, me popullatën më të vjetër në Evropën Juglindore që është Republika e Kosovës dhe në këtë program qeveritar që është për vitin 2008-2011 askund nuk shkruan fjala "protokoll".

Unë, në bisedë me ministrin e Punëve të Brendshme, shoqërisht kemi biseduar, askund nuk përfshihen shtylla të tjera, duke përfshirë atë se si shoqëri kosovare kemi kaluar në etapa të ndryshme transitive gjatë periudhës së okupimit, askund nuk përshkruhet departamenti i azilit apo si do ta quajmë në mekanizmat tonë institucional, duke kuptuar se jemi në epiqendër të shumë shteteve tash që na kanë njohur dhe mund të vijnë për të krijuar transfero të tjera ose dëshiron ndokush të vijë dhe në kuadër të një strehimi politik, që kërkon këtu, i pëlqen ndoshta të jetë edhe qytetar i Kosovës në të ardhmen. Do të thotë, neve këtë përshkallëzim nuk e kemi afruar afër vetes.

Te reformat e administratës, zoti profesor, zoti ministër – parashihen të gjitha. Është kompletimi i infrastrukturës ligjore për Shërbimin Civil të Kosovës. Unë nuk mendoj se mund të fillojmë me kompletimin pa nxjerrë ligjin bazik, sepse ende ky shërbim – Shërbimi Civil dhe të gjithë punonjësit e Shërbimit Civil ende punojnë me Rregulloren 2001/36 dhe ende nuk është ligji bazë.

Kur përmenda azilin atje, unë mund të përkufizohem edhe diçka, sepse ende askund në këtë program nuk përmendet diçka rreth çështjes së të huajve që sot veprojnë dhe punojnë në Kosovë, duke përfshirë biznese të ndryshme që vetëm sa te dera e Kuvendit ende nuk

na kanë çelur kinezët ndonjë biznes dhe nuk kemi një status të përkufizuar lidhur me punësimin e tyre dhe në kuadër të këtij punësimi përkufizohem në atë se puna dhe punësimi nuk përmenden askund në Programin e Qeverisë 2008-2011.

Programit, edhe tash e tutje i mungon gjithçka, sikur ndoshta ideja e Qeverisë nuk ka qenë, por duhet kuptuar se Qeveria për t'u konstituuar iu ka dashur një kohë e gjatë rreth mosmarrëveshjeve që ka pasur me kë do të hyjë në koalicion qeverisës. Shihet se edhe deputetët e pozitës e kundërshtojnë, shumë prej tyre më me ngulm se opozita nganjëherë programin qeveritar, për shkak se e kemi thënë edhe më hershëm se kjo lidhje është e panatyrshme, përfshirë këtu mundësinë se as kjo Qeveri nuk do të dalë ballëhapur e të merret me probleme të punonjësve dhe punëdhënësve të Kosovës, askund nuk e përmend implementimin e Marrëveshjes kolektive, punëtorët sindikalistë dhe Odën ekonomike që ne mendojmë se do të kemi ekonomi më të zhvilluar dhe më të avancuar. Këtë Marrëveshje nuk dëshiron ta çojë drejtpërdrejt për të mund të përkufizohen të arriturat e ardhshme, çka do të thotë se në shekullin e kaluar, edhe para një shekulli, shtetet e ndryshme e kanë tejkaluar këtë fazë.

Duke i munguar gjithë kjo, në Program mungon organizimi i Fondit pensional dhe invalidor, apo në qoftë se nuk kemi të drejtë ta organizojmë atë fond, kemi mund të bisedojmë rreth Trustit pensional, ku janë ato mjete dhe kur mendohet t'i kthehen Kosovës, që buxheti i Kosovës të menaxhojë me to, apo Ministria për Ekonomi e Financa, apo cilit resor i takojnë.

Në kuadër të kësaj, përmendet që do të implementohet sigurimi shëndetësor. Sigurimi shëndetësor nuk përfshin mundësinë e implementimit të ligjshëm, por duhet të krijohet fondi, sepse e dimë që shumë shërbyes civilë të Kosovës mandatin prej 6 muajsh, kur është rrezikuar shëndeti i tyre, ata kanë mbetur pa pagë bazë dhe askush nuk ka mund t'u sigurojë mbrojtje shtesë për shëndetin e tyre. Kemi pasur rastin me punëtorët e Shërbimit Policor të Kosovës.

Po ashtu, mungojnë edhe fondet tjera, që i kemi përmendur edhe më herët për mbrojtje të fëmijëve, sepse fëmijët e Kosovës ende edhe deri në 2011 duhet të shëtisin rrugëve. Është fjala për shtesat e fëmijëve, për mundësinë e krijimit të atij fondi që të fitojnë 1 apo 2 euro për të pasur mirëvajtje në shkollim edhe në rrethana tjera avangarde.

Në Programin qeverisës 2008-2011 askund nuk përmenden kategoritë e dala nga lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, çka do të thotë se as deri më tani nga Qeveria e Kosovës nuk ka pasur asnjë subvencionim lidhur me këto kategori, përpos një traktor që i ka ofruar atij shkaut të vogël Kryeministri do ditë përpara dhe s'di a janë ndjekur procedurat e prokurimit.

Flitet, dhe deputetët e pozitës e vlerësojnë si shumë pozitiv mundësinë e programit, kuptohet janë aktualisht në pushtet, janë pozitë, besojmë se bashkërisht edhe këto procese do t'i çojnë deri në fund, dhe flitet se Kosovën do ta anëtarësojnë në strukturat Euroatlantike. Mirëpo, jemi dëshmitarë se para 3 ditësh, Këshilli i Evropës kur debaton për mundësinë e anëtarësimit të Kosovës në Këshillin e Evropës, zotëri Dejvis thotë se, nuk kemi të drejtë ta shqyrtojmë këtë se Kosova ende nuk ka bërë kërkesë për t'u anëtarësuar në Këshillin e Evropës. Ky është ai pozitiviteti që nxjerrim para vetes se a është Qeveria e Kosovës duke shkuar hapave të sigurt në këtë drejtim.

Ne e kuptojmë se jemi deputetë të rinj në Kuvendin e Kosovës dhe subjekt i ri, mirëpo kemi mbaruar duke dëgjuar histori të së kaluarës në këtë Kuvend rreth mundësisë se kush ka bërë më shumë apo më pak. E dimë se vota e ka përcaktuar numerikisht kush mund të jetë sot në institucione të Kosovës, por në këtë rast po diskutohet shumë ashpër duke kërkuar lidhur me privilegjet. Një nga deputetët e pozitës tha se neve na vjen keq se i keni humbur privilegjet dhe po flitni për privilegjet e humbura. Unë besoj dhe e kundërshtoj një mundësi për të biseduar ashtu, sepse besoj që edhe kjo Qeveri nuk e konsideron privilegj të qenit në krye të institucioneve të Kosovës, por besoj se ka përgjegjësi të mëdha para qytetarëve të saj. Faleminderit, zoti Kryetar, duke mbetur me shpresë se do të inkorporohet diçka në Programin qeverisës nga të gjitha këto që janë bazike për rrjedhat e së ardhmes institucionale të Kosovës. S'do t'u marr kohë më shumë. Faleminderit shumë!

KRYETARI: Faleminderit, Demalijaj!

Fjalën e ka deputetja Nurishahe Hula. Më duket se është deputetja e fundit e lajmëruar për debat, pastaj fjala i kalon Qeverisë.

NURISHAHE HULAJ: Faleminderit, Kryetar i Kuvendit të Kosovës,
Zëvendëskryeministër,
Kabinet qeveritar,
Kolegë deputetë,

Ekziston arsyeja për të kontribuar me disa fjali për Programin e Qeverisë 2008 – 2011 me qëllim pozitiv dhe konstruktiv, me aksent të veçantë për shëndetësinë, duke konsideruar se edhe shëndetësia, sikurse edhe arsimi, është shtyllë e rëndësishme për qytetarët e Kosovës.

Është vullneti i mirë i Ministrisë së Shëndetësisë që të avancojë sistemin shëndetësor, por pa punë programore prioritare vështirë se mund të realizohet.

Strukturimi dhe përbërja e brendshme e Programit të Qeverisë së Republikës së Kosovës është i përgjithshëm më pak përmbajtësor, është i paraqitur me vija të trasha pa cekur afatet e realizimeve programore, afatshkurtra dhe pa indikatorë të konkretizimit, që kishin për të qenë më të prekshëm për qytetarët.

Që të jem më konkrete, konsideroj se është plotësisht e arsyeshme që shëndetësia të futet në grupin e prioriteteve programe me këto qasje.

Nën 1, krijimi i mekanizmave për të vënë në implementim Ligjin për fondin e sigurimeve shëndetësore, që shumë kolegë e përmendën sot këtu në debat, me të cilin sigurohet matja e shërbimeve shëndetësore, matja e resurseve personeli shëndetësor dhe matja financiare buxhetore për secilën organizatë shëndetësore, do me thënë, aq sa punon një organizatë shëndetësore, aq edhe buxhetohet.

Nën 2, gjithashtu është prioritet përcaktimi i normativave dhe standardeve në sistemin shëndetësor, të cilat janë shumë të kërkueshme dhe ende nuk janë të paraqitura dhe të definuara.

Nën 3, matja e implementimit të strategjisë shëndetësore, të ligjeve e të akteve nënligjore të cilat ekzistojnë dhe për të cilat është punuar shumë edhe në strategji edhe në ligje, por

sa janë të implementueshme, kërkohet dhe kërkohet personalisht që të vazhdohet të maten përmes programeve prioritare qeveritare.

Nën 4, sistemi i informimit shëndetësor kërkon investim, është një sistem bazik që rregullon sistemin shëndetësor, është një segment i marginalizuar dhe anë anën tjetër është shumë i rëndësishëm për evidentimin, mbledhjen, përpunimin, sistemin e të dhënave shëndetësore. Me këtë mundësohet analiza shëndetësore dhe orientimet zhvillimore të mëtejme të sistemit shëndetësor.

Nën 5, Praksa private shëndetësore gjithashtu kërkon përkrahje programe, kontroll dhe mbikëqyrje në baza ligjore. Ekziston ligji për praksën private, sa është i implementueshëm të matet gjatë periudhave të ardhshme të programit qeveritar.

Do t'i ceki dy indikatorë të rëndësishëm që janë të përfshirë në program. 30 deri 40% papunësi dhe 35 deri 40 promilë vdekshmëri e foshnjave në 1000 lindje gjallë. Zvogëlimi i tyre bëhet vetëm me investim prioritar programor, që në afate kohore maten për të pasur informatë se a janë zvogëluar apo kanë mbetur në nivel të njëjtë. Do me thënë, sa do të jetë dinamika e zhvillimit të këtyre indikatorëve në 2009, në 2010 dhe 2011, a do të jetë në 2009 20% papunësia, a do të jetë 16 promilë vdekshmëria e foshnjave në 2009 apo në 2010.

Dhe, në fund, mund të them se vetëm me afatet të matshme kohore të realizimeve programore mund të bëjmë ofrimin zhvillimor dhe mirëqenien më të avancuar për qytetarët e Republikës së Kosovës.

Kërkoj dhe për këtë e kam marrë fjalën dhe jam paraqitur, kërkoj nga Qeveria që të marrë në konsideratë shqyrtimin edhe njëherë të shëndetësisë për ta vënë në grupin e prioritetëve programore nacionale. Njëkohësisht, të mendojë për rritjen e pagave të personelit shëndetësorë të Kosovës. Ju faleminderit!

Diskutim i bashkangjitur

MIMOZA AHMETAJ: I nderuari Kryetar,
Kabinet qeveritar,
Të nderuar deputetë,

Nga ajo që u tha deri më tash nga deputetët e opozitës, do të kisha thënë se toni i lartë dhe arrogant që deputetët e kanë përdorur, nuk është argument bindës për ta kundërshtuar programin qeveritar dhe punën e deritanishme të Qeverisë.

Aq më parë, kur dihet se Qeveria e kaluar de facto dhe de jure ka instaluar nepotizmin, krimin e organizuar, papërgjegjësinë ekonomike, politike e kombëtare, e që sot ndihet komot në këtë Kuvend dhe flet sikur ata të kishin bërë mrekullitë e botës. Me këtë taktikë të opozitës, me dashje apo pa te, fitohet përshtypja sikur opozita kërkon ta fsheh kaosin e lënë prapa.

E drejta e fjalës nuk do të thotë edhe manipulimi i saj. Mirëpo, pozita ju garanton se ligji dhe përgjegjësia institucionale do të funksionojë dhe Kosova bashkë me qytetarët e saj do ta ndjejnë efikasitetin e Qeverisë dhe suksesin e saj në të gjitha sferat e jetës.

Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës përfshinë të gjithë sektorët që kanë të bëjnë me zhvillimin dhe përparimin e Republikës së Kosovës në të gjitha sferat e jetës, prandaj mendoj se, si i tillë, duhet të pranohet në mënyrë që ne t'i hapim rrugë Qeverisë për punë konkrete.

Qeveria me programin e vet do të ofrojë stabilitet, siguri duke qenë e sigurt në mundësitë dhe potencialet e saj për të drejtuar shtetin.

Qeveria e Republikës së Kosovës është e vendosur që të ofrojë një politikë të përgjithshme, të pjekur dhe transparente që do ta shpie Kosovën drejt një rritjeje të shpejtë dhe të qëndrueshme ekonomike, drejt një ambienti të qetë dhe të sigurt për të gjithë qytetarët.

Duke marrë për bazë nivelin e lartë të papunësisë që arrin mbi 40% dhe varfërinë e skajshme deri në 15%, bëhet e qartë se një ndër prioritet themelorë do të jetë zhvillimi ekonomik i vendit.

Gjithashtu, energjetika, shfrytëzimi i pasurive natyrore, mineralet dhe turizmi do të jenë pikat kyçe që kjo Qeveri do t'i vejë në funksion për ngritjen e mirëqenies së qytetarëve të vet.

Infrastruktura rrugore dhe hekurudhore janë, po ashtu, shtyllat themelore të cilat Qeveria do të synojë t'i ngrejë në përputhje me standardet evropiane që të jenë bartëse të zhvillimit ekonomik, si dhe do t'u kontribuojnë investimeve me interes kombëtar, gjeopolitik dhe gjeostrategjik.

Jo më pak i rëndësishëm do të jetë edhe arsimi, ndërtimi i hapësirave të reja shkollore dhe rinovimi i hapësirave ekzistuese që tashmë janë evidente në vendin tonë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Tani nuk ka më të paraqitur për diskutim, është mbyllur debati lidhur me këtë pikë. Fjalën e ka Enver Hoxhaj, ministër i Arsimit. Pasi ai hoqi dorë nga fjala e tij, fjalën e ka zëvendëskryeministri Hajredin Kuçi.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, zoti Kryetar!
Të nderuar deputetë,
Të nderuar anëtarë të Qeverisë,

E di që nuk është shumë familjare të flitet shumë gjatë tash, por do të mundohem të rrumbullakoj qëndrimin e Qeverisë për këto debate që i bëmë gjatë dy ditëve.

Fillimisht, me një marrëveshje me anëtarët e Qeverisë u morëm vesh që unë të diskutoj, ndërsa kjo nuk do të thotë që vërejtjet dhe sugjerimet tuaja nuk i ka marrë secili ministër, veç e veç.

Dua t'ju falënderoj të gjithë deputetëve të Kuvendit të Kosovës për këtë debat, me cilin keni treguar se pozita dhe opozita domosdo nuk janë miq, dhe domosdo nuk janë edhe armiq.

Ne kemi vënë në debat në këtë Kuvend Programin qeveritar me një arsye, që t'i marrim vërejtjet sugjerimet, propozimet tuaja, ta përmirësojmë këtë program dhe ta fitojmë

pronësinë e Kuvendit të Kosovës mbi këtë program. Unë jam i bindur se ka pasur vërejtje dhe sugjerime të mira, ka pasur angazhime të cilat e kanë bërë më cilësor dhe Qeveria e Kosovës me këtë program që nga sot ndihet më mirë.

Sinqerisht mund të them se vërejtjet dhe sugjerimet kanë ardhur nga të gjitha anët dhe kanë qenë të mira. Unë, personalisht po e them se kemi angazhuar në emër të Kryeministrit edhe stafin tonë si Qeveri, por edhe të gjithë ministrat, veç e veç, që të mbajnë shënime, por do ta marrim edhe transkriptin nga Kuvendi i Kosovës dhe do t'i shkojmë të gjitha diskutimet tuaja dhe me kujdes do t'i bartim në Programin qeveritar.

Ky program që kemi ofruar sot është program i fuzionuar me kujdes nga Partia Demokratike e Kosovës dhe Lidhja Demokratike e Kosovës dhe sot, edhe me sugjerimet tuaja, me propozime tuaja, ka marrë edhe një cilësi të re edhe të Kuvendit të Kosovës dhe nga sot mund ta quajmë se është Program i Qeverisë së Republikës së Kosovës, e cila mëton që të shërbejë për të gjithë qytetarët e Kosovës.

Ne kemi bërë një Program, i cili, në shikim të parë ndoshta duket vizion, duket ndoshta strategji, por them është një program i zbatueshëm, është i mundësive buxhetore, i kapaciteteve tona edhe si një njerëz, edhe si vend, dhe mund të them, mbi të gjitha, është real dhe jo iluzionist. Ne mendojmë se pas 17 shkurtit në Kosovë ka vend për iluzione dhe për improvizime. Në këtë drejtim kemi ofruar edhe programin e tillë.

Nëse më lejohet një vlerësim, paksa personal do ta bëj, edhe si Qeveri. Kemi vërejtur tri lloj vërejtjesh apo vlerësimesh, do t'i quaja më mirë vlerësime. Vlerësimet e para dhe të shumta dhe të mira janë përmbajtjesore. Vlerësimet e dyta nga gjithë deputetët, s'po dua ta bëjë ndonjë përjashtim, që kanë ardhur edhe përmbajtjesore por edhe të dytat janë vlerësime që kanë premisa pak sa personale dhe kanë qëndrim refuzues. Qeveria e Kosovës nuk ka qëndrim refuzues, as mohues ndaj askujt, sikurse edhe nuk ka qëndrim pranues me ata të cilët nuk ka përafrim, do ta thosha, në kuptimin konceptual. Dhe, vlerësimet e treta kanë entuziazëm. E kuptoj atë entuziazëm, me siguri e kanë bërë deputetët që janë në pozitë, por nga pak nga inercioni prej reagimit të opozitës. Të tri vlerësimet i vlerësojmë lart dhe unë, do të më lejoni që të ndalem pak në vlerësimet përmbajtjesore.

U përmendën shumë fusha dhe shumë segmente dhe unë, më lejoni që të them, të koncentrohem në disa prej tyre.

Që në fillim dua të filloj nga opozita. zoti Makolli i dha disa vërejtje të mira, ndër të tjera ofroi edhe projekte që i ka partia e tij dhe i afroi për Qeverinë. E falënderojmë shumë dhe e lusim që ato projekte t'i sjellë në Qeverinë e Kosovës, i premtoj që do t'i shqyrtojmë me kujdes dhe nëse nuk janë në dallim me politikat konceptuale që i kemi ne si Qeveri, do të thotë Partia Demokratike dhe Lidhja Demokratike, dhe nëse ka mundësi buxhetore dhe partnerët tjerë të koalicionit ne do t'i pranojmë me kënaqësi, por ka projekte të cilat konceptualisht na dallojnë me të tjerët.

Unë po bëj pak shaka, që t'ju relaksoj. Zakonisht, meshkuj kanë qenë më konstruktiv në kuptim e vërejtjeve, ndërsa femrat pak më reaguese. Me siguri e keni ditur që ne nuk reagojmë ndaj diskutimeve të femrave. Por, ne kemi pasur edhe disa vërejtje që kanë ardhur edhe nga deputetët e pozitës, qoftë të Partisë Demokratike të Kosovës, qoftë të Lidhjes Demokratike të Kosovës. Edhe kritikata që janë bërë, nuk i konsiderojmë mohim të Qeverisë, por edhe vërejtjet që janë bërë nga opozita se konsiderojmë që janë mohim i

Qeverisë, janë qëllim për të rregulluar më mirë. Disa kanë bërë vërejtje për shkak se kanë qenë në dikasterin e mëhershëm dhe i kuptojmë dhe i pajtojmë plotësisht. Disa kanë bërë vërejtje për shkak të pozicionit personal momental dhe disa kanë menduar se mund ta rrisin cilësinë. Të tri këto vërejtje i kemi shqyrtuar me kujdes dhe po e them me sinqeritet, këto vërejtje kanë ndikuar dhe ndikojnë, me përjashtim të disa vlerësimeve personale.

Vlerësime personale, kushdo që i ka bërë, në cilindo krah politik që i ka bërë, për Qeverinë e Kosovës nuk do të jenë pjesë e programit ose e punës sonë. Në anën tjetër, mendoj se ka pasur vërejtje që u përmendën edhe nga zoti Maloku, janë përmendur të premten. Unë ia marrë për guxim politik zotit Maloku që vërejtje të ngjashme ka dhënë edhe kur ka qenë zoti Dugolli ministër i Tregtisë dhe i Industrisë, ka pasur edhe debat publik dhe po ju premtoj publikisht, do t'i marrim parasysh ato vërejtje.

Në anën tjetër, ne kemi pasur vërejtje në fushën e kulturës, që i dha zoti Hamiti, i dha me të drejtë profesori. Besoj që këtu i kemi dy qasje, qasja që të ndihmohet kultura aktuale në Kosovë, dhe qasja që kërkohet nga ne që kultura ose segmente të caktuara të kulturës të jenë si profitabile, pasi ende s'kanë mund t'i marrin këmbët, nëse më lejohej ta them kështu, të jenë profitabile. Ne do të jemi të kujdesshëm ta bëjmë një zgjidhje të ndërmjetme, ngase mundësitë buxhetore në Kosovë nuk lejojnë që të bëjmë ndonjë film shumë me rëndësi, por mendoni 9 vite pas lufte, ne nuk kemi ende ndonjë film që mund të lavdërohem për vendin tonë ose ndonjë botim të veçantë.

Ne kemi marrë vërejtje edhe nga zoti Shatri dhe nga të tjerët. Unë i lus të gjithë deputetët e Kuvendit të Kosovës, në veçanti deputetët e pozitës, të bashkëpunojnë me ministrat. Unë ju premtoj që ministrat e kanë derën hapur për ju, për gjithë deputetët dhe janë të gatshëm t'i pranojnë vërejtjet dhe sugjerimet tuaja.

Zoti Bukoshi i përmendi, ndër të tjera, dy gjëra. Qeveria e Republikës së Kosovës nuk e mohon asnjë aktivitet, asnjë kontribut të askujt, nuk e mohon asnjë datë, asnjë aktivitet, as tuajin, as të Qeverisë së Republikës së Kosovës nga viti '90 e më tutje, ajo është pjesë e historisë sonë. Kuptimi legal juridik është çështje tjetër si do të flitet në të ardhmen. Kuptimin e historisë askush s'do të mund ta mohojë. E përmendi që duhet ta vëmë rendin dhe ligjin prioritet. Është e vërtetë. Bile në fjalorët tonë nganjëherë duket se është stërmadhuar kjo. Por, e them me sinqeritet, që rendi dhe ligji do të jetë prioritet i prioritetëve. Të gjitha këto prioritete, nëse nuk do të ketë rend dhe ligj, unë ju premtoj se nuk do të ketë mundësi që të zbatohen në vendin tonë.

Unë jam i bindur se këtë do ta kem parasysh ministrat, në radhë të parë, Kabineti qeveritar dhe të gjithë të tjerët.

Zonja Hulaj, zonja Novobrdaliu përmendën edhe për arsimin, edhe për shëndetësinë. Te sigurimi shëndetësor na duhet edhe pak kohë, besoj që e dini, arsyeja e parë është që duhet të fillojmë shkallë, shkallë. Nuk kemi mundësi, në radhë të parë, për kategori sociale që e përmendi edhe zoti Demaliaj, që janë të përfshira gjithsesi në program, dhe nuk kemi mundësi t'i përfshijmë të gjithë, por si pilot-projekt, ju premtojmë që do të fillojmë.

Ish ministri Agim Veliu përmendi segmente të theksuara në fushën e arsimit, dhe unë besoj që strategjitë, jo vetëm të Ministrisë së Arsimit, ky program është i ndërtuar mbi strategjitë e qeverive paraprake dhe ne nuk e kemi mohuar në tërësi, por na është dhënë e drejta t'i rishikojmë disa ose disa projekte të theksuara t'i ndalojmë.

Në këtë vazhdë janë edhe diskutimet për Kosovën C. Kosova C nuk është projekt që ne e ndalim. Kosova C është projekt që ne do ta vazhdojmë, është projekt që ne do ta mbikëqyrim, do ta bëjmë pa dilema, me transparencë. Ky është qëllimi ynë dhe ky është edhe aduti ynë, por ne na është lejuar dhe kemi menduar që të bëjmë edhe strategji alternative, si: energjinë me ujë, energjinë me erë, energjinë solare, nëse ka mundësi, por çdo mundësi ta shfrytëzojmë që e ka Kosova në mënyrë që ta kemi mundësinë që të plotësojmë atë që ne e kemi quajtur mandator ose premtim mandator.

Unë e di se janë përmendur, edhe zoti Beqiri e përmendi, fushën e planifikimit hapësinor. Me ligj është e obliguar dhe unë premtoj se Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor ose do t'i nxisë komunat, ose do ta bëjë një veprim të tillë vetë, do të thotë që njëra prej mënyrave duhet të jetë.

U përmend zonja Morina, u përmendën dhe të tjerët, duket që shëndetësia, arsimi e kështu me radhë, edhe zoti Smaka pati të drejtë për gjuhën juridike, do të thotë, nuk i lejohet ekzekutivit të thotë në kohën e ardhme, por më shumë duhet në gjuhën ekzekutive, gjuhën juridike edhe pse ky fjalor kështu duket pak i vrazhdë, por ekzekutivi e ka këtë mandat.

Normalisht që energjetika është problemi kryesor në Kosovës. Mendoj që strategjia që është miratuar në Kuvendin e Kosovës, hapat e parë që janë ndërmarrë, por po e them të gjithë hapat e mëdhenj në Kosovë që kanë të bëjnë me koncesionin, me energjetikën, me privatizimin, do t'i bëjmë në mënyrë shumë transparente, në procedura legale dhe për të gjitha do të njoftoheni me kohë dhe të gjitha të parapara me ligj, po ju premtoj, do t'i vëmë në votim në Kuvendin e Kosovës. Nuk është qëllimi ynë ose mandati ynë që të bëjmë diçka jashtë jush, e aq më pak jashtë qytetarëve të Kosovës.

Unë e di se u përmend anëtarësimi në mekanizma ndërkombëtar, njohja. Ka ekzagjerime në këtë drejtim, nuk është në dorën tonë. Ne duhet të jemi shumë sinqertë, nuk ka njeri në Kosovë, e aq më pak nëse ka një pozicion institucional, që nuk e dëshiron njohjen të secilitdo shtet, përfshirë edhe Serbinë. Në këtë drejtë besoj kemi bërë aktivitetet dhe po bëhet. Aktivitetet tona nuk janë shumë të zhurmshme, janë koordinim edhe me miqtë ndërkombëtarë dhe këto aktivitete nuk po ndalen. Por, po e them realisht, fuqia jonë nuk është që të ndikojmë fuqitë e mëdha botërore. Ndoshta dikush tjetër ka ndikuar në Senegal para se ne të ndikojmë që të na njohë Senegali. Mendoj që këtë strategji duhet ta vazhdojmë. Bile, nëse ka diçka për t'u lavdëruar Kosova, unë e them, orientimi, mos të hyjë shumë në histori, i luftës së Skënderbeut, orientimi në fjalorin e gjuhës shqipe, në fjalorin latin dhe orientimi politik e ushtarak 1990-1999, janë orientime më të mira properëndimore dhe këtu s'ka dilemë askush, as pozita, as opozita.

U përmendën edhe disa mundësi për legjislacion. Unë po e them që është shumë e vërtetë që ne i kemi trashëguar disa ligje, dhe është e vërtetë që 24 prej tyre i kemi dërguar në Kuvend. Është shumë e vërtetë që janë dërguar edhe 26 të tjera, dhe është shumë e vërtetë që ky Kuvend, me punën tonë, bashkërisht me tuajën, ka miratuar për tremujshin e tij 50 ligje. Nuk dua t'i mati ose t'i krahasoj me legjislaturat e kaluara, por duhet të them se ka qenë intensiteti i lartë, por kjo çka...

KRYETARI: Regjia, le t'i vazhdohet fjala!

Faleminderit! Miratimi i ligjeve është orientim politik i yni, filozofi politike e Qeverisë dhe e Kuvendit, ndërsa hartimi i tij është punë e ekspertëve. As nuk dua ta lavdërojmë Qeverinë paraprake, as këtë Qeveri që e ka hartuar ligjin. Orientimet politike po, edhe të legjislacionit.

Unë, çka dua të them, gjithë këtë program qeverisës, gjithë punën tonë do ta bazojmë shumë, qind për qind në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, në ligjet e nxjerra nga ky Kuvend që janë në fuqi dhe ato që do t'i nxirrni ju në të ardhmen. Veprimet tona do të jenë legale, duke u angazhuar gjithmonë, jo vetëm në ju, që jeni si Qeveri, po u them anëtarëve të mi, por në ju, në mbështetjen tuaj si deputetë të Kuvendit të Kosovës dhe të secilit qytetarë, përfshirë edhe shoqërinë civile. Në veçanti, do t'i bëjmë kërkesë secilit shërbyes civil. Ky program është një letër, nëse shërbyesit civil nuk punojnë. Ne s'kemi bërë angazhime në kuptimin e presionit ndaj shërbyesve civil. Të gjithë jemi të vetëdijshëm që shërbyesit civil kanë kryer një punë të mirë, janë profesionale, por të gjithë pajtohemi që ka nevojë të ngritët më shumë. U përmend edhe reforma në administratë. Ne e kemi nisur një projekt, rishikimin e funksionimit administrativ dhe me këtë projekt deri kah shtatori do ta dimë gjendjen ku e kemi, ndërsa në të ardhmen e afërt, me siguri që do të bëjmë angazhime shtesë.

Unë, duhet të them, që të mos i mbetem borxh zotit Brajshori, që e përmendi rishikimin për kulturë, rini dhe sport. Po premtoj se do ta bëjmë një gjë të tillë dhe ju ftoj që të takoheni. Mementalisht është zëvendësministria, por brenda dy-tri ditësh do të jetë ministër zoti Valton Beqiri, besoj që me kompetencë do ta bëjë një gjë të tillë. Ju jeni nga ajo fushë dhe lirisht mund të vini dhe të bashkëpunojmë.

Unë, krejt në fund, duhet ta them një gjë. Për Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe për ju, deputetë të nderuar, legjitimiteti nuk buron vetëm ditën që fitohet vota. Për ne është legjitimiteti që të qeverisim në përputhje me vullnetin e qytetarëve të Kosovës, në përputhje me vendimin dhe vullnetin që e keni ju, deputetë të nderuar. Dhe, krejt në fund, ju faleminderit për kontributin, për angazhimet, për durimin që e keni pasur dhe po e them që Qeveria po ndihet më mirë me sugjerimet dhe vërejtjet tuaja.

Programi do të jetë i qytetarëve të Republikës së Kosovës. Ne do të mundohemi ta menaxhojmë bashkërisht me ju, nën mbikëqyrjen tuaj dhe të qytetarëve dhe, në fund të fundit, mateni punën tonë mbi bazën e atyre që i kemi plotësuar me këtë program. Ju faleminderit!
(duartrokitje)

KRYETARI: Ju faleminderit, zoti zëvendëskryeministër Kuçi!

Deputetë të nderuar, ju falënderoj për kurajën tuaj për të diskutuar dhe për të debatuar për Programin e Qeverisë. Besojmë që Qeveria do të ketë parasysh gjithë atë që është thënë gjatë këtyre dy ditëve në Seancën plenare për Programin e Qeverisë së Kosovës. Ju njoftoj se konform Rregullës 22 të Rregullores së Punës së Kuvendit, po e lexoj pikën nën shkronjën (g): “Në fund të diskutimeve, propozuesi i Projektligjit, pos mocionit përmbajtësor, ka të drejtë të përgjigjet, e pastaj Kryetari i Kuvendit mbyll diskutimin”.

Bazuar në këtë, unë, pas fjalës së zëvendëskryeministrit, e mbyll debatin dyditor për Programin e Qeverisë së Kosovës.

Ju faleminderit dhe mirë u pafshim në seancën e ardhshme!

Përgatiti: Njësia e Transkripteve